

Razi Brahim

# VEPRA DHE PROFILE KRIJUESE

STUDIME  
DHE ARTIKUJ  
PËR LETËRSINË



... Sn. Musaraj, Dh. S. Shuteriqi,  
Z. Sako, J. Xoxa, A. Abdihoxha,  
D. Agolli, I. Kadare, F. Arapi,  
Dh. Xhuvani.

SH  
1382

SSH  
1382

RAZI BRAHIMI

VEPRA  
DHE PROFILE  
KRIJUESE

•  
STUDIME DHE ARTIKUJ  
PËR LETËRSINË  
•

...Sh. Musaraj, Dh. S. Shuteriqi,  
Z. Sako, J. Xoxa, A. Abdihoxha,  
D. Agolli, I. Kadare, F. Arapi,  
Dh. Xhuvani...

BIBLIOTEKA E RRETHIT

CHIROKASTER

NR 49607

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## VEPRA LETRARE E SHEVQET MUSARAJT

Shevqet Musaraj është një prej shkrimtarëve të parë e më të shquar të letërsisë sonë të realizmit socialist. Gjatë afro gjysmë shekulli ai ka ndjekur hap pas hapi historinë, jetën e popullit, ka njohur shpirtin e masave, hallet e brengat, luftërat e fitoret, ka marrë pjesë gjallërisht në veprimtarinë për realizimin e idealeve patriotike, demokratike e socialiste, në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe në punën për ndërtimin e socializmit në Shqipëri. I edukuar me idetë dhe idealet patriotike antiimperialiste të Luftës së Vlorës, me fjalën dhe veprën revolucionare të Halim Xhelos me shokë, ai u gatua që në fëmijëri ta shihte jetën me syrin e fshatarit të varfër, atdhetar e luftëtar, të depërtonte dalëngadalë në kontradiktat e kohës, të mbante gjithnjë më me siguri anën më të përparuar të lëvizjes shoqërore, mendore e letrare të viteve 1930-1940. Në këtë kohë, ndonëse pa ndonjë veprimtari të gjerë letrare, ai u rendit me letrarët më përparimtarë e realistë dhe në krijimet poetike shprehu, herë me aludime e herë ca më hapur e më me guxim, brengën e atdhetarëve të papërfillur prej atyre që kishin forcën dhe pasurinë në dorë, urrejtjen për imperialistët italianë që mbanin të pushtuar Sazanin dhe përgatitnin robërimin e Shqipërisë, shprehu hallet e bujkut dhe ëndrrat e brezit të ri që aspironte një jetë të re. Një pjesë e mirë e ciklit «Vjershat e sirtareve», poema «Bujku i Hanko Hallës» dhe vjersha «Vajto, vëlla», që mbyll fazën e parë të krijimtarisë letrare të Sh. Musarajt, dëshmojnë se ai u shkëput nga ndikimi

i poezisë së rëndomtë të kohës dhe u vu në rrugën e sigurt të lidhjes me popullin. Kjo spikati në orientimin tematik të shkrimeve dhe në përpunimin e gjuhës poetike.

Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare, në të cilën Shevqet Musaraj mori pjesë vepruese dhe jetoi ngjarje të rëndësishme, puna si një ndër drejtuesit e organizatës së Partisë të Tiranës, përforcuan frymën revolucionare të krijimtarisë së tij dhe e ngritën në nivel të ri ideoartistik. Kjo është faza e pjekurisë ideologjike e artistike të shkrimtarit, kur ai përcakton përfundimisht rrugën e vet në jetë e në letërsi dhe krijon vepra, si poemën satirike të ashmë popullore «Epopeja e Ballit Kombëtar», përshkrimin «Shteg më shteg me partizanët e Divizionit të Parë Sulmues» dhe disa tekste këngësh partizane.

Në vjetët e Luftës, për t'iu përgjigjur flakë për flakë problemeve të kohës dhe ngjarjeve të rëndësishme, që ndiqnin njëra-tjetrën me shpejtësi, Shevqet Musaraj iu kushtua shkrimeve publicistike, shumica e të cilave u botuan në shtypin e Partisë («Zëri i popullit», «Kushtrimi i lirisë», «Bashkimi» etj.). Ndër to ka shkrime që zënë vend me rëndësi në traditën e publicistikës sonë, siç janë përshkrimi që u përmend dhe pamfleti «Dje dhe sot».

Bashkëpunimi veprues me shtypin e Luftës Nacionalçlirimtare, për krijimin dhe botimin e të cilit ai dha ndihmë të çmuar i çeli shkrimtarit një fushë të re veprimtari dhe shërbeu si shkollë e vërtetë e trajtimit të materialit të ri jetësor, e shprehjes së frymës inilitante dhe e përpunimit të shprehjes letrare në prozë. Veprimtari publicistike Shevqet Musaraj e vazhdoi edhe më vonë me përshkrime, reportazhe, artikuj e kujtime. Kjo veprimtari ka lënë gjurmë në stilin e tij si prozator, në sensin e mprehtë politik, në vërtetësinë jetësore të situatave e të episodeve, në saktësinë e shprehjes, në konkretësinë e tipave e të mjediseve, në qartësinë dhe thjeshtësinë e frazës.

Vjetët e Luftës Nacionalçlirimtare ishin dhe për shkrimtarin shkollë e madhe dhe provë e vështirë, burim

i një materiali të pasur për veprimtarinë e mëvonshme letrare. Autori u lidh aq ngushtë me këtë epokë nga më të lavdishmet e historisë sonë, sa që në çdo vepër të tij do të gjejmë jehonën e asaj kohe dhe frymën e vazhdimësisë së idealeve të saj në punën e përpjekjet e njerëzve tanë sot.

Veprimtaria letrare e periudhës së Luftës Nacionalçlirimtare e bëri Shevqet Musaraj një prej pionierëve të letërsisë së re të realizmit socialist. Me punën e vet të palodhur e me qëndrimin konsekuent, bashkë me shkrimtarë të tjerë të dalë nga Lufta, ai ka dhënë ndihmesë të çmuar për zbatimin e vijës së Partisë dhe të mësimëve të shokut Enver Hoxha në fushën e letërsisë e të arteve, për demaskimin e prirjeve devijatore në letërsi, për përkrahjen e talenteve të reja, për vlerësimin e drejtë të traditave letrare të së kaluarës, për forcimin e partishmërisë proletare e të fizionomisë kombëtare popullore të letërsisë. Shoku Enver Hoxha në letrën që i dërgoi shkrimtarit me rastin e 70-vjetorit të lindjes, e cilësoi atë: «*krijues i talentuar e i papërtuar, optimist e kurdoherë gjithë humor. Vepra jote e çmuar është she-mbull i partishmërisë së lartë e i frymës popullore nga e cila kanë mësuar e do të mësojnë brezat e rinj të krijuesve tanë*». (Drita, 25 nëntor 1984).

Megjithëse Sh. Musaraj shkroi edhe ndonjë vepër të re poetike (poema satirike «Do bëhen zgjedhjet»), në krijimtarinë e tij të periudhës së Pasçlirimit zotëroi proza. Ai u shqua si publicist dhe tregimtar, më pas lëvroi tregimin e gjatë, novelën e, në fillim të viteve '60, iu kushtua romanit. Këtë ecuri e shohim në radhën që ndjek botimi i veprave të tij: «Të shkuara, të pahirruara», «Llaz Qesarati», «Isha unë, Çobo Rrapushi», «Para, agimit», «Dritë»\*) Tematika e tyre përfshin periudhën e Luftës Nacionalçlirimtare, shndërrimet revolucionare në jetën e vendit e në ndërgjegjen e njerëzve.

---

\*) Studimi është shkruar para se të botohet romani «Belzhiku që këndonte vendçe». I është bërë vetëm ndonjë shtesë

kritikën kundër mentaliteteve e psikologjisë patriarkale e mikroborgjeze, demaskimin e armiqve të brendshëm e të jashtëm.

Vërtetësia e përmbajtjes jetësore, fryma popullore, mprehtësia politike në trajtimin e problemeve, fizionomia kombëtare e tipave shoqërorë, thjeshtësia dhe saktësia e paraqitjes së fakteve e subjekteve, lirizmi i lehtë dhe humori i këndshëm, gjuha e pasur dhe pa ngarkesë të tepruar emocionale, gjetja e zgjidhjeve reale historike për kontradiktat e konfliktet e pasqyruara dhe optimizmi revolucionar, janë disa prej karakteristikave më themelore të veprimtarisë së tij letrare, që prej poemës «Bujku i Hanko Hallës» (1934) deri te novela «Dritë» (1972). Dhe, po ta pranojmë plotësisht mendimin e njohur «stili është njeriu», do të thoshim se një shembull i bukur për ta provuar atë është dhe vepra e Shevqet Musarajt.

## II

Si shumë shkrimtarë të tjerë edhe Shevqet Musaraj e nisi veprimtarinë letrare me vjersha, si poet. Po në këtë rast ky fillim poetik duket se nuk është thjesht çështje moshe. Përveç faktit të njohur që letërsia shqiptare në vitet 30 vazhdohte të ishte një «letërsi poetësh» (me përjashtime të rralla në këtë rrugë hynë edhe të rinjtë e asaj kohe), në formimin letrar të Shevqet Musarajt do mbajtur parasysh edhe vendlindja e tij: Labëria, që ka qenë e mbetet një vatër e poezisë sonë popullore. Ai u mëkua që në foshnjëri me këngën labe, që i fitoi zemrën dhe i hyri në gjak, i dha fillin drejtues për të gjetur e për të shprehur vetveten si poet i popullit.

Vjershat e para të Shevqet Musarajt janë të vitit 1929. Më 1934 ai shkroi e botoi një prej krijimeve poetike më të rëndësishme të asaj kohe — poemën realiste

me frymë demokratike «Bujku i Hanko Hallës», për të arritur dhjetë vjet më vonë, po me atë frymë të shëndoshë popullore, te një nga kryeveprat e letërsisë sonë të re, poema «Epopeja e Ballit Kombëtar».

Në vjetët 1930-1940 e diçka më vonë, në krijimtarinë poetike të tij ka kërkime e luhatje, njëfarë përzierje e ndeshje prirjesh në konceptimin poetik të realitetit, në formën e shprehjes poetike, në mjetet stilistike e teknike të vjershërimit. Luhatje të tilla hasen në disa nga vjershat më të hershme, si «Perëndimi» dhe «Mëngjesi» (1929), po edhe në krijime të mëvonshme si: «Vështrimit tënd» (1935), «Vitin e gjashtë» dhe «Vetëm ty» (1936) etj. Poeti i ri, nën ndikimin e disa poetëve stilizantë të kohës, synon të shkruajë për tema eterne, t'i këndojë brengës së një dashurie të papërcaktuar, të përdorë gjuhë të stisur, i joshur prej simboleve e alegorisë dhe të lakmojë përsosmërinë e jashtme të vargut e muzikalitetin e fjalës, ku disa herë ndrydhet e përdhunohet mendimi, si në vjershën «Mëngjesi»:

*Nga Azia perandori vargonjartë, perdegrisur,  
nëpër pluhur të agimit, duke rendur si i krisur,  
kandalit të rimtin qiell, det të tymtë, që po fsheh  
ujt' e natës brenda gjirit ngjyrëkaltër kadife.*

Por, në thelb, asgjë nuk e lidhte poetin e ri me formalizmin dhe me vargëzuesit e mbyllur në guaskën e tyre. Madje edhe në këto vjersha të para, ai gjen rastin për aludime të qarta politike e atdhedashëse. Teksa zbulon peizazhin e bregdetit tonë në agimin e një dite të re, poetit i ushtojnë në kujtesë gjësimet e luftës ant imperialiste të 1920-ës, prandaj nuk mund të mos theksojë se: «mal' i luftës së njëzetës... krenarinë e luftës së shikuar mban në zemër e nuk flet», kurse «...tejetit, robëruar, ndrit me zor Sazani plak...».

Që këtu zë fill prirja e shëndoshë që u bë gjithnjë e më zotëruese, derisa shmangu çdo gjurmë ndikimesh

jorealiste. Vjersha e parë që ai ka botuar («Në fshat»), sadoqë ende e papërcaktuar, në frymën e vjershës «Dimri» të Naim Frashërit, ka tingëllim shoqëror. Dimri i ashpër, të ftohtit, errësira, frika, varfëria i shërbejnë të krijojë një përfytyrim poetik të paidilizuar të fshatit shqiptar të kohës ku:

*Një zë, si nga tjetër botë,  
i mekur, gjithë trishtim,  
dëgjohet fortë më fortë;  
kush të dalë s'ka guxim.*

Krahas afrimit me realitetin dhe me kthjellimin e mendimit, qartësohet e bëhet më funksionale dhe shprehja poetike. Ky përparim do të shpjerë në kërkesën për t'iu drejtuar rrethëve demokratike dhe masave të popullit, prandaj dhe gjuha poetike e shumicës së krijimeve ndjek vazhden e poezisë popullore, ose traditën e poezisë patriotike e demokratike të Rilindjes e të viteve '30.

Në vjershat e kësaj periudhe duket qartë ndikimi i poezisë së Rilindjes në etapën më të vonë të saj: brenga e atdhetarëve që shikojnë si nëpërkëmben idealet që i udhëhoqën në luftë për pavarësi, protesta shoqërore e politike, afrimi me këngën popullore dhe me krijimtarinë letrare që e ndoqi atë.

Vecori e vjershave të kësaj kohe është shkrirja e motiveve shoqërore me motivet atdhetare ose trajtimi i tyre nga pozitë e një demokratizmi revolucionar e me frymë të theksuar antiimperialiste, ndërkohë që rreziku kanosës i fashizmit vuri në gjendje alarmi të gjithë ata që u dhembei atdheu. Kjo është arsyeja që si dhe në shkrimet e disa letrarëve të tierë, evokohet heroizmi i popullit dhe demaskohet qëndrimi mospërfillës i shoqërisë Feudo-borgjeze ndaj heronive të luftërave çlirimtare, mbetur udhëve pa bukë. Vjersha «Fol, poet!», na jep tablo tronditëse të luftërave të kaluara:



*..Rreth tij ullinj të pazhulitur  
e gropa dherash fundëruar  
e vende e brigje të roitur,  
pasqyrë e kohës së kaluar.  
Më tutje varre dhe hendeqe  
me eshtra e kafka njerëzore,  
më t'hu opinga, breza, leqe,  
mbi bezga kalbet një mëngore.*

Shevçet Musaraj, si edhe shkrimtarë të tjerë përparimtarë të asaj kohe, rrihte t'i tregonte popullit se mospërfillja ndaj traditave dhe dëshmorëve të lirisë, ishte shprehje e karakterit antipopullor të feudo-borgjezisë, e tradhtisë kombëtare, që të demaskohej pseudo-atdhetaria e regjimit të Zogut dhe e kalemxhinjve lajkatarë, që, me pompë e bujë flisnin për «kreshnikë» e për «Shqipëri të lumtur» me «kroje argjendorë» e me «ksolla plot qetësi». Duke iu drejtuar ndjenjave atdhedashëse të popullit në çaste vendimtare për fatet e atdheut, bëhej e qartë se barrën e të gjitha luftërave për liri e pavarësi e kishin mbajtur gjithnjë njerëzit me «opinga, breza e leqe», se ndërmjet tyre dhe klasave shfrytëzuese ishte hapur një hon i thellë i pakapërcyeshëm. Dhe, më mirë se kushdo, këtë të vërtetë e kuptonin luftëtarët, që kishin mbetur gjallë «për fat të zi» «pa pulqerë në magje». Kështu preket një prej nyjave më tragjike të kontradiktave të kohës dhe nxitet stuhia e revoltës, duke bashkuar në një urrejtjen kundër shtypjes shoqërore me atë kundër tradhtisë kombëtare. Poetit, siç thotë me trishtim në vjershën «Ç'thotë vala?», vetëm nga e kaluara i vijnë jehonat e «fjalës së zhuritur» të «atij brezi që u shua./ /që u dogj flakë e u bë hi,/ që u hodh poshtë e u harrua/ tek i thonë Shqipëri», kurse shoku i heronjve, hero dhe vetë, jeton në mjerim e në zi, siç është paraqitur me ngjyra rrëqethëse e po me atë kadencë vajtimtare në vargjet e vjershës «Patriotit të përbuzur». Poeti e vë veten në pozitën e dëshmitarit të dy gjendjeve në kontrast flagrant me njëra-tjetrën:

*Të pata njohur vjet' përpara:  
ti ishe trim që s'pate shoq  
e, as grykë për grykë kur re me vdekjen,  
ty trimëria nuk t'u hoq.*

.....  
*Po sot, ah sot! Furtunë e kohës,  
më pa logjikë e pa mëshirë,  
në varfëri, në mospërfillje,  
në mes të udhës të ka shtrirë.*

Në krijime poetike me tema të mirëfillta shoqërore, spikati hapur në atë kohë qëndrimi klasor ndaj shtypjes dhe padrejtësive, u bë dallimi i qartë i ndarjes së shoqërisë, sidomos i fshatit shqiptar, në të pasur e në të varfër dhe poeti lëshoi thirrje që nxitnin revoltën e të shtypurve, që aspironin për një botë të re.

Krijimi poetik më i rëndësishëm i Sh. Musarajt në vitet 1930-1940 është, pa dyshim, poema «Bujku i Hanko Hallës». Në të autori na jep për herë të parë një tablo pak a shumë të gjerë të fshatit (më saktë të një fshati të Labërisë), të parë nga pozita demokratike konsekuente, me nota realiste e me një trajtë poetike popullore.

Shkas letrar për hartimin e kësaj poeme ishte botimi i veprës satirike «Hanko Halla» të Ali Asllanit, që bëri bujë dhe u prit me dashamirësi prej letrarëve përparimtarë. Por, ndërsa në poemën e Ali Asllanit vihej në qendër figura e Hanko Hallës dhe satirizohej mentaliteti i saj i mykur dhe psikologjia e një bejlereshe foddulle, që mburret me fis e me argjend, e lidhur me mish e shpirt me një botë që po perëndonte, në qendër të poemës së Shevqet Musarajt vihen dy fshatarë: bujku i Hanko Hallës me të shoqen. Që këtu vepra merr karakter polemik, si në aspektin shoqëror edhe në atë letrar. Shevqet Musaraj tregoi se jeta pasqyrohet më plotë e nga pozita më të përparuara dhe denoncimi i Hanko Hallës bëhet më efektshëm kur vihet në qendër njeriu i shtypur e i shfrytëzuar dhe kur shtypësi i

nënshtrohet përvojës e gjykimit të bujkut të thjeshtë. Kjo zhvendosje e vëmendjes nga bejleresha te bujku ka bërë që, ndërsa subjekti i «Hanko Hallës» shtjellohet në rrafsh satirik, në mjedise sarajesh, bashkëbisedimi i bujkut me të shoqen bëhet te gardhi i kopshtit. Poema e Shevçet Musarajit ka përmbajtje themelore dramën e rëndë të jetës së bujkut të varfër, protestën kundër shfrytëzimit e shtypjes. Ai e denoncon Hanko Hallën në çdo pikëpamje dhe me këtë shpërndan iluzionet e parakimët e së shquës, e cila përfaqëson tipin e fshatares së nënshtuar dhe të ambjentuar me gjendjen. «Kështu kemi lerë, kështu jemi rritur», — thotë kjo grua, kurse bujku na jep portretin real të Hanko Hallës, e cila «rri në fron me fletë, hallet e kusuret i ka bujku i shkretë». Hankua «kur të flet një herë, mu sikur të vret, /mu sikur të bie syve me pëllëmbë» dhe «... në punë e në lumë do që të na tretë». Ajo dhe bejlerët e tjerë:

*... Më gjak fukarai u frynë e u rritën,  
mbi kasolle kashte kështjella goditën...*

Të mbajturit me të madh dhe mburrja me fisin e vet, pohimi se shogëria e kohës çmon paranë e pasurinë si kriter kryesor të vlerësimit e të lavdisë përdoren me mjeshtëri si vetëdemaskim i mentalitetit dhe psikologjisë së bejlerëshës. Bujku ka arritur të kuptojë se i ka rrënjët më të lashta se fisi i zonjës që:

*Jam, — thotë, — derë e parë, derë dyqind breza.  
Jemi ne të shkretët dyqind e përmbi,  
po nga skamj' e shkretë s'na përfill njeri...*

Në këtë poemë Shevçet Musarajit ka përdorur gjerësisht gjuhën, frazeologjinë dhe vargun popullor, vërtet sipas modelit të përpunuar prej Ali Asllanit, po të pasuruar e të përshtatur temës së veprës dhe tipit që është vënë në qendër të saj.

Poema «Bujku i Hanko Hallës» është vepra kryesore

e Shevqet Musarajt në fazën e parë të veprimtarisë së tij letrare. Ndërsa në disa vjersha të vitit 1936, ndër të cilat më e përparuara është ajo me titullin «Katundarëve», poeti arrin një shkallë të re formimi e vetëdije klasore, kalon nga konstatime tronditëse në thirrje të hapura:

O burra, djem të gurit,  
të shatit, të sëpatës,  
të kazmës, të lopatës,  
.....  
radhosi të gaditur,  
se mjaft në tokën tuaj  
jetuat si të huaj!

Një pjesë e këtyre vjershave, për arsye që kuptohen lehtë, nuk u botuan në atë kohë dhe nuk u bënë fakte letrare. Por ato dëshmojnë rrugën e ndjekur nga shkrimtari dhe janë përligjur prej veprimtarisë së tij të mëvonshme.

Në frymë demokratike realiste janë shkruar edhe mjaft skica e vizatime letrare për tema shoqërore të ditës, botuar në gazetën «Shtypi» dhe në ndonjë organ tjetër të kohës. Tematika është e njëjtë me atë të shkrimtarëve të tjerë të brezit të tridhjetës: u qahet halli të mjerëve të qytetit («Filmi i jetës» «Martesë», «Rrobot e bardha», «Brenge»), vizatohen pamje të varfërisë, të paditurisë e të braktisjes së fshatit («Mbështetja e fundit», «Gurë nga qielli»), shtrohen probleme etike e shoqërore të kohës («Shpirti i vajzës», «Unë dhe ti», «Zotrote»), Ndonjëherë ka edhe shpërthime në një rrafsh më të përgjithshëm për gjendjen e rinisë përparimtare të asaj kohe, që përpëlitej në darën e problemeve shoqëtesuese e nuk gjente rrugëzgjidhje, humbiste shpresat e pinte në dëshpërim («Duke kërkuar të vërtetën»). Shfaqet në të pakënaqësia ndaj rendit shoqëror, brenga për vuajtjet e të varfërve dhe pamundësia që, brenda caqeve të rendit feudo-borgjez, të bëhet ndo-

një ndryshim sado i vogël në dobi të të mjerëve. Duke pasqyruar me vërtetësi realitetin, qoftë dhe në fragmente të vogla jete, shkrimtari nuk ushqen iluzion, nuk i josh, lexuesit me shpresa të kota. Nga ana tjetër, në çdo skicë, prozë poetike a përshtypje nga jeta ai mban vendosmërisht anën e popullit, të të varfërve, të rinisë përparimtare. Herë-herë, në raste dëshpërimi të thellë, ashtu siç u ndodhte edhe letrarëve të tjerë, atij i duket se nga ai rreth i «magjepsur» nuk mund të dilej.

«Jam si në fushën pa fund, pa shokë, pa njeri... — thotë heroi i skicës «Duke kërkuar të vërtetën». — Dhe kur kërkoj shpëtim me zë të fortë, zëri bën oshëtimën e zakonshme nëpër shkëmbinjtë e thatë dhe kthehet përsëri më i vuvër nga ç'u nis... Kërkoj shteg për t'i shpëtuar kësaj katastrofe, po shtigjet janë mbyllur, kërkoj mjete për të çelur shtigjet, po mjetet janë përvëluar...»

Në gjendje pa udhëdalje është edhe argati i mjerë i skicës. «Filmi i jetës»; ai ka tre fëmijë, të shoqën të sëmurë dhe jeton «në një shtëpi përdhese. Pa dritë. Pa shërbim», pa shpresë. Në ankth vuan dhe vajza e robëruar prej ligjeve të pashkuara të mentaliteteve e të zakoneve konservatore. Ajo... «jeton në kafaz». «Emancipimi për to, — thotë shkrimtari, — s'është veçse një dritë e largët e zbehtë, që e admirojnë sa herë që qajnë fatet e tyre, duke ndenjtur prapa qelqeve të dritares, nën drithmën e hijes së prindërve të tyre, brenda mureve të lashta ku janë rrethuar...». Atij i duken të kota ligjet demagogjike e formale mbretërore, sadoqë nuk ka arritur të zbulojë rrënjët shoqërore të skllavërimit të vajzave e të grave.

Si në poezi, edhe në prozë, që në fillime, Shevqet Musaraj tregoi interes të veçantë për jetën dhe problemet e fshatit. ~~Shikon me pikëllim braktisjen e tij dhe harrimin prej atyre që marrin udhën e qytetit, duke lakmuar tregtinë, nëpunësinë ose që mbeten rrugëve pa punë. Sidoqë edhe në këtë rast gjejmë më tepër aspektin etik, sesa thelbin shoqëror të problemit, dhe mbaja që shprehet është tronditëse.~~

«U lëshuam ka kohë nëpër rrugët e qyteteve. Ikëm

nga kasollet tona, me shpresë se një ditë do të kthehem  
shim të pasur, të lumtur, të zotë për të ngritur atje  
mbi gërmadhat e kasolleve shtëpinë e vërtetë të jetës...  
Pamët që patëm mbjellë me duart tona nëpër kopshtijet  
që rrethojnë ato kasolle, janë rritur pa kujdes dhe lulë-  
zojnë çdo pranverë; shpresojnë se dora që i mbolli do të  
kthehet ndonjëherë... do t'i ndreqë, do t'i krasitë...»

Në shënimin «Gurë nga qielli», shkrimtari gjen rastin  
të qajë hallet e krahinave fshatare të braktisura në  
«fatin e tyre», të veçuara e të harruara nga bota, ku  
varfëria kishte motër binjake paditurinë. Prandaj kom-  
mentet naive të fshatarëve për aerolitin, në vend që ta  
bëjnë për të qeshur, e trishtojnë shkrimtarin, se në  
to shikon «ata banorë, që kanë fatin të bëjnë dhe sot  
e kësaj dite jetën e dënuar, të ndarë krejtësisht nga  
bota e qytetëruar, pa një udhë automobilash prej nga  
do të përshkonin vendet vizitore të ndryshëm, pa një  
rreth njerëzish, që të çelte në mendimet e tyre të  
tjera horizonte».

Pak a shumë këto ishin shqetësimet e prozatorit të  
ri gjatë vjetëve '30, shprehur në disa shkrime të pakta  
e të shkurtra letrare e publicistike, ku, përveç anësisë  
popullore dhe idealeve demokratike, spikatnin shkëndi-  
jat e talentit të ri në formë dhe vecori stilistike mjaft  
të ngjashme me ato të moshatarëve të tij. Por në këtë  
periudhë, siç vëren Dritëro Agolli, «me gjithë dëshirat e  
përpjekjet, me gjithë tendencën demokratike e revolu-  
cionare, krijimtaria e viteve '30-të e Shevqet Musarajt  
kishte një tematikë të kufizuar, e varur kjo nga vetë  
koha dhe domosdo nga mosha e tij» (Drita, 1984,  
25 nëntor).

Në vitin 1939, kur pushtuesit fashistë italianë shke-  
lën vendin, Shevqet Musaraj ishte ndër të parët që dha  
kujtën në poezi, duke vazhduar kështu fillin e shëndoshë  
atdhetar të vjershave të mëparshme. Vjersha alegorike  
«Kasolles» botuar fill pas pushtimit fashist, është ndër  
shkëndijat e para të një faze të re të letërsisë sonë  
kombëtare, temë kryesore e së cilës do të bëhej lufta e  
popullit kundër pushtuesit fashist. Sado alegorike,

vjersha u kuptua pa vështirësi prej lexuesve patriotë e antifashistë, po edhe prej autoriteteve të pushtimit. Aludimi është i qartë:


*E sheh ti valën e egër si vërtitet,  
i sheh themelet nga po shkulen radhë?  
Kasollja jonë, vëlla, po ronitet,  
klithm' e kushtrim ligjëro ti mbi gërmadhë...*

Alegoria, simbolet e metaforat përdoren dhe në vjersha të tjera që Shevqet Musaraj shkroi e botoi në kushtet e censurës së pushtimit. Tipike për një trajtim të tillë janë vjershat: «Mëngjes e mbrëmje pas dritares» (1939), «Ëndërr» dhe «Kërkova jetë» (1941). Në vjershën e parë poeti i drejtohet një vajze të mbyllur në shtëpi, po ndihen aludimet për robërinë, luftën dhe për idealet komuniste:

*Duron e fjalën dy askujt s'ia prënd  
e shpresa edhe dëshira  
në zemër ndryn  
siç e kërkon mynxyra,  
skllavëri, zakon i rënd' i vendit tënd...*

.....  
*Po zbrazet qielli krejt, se era ret' i shtyn  
e drita zu po çel  
në majë malesh  
si gjetkë dielli del,  
në shiptin tënd, vec, drit'as diell s'po mbërrin.*

Kështu, në krijimet e pakta poetike të vjetëve të parë të Luftës, ndihet prirja për të futur në poezi idealet antifashiste dhe aludime komuniste, gjithnjë me pikësynimin që vjershat të mund të botohen. Kjo është arsyeja që ai ruan ende alegorinë si mjet kryesor të shprehjes poetike. Mirëpo ndërmjet përvoiës së tij të mëparshme letrare dhe këreksave për një poezi më militante — kërkesa që shkrimtari i bëri të vetat — krijohet një kontradiktë, e cila duket sheshit në vjershat



«Mëngjes e mbrëmje pas dritares», «Kërkova jetë» etj. Njëfarë zgjidhje, kryesisht nga pikëpamja e mënyrës së shprehjes, kjo kontradiktë e gjen në vjershën «Liri popullit për jetë», në të cilën autori i shfaq hapur mendimet e veta, ndonëse nga pikëpamja artistike kjo dhe disa vjersha të tjera të ngjashme me të nuk arrihen një nivel të kënaqshëm.

Në vitin 1944, kur Lufta Antiafshiste Nacionalçlirimtare kishte arritur kulmin dhe çlirimi i Shqipërisë ishte bërë çështje ditësh, në poezinë e Shevqet Musarajt (shih për këtë: «Marshi i Divizionit të Parë» dhe «Himni i Korparmatës së Parë»), arrihet një shkrirje e bukur e toneve madhështore me ritmet marciale luftarake, shprehëse të ngadhnjimeve dhe të vendosmërisë për fitoren përfundimtare. Gjerë e plot siguri fillon «Marshi i Divizionit të Parë»: «Gjëmojnë malet shqiptare — dhe bota zien anembanë...» dhe vazhdon me ritëm e forcë sulmuese:

*Me gjak e flak' i pagëzuar,  
me bijt' më trima luftëtarë,  
dërrmon armiqtë e mallkuar  
në sulme Divizioni i Parë...*

Vjersha Shevqet Musaraj ka shkruar edhe më vonë. Ndër to meritojnë vëmendje vjersha satirike «Erdhën» (1947), poema «Do bëhen zgjedhjet» (1948), vjersha «Sulmojnë çikat vullnetare» (1966) etj. Po vepër madhore e tij, që ka hyrë në fondin e artë të poezisë sonë, ka mbetur poema «Epopeja e Ballit Kombëtar», që u shkrua e u botua në zjarrin e Luftës, në verën e vitit 1944.

Në këtë vepër vihet në lojë farsa «patriotike» e organizatës tradhtare të «Ballit Kombëtar», së cilës Lëvizja Nacionalçlirimtare ia kishte nxjerrë bojën. «Balli» dhe ballistët ishin bërë objekt anekdotash të shumta. Shevqet Musaraj për t'ia dalë mbanë veprës shfrytëzoi tri burime kryesore: karakterizimet që i ishin bërë kësaj organizate në dokumentet e Partisë e në shkrimet e shokut Enver Hoxha; pasurinë e gjallë të humorit e



të satirës popullore; përvojën vetjake të luftës kundër krerëve të Ballit Kombëtar në Tiranë dhe njohjen me ta.

«Epopeja» nis me gjendjen e «Ballit» në prag të kapitullimit të Italisë fashiste, kur «mbytet gjemia me federalë» dhe krerët e «Ballit» i japin munxat «fashizmit e vincemos» dhe orvaten «ta kthejnë fletën sa s'është vonë». Ky çast është zgjedhur me vend, si i pari moment me rëndësi në «epopenë» e «Ballit», që e vë atë në gjendje plotësisht për të qeshur, e tall dhe demaskon thirrjet «patriotike» dhe synimet për të mos mbetur pa pjesë në Shqipërinë e pasluftës. Thelbin e fizionomisë politike të krerëve të «Ballit» e përbëjnë pikërisht interesat klasore të tyre, veshjen politike — demagogjia, ndërsa anën komike të gjendjes në të cilën vihen — kontradikta ndërmjet qëllimeve të vërteta dhe fjalëve të bujshme e dredhive për të ndalur rrokullimën e tyre. E dinë që e kanë «humbur kartën» dhe që «do të ngrihen këmbët t'i bien kokës», u vjen keq që nuk e bënë Shqipërinë «det e tërmet», por që të gjejnë mënyrën të dalin përsëri në krye, duke nxjerrë si deri dhe gështenjat me duart e të tjerëve, hedhin parullën «luftë për atdhe». Pasi ngordhi kali i fashizmit, «Balli» vrapon «t'i heqë potkonjtë».

*Pa kur t'i shohësh  
derven' dervenë,  
në vend të pushkës  
gota dhe enë.*

*Jaka të ngrira,  
bastun, ombrella,  
pantofla, gante,  
picham, kapela.*

Kur kjo manovër nuk pi ujë, krerët e «Ballit» kthehen nga mali dhe jetojnë «ilegalisht» në qytet me roja gjermane te dera! Ky është momenti i dytë komik i historisë së ndyrë të Ballit Kombëtar, akti i dytë i farsës «patriotike» të tij. Ndërsa në pjesën e parë «ballistët»

ishin thjesht qesharakë, në këtë pjesë ata krahas kapardisjes, bëhen më veprues, më të cgër e më të paturpshëm në bashkëpunimin me të huajin, për të shtypur e masakruar popullin e ngritur në luftë. Ndaj shpërthen zemërimi i poetit dhe elementet humoristike e satirike përzihen në poemë me elementët e madhërishëm dhe dramatikë të luftës.

Akti i fundit i komedisë zhvillohet në prag të çlirimit. Sa më afër qyteteve ndihet pushka partizane, aq më të sjellshëm e të njerëzishëm bëhen ballistët, aq më të penduar për rrugën që kanë ndjekur, aq më të interesuar të parashohin fatin e tyre të ardhshëm. Dhe, kur gratë u zënë në gojë byrekët e pulat, ata qahen.

*Lerna, të thashë,  
për kokën tënde,  
ata po vijnë...  
Ti na shtet mendje...*

Strukturën e poemës e ka përcaktuar historia e vërtetë e Ballit Kombëtar dhe metamorfozat demagogjike të politikës së organizatës tradhtare, në krye të së cilës do lën disa prej syfeteve të njohura të «njëqind flamurëve». Nga kjo pikëpamje autori ka qenë i prirur t'i përmbahet rendit kohor të ngjarjeve. Vetë historia i përcejell me daulle të gjitha ato forca e personalitete shoqërore që i kundërvihen rrjedhjes së natyrshme paraecëse. Ky komizëm në poemë është real dhe merita është që zbulohet në momentet më kryesore, pa shumë trillime dhe hiperbolizime. Grotesku përmbahet në vetë natyrën e ngjarjeve e të syfeteve që parakalojnë e janë karakterizuar shpejt e saktë: «Ca avokatë,/ ca profesorë,/ gjithë po na dalin/heronj... therorë! /Të gjithë të pushkalit...». Të tillë janë Mithat Frashëri, «me jakë të ngri-rë prej diplomati». Hasan Dosti, i cili ankohet e vetëmbrohet se fashistët e bënë ministër me zor; Abaz Ermenji — «trim që vjen nga mali» etj.

Përballë tradhtisë, terrorit dhe skotës së tradhtarëve

lartohet populli i ngritur në luftë, heroizmi partizan, figura e dashur e gazmore e Dajë Cenit, i cili me një humor karakteristik vë në lojë krerët e Ballit, demaskon çdo dredhi djallëzore të tyre. Poema plotësohet edhe me mjaft episode komike konçize që u përgjigjen rrethanave në të cilat zhvillohen ngjarjet e veprave personale. Ajo është bërë shumë popullore dhe lexuesit i kujtohen dalja e krerëve të «Ballit» në mal, kujdesi i grave që të mbajnë të fshehtën e burrave «ilegalë», qëndrimi i «sjellshëm» ndaj njerëzve të popullit, episodi me fjalëshoren, grindjet në familje etj. Elementit komik që përmbajnë vetë situatat, i shtohet plot efekt fjala autodemaskuese e ballistëve, karakterizimet satirike të autorit dhe sidomos komentet e stigmatizimet e mprehta të Dajë Cenit — personazhi pozitiv i individualizuar me forcë të madhe përgjithësuese.

Stili i autorit është i thjeshtë, i qartë dhe i shkathët. Vargjet e shkurtra pesërrokëshe me theks fundor krijojnë një atmosferë gazmore dhe i japin ritëm të shpejtë tregimit, kurse përdorimi i gjerë i frazeologjisë së pasur dhe i humorit të shkëlqyer të Labërisë e të Shqipërisë së Mesme, e kanë bërë poemën edhe më të afërt e të dashur për të gjithë. Me figurën e Dajë Cenit dhe me mjetet shprehëse e karakterizuese që janë përdorur është vënë theksi në idenë se është populli që tallet me kalanderët e «Ballit Kombëtar».

Duke çmuar vlerat e kësaj vepre madhore të satirës tonë të re shoku Enver, thoshte më 1949:

*„... Sipas pikëpamjes sime, Fishta me satirat e tij nuk pinë ujë përpara «Epopesë së Ballit Kombëtar» të Shevqet Musarajt. Veprat e shokëve tanë, që shkruajnë për luftën, për jetën dhe punën e popullit qëndrojnë më lart, janë me një përmbajtje të shëndoshë», (Veprat, vëllimi 6, f. 190).*

### III

Pas Çlirimit proza u bë fusha kryesore e veprimtarisë së Sh. Musarajt. Përshkrimet e pamfletet, artikujt e reportazhet, skicat dhe portretet, kujtimet dhe përshtypjet nga jeta, tregimet e shkurtra dhe novelat, pastaj romani «Para agimit» kanë qenë frytet e veprimtarisë së tij letrare në këtë periudhë. Ai ka pasur bashkëpunim të vazhdueshëm me shtypin, sidomos me gazetën «Zëri i popullit», «Bashkimi», «Drita», me revistat «Hosteni», «Nëntori» dhe «Ylli» ku ka publikuar pjesën më të madhe të shkrimeve në prozë. Në vëllimet më vete janë botuar përmbledhja me shkrime humoristike: «Të shkuara, të paharruara» (1956), tregimi i gjatë humoristik «Isha unë, Çobo Rrapushi» (1959), romani «Para agimit» (1966), novela «Dritë» (1973), përmbledhja «Novela» (1975) ku u përfshinë edhe tregimet «Llaz Qesarati» dhe «Unë, Mato Labi konservator?...»

Në shënime politike e në artikujt të kohës së luftës si: «Armiku s'ngopet me gjak», «Ngjarje e komente», «Marifete nga të fashizmit», «Zëri i Vlorës», «Mustafa Kruja fshehi diellin me shoshë», «Kolona e pestë po i tepron zullumet» autori synoi t'u hapë sytë masave që të orientohen në situatat demagogjike që sajonte fashizmi, të merrnin anën e luftës kundër tij dhe të mos e humbisnin toruan e besimin as në çastet e terrorit më të madh, kur kasnecët e okupatorëve e të kuislingëve trumbetonin shkatërrimin e Frontit Nacionalçlirimtar e të vetë Partisë. Të gjitha këto parulla frike, thotë shkrimtari, «s'kanë tjetër burim përveç atij të fashizmit dinak».

Ndër shkrimet publicistike më përfaqësuese të kësaj periudhë është pamfleti «Dje dhe sot», shkruar në janar të vitit 1944 dhe çmuar si një prej gjërave më të fuqishme të publicistikës sonë. Shkrimi, duke iu kundërvënë propagandës dhe terrorit të nazistëve gjermanë e kuislingëve vendës la përshtypje të thella te masat. Në çaste nga më dramatiket ai frymëzoi besimin në forcën e pamposhtur të luftës së popullit, zbuloi fy-

tyrën e vërtetë të qeveritarëve që, siç u duk pas botimit të pamfletit, ishin armiqtë më të egër të popullit, organizatorë të masakrës së 4 shkurtit 1944.

«Po shtiren si patriotë, — shkruan autori, — ata që s'kanë çarë ndonjëherë kokën për fatin e atdheut», mbeturinat e fashizmit italian, që «... kishin fshehur në shtëpitë e tyre këmishat e zeza», «duaxhitë e çmendur të nazizmit», të cilët thoshin se «është detyra kombëtare që i shtrëngon t'i heqin kapelen ushtrisë gjermane». Dhe Balli Kombëtar, është «daullja që mban avazin në orkestrën e tradhtarëve».

Dje tradhtarë dhe sot tradhtarë, pavarësisht nga ndërrimi i maskave; po ndërsa dje u shkonte kungulli mbi ujë, sot nuk u ecën më, se populli është zgjuar dhe po u tregon vendin, lufta e tij ua djeg kartat në dorë, prandaj po bëhet gjithnjë më e vështirë që të mbajnë maskat apo t'i këmbëjnë sipas situatave. Ky është mendimi që përshkon pamfletin.

Skicat letrare ë humoristike, edhe këto me temë politike e atdhetare, janë me subjekte më konkrete. Shkrimtari në to zbulon para lexuesve se si po depërtojnë në popull idetë e Luftës e të Revolucionit Popullor, si realizohet e çelikoset uniteti i masave rreth Partisë, si po nisnin vetë masat ta kuptojnë kthesën historike që po ndodh dhe rolin që duhet të luajnë. Të vërteta të tilla përshkoinë skicat: «Djemtë e fshatit», «Në pragun e lirisë», «Nëna e Zifait», «Punëra pa lëzet», «Mik me të rinjtë», «Vate, vate aio kohë», «Ne dhe ata». Autori skicon portretet e heronive të rinj, që dalin nga gjiri i masave popullore dhe lartësohen si përfacësues të madhërisëm të idealeve revolucionare. Në qendër të të gjithë këtyre shkrimeve është njeriu i thieshtë që në kthesën e madhe të historisë di të zgjedhë rrugën drejt lirisë dhe së ardhmes.

Është meritë e Shevqet Musarait pasqyrimi i kësaj dinamike të lartësimit të ndërgjegjës së popullit në luftë në dritën e perspektivës revolucionare. Kuptimplote janë fjalët për fëmijët në skicën «Vate, vate aio kohë»:

«Kur të rriten, ata do ta çmojnë lirinë më shumë

nga ne të sotmit, do të jenë më të zgjuar e më të bashkuar me shoqi-shoqin, që kështu të mos guxojnë dot e të fusin hundët në punët e atdheut as ata «të politikës me dy karrige»... as edhe maskarenjtë e huaj që kërkojnë të bëjnë dasmë me qese të botës». Këtë besim, që koha e përligji plotësisht, shkrimtari e mbështeste në realitetin e vjetëve të Luftës, kur populli u hodh në kryengritje të përgjithshme dhe farkëtoi me gjak unitetin kombëtar, përpara të cilit armiqtë mbetën me gisht në gojë. Këtë tregon plot humor edhe një plakë në skicën «Djemtë e fshatit».

«Milicët e xhandarët venë e vijnë. Kërkojnë kryengritësit. Po kush ua var trastën. Kryengritës jemi të tërë nashti: s'ka më ujdira me armiqtë. E kemi kuptuar tej për tej se ku na pikon shtëpia. Dijmë të ndajmë të zezën nga e bardha...».

Përshkrimi i gjatë «Shteg më shteg me partizanët e Divizionit I Sulmues», shkruar disa muaj pas pamfletit «Dje dhe sot», në pranverën e vitit 1944, sjell një atmosferë të re: ndërsa në shkurt Tirana vuante në ankthin e terrorit, tani fare afër saj, në kodrat tej qytetit, ndodhën partizanët e Divizionit I Sulmues, të cilët mezi presin urdhrin të sulmojnë. Kësaj rrethane i shtohet edhe fakti se shkrimtari, pas jetës së vështirë ilegale, tani ndodhej në një zonë të lirë, mes partizanëve e fshatarëve, këngëve e optimizimit të tyre për ditën e afërt të lirisë. Prandaj përshkrimi është plot dritë, i lehtë dhe flladitës si erë pranverore. Përmes episodesh të thjeshta autori flet për elementët e rinj botëkuptimor që futi Partia në ndërgjegjen e njerëzve, skicon tiparet e njeriut të ri të revolucionit, që është në gjendje të bëjë mrekullira.

Periudha që nisi pas Çlirimit të Shqipërisë, duke qenë periudha e hopit cilësor ideoestetik dhe më e gjata në kohë, është, më e pasur në krijimtari.

Në tematikën e shkrimeve publicistike a humoristike të autorit vazhdon të ndihet jehona e ngjarjeve dhe e heroizmave të popullit në Luftën Nacionalçlirimtare, trajtohen probleme të luftës së klasave, sidomos në te-

rrenin politik, flitet për shndërrimet revolucionare në jetën e fshatit deri në kolektivizimin e bujqësisë, vihen në lojë politikanët e vjetër, që mundohen të mbajnë avazin e dikurshëm ose t'i përshtaten situatës, fshikullohen shfaqjet e mentaliteteve e të psikologjisë së vjetër në njerëzit tanë, kritikohen të metat në punë etj.

Në shkrimet e kësaj periudhe, duke u kristalizuar veçoritë e individualitetit të shkrimtarit, vihen re zotërimi më i plotë i formës së tregimit të shkurtër, që i kalon çaqet e skicave e të përshtypjeve nga jeta, shtjellohet më plotësisht subjekti, portretizohet më dukshëm figura e njeriut në rrethana e mjedise të caktuara. Por, krahas kësaj, duhet thënë që, disa herë, shkrimeve të tilla me vlerë njohëse u mungon forca përgjithësuese dhe emocionuese.

Në formën e kujtimeve ose të «tregimeve të jetuara», siç quhen ndryshe, janë shumica e shkrimeve për Luftën Nacionalçlirimtare. Disa herë autori e zgjedh këtë mënyrë edhe për tregimet e mirëfillta, qofshin me temë të Luftës, qofshin me temë të aktualitetit. Ndër shkrimet, me kujtime të kohës së Luftës përmendim: «Ber Tafa», «Profecia e plakut», «I deleguari», «Shqiponja e re», «Xhetoja», «Vogëlushi», «Kamerjerja naive», «Ciroku». Për nga brendia këto shkrime janë të ngjashme me ato të shkruara gjatë Luftës, edhe pse tani Lufta shikohet si një e kaluar e afërt dhe e paharrueshme. Krahas përpjekjes për të dhënë me vërtetësi ngjarjet e figurat, zë vend edhe ndjenja e nostalgjisë për to, shkëlqimi i ri, që marrin ato nën dritën e fitores së revolucionit popullor. Subjekti lidh ndonjëherë në një tërësi të dy periudhat historike, si në shkrimin «Shqiponja e re». Me mirënjohje e nderim autori flet për njerëzit e popullit, të cilët nuk bëjnë ndonjë «mrekulli», po kryejnë detyrën ndaj atdheut me atë thjeshtësi, çiltërsi e bindje që është karakteristike për popullin. Kështu del partizan Ber Tafa, njeriu që e zgjon lufta dhe e bën të njohë e të dënojë tradhtinë: xha Veizi («Profecia e plakut»), që është krenar se ka parë «njeriun që di t'u japë udhë këtyre punë-

ve», Xhetoja i vuajtur që flijon veten për lirinë e atdheut; Vogëlushi, që njeh «ilegalin», kur shikon shokun Enver pas Çlirimit; Ciroku, që me zgjuarsie vendosmëri gjen shtegun të njoftojë Partinë për një krim që do të kryejnë fashistët etj. Disa prej këtyre episodeve shkrimtari i përfshiu më vonë në romanin «Para agimit» si elementë të shtratit popullor të subjektit të veprës.

Një pjesë e mirë e shkrimeve të kësaj kohe kanë formën e prozave poetike, frymëzuar nga ngjarje e mendime të ditës. Të tillá janë shkrimet: «Ëndërroj një monument» kushtuar heroizmave të Ushtrisë Popullore, «Sahati i qytetit», ku nëpërmjet monologut flitet për historinë e Tiranës e të të gjithë vendit, «21-vjeçar» kushtuar përvjetorit të pushtetit popullor, që është «në historinë e njerëzimit ai fenomen i ri, të cilit i përket e ardhmja» etj.

Interes të veçantë zgjojnë tregimet, në të cilat jepen tablo më të gjera të luftës dhe trajtohen tema të aktualitetit politik e shoqëror, probleme të reja, që prisnin të mishëroheshin artistikisht në subjekte e në personazhe. «Përpara pranverës», «Ëndrra në diell», «Mauzeri», «Unë, gruaja dhe gërshetat e vajzës», «Bajo Lika», «Halli i Ibro Lames», «Ushtari i popullit», veçanërisht: «Në vitet e stuhishme» dhe «Brenjë nëne».

Tregimi «Në vitet e stuhishme» na njeh me karakterin e fortë të një gruaje labe gjatë Operacionit gjermano-ballist të Dimrit të 1944-ës. E ndodhur befasisht nën kërcënimin e forcave armike bashkë me foshnjën e vet, për të shpëtuar, ajo largohet nëpër errësirë e në të ftohtë dhe gjen strehë në një guvë. Por në shpellë ajo pa edhe diçka tjetër të llahtarshme. Në këndin tjetër të gufës kishin ngritur kokat e po shikonin si të habitur dy këlyshë të vegjël ujkonje»:

Gjendja bëhet e nderë: nga jashtë u kanoseshin edhe gjermanët, edhe ujkonja, që mund t'ia behte nga çasti në çast. Episodi është tronditës dhe me kuptim të thellë e të pasur: njerëzit luftojnë të shpëtojnë nga egërsirat fashiste që janë më të këqij nga bishat.



Tregimi «Bregë nënë» ka shtrirje më të madhe. Flitet në të për plakën Fize, nënën e dëshmorit Seit Bleda, e cila nuk i është trembur vdekjes dhe nuk është tronditur aq shumë kur i sollën mandatën e Seitit, sësa nga shpifja e një rrufjani, që do të hedhë baltë mbi figurën e birit dëshmor. Se, për nënën, si për çdo njeri të ndershëm, vdekja është mjaltë para turpit. Brenga e Fizes është bregë për të gjithë ne, është thirrje për të mos lejuar të hidhet baltë mbi emrat dhe veprës e ndritur të atyre që na dhanë ç'kishin më të shtrenjtë: jetën dhe rininë e tyre! Bashkohen në një nyjë të fortë dy kohë dhe shkrimtari me një kompozicion të natyrshëm, të shkathët e të shumanshëm, ka mundur të na flasë edhe për Fizen, edhe për të birin e saj, dhe për episode të Luftës e të kohës sonë.

Vend të veçantë në prozën e shkurtër të Shevqet Musarajt zënë skicat dhe tregimet humoristike e satirike.

Objekt i satirës therëse janë syfetet e njerëzve të deklasuar, që shohin «ëndrra në diell», që përpiqen të hedhin gurë në rrota, por «gjejnë atë që kërkojnë» në farkën e demokracisë e të socializmit. Të tillë janë Nelo Ziu («Ç'kërkoj gjeti»), Teme Agai («Vallja e Teme Agait»), Seit Efëndiu («Uthull për inatçinjtë»), Mete Agai («Hesapet e Metë Agait»), Meço beu («Peshqeshet e Vitit të Ri»), etj. Zhvillimi shoqëror e politik i vendit dhe përparimet e tij i vënë këta tipa në situata komike dhe bëjnë të duken më qartë tiparet e tyre të dëmshme qesharake, si përfaqësues të një bote të perënduar.

Shevqet Musaraj, si humorist e satirist, ka krijuar disa personazhe, që janë bërë popullorë nëpërmjet revistës «Hosteni» dhe botimeve të tjera, si Lato Godoja, Teló Goxhoja, Mato Labi dhe Cobo Rrapushi, të gjithë sipa nga Labëria. Përmes zberthimit të psikologjisë së tyre, krahas ngjyrave lokale, autori shtron e zgjidh drejt disa prej problemeve kryesore të humorit e të satirës sonë të re: vënien në qendër të temës aktuale të njeriut tonë, i cili bëhet i vetëdijshëm edhe ndaj dobësive, të metave dhe shfaqjeve të huaja në jetën

e në veten e tij, shikuar në prizmin e normave të reja popullore socialiste, duke u çliruar nga trashëgimet e këqija të së kaluarës. Në këto shkrime zotëron atmosfera e shëndoshë, pozitive, optimiste e jetës sonë; ndihet ecja përpara në rrugën e socializmit dhe në këtë terren shfaqen e përcaktohen dukuritë e situatat komike. Personazhet që u përmendën janë, si të thuash, syri popullor me të cilin shkrimtari sheh e pasqyron këto dukuri. Ata janë tipa të zgjuar, të ndershëm, shakatarë, që me mprehtësinë e tyre qortojnë e fshikullojnë dobësi e të meta pa u veçuar as vetë nga masa e shakatarëve. Ata janë përfaqësues të masave, po për çështje të veçanta vihen edhe vetë në situata komike prej zhvillimit shoqëror; prandaj lexuesi qesh jo vetëm me batutat e tyre plot humor, po dhe me «seriozitetin komik», me të cilin shfaqin vetveten, bëjnë autokritikë kur e kuptojnë se çalojnë, ose përpiqen të hedhin hendekun. Disa herë ata e kuptojnë dhe i japin rrugëzgjdhje me vështirësi kontradiktës përballë së cilës vihen. Kështu Telo Goxhoja nuk pranon të hyjë në kooperativë, shumë çështje i trajton në mënyrë patriarkale, ndonëse politikisht mbahet (dhe është) i lidhur me pushtetin popullor. Teloja vihet në situatë komike se nuk e kupton që bie ndesh me prirjen e përgjithshme të ecjes përpara. Këtë plagë prek e shoqja kur i thotë me rreptësi:

«Ç'thua, mor i zi! Ti po ikën fare nga çarku më duket. Në kooperativë s'na fute; me të rinjtë xheç ke filluar ta prishësh fjalën; ligjin që më jep muq të drejtën si ti s'e ke në defter. Ç'kanë më tepër se kaq armiqtë?»

Tipari komik i këtyre personazheve trashet vetvetiu ngaqë ata nuk e kuptojnë pozitën e tyre, kur mbahen më të madh si «njerëz të luftës e të pushtetit», që u duket se s'kanë njollë e nuk bëjnë hije.

«Kjo qenka ç'qenka, — thoshte Shemia, kur i binin kokës me kritikë për punët e këshillit që nuk shkonin mirë në fillim. — Ku je, o kohë e luftës, të marsha të keqen! Gishtin automatikut dhe nuk çaje kokën

për gjë tjetër. Kurse tashti... Tashti udha na qenkej edhe më e përpjetë. («Të shkuara të paharruara»).

Kështu zbulohet thjesht e fare natyrshëm një prej tipareve themelore të realitetit tonë politik e shoqëror. Revolucioni vjen gjithnjë duke u thelluar, shoqëria çan përherë përpara, njeriu ngrihet në lartësi të reja; prandaj lufta ndërmjet së vjetrës e së resë, si kudo edhe në ndërgjegjen e njerëzve, është ligj i përhershëm, pra, dhe burim e mundësi situatash e konfliktesh komike si dhe zgjidhjesh pozitive në pajtim me prirjen e zhyllimit.

Në tregimin «Mato Labi pret mysafirë» Matoja i drejtohet kështu njerës prej bashkëfshatareve:

«Vërtet ke luftuar si burrat, ke punuar si burrat, shqiponjë me krahë ke qenë, mal më mal e vërrri më vërrri. Po sa para bën kur nuk ia mëson këto cilësi edhe sat bije? Ma dashke çupën të mbyllur si domaten në serrë; të mos rritet si sorkadhe mali, po si breshkë moçali, si bijë beu, si borgjeze. Ah, Lalote, Lalote!».

Ka ndër këto shkrime edhe skicime të shpejta, që nuk i kapërcejnë pretendimet e shënimeve të shkurtra gazetareske, për të meta, dobësi e probleme të caktuara. Në këto raste personazhet e skicave e të tregimeve vihen drejtpërdrejt në funksion të problemit që trajtohet, por situatat komike janë të varfra. Si mjet kryesor satirik shërben fjala e personazheve pozitive, e tallura e tyre ose ndërhyrja me të njëjtin ton e autorit. Dobësi të kësaj natyre u vunë re në përmbledhjen «Të shkuara, të paharruara» dhe në disa tregime e shkrime botuar më vonë në shtyp. Por le të kujtojmë se jemi në fillimet e satirës sonë të re dhe se autori shpesh e përdor vetëdiuishëm arsenalin e gazetarisë.

Koha bën përzgjedhjen edhe në letërsi. Me rëndësi është se rruga e ndjekur prej Shevqet Musarajt, si një prej humoristëve tanë më të parë e më të shquar, është e drejtë. Edhe shkrimet e hershme të autorit, në tërësi e në frymën që i përshkon, kanë qenë ndihmesë në hapat e parë të satirës shqiptare të realizmit socialist.

Novelat

IV

Katër novelat («Llaz Qesarati», «Isha unë Çobo Rrapushi», «Dritë» dhe «Unë, Mato Labi, konservator?») shënojnë një tjetër ecuri e arritje në punën krijuese të shkrintarit, në zgjerimin e kuadrit ideotematik, në ngritjen e mjeshtërisë artistike në një lloj më të gjatë të prozës.

Novelat, sado të ndryshme ndërmjet tyre (dy janë humoristike), anë themelore të përbashkët kanë vënien e njeriut të sotëm përballë zhvillimit socialist dhe përparimit shoqëror, trajtimin e kontradiktave që lindin prej karakterit revolucionar të këtij zhvillimi dhe prapambëtjes në disa anë të ndërgjegjes së njerëzve tanë. Kështu, Çobo Rrapushi e Mato Labi, Llaz Qesarati e Faslli Guri, njerëz të popullit e të Luftës, sjellin nga e kaluarat edhe mbeturina shqetësuese, vihen përkohësisht në pozita dramatike ose komike, nga të cilat dalin nën ndikimin e faktorit shoqëror dhe të bashkëkohësve më të përparuar. Karakteri i tyre dramatik ose komik nuk mbetet e nuk mund të mbetet një çështje vetjake. Kontradiktat e tyre të brendshme marrin karakter shoqëror bëhen burim ndeshjesh e konfliktesh ndërmjet tyre e shoqërisë. Zgjidhja pozitive e konflikteve shpie në mbrojtjen e interesit të përgjithshëm dhe në çlirimin e tyre shpirtëror, duke i bërë më njerëzorë e më revolucionarë.

Anë tjetër e përbashkët e novelave janë mjediset fshatare, fshati ynë në periudhën fill pas Çlirimit, në fazën e kolektivizimit të bujqësisë e të forcimit të tij, fshati i kurr në të ngul thellë plugun revolucionari ideologjik e kulturor.

Ndërthurja e kohës së Luftës Nacionalçlirimtare me aktualitetin e sotëm shoqëror, paraqitja e tyre si rrjedhë e një procesi revolucionar të pandërprerë, është një tjetër tipar dallues i këtyre novelave. Heronjtë dhe personazhet e novelave, njerëz që e kanë jetuar Luftën dhe kanë marrë pjesë në të, janë krenarë për të kaluarën e tyre, i mbajnë të gjalla kujtimet e atyre vje-

tëve, që ndikojnë për mirë dhe në zgjidhjen e drejtë të problemeve përpara të cilave vihen. Një konceptim i tillë i ka dhënë dorë shkrimtarit për të nxjerrë në ballë anën politike të çështjeve, për të tërhequr vëmendjen në edukimin me dashuri për punën, për të theksuar se revolucionarët e vërtetë nuk qëndrojnë kurrë në vend, por ecin pa u ndalur si vetë revolucionit.

Këtë rrugë ndjekin, në rrethana të ndryshme, personazhet kryesore të novelave, duke u diferencuar prej elementëve armiq. Kështu, është theksuar ideja se e sotmja ushqehet prej traditës së bukur të së kaluarës, ruan dhe ngre më lart këtë traditë, po bën që e kaluara të shihet e të vlerësohet edhe nën prizmin e arritjeve e të perspektivave të revolucionit.

Në të gjitha novelat, krahas luftëtarëve të vjetër, me interesim të veçantë shikohen luftëtarët e rinj, brezi i ri i vendit, si faktor jetik për përparim të mëtejshëm. Shkrimtari ka gjetur e pasqyruar unitetin klasor revolucionar të brezave, pa iu shmangur kontradiktave e konflikteve reale, pa lënë shteg, madje, duke i fshikulluar rreptë teorizimet borgjezo-revizioniste mbi të ashtuquajturën «luftë brezash».

Novelat kanë afërsi dhe në thurjen kompozicionale. Me gjithë veçoritë e secilës, ato kanë në qendër një figurë kryesore, mbartëse të kontradiktave dhe, me përjashtim të «Llaz Qesaratit», janë ndërtuar në plan retrospektiv. Ngjarjet rrëfohen nga vetë heronjtë e novelave (Çobo Rrapushi, Mato Labi) ose nga një prej personazheve kryesore, që nuk mund të identifikohet kurdoherë me autorin (Kalem Asllani i novelës «Dritë»). Në rastet kur ngjarjet paraqiten prej heronjve kryesorë, zotëron stili përshkrues dhe subjekti është më pak i ndërlikuar. Në rastet që tregon autori ose një prej personazheve, tregimi merr shtrirje më të gjerë, kalohet më me lehtësi nga një situatë në tjetrën dhe karakterizimi e vlerësimi i figurave kryesore bëhet më i drejtpërdrejtë, me anë vlerësimesh të shkrimtarit ose të opinionit shoqëror që sjell tregimtari.

Po krahas të përbashkëtës në pëlqimet tematike

dhe në stilin e shkrimtarit, çdo novelë mbart një copë jete dhe sjell tipa të veçantë.

Novela e parë, «Llaz Qesarati», sjell material jetësor nga faza vendimtare e kolektivizimit të bujqësisë në zonat fushore të vendit. Shkrimtari mori pjesë vetë në përbërjen e ekipeve të Partisë në këtë kthesë revolucionare që po ndodhte në jetën e fshatit.

Ngjarjet vendosen në një fshat të Myzeqesë. Fshatarët, që kishin marrë tokë nga Reforma Agrare dhe mezi qenë mëkembur, e patën të vështirë të kuptojnë sakaq se ishte në interes të tyre të bashkohen në kooperativë. Këto vështirësi rriten për shkak të shfrytëzimit të sedrës së sëmurë dhe të zakoneve patriarkale nga kulakët e armiqtë e tjerë, që nxitin me marifet fshatarët të ngrihen kundër krijimit të kooperativës. Një botë e vjetër shembet me vështirësi të madhe dhe një botë e re që lind me dhembje e me përpjekje, sepse, duke shndërruar marrëdhëniet e vjetra të pronësisë, duhet të ndryshojë edhe ndërgjegjen shoqërore të fshatarit.

Me Llaz Qesaratin shkrimtari ka synuar të paraqesë një fshatar, aspiratat e të cilit pajtohen plotësisht me ngritjen e kooperativës, mirëpo ai ngurron. I nxitur edhe prej thashethemeve rreth së bijës, vë inat me sekretarin e Partisë, të cilin armiqtë e klasës kërkojnë ta njollosin.

Si duhet vepruar? Ky është problemi që ka tërhequr vëmendjen e shkrimtarit. Dhe, për këtë qëllim, ai na njeh me Llaz Qesaratin e me familjen e tij, me Wangjel Kushon që i është vënë me mish e me shpirt çështjes së kolektivizimit, po pandeh se mund të pritet lisi me një sëpatë, me kulakun Gori, me armikun Toli, apo edhe me militantin Xhoxhi Driza. Me anë të portretizimit të secilit dhe të përcaktimit të marrëdhënieve që kanë, në mes, tyre, shkrimtari hedh dritë në natyrën e vërtetë të konfliktit që ka lindur dhe zgjidh drejt dramën shoqërore e vetjake të Llaz Qesaratit. Duke pastruar ferrat «s'është e mundur... të mos gjenet fjala ndërmjet njerëzve që në themel të jetës së

tyre kanë diçka të përbashkët. Cila është e përbashkët në jetën tonë? Udhë e Partisë, pa të cilin... nuk mund të ketë jetë e gëzim për ne».

Këto fjalë që i thotë në mbledhjen e fshatit Xhoxhi Driza përbëjnë themelin ideor të novelës dhe pikënisjen e kthesës së Llaz Qesaratit, të cilin e ndihmojnë të kuptojë të vërtetën edhe qëndrimet armiqësore të Gori Pishës, dhe të Toli Rerëzës, që pandeh se mund ta bëjë për vete.

Në shtratin e këtij kolizioni gjejnë zgjidhje edhe problemet e tjera. Sado zemërak dhe i ndërkrjer, i çli-ruar prej brengave e dyshimeve që e mundonin, Llazi bëhet më i dashur e më i dhemshur me njerëzit e shtëpisë, me gruan e me të bijën. Ai gjithnjë e më tepër «u gëzohej ditëve që erdhën». Tek ai fiton e mira mbi të keqen, e bukura mbi të shëmtuarën, sado që zgjidhja ideoartistike e konflikteve është dhënë shpejt e përciptas dhe momentet kyçe janë kaluar lehtë.

Me interes është portreti i Vangjel Kushos, vërtet i vendosur për udhën që ka zgjedhur, po jo kurdoherë me qëndrim të drejtë ndaj të tjerëve. Përmes kësaj figure shkrimtari ngre problemin e afërsisë dhe të taktit ndaj njerëzve, pa rënë as në oportunitizëm as në sektarizëm, sepse njeriu, si thotë njëri prej personazheve, «kur nuk e afrojnë largohet më shumë».

Të një stadi shoqëror më të përparuar janë konfliktet e vëna në themel të novelës «Dritë». Kooperativistët e Krekëzës, veçanërisht të rinjtë, janë të etur për përparim. Ata duan t'i vënë shpatullat aksionit për ndërtimin e hidrocentralit dhe shndërrimeve të tjera në jetën e fshatit, po ndeshen me koncepte e qëndrime frenuese me zakonet e psikologjinë patriarkale e mikroborgjeze. Mbartës konceptesh e qëndrimesh të tilla është edhe kryetari i kooperativës së Krekëzës, Faslli Guri, i cili vihet nën zjarrin e kritikës së rreptë të të rinjve dhe shtyhet të rishikojë veten.

Me gjithë ndryshimet në kohë, në pozitën shoqërore të personazheve dhe në problematikë, ndërmjet novelave «Llaz Qesarati» dhe «Dritë» ka njëfarë për-

gjasimi, që i bën të duken vazhdim i njëra-tjetrës në sensin ideor, deri diku dhe në elemente të strukturës. Ndofta me qëllime të paracaktuara shkrimtari e ka vënë edhe Fasli Gurin para disa çështjeve të përafërta me ato që është ndeshur dikur Llaz Qesarati. Si Llazi, edhe Fasliu kanë nga një vajzë që e kanë fejuar të mitur dhe hyjnë në konflikte me djemtë që ato dashurojnë për të mos shkelur zakonet dhe fjalën e dhënë. Dhe, meqë si Vangjeli i novelës së parë dhe Pali i «Dritës», janë përfaqësues të së resë revolucionare, Fasliu, si Llazi dikur, i cënuar në sedër, pa dashur e shtrin konfliktin personal në çështjet e kooperativës. Por, ndërsa Llazi mënjanohet i fyer, Fasliu me pozitën e kryetarit të kooperativës hidhet në sulm kundër të riut duke përdorur si mburojë meritat e luftës. Ky ka edhe një epërsi tjetër: krushku i tij është bujk i nderuar dhe jo ndonjë i deklasuar si Toli Rerëza. Të rinjtë e Kreckëzës nuk dëgjojnë të heshtur si të novelës e mëparshme, po ndërhyjnë energjikisht të përkrahur nga organizata e Partisë dhe nga atmosfera revolucionare e kohës.

Në sfondin e veprimit të gjallë të rinisë shkrimtari shtron për diskutim e për zgjidhje çështjen se si duhet të çajë përpara revolucionarët e vërtetë.

Shkrimtari ka besim të plotë në shpëtimin dhe shërimin e njerëzve tanë që gabojnë. Ai e shikon me optimizëm e besim realitetin dhe forcën përtëritëse të shoqërisë sonë, mbështetur dhe në vullnetin e atyre që duan të ecin përpara. Kështu Fasliu dalëngadalë çlirohet nga çdo hije dyshimi e nga çdo ankth kompleksësh mikroborgjeze dhe lartësohet moralisht. Simboli kisht në novelë kjo e vërtetë është dhënë në ngjitjen me mundim së përpjetës ku «për çudi, ato dhembjet në çapok e në gjithë trupin që e kishin munduar tërë natën, nuk po i ndiente».

Në novelë ka shumë dritë. Para kësaj drite zbehën hijet e murme të së kaluarës, që zënë akoma vend në shpirtin e në mendjet e disa njerëzve. Mundet që dritëhijet të ishin më të theksuara, por, shkrimtari, në



krahasim me të kaluarën, jeta sot i duket tejprtejt dritë. Dhe ka të drejtë, aq më tepër kur hedh shikimin përpara.

«Ajo natë, — thotë tregimtari, duke kujtuar një akcion popullor, — na dha me të vërtetë të kuptojmë se, kur u bashkuakan mendjet dhe vullnetet e njerëzve dhe kur arrihet të binden tejpërtej se çështja është në interes të të gjithëve, s'ka vështirësi që të mos kapërcehet».

Do të ishte kuptimplot edhe krahasimi se ndërsa te «Llaz Qesarati» të krijohet përshtypja që në fillim se jeta, si Llazi, ecën ngadalë dhe njeriu ende mbetet disi i veçuar në shumë gjëra, në novelën «Dritë» zotëron lëvizja, veprimi i përbashkët. Jeta e njerëzve nuk paraqitet e mbyllur më brenda katër mureve; ajo është bërë një jetë shoqërore dhe ka fituar ritëm të ri.

Në dy novelat humoristike, vazhdim i njëra tjetrës, spikat i njëjti tip shoqëror, mishëruar në dy karaktere të përafërta. Këta «personazhe shëtitës», që i gjejmë dhe në shkrime të tjera të Shevqet Musarajt, prejardhja shoqërore, jeta, lufta dhe karakteri i tyre i ka lidhur me fatet e vendit e me socializmin, i shtyn të mbajnë qëndrim të papajtueshëm ndaj armiqve, të kritikojnë hapur e me guxim, të thumbojnë hidhur veset e njerëzve; herë me të folur, herë me të shkruar, qeshin me dobësitë e të metat, pa harruar dhe ndonjë huq të vetin.

Tipa të tillë ka pasur e ka në çdo fshat të Labërisë. Janë zakonisht pleq të mençur e gaztorë, plot thumba satirikë e bejte, që kalojnë gojë më gojë në formë aforizmash, anekdotash e shprehjesh porverbiale. Humori i tyre, sado i mprehtë e ngacmues, nuk fyen njeri. I lindur nga populli ky humor është popullor në gjithcka: në drejtimin kryesor dhe në shfaqjet e veta më të thjeshta.

Këtë traditë të pasur Shevqet Musaraj e ka shfrytëzuar, përpunuar e përtërirë, duke i dhënë përmbajtje aktuale dhe një formë artistike bashkëkohore.

Krahas kritikës ndaj veseve e dobësive dhe stigma-

tizimit të armiqeve, anë tjetër, që bie më shumë në sy dhe ndërthuret natyrshëm me të parën, është pozita komike në të cilën wihen shpesh vetë personazhet e dy novelave! Atyre u duhet të hedhin me vështirësi hapin drejt së sotmes, sado që pandehin se «hendekun» e kanë hedhur me pushkët që kanë zbratur. Në shikojmë veten në dobësitë e të metat e tyre dhe pastrohemi bashkë me ta. Ndërtimi i subjekteve me retrospektivë, shërben që personazhet të sjellin ndër mend rrugën e përshkuar, të shikojnë me sy autokritik dobësitë e të metat e tyre. Ajo që ata e pandehin në fillim dramë, kthehet në komedi. Çobë Prapushi mendonte se pas Luftës kishte të drejtë të endej udhëve të Tiranës për qejll, por, pas kthesës, ai tallet me vetveten dhe e shikon më sy tjetër të kaluarën. Po kështu edhe Mato Labi. Ky u flet të rinjve për Luftën e për Shqipërinë, po ka mbetur njëzet vjet prapa me ato që thotë. Këtë e kupton më mirë kur ndodhët përballë shndërrimeve të mëdha që ka pësuar vendi.

Pa u zgjatur, themi se Shevqet Musaraj me novelat dhe me shkrimet e fiera humoristike e satirike, ka dhënë ndihmesë të çmuar në krijimin e një letërsie satirike, ku pasqyrohen problemet e jetës së masave të gjera popullore, për trajtimin artistik dhe zgjidhjen e drejtë të kontradiktave antagonistë e joantagoniste, në dritën e realitetit e të ideologjisë sonë. Ai ka zgjidhur drejt e me sukses edhe probleme të «humorit pozitiv» e të heroit veprues në letërsinë satirike.

Romani «Para agimit», vepra më e gjerë epike e Shevqet Musaraj, qëndron përkrah poemës «Epopeja e Ballit Kombëtar» dhe ka zënë vend me meritë në historinë e letërsisë sonë të realizmit, socialist. Autori, me sa duket, i ka vënë vetes qëllim të paraqesë rolin historik udhëheqës të Partisë në luftën për çlirim

kombëtar e shoqëror, formimin e vetëdijes revolucionare në valët e ndeshjeve politike e ideologjike, kalitjen e komunistëve si shprehës të interesave kombëtare e poullore në periudhën e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Nisur nga ky pikësynim ideoartistik, ai e ka zënë fillin e subjektit në mesin e vjetëve '30, kur kontradiktat shoqërore e politike ishin acaruar dhe përballë forcimit të reaksionit e të rrezikut fashist çdo njeri i vetëdijshëm përpigëj të përcaktonte sa më qartë qëndrimin e vet, të mbronte interesat e veta klasore, të rrokte rrugën më të përshtatshme për të dalë nga gjendja e amullisë, në të cilën mbahej vendi i sunduar nga një regjim thellësisht antipopullor. Pikërisht në këtë kohë hyn në jetë edhe Qemal Orhanaj — heroi kryesor i romanit. Ky i ka shërbyer shkrimtarit si mishërim i tipareve të të riut revolucionar, që vihet në rrugën e luftës dhe kalitet e rritet në kudhrën e saj, si mjet ndërlihdhës mes rrafshëve e linjave të ndryshme të subjektit, por, sidomos, si një tregues kuptimplotë për kthesën e madhe historike që ndodh gjatë Luftës, nën udhëheqjen e Partisë Komuniste të Shqipërisë.

«Para agimit» është një vepër letrare me temë politike. Në sfondin shumë veprues të ngjarjeve të luftës në Tiranë, të veprimtarisë së popullit të udhëhequr nga komunistët më një anë dhe të fashizmit e të shërbëtorëve të tij në anën tjetër, është dhënë një tablo mjaft e gjerë dhe e vërtetë e lëvizjes politike e shpirtërore dhe janë zbuluar në mënyrë bindëse rrenjëjt shoqërore e klasore të qëndrimeve që mbahen ndaj çështjeve të së ardhmes dhe ndaj problemit shqetësues e themelor: luftës për çlirimin e Shqipërisë.

Lidhjet personale të Qemal Orhanajt me Ermira Velon, bijë e një prej familjeve aristokrate, i kanë shërbyer shkrimtarit për të provuar se antagonizmat klasore i detyrojnë ata të hidhen në anë të kundërta të barrikadës si dhe për të ballafaquar dy kampet, për të treguar si bie e degjeneron «parësia» dhe si ngrihet e lartësohet populli. Kjo dialektikë e zhvillimit historik e çan rrugën jo aq lehtë dhe jo aq lehtë pasqyrohet

në art, sidomos kur ajo përthyeret në botën shpirtërore të njerëzve.

I frymëzuar nga aspirata intelektuale dhe nga dashuria për Emira Velon, Qemal Orhanaj hyn me drojtje në mjediset e rrethit të miqve të saj dhe rri në këtë shoqëri «si mbi gjemba». Po shpejt bindet se «këta intelektualë të mëdhenj», kjo «elitë» siç i quan Emira, «s'njohin gjë prej gjëje nga jeta prej skllavi e fshatarit dhe e punëtorit tonë dhe flasin për ta. Rrahin ujë në havan këta», — i thotë ai shoqes së rinisë.

Këtu zë fill një prej konflikteve më të vështira e më delikate për dy të rinjtë, që ta tërheqin shoshogjin secili në anën e vet. Ermira ka besim në «epërsinë» shoqërore të familjes së vet dhe në dashurinë, që, sipas saj, do ta shtyjë Qemalin të pajtohet me «elitën», kurse Qemali ushqen iluzionin se, me forcën e bindjeve të veta revolucionare, «sikur ta bënte shoqe jete vajzën, do ta bënte, pa një pa dy, edhe shok të idealit të tij».

Por, në kundërshtim me këto dëshira e iluzione, sa më tepër afrohen, aq më të largët e më të huaj ndihen e bëhen ata për njëri-tjetrin. Ermira orvatet të kapërcejë paragjykimet klasore për hir të dashurisë, madje, të prishë edhe fejesën me aristokratën Petrit Kasimati, po gjithnjë e më qartë ajo e kupton se këtë mund ta bënte vetëm me një kusht: Qemali të shkëputej prej komunistëve dhe prej luftës kundër fashizmit. Patriotizmi i saj është fasadë fjalësh e deklaratah që fsheh prapa egoizmin e klasave shfrytëzuese, përbuzjen e tyre për popullin, gatishmërinë për të bërë tregti politike, mjaft që të mos u preken interesat klasore. Sado e çiltër dhe e ndershme, ajo nuk i shpëton degjenerimit politik të klasës së vet. Nga ana tjetër, Qemali bëhet gjithnjë e më i vetëdijshëm për interesat e popullit dhe vihet vendosmërisht në rrugën e luftës për çlirim kombëtar e shoqëror. Ky është një përfundim me rëndësi të madhe, një përgjithësim e tipizim i fortë letrar artistik i dukurive e proceseve reale, objektive.

Problemi: kush do ta shpëtojë Shqipërinë, që preokupon të dy palët merr përgjigje e zgjidhje nga procesi revolucionar dhe nisma historike e komunistëve shqiptarë. Ndërkohë, e ushqyer nga paragjykimet e klasës dhe e yshtur nga stima për politikanë të kallëpit të Mithat Frashërit, Ermira ka bindjen se fatet e atdheut duhet të lihen në dorën e tyre. Qemali i bën llogaritë duke marrë parasysh forcën e popullit të udhëhequr nga komunistët. Vetëdija e forcës dhe e drejtësisë popullore e bën gjithë më me peshë figurën e djaloshtit. Para tij «Ermira Velo nuk po e ndiente veten të zonjë të mbronte ato çka kish ndër mend. Ajo çuditej më shumë tani me gjallërinë që tregonte djaloshi në të folur, me forcën dhe qartësinë e mendimeve të tij». Megjithëkëtë, sa më tepër kohë kalon, aq më kryeneçe bëhet ajo dhe aq më thellë zhytet në llumin e intrigave e të poshtërsive të «elitës», aq më i pamundur bëhet vazhdimi i dashurisë së tyre. Autori e ndjek hap pas hapi këtë shndërrim, duke e motivuar me argumente klasore, morale e psikologjike.

Në fundin e pjesës së parë të veprës rrugët e dy të rinjve ndahen përfundimisht. Në roman krijohet nyja kyç e dy vijave, që ndërpresin njëra-tjetrën në kahe të kundërta, njëra duke u ngjitur e madhuar, tjetra duke rënë e zhvleftësuar. Ermira i kundërvihet hapur Qemalit pikërisht nga pozitat e «epërsisë». «Mua më quajnë Ermira Velo, — i thotë ajo, — dhe vij nga një familje që s'është aq mangut sa pandeh ti as nga kultura, as nga ndjenjat e atdhetarisë. Më kuptoni? Nuk jam as aventuriere unë, që të shkoj pas asaj turmës satë të verbër... amorfë... profane... aq të shtrenjtë për ty me shokë... Ku e ke elitën e vendit zotrote, ku? Apo tek ata komisarët e tu, që s'dinë nga mbahet pena?».

Në këtë çast Qemal Orhanaj nuk gjen fjalë tjetër për të karakterizuar vajzën veç fjalës: injorante! Pas-këtaj secili ndjek udhën e vet: Qemali pushtohet nga ndjenja e gëzimit për fitoren e popullit, kurse Emira Velo, që ka parë e jetuar rënien dhe perëndimin e botës së vjetër, struket mënjanë e papërfillur.

Rruga e dy të rinjve nuk është çështje vetjake e tyre, as diçka e veçantë. Ata janë përfaqësues të dy forcave të kundërta shoqërore. Prapa secilit qëndrojnë e veprojnë klasat dhe logjika klasore. Rreth tyre lëvizin interesat, idetë, idealet, hidhen në luftë partitë, thuren plane e ndërmerren aksione, dalin në skenë figura të tjera, që përbëjnë forcat reale në ndeshjet e ashpra politike. Dhe kompozicioni i romanit pëson ndryshime serioze. Ndërsa në pjesën e parë ai ka një ndërtim vijimor e të ngushtë, që lidhet me marrëdhëniet e dy të rinjve dhe ka më tepër meditim se aksion, në pjesët e tjera, me thellimin e kontradiktave ndërmjet. Qemalit dhe Ermirës, ai ndahet gjithnjë më tepër në dy degëzime që pleksen herë-herës me njëri-tjetrin në kontraste të ashpra. Sipas natyrës klasore të forcave ndërluftuese, zhvillohet edhe secili degëzim, duke e bërë më të zhdërvjelltë e më interesant kompozicionin.

Po të shikojmë degëzimin që merret me mjediset shoqërore të Ermira Velos, do të vëmë re se ai ndjek një rrjedhë të ngushtë bisedash, debatesh e konfliktesh në sallone e dhoma të mbyllura, ku vijnë edhe jehonat e jashtme, por vendimtare mbetet kurdoherë gjetja e marifeteve; për të dalë nga situata dhe për të hedhur në luftë «rezervat». Kalojmë para lexuesit Ajet Veloja me pikëpamjet e «neoshqiptarizmit» e të socialdemokracisë; Galip beu, xhahil e teveqel; Hajdar bej Kasimati me «kredi» antizogisti dhe, i biri, Petrit Kasimati — kokosh i fashizmit dhe reaksionar i bindur; mbi të gjithë — Mithat Frashëri «me bindjen» e patundur në gjeneralitetin e vet dhe me breroren e «patriotit të kulluar» në kokë. Më batakcju, po edhe më i rafinuari prej tyre, Afiz Turhani, e nuhat më mirë situatën dhe i kupton më qartë rreziqet që u kanosen.

Shevqet Musaraj nuk e përshpejton fundin e këtyre personazheve dhe as e ngushton veprimin e romanit në konflikte e intriga melodramatike. Skenë e veprimit dhe e ndëshkimit të tipave negativë është lufta e cila sjell edhe rënien e pashmangshme të «elitës». Nuk ishte

puna thjesht që të përshkruhej fitorja ushtarake e politike mbi ta, por të tregohej fundi logjik, i pashmangshëm i botës që ata përfaqësonin, të zbulohet ndyrësia e asaj bote, të dilte qartë se ç'fshihej prapa pompozitetit dhe shkëlqimit fals të këtyre njerëzve. Galipin e pushkatojnë partizanët, Backa vret veten, Petrit Kasimati hidhet në greminë, Ajet Veloja arrestohet e dikush tjetër arratiset për t'i shpëtuar dënimit. Këto përforcjnë te lexuesi bindjen për fundin e turpshëm të tyre, urrejtjen për ta dhe botën e tyre të poshtër. Kështu një prej meritave më të mëdha të shkrimtarit është se, duke shkruar një roman me temë politike, nuk i ka mbështetur shpresat në frazeologjinë politike të një tendencioziteti vulgar, po ia ka lënë rrjedhës historike të ngjarjeve të bëjë vlerësimet e të japë përfundimet, të kurorëzojë fitimtarët e ligjshëm e të ndëshkojë botën e vjetër të dënuar me vdekje.

Përballë kësaj bote të ndyrë e të mbyllur, shkrimtari ka përshkruar një botë tjetër të madhe, të hapur, të gjallë: botën e pasur e të ndritur të popullit që është ngritur në luftë. Pasqyrimi i kësaj bote përbën degëzimin tjetër kompozicional, që në përgjithësi lidhet me veprimtarinë e Qemal Orhanajt, i cili bëhet një prej drejtuesve të Komitetit Qarkor të Partisë në Tiranë. Degëzimi i parë është më i përcaktuar e më i ngushtë. Ky i ngjan më tepër një mozaiku të madh me shumë figura. Shkrimtari mund të kishte bërë punë më të madhe përzgjedhëse, t'u shmangej disa parantezave të gjata me episode të dorës së dytë, ku, pa qenë e domosdoshme, ndiqen me hollësi peripecitë e Qemal Orhanajt e të ndonjë personazhi tjetër. Por ndërtimi i romanit i përcilljet mirë pikësynimit të autorit për të paraqitur luftën në shtrirjen e saj epike, me dramat e të papriturat reale të saj. Sh. Musaraj e ka vënë veten përballë detyrës që të tregojë pjesëmarrjen e popullit në luftë jo si një «turmë amorfe» e udhëhequr nga «heronjtë», po si forcë masive, që mban mbi shpinë barrën më të rëndë dhe kryen çdo ditë heroizma. Qemalit dhe ilegalëve të tjerë u duhet të kalojnë nga një bazë në

tjetrën, të shikojnë fytyra të reja, të japin e të marrin me shumë aktivistë e simpatizantë të Luftës. Këta personazhe episodike janë dhjetëra. Pothuaj në çdo kapitull të romanit tregohet nga një episod prej heroizmit të tyre që, së bashku, formojnë tablonë e madhe të heroizmit popullor.

Shkrimtari me vërtetësi e saktësi ka paraqitur zgjimin e ndërgjegjes popullore, lartësimin e njerëzve të thjeshtë të edukuar nga Partia. Përballë Ermira Velos dhe «elitës» së saj nuk ngrihet vetëm Qemal Orhana, po shumë bij të popullit, që fitojnë ndërgjegjen e klasës dhe mësojnë të vërtetën e luftës e të revolucionit. Adijaja e përvuajtur, të cilën Ermira vetëm e ka mëshiruar, di të bëjë dallimin ndërmjet komunistëve dhe politikanëve «që të mysin me llafe të bukura për lirinë e Shqipërisë dhe nuk sakrifikojnë as fijen e flokut për të...». Kurse Demka «i rrugëve» di t'i japë edhe mësimë zonjushes.

«Qenke thëngjill i mbuluar ti, Demkë! S'të paskam njohtur, — i tha me një të qeshur therrës Ermira. — Kush t'i ka mësuar të gjitha këto?

— Partia! — u përgjigj pa asnjë ngurim dialoshi. — Kush do të më mësonte tjetër? Vetëm ajo mendon për të varfërit».

Zgjerimi i vazhdueshëm i sferës së interesimeve të shkrimtarit, detajimi i subjektit dhe ritmi më dinamik i ngjarjeve në pjesën e dytë të romanit janë diktuar nga vetë realiteti, nga pasuria e fakteve dhe shndërrimet e vullshme që ndodhnin. Edhe kur episodet përshkruhen me hollësi, lexuesi ndien se në to zotëron një ritëm në pritje vëmendia e titë ndiek shumë ngjarje, shumë personazhe nërjeton situata nga më të ndryshmet e të «parashikueshmet». Shevçet, Musarai, i është përmbaiftur determinizmit historik dhe është përmbajtur që të mos thurë një subjekt të mbyllur. Ai është nisur të rrasovroie jetën politike të kryeqytetit në një periudhë plot lëvizje, trazira, të papritura, ku nuk ka shumë nge për meditime, heronj kryesorë haher njerëzit e veprimit revolucionar. Pasuria e materialit, përshtypjet e shumta



e të freskëta nga jeta në kuadrin e veprës janë ndër faktorët më me rëndësi që kanë bërë të shmanget skemalizmi dhe shtampat në pasqyrimin e Luftës dhe të njerëzve në luftë.

Por ndihet nevoja që shkrimtari të përqendrohej më tepër në disa momente kyçe, t'u kishte dhënë më tepër mundësi disa prej personazheve kryesore të zbulonin më mirë botën e tyre të brendshme, motivet që i bëjnë të veprojnë. Shkrimtari, i kursyer në portretizimin fizik të personazheve, në përshkrimin e mjedisit, në analizat psikologjike e në zbulimin e gjendjes shpirtërore, tregohet mjeshtër në përshkrimin dhe në dhënien e situatave ku duken më së miri edhe lëvizjet më të vogla që ndodhin në qëndrimet politike dhe në shpirtin e njeriut. Disa herë vetëm me një përshkrim të shkurtër ai e fut lexuesin në atmosferën dhe ndryshimet e kohës. P.sh. në kapitullin e shtatë të pjesës së parë tatë-pjeta e fashizmit jepet nëpërmjet përshkrimit të ndryshimeve që kishte pësuar Petrit Kasimati, i cili «me gjithë gradat që mbante akoma... nuk ishte më ai oficeri bukurosh kapadai i afro dy vjetëve të kaluara, me cullufet e dredhura dhe me faqet ngjyrë trëndafili si të vajzave». Ose të kujtojmë përshkrimet për Tiranën, pas kapitullimit të Italisë, kur gjermanët kurdisën lodrën demagogjike «të mosndërhyrjes». «Në postbllokun e rrugës së Shëngjergjit, pranë teqesë, kishin zënë vendin e kapterit të rojës disa fëmijë, që me një kapele xhandari në kokë dhe me nga një copë dërrasë të hedhur krahëqafë në vend të pushkës, u dilnin përpara kalimtarëve e, duke marrë pozën e kapterit, u thërrisnin «Alt! Ku shkon? Letërnjoftimin!».

Me ndryshimin e gjendjes, rrugët shkretohen: «Dyqanet hapeshin vonë e mbylleshin shpejt dhe ata pak banorë të qytetit, që dukeshin rrallë, ndiqnin më tepër rrugicat e pazarit të vjetër, blenin shpejt e shpejt gjërat më të nevojshme dhe ktheheshin nëpër shtëpitë e tyre të hutuar, të heshtur, me zemrën helm e kokën të rënduar nga lloj-lloj mendimesh».

Ballafaqimi i Qemal Orhanajt me Petrit Kasimatin

në kapitullin e gjashtëmbëdhjetë të pjesës së gjashtë, shkruar me mjeshtri të rrallë, jep portretin e plotë të tipit shogënor të një reaksionari të bindur e njeriu të shtazëruar. Duke kujtuar takimin me të Qemali shënon dialogun ku del egoizmi i Kasimatit në «dashurinë» ndaj Erminës:

«S'të thotë mendja se mund të ketë dashuruar ndonjë tjetër? — e ngacmova unë, me qëllim që të vijonte dhe i zgjata cigaren e nyrë»

— Ndonjë tjetër? — pshierëtu ai. — Kështu kishin menduar edhe ta maq të mi. Po jo, jo. — Krembeu cigaren, e ndezi në minutë dhe, si e thathi fort dy herë rresht, shtoi duke lëshuar tymin në drejtim tjetër, që të mos më bezdiste mua!

S'ka dashuruar tjetër ajo. Jam i bindur për këtë. Epo atëherë të ka urryer për idetë e tua, — ia plasa unë. — Për këmishën e fashizmit, që veshe pa ardhur mirë në Shqipëri. Përsë tjetër mund të të urrente?

E pashë që u prek shumë dhe iu desh kohë që të rimerite fjalën:

— Po të mos kishe përmendur këtë, sigurisht s'do të më kushtonte gjë ta hiqja për hir të saj dhe këmishën e zezë.

— Të sakrifikoje idealin për dashurinë, — më shpëtoi mua fjala pa dashur dhe qesha.

Ai ngriti kokën dhe më shikoi me urrejtje:

— Kjo do të thotë se s'keni dashuruar ndonjëherë seriozisht dhe as që mund të kuptoni se ç'është forca e dashurisë. Nuk mund të kuptoni jo...

E lashë të shfrenatë...

— ... Mjafton t'ju them, zotëri, se unë e kam pasur në dorë ta grabitja, ta përdhunoja dhe ta zhdukja edhe nga faqja e dheut atë vajzë, kështu që asnjë tjetër, përveç meje, të mos gëzonte visaret e saj... Po unë s'arrita gjer aty, se s'më la forca e dashurisë që kisha për të. Dhe s'bëra mirë. Më kuptoni? S'bëra mirë.

— Ju kuptoj, — shtrengova dhëmbët unë. — Në

gjuhën e inteligjencës ka edhe kjo emrin e saj, në mos gaboj. I thonë sadizëm, apo jo? Njeri i ndyrë!...

Shkrimtari nuk është rrekur pas hollësiye sentimentale. Ai ka treguar jetën, ka shpalosur disa faqe të historisë, për të provuar se cila ka qenë bota që duhej të përmbysj dhe u përmbys dhe cilët qenë njerëzit që i çelën shtigjet botës së re. Emocionaliteti i veprës përmbahet, para së gjithash, në realitetin që pasqyrohet në të dhe në idetë që e përshkojnë. Prandaj mund të thuhet me plot gojën se «Para agimit» është vepër nga e cila njeriu mëson shumë vepër që vlen të lexohet me vëmendje, për të njohur të vërtetën e një periudhe historike, ku ka rrënjët jeta jonë e sotme socialiste. Nga kjo pikëpamje, me gjithë ndonjë dobësi kompozicioni e me retorikë agitative vende-vende, romani i Shevqet Musarajt është një ndër veprat më në zë të detërsisë sonë të sotme, që përmes thirrjes e figurave artistike sjell material të pasur dokumentar dhe dëshmon për vlerën e paçmueshme që kanë njohja e përjetimi i realitetit për krijimtarinë artistike.

## VI

Vepra letrare e Shevqet Musarajt, krahas krijimtarisë sonë më të mirë, ka ushtruar e do të ushtrojë ndikimin e vet në edukimin komunist të njerëzve tanë me forcën e pasqyrimeve realiste, të ideve që e kanë frymëzuar dhe me vlerat ideoartistike që ka. Në të njerëzit do të gjejnë jetën, punën, luftën, brengat e gëzimet e popullit, fjalën e tij të thjeshtë e të bukur, virtytet e tij të larta, heroizmin popullor, shembullin e sakrificave e të vetëmohimit, urrëjtjen për armiqtë dhe për vjetërsirat, humërin e gëzuar dhe satirën fshikulluese, besimin e patundur në të ardhmen, gatishmërinë për t'i shërbyer atdheut në çdo rast.

Në të gjithë veprën e Shevqet Musarajt zotëron një atmosferë e shëndoshë dhe e sigurt popullore.

Si në veprat e gjera epike, edhe në tregimet e shkurtra, në skica e në shkrimet publicistike problemet e trajtuara janë shqetësime të masave të gjera, burojnë nga jeta e këtyre masave dhe shqyrtohen e zgjidhen nën prizmin e interesave, prarjëve e të aspiratave të tyre.

Fryma popullore që përshkon veprën e Shevqet Musarajt është përftuar nga pasqyrimi i jetës shqiptare në fshat e në qytet, në mjedise e periudha të ndryshme. Ajo përmbahet jo thjesht në prirjen e shkrimit taqit për të paraqitur mjedise dhe karaktere popullore, por në idenë e luftës e të përpjekjeve për realizimin e idealeve të popullit. I nisur nga e vërteta e jetës ai ka paraqitur në realizëm forcën e madhe shndërruese që kanë pasur dhe kanë në zhvillimin e revolucionit Partia, komunistët, masat punonjëse, njerëzit e pararojës dhe idetë e marksizëm-leninizmit.

I pushtuar nga dashuria për popullin dhe për njerëzit e thjeshtë të punës e të luftës, shkrimtari nuk i ka idealizuar ata, po i ka paraqitur siç janë: të madhërisëm në historinë, në heroizmat dhe në thjeshtësinë e tyre, por edhe si njerëz në mendjen e në ndërgegjen e të cilëve s'ka si të mos rëndojnë akoma disa trashëgime të këqija të së kaluarës, të mjerimit, të skllavërisë e të errësirës që kanë sunduar mbi ta. Por edhe për çlirimin shpirtëror të masave, si forcë kryesore prapë është paraqitur populli i udhëhequr nga Partia dhe jo ndonjë hero me virtytë të rralla, çuditëse. Sado e vështirë, disa herë dhe me dhembje e trazime të forta, edhe lufta për çlirimin shpirtëror të njerëzve duhet të bëhet vepër e vetë masave.

Lidhjet me popullin, me jetën e masave punonjëse kanë gjetur pasqyrim të plotë në tematikën, në idetë që kanë udhëhequr shkrimtarin, në materialin jetësor që ai ka përdorur për trajtimin e temave dhe në shprehjen e ideve. Në rrethanat tipike dhe historikisht konkrete të revolucionit e të ndërtimit të socializmit janë zbuluar në vepra situata të ndryshme epike, dramatike e komike, janë krijuar tipa e karaktere të spikatur,

është shprehur mendimi i masave, është përdorur me shije dhe efekt frazeologjia popullore.

Në krijimin e situatave, në përshkrimin e mjediseve, në karakterizimin e personazheve e të përjetimeve të tyre vërehet një autenticitet popullor, saktësi dhe thjeshtësi e madhe, larg çdo prirje intelektualizante. Rrallë shkrimtari komenton, arsyeton dhe filozofon. Mendimi përmbahet në jetën e pasqyruar, në rrugën që marrin konfliktet e paraqitura, në veprimin e personazheve. Por, kur duhet, personazhet e deklarojnë gartë dhe hapur pozitën dhe bindjen e tyre, bëjnë agjitacion revolucionar, në përputhje me rrethanat, në harmoni me stilin e veprës në tërësi. Dhe, zakonisht, përjetimet dhe arsyeimet e personazheve pasqyrojnë situatat e dhëna dhe ruajnë në komunikim natyrën e thjeshtë të një çiltërsie popullore, ku edhe të vërtetat më të mëdha, mendimet më të thella e përjetimet më tronditëse jepen në një formë tepër konkrete e të besueshme. Kështu ndodh dhe në rastet, kur autori hedh dritë në gjendjet shpirtërore të personazheve ose kur këta vetë meditojnë për jetën, për vetveten e për gjendjen në të cilën ndodhen. Spekulumet intelektualiste janë të huaja për Shevqet Musarajin. Sepse, siç thotë autori në romanin «Parë agimit», «... Që të kuptohesh me popullin, duhet të jetosh me të, t'ia njohësh plagët, të mësosh shumë gjëra prej tij». Vetëm kështu mund të arrihet të pasqyrohen me besnikëri jeta, bota shpirtërore dhe karakteret popullore dhe personazhet të mos jenë mishërime letrareske përfytyrimesh subjektive.

Duke ndjekur këtë parim, në tregimet e novelat ku pasqyrohet jeta e fshatrave të Labërisë, autori ka ruajtur në stil edhe ngjyrat lokale, kurse në rastet e tjera mënyra e tregimit merr trajta më të përgjithësuara, pa u larguar asnjëherë prej shtratit popullor. Fryma popullore nuk është një shfaqje e jashtë stili, po është natyrë e vërtetë e çdo veprë. Ajo përmbahet në orientimin tematik të krijimtarisë, në botëvështrimin e shkrimtarit, në psikologjinë e personazheve, në humorin, në mënyrën e të arsyeuarit e të të vepruarit, në gjuhën

e tyre. Ajo përmbahet gjithashtu, në mënyrën e të rrëfyerit, në strukturën e veprave, në ndërtimin e subjekteve, në mënyrën si shtrihen, trajtohen e zgjidhen artistikisht konfliktet. Kjo të bëjë në sy veçanërisht në tërësimet e në novelat ku duket sikur shkrimtari kujdesin kryesor e ka që të pasqyrojë një copë jetë në pamjen reale të saj, të flasë ashtu siç ndien e mendoi njëri i luftës dhe i punës.

Në veprat e Shevqet Musarajt vihet re një ndjeshmëri e hollë, e fortë dhe e sprovuar politike. Duke qëndruar kurdohere në pozita të drejta ideopolitike, si shkrimtar komunist, ai shpesh u është përgjigjur flakë për flakë kërkesave të kohës së Luftës dhe momenteve më të rëndësishme të jetës shoqërore e politike pas Çlirimit. Temat e trajtuara prej tij janë përthyerie artistike e kërkesave dhe realizimeve shoqërore e politike në jetën e vendit.

Kupimi dhe trajtimi politik, revolucionar i problemeve përmbahet, në vetë frymëmarrjen e veprave e në këndin e shikimit të çështjeve. Cilado, qoftë tema e veprave për problemet, gjykohet, në radhë të parë, politikisht, në prizmin se kujt i shërben, në dobi të kujt është. Tendencioziteti politik varet re qartë përfundimisht në çdo motiv e në çdo episod me rëndësi. Shevqet Musaraj ka provuar në veprat e veta se pikërisht zbatimi i politikës marksiste-leniniste është mishërim e burim i humanizmit të vërtetë revolucionar. Do të mjaftonte të kujtonim ortimin e Qemal Oshanajt për rrugën që merr Ermira Veqaja, kritikën që i bën Llaz Qesaraj qëndrimit sektar të Vangjel Kushit; kuptimin që i jepet kritikës ndaj Pasllit Çunit në novelën «Dritë»; zemërimin ndaj shkaktarëve të brëngës së nënë Fizes në tregimin «Brëngë nënë» etj. Dashuria për njeriun e popullit përshkon të gjitha veprat si një motiv kryesor, që i bën më të prekshme urrejtien për armiqtë e revolucionit dhe adhurimin për revolucionarët.

Në afro gjysmë shekulli veprimtari letrare Shevqet Musaraj ka përkthyer rrugën e shkrimtarit të lidhur ngushtë me popullin e historinë e tij: me lëvizjen demokratike revolucionare, me Luftën Nacionalçlirimtare, me revolucionin socialist, me Partinë. Ai ka sjellë në letërsi tablo përgjithëse dhe origjinale mbi jetën e popullit, botën e pasur dhe aspiratat e tij.

Vepra e Musarajt është afirmim i idealeve tëna revolucionare, ka një fizionomi të qartë popullore, kombëtare e socialiste, frymëzohet e përkohet në çdo ind nga partishmëria proletare. Ajo është një prej dëshmive më të mira të rrugës që ka ndjekur dhe e sukseseve që ka arritur gjithë letërsia jonë e re, shembull mishërimi në krijimtari të kërkesave e tipareve të realizmit socialist, shembull origjinaliteti, mjeshtërie dhe realizmi.

1979

VEPRA LETRARE E DHIMITËR S. SHUTERIQIT

(poëzia dhe tregimi)

Brezat takohen dhe është lumturi kur ndjekin njëri-tjetrin në rrugën e madhe të pambarim të jetës së popullit, «... që shkon tutje dhe s'ndalet», që «veç ndryshon e prapë diç i mbet nga dje».

Kështu ndodh dhe në letërsi. Ne, që nisëm të vijmë valë-valë në letërsi në vjetët e parë pas Çlirimit dhe që tanë po thinjemi, u mëkuam në moshën e rinisë sonë me një copë misërnike, po dhe me një ndjenjë të pashembullt optimizmi dhe entuziazmi që zgjonin në zemrat tona liria, shndërrimet socialiste, lufta dhe puna e popullit, Partia. Vargjet e poetëve, skicat dhe tregimet e para të prozatorëve tanë të rinj, të rinj në moshë, në letërsi, në ideale, na i shtonin dhe më tepër entuziazmin. Ata, duke u ngritur mbi vështirësitë dhe hallet e shumta, i këndonin me iltërsi mendimi e frymëzimi jetës sonë të re, luftës sonë, Partisë dhe ëndrrave komuniste. Tok me jehonën e Luftës heroike ata sillnin dhe hovin shpërthyes të vrullit revolucionar. Entuziazmoheshim ne se kishim tanimë letërsinë tonë të re, shkrimtarët tanë të revolucionit, veprat tona letrare.

Lexuesi i ri sot nuk mund të marrë me mend ç'gëzim sillnin numrat e revistës «Literatura jonë», vjershat, poemat, përmbledhjet e para me skica e tregime, të pakta në numër, në vëllim e botuar teknikisht dobët.



«Epopeja e Ballit Kombëtar», «Enverit», «Ashtu, Myzeqe!», «Prishtina», «Pika gjaku», «Nga jeta në luftë» ishin gëzim i madh për ne që, po jetonim formimin e kësaj letërsisë.

Prej përfaqësuesve të parë dhe më veprues të letërsisë së re u mësuan ta shikojmë e ta kërkojmë shpesh e më shpesh emrin e Dhimitër Shuteriqit, sikurse emrat e Shevqet Musarajt, Aleks Çaçit, Lllazar Siliqit, Kolë Jakovës, Fatmir Gjatës, Luan Qafëzezit, Zihni Sakos dhe ca më vonë dhe të shkrimtarëve të tjerë të rinj e të atyre që njiheshin më parë e kaluan në pozitë e realizmit socialist si, Nonda Bulka, Sterjo Spasse etj.

Dhimitër Shuteriqi, si dhe Shevqet Musaraj, Andrea Varfi e ndonjë tjetër, hynte në letërsinë e realizmit socialist si në një shtëpi në derën e së cilës kishte vite që po trokiste. Ai, megjithëse nuk arriti të bëhej një shkrimtar i njohur para Çlirimit, siç ishin Migjeni, Nonda Bulka, Haki Sterni, Sterjo Spasse, që në moshë fare të njome provoi më aftësi forcat në fushën e letërsisë. Libri i tij i parë me vjersha «Këngët e rinisë së parë» ishte botuar që më 1933 dhe, fill pas një viti pa dritë dhe përmbledhja e dytë poetike «Këngë», që u përshëndet nga letrarët më përparimtarë të kohës. Në këngën e Dhimitër Shuteriqit, atëherë liceist — siç shkruante në shtator 1936 Andrea Varfi — «... një botë kërkon të thotë fjalën e saj. Ajo botë që: «... mbi një shamë të kuqe e ka shtruem/ bukën e trashë prej misri t'verdhë.../dhe qepen e njomë».)

Më qartë mendimet dhe idealet për një letërsi të re kombëtare, popullore, realiste dhe bashkëkohore në brendi, në formë dhe në mjetet shprehëse Shuteriqi i paraqiti në artikujt «Drejtimit e reja letrare» botuar në revistën «Bota e re» si dhe në shkrimin «Arti i Migjenit».

Eshtë koha kur Shqipëria, e përfshirë në krizën e

1) Andrea Varfi, «Manifestime të një kënge të re» (shih: N. Jorgaqi, «Antologjia e mendimit estetik shqiptar», T. 1979, f. 430).

përgjithshme të kapitalizmit, e varfër, e prapambetur, e sunduar nga klika feudo-borgjeze, ziente e gulçonte. Lufta e masave kundër shfrytëzimit ekonomik e shtypjes politike ndërthurej në një nyjë të vetme me shqetësimin e madh për fatet e vendit rënë në kthetrat e imperializmit. Kjo gjendje shpuri në aspirimin dhe shtrirjen më të gjërë të luftës së klasave, të terrenit nga lindi dhe u zgjerua lëvizja komuniste në Shqipëri. Me këtë lëvizje u bashkuan intelektualë të rinj, me revolucionarë dhe letrarë të përparuar. Për orientimin dhe gjallërimin e talenteve të reja shërbeu mjaft revista «Bota e re», që botohej nga Grupi Komunist i Korçës. Në këtë revistë bashkëpunoi Migjeni dhe botuan shkriimet e tyre letrare përparimtarë e revolucionarë të kohës si Misto Freska, Kristaq Cepa (Kapa), Dhimitër Shuteriqi etj. Këta përfaqësojnë në lëvizjen për «drejtme të reja letrare» — shprehje e luftës kundër letërsisë laikatare e konformiste, obskurantizmit fetar dhe agresivitetit reaksionar klerikal, depërtimit të letërsisë e të artit dekadent borgjez si dhe kundër formalizmit, «asnjanësisë», anakronizmit, romantizmit të sëmurë dhe çdo shfaqjeje që i shkaktojnë letërsinë dhe artin nga populli, nga idealët demokratike e kombëtare, nga problemet e mëdha e të mprehta që shtronte jeta.

«Drejtmet e reja letrare» nuk ishin realizëm socialist. As përfaqësojësit më entuziastë të tyre nuk ishin letrarë realistë socialistë. Pa ata kërkonin ndryshime rrënjësore në konceptimin dhe pasqyrimin e realitetit, donin të niseshin nga populli e t'i drejtoheshin popullit, të futnin në vargje jo vajtim e brëngë, po militantizëm. Se ishte koha, sic shkroi më pas Dh. Shuteriqi, kur «...mbi horizonte, nga oqeani në oqean, / Lenini ngrinte grushtin e buzëgëshjen / dhe Ali Kelmendi sapo na mësonte / të belbëzonim të vërtetën qartë...» («Poemë e pambaruar», 1972).

Në këtë atmosferë hodhi hapat fillestarë të guximshëm e me interes dhe dha ndihmesën e parë në letërsinë e kohës Dhimitër Shuteriqi, anëtar i Grupit Komunist të Korçës dhe, pasi u kthye në atdhe prej stu-

dimeve, anëtar (nga viti 1943) i Partisë Komuniste të Shqipërisë (sot Partia e Pënpës).

Në fillimet e veprimtarisë letrare të shkrimtarit, duke gjykuar nga botimet e asaj kohe, por edhe nga ndonjë material që nuk mundi të botohej atëherë, arrijmë në përfundimin se vihen re simptoma të qarta të zhvillimit të mëvonshëm. Këto e bëjnë një proces të natyrshëm e logjik kalimin, e tij në pozitën e realizmit socialist si edhe pjesëmarrjen në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe punën shumë të frytshme pas Çlirimit në fushën e arsimit, të kulturës, të letërsisë e të arteve të realizmit socialist.

Parashtimin e parë, si të thuash, programatik, për letërsinë Dhimitër Shuteriqi e dha në artikullin «Drejtimet e reja letrare». Në artikull përkrahen e argumentohen përpjekjet e shkrimtarëve të rinj për një letërsi «... kombëtare, realiste, shoqërore». Kjo letërsi, që, sipas Shuteriqit, i ka dhënë provat e para shpresëdhënëse, «... duke folur për popullin... bëhet taman kombëtare...», me një «origjinalitet më shumë kombëtar...». Për të qenë vërtet e tillë, kjo letërsi duhet të përshkohet nga fryma bashkëkohore dhe nga ndjenja e perspektivës. «Ne, — thuhet në artikull, — duam njerëz që rrojnë me të sotmen, njerëz me gjallëri dhe me shikim për nesër. Vetëm ata që rrojnë për kohën e tyre, vetëm ata mund të shikojnë në të ardhmen e tyre, vetëm ata mund të japin shpresa». Ai tallet hidhur me ata që rrojnë me të kaluarën e me kurorat e dafinave të së kaluarës. Në vjershën «Gotterdammerung» (1935), duke na sjellë ndër mend «Na t'bir e shekullit të ri» të Migjenit, shkruan:

*Po qeshim na për ta, qeshim me ta.  
Qeshim, se dëshprimi  
dhe t'zymtit, që rrojnë vetëm me të shkuemen,  
janë prapsina dhe helmi i jetës...  
Ngadhnjimin e botës, po!  
Fitim'n e mendjes!  
Fundin e andrrës shterpë të vjetër...*

Letërsia e re duhet të jetë realiste, se «vetëm e vërteta të shpie në përparim. Duhet të themi të vërtetën. Duhet të mundohemi të jemi realistë me sa të jetë e mundur më shumë». Dhe, mëqë «shoqëria e bën artin për nevojat e saj» dhe vetë është në zhvillim të përherëshëm, letërsia e re «duhet të ketë si qëllim kryesor përshkrimin e kritikën e shoqërisë». Romantikët, shprehjet kategorikisht shkrimtari i ri (ndonëse vetë ka doza të dukshme romantizmi në krijimtari) «... nuk na hyjnë në punë, qofshin a s'qofshin të sëmurë». Sa për formalizmin, as që diskutohet: «Që atëherë kur ne do të përpiqemi të bëjmë artin vetëm për art, që atëherë bëjmë një sofizëm».

Shuteriqi shpreh besimin se, duke ndjekur këtë rrugë e këtë «plan veprimi», letërsia do të fitojë vlera të mëdha shoqërore dhe do të jetë bazë për zhvillimet e ardhshme. Ai shkruan për drejtimit e reja letrare se: «Kjo literaturë e re do të jetë një shembull nxitës për brezin e ardhshëm, do të jetë një bazë ku ai do të mbështetet pa frikë. E atëherë do të shohim edhe qëllimin tonë të shkëlqejë, në mos shkëlqeftë që sot me veprën e ndonjë shoku gjenial.. Ajo që vlen më shumë, pra, është të mëjtuarit për nesër. Puna jonë do mundime, do sakrifica. Ajo pret nga ata që duan kontribin të përparuar. Egoistët, që punojnë vetëm për kënaqësi të pamërituara, kur bëjnë vepra pa vlerë për popullin ata nuk janë shokët tanë, ndofta janë edhe armiq të tanë».

«Shok gjenial» të letërsisë së re ai, me të drejtë, çmon Migjenin, se «...në të gjejmë prijësin ma të vlefshëm të një rryme poetike, që nesër mund të zają një vend me randësi të parë në literaturën tonë». Dhe nuk e pati gabim.

Diskutimi për «drejtimit e reja letrare», në të cilin nuk është e vështirë të dallosh ndikimin ideologjik të Grupit Komunist të Korçës, ishte tepër i gjallë. Në Shqipërinë e «dyzet opinioneve», siç e cilësonte Selim Shpuza asokohe, do të ishte pa vend të kërkoje, sidomos nga letrarët e rinj, një pjekuri marksiste dhe një

konsekuencë shkencore në mendime dhe në programet e tyre. Kështu dhe të Dhimitër Shuteriqi, si në artikuj, edhe në vjersha. Në mendimet e shprehura në artikull nuk janë të rralla kundërtitë, madje, dhe mendimet pa bazë e të gabuara, që bien në sy sidomos në pjesën e dytë të tij. Pikëpamjet e autorit për një «objektivitet njerëzor» si kusht realizmi, për «homogjenitet kombëtar», që do të arrihej prej «homogjenitetit për bukuri në mes disa djemve e disa çupave më të zgjuar e më të vlershëm» si dhe mendimi se «drejtimit e reja letërarë» nuk kish ku e pse të mbështeteshin në traditën e letërsisë kombëtare, po duhet të përfitonin «nga shkrimet më të mira të popujve të ovtetëruar» se «atje do të gjejmë drejtime të sigurta...», jo vetëm që do t'i quajmë të gabuara, po dhe në kundërshtim me vetë pikësynimet themelore të autorit. Me bindjen se letërsia duhet të jetë realiste, ai shfaq njëherësh dhe rezervën se «... disa të rinj më të zotë» mund të bëjnë realizëm e, «më anë tjetër», të vazhdojnë «punën e mëparshme», d.m.th. të ndiekin rrymat jorealiste si simbolizmi etj. Reflekse ndikimesh romantike e simboliste u vërejtën dhe në disa kriime të hershme të autorit, në të cilat poeti i ri ndjek simbolistët francezë, duke iu larguar në ndonjë rast vetë objektit njerëzor-shoqëror të poezisë. Këto si dhe njëfarë prirje intelektualizante kanë qenë «sëmundie foshnjore» kurse doza racionalizmi do të vërehen edhe në kriime të mëvonshme.

Po çdo gjë do gjykuar lidhur ngushtë me kohën e vet, me atë që sjell të re e përparimtare në krahasim me paraardhësit e me të kaluarën. Nga kjo pikëpamje mendimet e Dhimitër Shuteriqit si dhe vjershat e tij të periudhës 1935-1943, me gjithë lëkundjet, turbullirën, shkarjet e mangësitë, në tendencën kryesore të tyre dhe në pjesën më të shëndoshë dëshmojnë për një prirje nga itëse, të vazhdueshme e të vetëdijshme ideo-artistike, që ka cuar ca nga ca në formimin e koncepteve të arta e të plota realiste socialiste, pjesërisht që në kriimet e viteve 1943-1944 e, gjithnjë e më duk-

shëm, në krijimtarinë poetike të tij në dekadat e ndër-  
timit socialist të vendit. Kjo vërehet qartë në kuptimin  
që i jep shkrimtari poezisë dhe në vendin që i cakton  
poetit në jetën shoqërore në vjershën «Veritas?», me  
të cilën çelet përmbledhja «Kangë?» (1936) te vjersha  
«Një poeti neutral» (1944) e, së fundi, te «Këngë e re»  
(1962), që të përmendim kështu vetëm nga një për çdo  
fazë me rëndësi të veprimtarisë letrare të tij.

*Këndova kangën teme, që shkoi të kërkojë dritën  
nëpër sketërrë të jetës, ku shpirti s'qe dridhtuem.  
Dhe një herë thellë e ndjeva shpirtin tem të  
munduem,  
po lot nuk derdha më.*

Me këto vargje çelet fleta e parë e librin «Kangë?»,  
nga ku Andrea Varfi merr shkas të nxjerrë përfundimin  
e guximshëm revolucionar: «Duhet ndërruar mënyrë.  
Duhet më gjallëri. Vaji dhe brenga, gjersa mbeten ve-  
tëm në atë stad, gjersa nuk japin shkas për sulmë të  
reja, s'janë gjë. Duhet më militantizëm!»<sup>1)</sup>  
Përmes një trazimi ndjenjash e mendimesh, kon-  
statimesh të dëmbshme dhe aludimesh metaforike,  
gjejnë shteg të shfaqen idetë e luftës, idealet për një  
të ardhme të ndritur, besimi në forcat e përparimit dhe  
dëshira për fluturime në një jetë të lirë.

*Breshnohu, o kangë!*

*Thërrmohu, sot që poterja e vrazhdë,*

*pa krye e fund,*

*në jetë i thër me gaz t'pashpirt,*

*shpirtinët që të krijojnë!*

*Më gaz t'pashpirt, që del nga helmi i zi,*

*djersa përcëlluese, që i përcëllon dhe zemrat,*

*thunëriomështrin, zhdruk dritën, tue krijuem*

*një flakë të re gjallnie për t'këndue*

1) Po aty.

*veç at'herë kur gjithë zemrat të ndriqohen,  
kur t'këndojë jeta e tanë!*

(«Breshknohu»)

Hamendje mund të ketë shumë, siç mund të ketë edhe skeptizëm. Për ç'ideal bëhet fjalë? Pa mëdyshje, mund të thuhet se kemi një aspiratë shndërrimi revolucionar demokratik. Arrijmë në këtë përfundim nga vjersha vetë, po dhe nga Korça e lëvizjes punëtore dhe e grevës së urisë, nga përfshirja e autorit në lëvizjen komuniste shqiptare; nga ekzistenca e njohja e të parit shtet socialist, shtet i punëtorëve dhe fshatarëve. Gjejmë të njëjtën aspiratë edhe në vegimin romantik të vargjeve:

*O shpirt i ri,  
o shpirti em!  
Si ta ndalim këtë sulm  
me dritë, që shkëlqen jetën tej në pambarim  
dhe shikon jetën t'ngrihet deri në kulm,  
me himne ngadhënjimi, në kuqllim  
t'agimit zemërhapët e qeruem?  
Si nuk e thue mbi helmën e pashuem  
at kangë për shpresën tande të vërtetë?  
Shpresa e një dite, t'nesërme gjithë jetë  
lumnie t'pastër, a lumni e vërtetë.*

(«Kujtim»)

Siç pohon autori, vjersha u shkrua pas Grevës së Bukës në Korçë në shkurtin e vitit 1936. Kjo përforcon idenë e lidhjeve me lëvizjen punëtore dhe frymëzimin nga përmbajtja e saj. Poeti i ri, që bënë nuk do ta so-disë prapa një xhami të gartë, po do era t'i pickojë fytyrën («Pa tis»), domosdo do t'i drejtohej «Një poeti neutral» me pyetjen therrëse dhe akuzuëse të popullit: «Ku ishe ti?».

Vjersha, e shkruar më 1944, është ndër më të fry-

mëzuarat, më të fortat dhe më të qartat, se në të janë shkrirë idetë dhe idealet e njohura të poetit (kujtojmë: «ata nuk janë shokët tanë ndofta janë edhe armiqtë tanë»), përvoja historike e Luftës Nacionalçlirimtare dhe liria e shprehjes së hapur e të saktë të mendimit, pa frikën e censurës dhe «marifetët e stilit» për t'i shpëtuar asaj. Kështu, në vjetët e mëvonshëm rrjedhin natyrshëm në të njëjtin shtrat ideoartistik «Orkestr' e dëshur bie te dera» (1959) dhe «Për ditën e re» (1962) — vijersha të shkruara në kohën kur gjithë zemrat janë marrëcuar dhe këndon jeta e tërë, kur dufeve të dikurshme në vargje ia zenë vendin fryma optimiste, entuziazmi dhe thirrjet frymëzuese e mobilizuese:

*Gumo në dallgët njerëzore,  
sulmo n'radhët punëtore,  
lulzo në kopshtet rinore,  
me ngjyrë agimi shkruaj.*

*Dhe të gëzosh apo të vuash,  
dhe të urresh apo të duash,  
ti gjoksit shkëmb-ja ruash,  
me ngjyrë agimi shkruaj.*

Kjo rrugë e poezisë, kjo bëtë e poetit është shprehur vijueshëm në krijimtarinë e shëndoshë poetike të Dhimiter Shuteriqit, sidomos në vëllimin «Kangë?» (1936), «Mi krahn' e pruar të paqës» (1950), «Këngë» (1961) dhe «Poemë e pambaruar» (1972). Në krahasimin e krijimtarisë poetike të vjetëve 1935-1941 me atë të periudhës 1941 e këtëj bie në sy ngulmimi i autorit drejt qartësisë, thjeshtësisë së formës, theksimit të frymës popullore dhe, domosdo e mbi të gjitha, pasurimi në motive, krijelltësia përherë e më e madhe ideore. Realiteti i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe i ndërtimit të socializmit, vepra frymëzuese dhe puna orientuese e Partisë, sukseset e letërsisë e të arteve kanë lënë gjurmët e tyre dhe në krijimtarinë poetike të Shuteriqit. Janë bindje e synim i shkrimtarit që t'i këndojë jetës



dhe të ecë me ritmin e kohës, të ndihet zëri i tij në «orkestrën e madhe» të poezisë së re shqiptare, mbase jo si violinë e parë, po prorë me ngjyrimin e spikatur individual artistik.

Bota e poetit, në periudhën e parë të krijimtarisë së tij, në formë përthyerjesh, tablosh, shprehje aspiratash dhe thirrje, përfshin urrejtjen dhe përbuzjen për shtypjen e për shëmtimet e jetës, dhimbjen për «mjerimet e botës», dufet e një shpirti në brengë e në shpërthim, revoltën e brendshme me afirmim idealesh të reja, kërkimin e vazhdueshëm e të etshëm të bukurisë e të lumturisë së vërtetë edhe në «jetën skëterrë».

*Si fishkëllin!  
Gjithë jeta nxin  
e vuan.*

*Dëgjo klithmat e largëta si lajmërojnë  
vajet e vargut t'gjatë pa punë,  
pa bukë, që tue u tha n'prag, pret ta  
kujtojnë,  
të shohin se si vuen.* («Era»)

Në këtë jetë që nxin, endet njeriu «... vetull vranuem mbi shifra pa stoli e zhytë në fëlliqni». Rinia «shkon e s'di ku shkon, ecën e s'di pse ecën, ecën me mendjen n'erë»: lypsi endet katund më katund gjersa «t'shuem'n e shoi ndër andrra t'idhfta prroi me dallgë pa fre» («Lypsi»). Përplasjet peshkatari me dallgët, lopotëthyer, kurse të nesërmen «nië barkë të re do ngrejë për mort të vet i riu» («Vdekia e peshkatarit»).

Po a ka kund lumturi? A ka kund bukuri në jetë? — pyet poeti i ri, që e kërkon dhe e gjen lumturinë e bukurinë në gazin e punës, në qeshjen e foshnjës dhe në drekën e vobektë të njeriut të punës («Lumturi»); në «Trëndafilin picërrak», në bukurinë e natyrës, të dashurisë, të miqësisë («Agimi», «O motër» «Baladë romantike»); në shpresën të forcat e reja shoqërore,

në bësimin dhe në fluturimet e mendimit tek e nesërmja,  
ku bukuria dhe lumturia marrin trajta frymëzuesë të  
madhërishtme.

Po këndojnë shpirtën të ri në shpëtim,  
lëshuëm mbi jetë me fluturim të lirë,  
Nuk duen harpën, as kitharë e lirë,  
po fluturojnë e fluturojnë, këndojnë  
himnin e jetës s're, tue i këputë  
vargojtë e ndytët...

(«Gotterdammerung»)

Siç shihet, elementi afirmues ka gjetur më se një  
herë shprehje në krijimet e hershme poetike të Shute-  
riqit, kryesisht në formë idealesh e thirrjesh me meta-  
fora e simbole.

Lufta shënon fillimin e një periudhe të re dhe ndër  
krijimet më të plota të këtij fillimi është poema «Lufta»,  
shkruar më 1941-1942, që u pasua më 1944 nga poema  
«O Ptoleme!» dhe më 1945, fill pas Çlirimit, nga poema  
«Enverit» — një himn për popullin, për Partinë dhe  
për udhëheqësin tonë të dashur.

«Lufta» është ndër krijimet poetike më të shtjellura,  
kushtuar një teme të madhe, përshkuar nga një ide  
revolucionare e njohur në letërsinë botërore, që me ro-  
manet «Zjarri» dhe «Qartësi» të Hanri Barbusit, por e  
trajtuar për herë të parë në letërsinë tonë. Është ideja  
e shndërrimit të luftës imperialiste në luftë për çlirim  
kombëtar e shoqëror, për shpëtimin e njerëzimit nga  
konflagracionet e përgjakshme. Poema, si dhe një pjesë  
e mirë e krijimtarisë së mëparshme të Shuteriqit, ka  
karakter reflektiv. Por nuk është aq e figurshme dhe  
sintetike, sado që vien më e qartë në mendim dhe në  
shprehje. Poetit duket sikur i ka interesuar më tepër të  
arsyetojë shtruar për çka ndodh, sesa të krijojë një  
sintezë poetike mbi bazën e një gjetjeje dhe organizi-  
mi fërësor të figurshëm të materialit.

Ndonëse nuk ka intensivitetin, ngjyrat e forta dhe

gjallërinë e brendshme të vjershave e të poemave të mëparshme, «Lufta» ruan vlerën për idetë që shpreh, për integrimin e hapur të shkrimtarit në letërsinë antifashiste, veçanërisht për orientimin e tij drejt qartësisë e thjeshtësisë së shprehjes. Kjo qartësi e thjeshtësi dallojnë gjithë veprën e tij të mëvonshme, përvëç poemës «O Ptoleme!», që për nga forma dhe figurshmëria ngjan më tepër me fillimet krijuese të poetit. Përshkrimi i dukurisë së përbindshme të luftës imperialiste plekset me afirmimin e luftës çlirimtare dhe me frymën e një polemike të rreptë politike, pa aludime dhe metafora, por me gjuhën e qartë e të ashpër të historisë:

*Ju deshët luftën,  
luftën deshët  
dhe lufta krisi.*

*Dhe lufta krisi,  
krisi kësaj here lufta jonë,  
lufta e popullit zot,  
krisi.*

Poema himn «Enverit» shpërthen në entuziazmin e fitores së Luftës dhe të fillimit të një epoke të re historike. Në asnjë vepër tjetër para saj nuk është shprehur me frymëmarrje të thellë, në një sintezë të tillë poetike ndjenja e fuqishme dhe mendimi i kthjellët i njeriut që asiston si para një zbulimi madhështor në fillimin e një epoke të re në historinë e popullit të vet. Popull-Parti-Enver janë shkrirë në një, siç janë shkrirë në një thjeshtësia e udhëheqësit të shquar me madhësinë dhe dinjitetin e njeriut të thjeshtë. Poema është ndër krijimet më të vëtyetishme e që lexohen me një frymë.

*Vigane koha cohet  
përmbi shpatllat e tu;  
e ardhmja shtrohet  
pa fund në sytë e tu,  
dhe mendja jote e ngre dhe e ngre*

*kulmin që në  
sot dashunojmë.*

Nuk është «mbinjeriu». Është shoku «... se unë/  
dhe ky/ dhe ai/ ecim me çapin tañ...», se ti, i drejtohet  
poeti, deshe «... të dimë se ç'jemi: /madhninë të dimë/  
dhe bukurinë/ e vefës tonë, të njohim veten,/ që të  
gjejmë shpëtimin, /tue gjete njerinë». Ndaj poema mbyl-  
llet me njësimin e popullit, të Partisë, të Atdheut dhe  
të udhëheqësit në një të pandarë:

*Ti je gjithcka në tokën tonë të lirë,  
se ti je zemra e tyne e dliërë,  
populli ngadhñues,  
Partia ngadhñuese,  
ngadhñuese Shqipria.*

Me poemën «Enverit» motivet e poezisë së Dhimitër  
Shuteriqit, frymëzuar kryesisht nga realiteti shoqëror e  
politik i Shqipërisë socialiste, janë cilësisht të ndryshme  
nga motivet e poezisë së tij të mëparshme. Tani e sho-  
him Dhimitër Shuteriqin si poet qytetar të ditës, si zbu-  
lues dhe afirmues të shfaqjeve të bukura të jetës së re,  
këngëtar dritash e gëzimesh, poet të përshtypjeve të  
gjalla nga realiteti i kohës.

Është e kuptueshme që kushtet e reja shoqërore  
e politike, dhe orientimi i ri ideologjik e estetik i letër-  
sisë sonë të ndikojnë jo vetëm në pasurimin dhe kthje-  
llimin e përmbajtjes, po edhe në formën e në mjetet e  
shprehjes artistike. Edhe në ato vjersha e poema që  
janë në vazhden e krijimtarisë së mëparshme, figura-  
cioni bëhet më i qartë, më i thjeshtë, (madje disi i thje-  
shfëzuar), edhe organizimi figurativ tërësor i materialit  
objektivizohet më mirë e pa ndërlikime. Herë-herë poeti  
i afrohet me sukses traditës poetike popullore dhe kri-  
jon në frymën e sipas modeleve të saj. Përgjithësisht,  
sidomos në poema, është më tepër parashtrues e disi  
përshkrues. Dicka e tillë konstatohet dhe në poemat  
«Lufta» dhe «Malli i Elbasanit», por bëhet më e duk-

shme në «Vangjush Mios» dhe në «Poemë e pambaruar» që është ndër krijimet e tij poetike më të arrira më vonë.

Vjersha, që do të përfshinte e simbolizonte të gjitha motivet dhe frymën që përshkon poezinë e Dhimitër Shuteriqit nga 1945-a e këtej, është «Këngë për nipat tanë komunistë». E shkruar më 1949, kjo vjershë e thjeshtë kuptimplotë dhe e bukur në idenë dhe thjeshtësinë e saj, tingëllon faktuale, domethënëse me forcë përgjithësuese edhe sot:

*... dësh një republik' e vogël; shokë,  
... e vogël, po ngrij socializmin.*

*... armiq' i kish pasur të shumë e të fortë,  
... po gjë nuk e mund socializmin.*

*Armiq' u tërbuan, të fort' e të liq,  
dhe dëshën ta zbresin flamurë,  
po trimat dërrmuan armiq mbi armiq  
dhe kush nuk e zbriti dot kurë.*

*Sa vite që erdhën, sa mote që shkuan,  
e gjenë dh'e lanë atje,  
dhe dorë më dorë nga mot e lartuan  
flamurë gjith' brezat për ne...*

Është historia e Shqipërisë socialiste dhe besimi i madh i poetit derdhur në këto vargje prej të cilëve koha na ofron një kuptim më të madh nga ç'kishin kur u shkruan.

Kjo frymë entuziaste përshkon të gjitha vjershat e autorit shkruar njëherësh me Aleks Çaçin e Lazar Siliqin, Luan Qafëzezin e Andrea Vërfin, që po ashtu u frymëzuan nga të njëjtat tema, ndjenja e rrethana dhe ato vuhë para së gjithash në themel të krijimtarisë së tyre. Çdo hov e shndërrim revolucionar, shëmbujt e

heroizmit dhe shfaqjet e tipareve të reja tek njerëzit tanë e tërheqin poetin dhe e ngazëllejnë. Këtë ngazëllim, thjesht, pō gëzueshëm e me vargje melodike u transmetojnë lexuesve vjershat e njohura «Kangë për shumëvjesorë tiszahit», «Për ditën e re», «Orkester e dashur (bie te dera», «Gruri ri», «Poemë e pambaruar» e «Kushuanë kjo lartësimi të gruas shqiptare, e, në një rrafsh më të gjërë, dhe marshimit të pandalshëm të revolucionit e të socializmit. Poeti është përpjekur të shkrijë në një realitetin socialist dhe lidetë revolucionare, me një dashuri e stimë drithëruese për njeriun e popullit, me mahnitjen ndaj natyrës, me çastet e spikatura të epikës shqiptare dhe me vetë zbulimin e përthyerjen e të gjitha këtyre në shpirtin e poetit, në tingujt e poezisë. Vërtet në këto krijime nuk ndesh në shpërthime të fuqishme ndjenjash, as në figura të bujshme poetike, po ka në to vetvetishmëri dhe çiltërsi mendimi, përshtypje poetike nga jeta, patos atdhetar, humanist e revolucionar:

*Vargjet proletare zemërueshëm flasin:*

*është mot i egër lind revolucionin.*

*Vargjet proletare, kur flasin godasin,*

*shembin nga themelet e themelesh çojnë,*

*po dhe s'u mungon*

*gazi në bugë.*

(«Vargjet proletare»)

Është në natyrën e poezisë së Shuteriqit të synojë zbulimin dhe shprehjen e çdo ndjenje që e lumturon njeriun. Ai e kërkton këtë në jetë dhe i gëzohet kur e zbulon. I gëzohet jetës, i gëzohet njeriut, lumturohet nga çdo vezullim i bukurisë së realitetit njerëzor. Duke sjellë ndër mend Vangjush Mion kujton piktorin «... me penel në duar, /që po kërkon egjen/ në ngjyrë e dritë/ shkëndinë që mahnit, /pafundësinë në liqen, /te një selvi mendim, /te një rrugicë, kujtim, /dhe kudo jetë, /jo veç jetë, /po gaz e mall e mallëngjime, /e mbi të gjitha, ëmbëlsi, /le t'ishte jeta, egërsia vetë». Përgjasimi i

idealit ideartistik të piktorit me atë të vetë poetit na duket tepër i dukshëm. E përforcojnë këtë vjershat: «Kujtim», «O motër, kush na tha», «Himarës», «Syt' e tu», «Mirdita, Mirditë», «Shkumbinit» etj. Po diçka më tepër gjen në këtë ideal poeti. Në të ai gjen jo aq vetveten sa shpirtin e popullit, vetë Shqipërinë:

Nëpër aq egërsi  
të shekujve, atdhe,  
ti a nuk qe  
dhe buzagaz i pambaruar,  
e pambaruar ëmbëlsi?

(«Vangjush Mios»)

Kënga e Dhimitër Shuteriqit është entuziaste. Ai, si dhe të tjerë poetë të njohur tanët, priret nga anët e ndritura të realitetit të sotëm, nga shkëndijimet deri te shpërthimi i triumfit dhe i gazit popullor:

Eja të rrojm', eja të rrojmë  
edhe të thurim të dy tok  
vjershën e re, që po dëgjojmë  
prej gazit t'udhëve, në, shok.

(«Orkestër' e dashur bie te dera»)

Në këtë dritë mendimi dhe synimi krahasues e kontrastues nënvizojmë: «Vijmë që nga larg, e dashur, / që nga pisha për dritë, / që nga e drunjtë parmendë/... Ehu, që nga vijmë./» (Poemë e pambaruar); me krenari për historinë shqiptare, për guximin «që shpërthen prej gurit e rreh detet, tej» «bashkuar trimëri, bukuri».

## II

Dhimitër Shuteriqi e nisi veprimtarinë si poet, po fitoi pjekuri e u afirmua më gjerë si prozator. Ai është ndër tregimtarët e parë dhe autori i të parit roman të

Pasçlirimit botuar si libër<sup>1)</sup> «Çlirimtarët» (vëllimi i parë i tij u botua më 1952). Vëllimet «Pesë tregime» (1953), «Rruga e rinisë» (1953), «Gurnecka» (1957), «Kënga dhe pushka» (1963), «Këngë në minierë» (1968), «Fyelli i Marsiasit» (1963), «Një mal me këngë» (1975), «Maratonaku ynë» (1977), «60 tregime në një» (1979) e renditin autorin në radhën e prozatorëve më të shquar të letërsisë sonë të re. Në këtë vlerësim janë temat e trajtuara, origjinaliteti krijues, mjeshtëria e lartë artistike e tregimeve më të mira si «Fyelli i Tanës», «Ditët e sprasme të Gjorg Golemit», «Zot e rob», «Kishin kaluar njëqind e pesëdhjetë vjet», «Ura në Tepelenë», «Buka dhe thika», «Dyshimet e Jonuz Ranxhës», «Shkallët e gurta», «Shtatë vjet pas», «Tetë letrat e Valtit», «Kujtime staneshe» dhe një radhë rrëfimesh të vëllimit «60 tregime në një». Dora e sigurt e tregimtarit u duk edhe në romanin «Çlirimtarët», i menduar si një vepër epike përmasash të mëdha, por që ngjan më tepër me një bashkim tregimesh mbresëlënëse, lidhur ndërmjet tyre me fije të dobta kompozicionale.

Nga gjerësia e temave dhe e motiveve të trajtuara proza e Dhimitër Shuteriqit rreh të përfshijë në kulme dhe në hollësi karakteristike historinë e mjedise shqiptare nga epoka e Skënderbeut gjer në ditët tona, të harmonizojë në fjalën e vet letrare pasionin e studiuesit, shpirtin dhe konceptimin e poetit, përshtypjet e gjalla të një shtegtari të palodhur, vërejtësi të hollë dhe hetuesi të vëmendshëm, njohjen e thellë të karaktereve kombëtare, të gjuhës sonë të pasur e të natyrës së ashpër e të bukur.

Nga tregimi në tregim lexuesit i takon të shtegtojë nëpër shekuj e në trevat më të ndryshme të vendit. Këtu me një episod të madhërishtë apo tragjik, aty me paraqitjen e një konflikti të rreptë apo të një ndodhie të dhimbshme, diku tjetër me rrjedhën e shndë-

1) Përpara tij është botuar në revistën letrare një pjesë e romanit «Ata nuk ishin vetëm» i S. Spasses.



rrimeve shoqërore e psikologjike, njohim botën shqip-tare në shumë prej manifestimeve historike e aktuale, gjejmë dhjetëra tipa e karaktere epokash, krahinash e shtresash të ndryshme shoqërore të pikturuara me mjeshtëri. Nga ditët e përzishme pas vdekjes së Skënderbeut në Lezhë («Fletë nga jeta e Marin Barletit»), përfshihemi në qëndresën heroike e të madhërisme të Gjorg Golemit në Sopot («Ditët e sprasme të Gjorg Golemit»), bëhemi dëshmitarë të qëndrimit burror dhe të fundit të dhimbshëm të Pjetër Budit buzë Drinit («Kishin kaluar njëqind e pesëdhjetë vjet»), shtegtojmë me Dhaskal Todrin dhe ndiejmë të na shpojë thika e Patrikanës dhe mëria e pushtuesve osmanllinj («Buka dhe thika»), në Elbasan njihemi me stoicizmin atdhedashës të Kostandin Kristoforidhit («Viti më 27»), në Tepelenë ballafaqohemi me «rebelin e madh» Ali Pashanë dhe njihemi me ndërtuesin e talentuar Petro Korçari («Ura në Tepelenë»). Autori na çon më larg, në gjurmët e bashkatdhetarëve tanë të shquar, në Stamboll te Naimi («Një ditë te Naimi»), në viset e Danubit, na takon me mendjendriturën Elena Gjikhën («Mbi të turbulltin Danub») etj.

Një tregim a çfarëdo vepër tjetër letrare nuk mund të shkruhet pa fantazi. Kështu dhe veprat që e marrin lëndën nga historia. Por në tregimet e Dhimitër Shuteriqit lexuesi aq sa joshet nga thurrjet mjeshtërore e përshkrimet e goditura të ngjarjeve e të karaktereve, po aq mund të besojë pa rezervë vërtetësinë historike të ngjarjeve e të atmosferës që na përcjell autori, në saktësinë e të dhënave, në përshkrime vendesh dhe në hollësitë e tjera të mjedisit.

Që në të ri të vet Shuteriqi parapëlqente mendimin se «realizëm ka vetëm kur ne të jemi interpretues besnikë të shoqërisë», mbasi «po të duam ta studiojmë shoqërinë, si e si më parë, duhet të mësohemi së vështruar, që vështrimi ynë të bëhet më i sigurt e më përshkues, prandaj është më e pëlqyeshme sikur modellet e para të na i japë realiteti...» («Drejtimit e reja letrare»).

Në tregimet e Dhimitër Shuteriqit vërehet se shkrimtari ka ndjekur me konsekuencë këtë parashtrim, duke i lënë lexuesit përshtypjen se tregimet nuk janë gjë tjetër veçse riprodhim copash të realitetit të njohur nga shkrimtari. Kjo përshtypje është më e dukshme në tregimet me motive të sotme, po është më e thellë në tregimet me motive historike, në të cilat ka një harmonizim të faktit e problematikës së mirëfilltë historike me ndërhyrjet e fantazisë dhe përpunimin krijues të lëndës nga shkrimtari.

Historinë kombëtare shkrimtari e ka parë e pasqyruar si një proces të pandërprerë luftash e përpjekjesh nëpër të cilat janë gatuar ndjenjat lirishtese dhe atdhetare të popullit dhe janë përftuar tiparet më karakteristike të tij, si: burrëria, qëndrueshmëria para situatave të vështira, fatkeqësive e dramave kombëtare, besimi në forcat e veta, krenaria dhe fisnikëria, vendosmëria për të çuar në fitore idealin e çlirimit e të mbrojtjes së vendit, përtëritja dhe lartësimi i jetës sonë. Të gjitha këto janë parë përmes përthyerjeve në shpirtin e në karakterin e personazheve, që hyjnë në konflikte me pushtues, tradhtarë, reaksionarë, armiq të hapur e të fshehur, shpesh duke u flijuar për idealin e shenjtë. Heronjtë e vërtetë të popullit tonë, për vetë kushtet e rrethanat historike, që nga lashtësia ilire deri në kohët më të vona, kanë qenë mishërim i idealeve kombëtare dhe kurdoherë popullorë, demokratë e revolucionarë të mëdhenj, sepse populli i ka nxjerrë e vetëm tek ai kanë gjetur mbështetje. Dashuria e tyre për atdheun ka qenë njëherësh dashuri për popullin. Në tregimet e Shuteriqit kjo ndjenjë atdhetare popullore është mishëruar në konceptin për heronjtë dhe në mendimin e patundshëm se është populli që bën luftën dhe përjetëson idealet e lirisë e të atdhedashurisë, se vetëm populli është i pamposhtur dhe i pavdekshëm. Është ai që e ruan dhe i bie nga shekulli në shekull «Fyellit të Tanës», që simbolizon dashurinë, atdhetarinë, përtëritjen e përjetshme, edhe kur stuhitë e rrebesht janë të përbindshme. Drejt këtyre na çojnë fijet e shum-

ta në tregimin «Fyelli i Tanës»: Miri dhe Tana, legjendarë, Shahin Gjoni dhe Daffina, që tanimë janë plakur dhe i gëzohen ardhjes së pranverës, djali i panjohur që i bie diku fyellit. Flitet për të gjithë këta, por, mbi këta ë përmes tyre, në tregim flitet për popullin, për jetën vetë, me ndjenjën e gëzimit se «çdo gjë m'u duk e përtërirë: njerëzit, fusha, malet».

«Miri vdiq, — thuhet në tregim. — Tana, vdiq si do të vdesim edhe ne, që na bashkoi ky muhabet e kjo miqësi. Po dashuria dhe miqësia nuk vdesin. Do të rrojnë bijtë e tu dhe nipçja im, or shok i dashur. Dhe kurrë të vdesin ata, do të rrojnë fëmijët e tyre, nipat tanë».

Poezi? Poezi e filosofi tok. Është ajo që e ka mbajtur gjallë popullin tonë në shekuj përballë tragjeditive e humbellave të thella të historisë, e ka nxitur të qëndrojë pa iu trembur luftës e sakrificave, duke u lartësuar mbi shekujt, mbi armiqtë dhe dhembjet.

Shkrimtari, njohës dhe admirues i folklorit, siç e dëshmojnë mjaft studime e gjurmime të tij, ka përthithur dhe sakrurë në tregimet e veta forcën e epikës dhe bukurinë e finesën e këngës popullore. Ashtu si popullit, edhe Shuteriqit nuk i pëlqen të mbetet te vajtimi për humbjet e për të rënë, po të këndojë, për trimëritë e për trimat, të zbulojë dhe në çastet më kritike, më të dhembshme e më të errëta rrezet e një drite të re apo madhështinë e flijimit. Se «Arbëri, — thotë Gjorg Golemi, — nuk mbahet me lot. Arbëri mbahet me krahë dhe me shpatë» dhe kurrë «s'ka mbejtur as pa mendje, as pa krahë...».

Dhimitër Shuteriqi në tregim u flet lexuesve për trimat që u rritën jo në shtëpi «po në fushat e luftërave» nga etërit trima, ndaj që e mundur që «...dyqind e treqind burra duftuan me njëzet mijë...». Dhe, paskëtaj, vjen mesazhi i këngës:

A do qajm'e të vajtojmë,  
apo turkun do luftojmë?

që... nipëria dhe stërnipëria të dëgjojnë e të marrin vesh... dhe të mos harrojnë kurrë se ç'ka pësuar kjo gjindje dhe të dinë se si e ruajtëm ne, Dheun tonë dhe si duhet ta ruajnë edhe më mirë ata, që të mos e përdhosë armiku e të mos e shtijë në dorë, që të mos prishet më Arbëri si u prish në këto ditët tonë të zeza e të mynxyrshme», — thotë autori me gojën e rrëfyesit Nikodin.

«... Vaji s'është historia jonë», — lexojmë në tregimin «Fletë nga jeta e Marin Barletit», ndërsa heroi i tregimit i thotë komandantit të rojave veneciane, pa e fshehur ndjenjën e krenarisë së ligjshme të shqiptarëve: «Ne një gjë e kuptojmë përmbi të tjera — madhështinë e luftës së drejtë! Dhe një gjë tjetër: se jemi bërë mburoja e Evropës!».

T'gatuar nga ky brumë i historisë shekullore të popullit, që u ngjesh edhe më mirë nën Skënderbeun, «Marin Barleti kërkonte në çdo libër antik atë maja që do të bënte të gatuhet një e ardhme e ringjallur vërtet».

Këmbëngulës, të papërkulur, krenar, me fytyrë të kthyer drejt së ardhmes — të tillë e ka parë shqiptarin e vërtetë Dhimitër Shuteriqi në tregimet e veta; njeri me ideale të larta kombëtare, i cili «u gëzohet mundimeve» që të arrihen ditë të bardha për kombin, për popullin: Historia jonë kombëtare është e mbushur me heronj e martirë, me karaktere të forta, me mendje të ndritura dhe me shpirt kryengritës liridashës, që meritojnë të përjetësohen, duke i ngritur përsëri kundër armiqve.

Këto ndjenja e mendime atdhetare, liridashëse e përparimdashëse janë manifestime të fuqishme që i kapërcejnë caqet kombëtare dhe bëhen shprehëse të idealeve të përbashkëta të popujve; mbesin shpatarë guximi e pishtarë frymëzues për liri e përparim kombëtar e shoqëror. Historia jonë është një shembull se si «njerëzit me të kaluar njëra gjëmë, e prisnin gjëmën tjetër më të fuqishëm. Ata s'e kishin dhënë veten kurrë, as nga lufta, as nga kolera, as nga murtaja». («Viti më

27»). Është optimizmi që buron nga populli, nga kuptimi i drejtë i historisë, nga besimi në të ardhmen. «Furtuna le të përpinte gjithçka, le të përpinte dhe atë vetë! — thuhet në tregimin «Buka dhe thika». — Kjo që kishte arritur ai, ishte një bujë e tillë, që nuk do të harrohej dot».

Historia është një rrjedhë e gjallë, një proces i pandërprerë. Kush i kthen krahët historisë, shkon symbyllur drejt së ardhmes dhe s'di nga t'ia mbajë në dallgët e furtunat e kohës. Këtu qëndron një prej vlerave njohëse e edukuese të tregimeve të Dhimitër Shuteriqit. Po jo vetëm kaq. Kjo është dhe një kryeide që i bashkon tregimet dhe bën të spikatë fizionomia dhe origjinaliteti kombëtar shqiptar në subjektet, në atmosferën që i përshkon; në karakteret, deri në përshkrimet më të thjeshta dhe në hollësitë stilistike.

Por, ndërmjet tregimeve me tema të nxjerra nga historia dhe tregimeve të tjera ka dhe një ndryshim. Të parët u kushtohen figurave dhe ngjarjeve të njohura historike, të dytat janë subjekte e karaktere të krijuara nga shkrimtari. Në të parat sundon motivi i atdhetarisë dhe problematika shoqërore i nënshtrohet atij, në të dytat kjo problematikë del më në pah për vetë karakterin e temave të trajtuara, për vetë sugjerimet që i bën shkrimtarit realiteti i ri. Me gjithë këto, tabani i njëjtit shqiptar, vazhdimësia dhe personaliteti i shkrimtarit ndihen kudo, në të gjitha tregimet e në çdo njërin veçmas.

Në tregimin «Thimi Arapi» është dhënë figurshëm kjo vazhdimësi në episodin e pushkatimit: «Thimin e rrëmbyen dhe e futën në togë. E çuan dhe e vunë me shpinë nga muri i kalasë së qytetit. Duart s'ia lidhën. Sytë nuk dëgjoi t'ia lidhin. E pyetën se a kishte gjë për të thënë. Ai ndjeu pas vetes gurët e mëdhenj të kalasë... U bë pjesë e atyre gurëve, e atij muri të lashtë».

Kjo lidhje e vazhdimësi është në logjikën e jetës sonë. Në tregimet kushtuar Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe epokës së ndërtimit socialist të

vendit, krahas konkretësisë, më të madhe të subjekteve, trajtave thujtase, aspak të legjendarizuara të heronjve, vihet re një ngritje e mëtejshme, e frymës, optimiste, kthjellim i sfondit tragjik; prirja për të pasqyruar krahas madhësisë së heroizmit dhe dramacitetit të disa konfliktëve karakteristike, edhe ndjenjën e entuziazmit për bukurinë e jetës, për fisnikërimin e njerëzve e të marrëdhënieve në mes tyre. «Tani të rroj!» thotë me të drejtë skulptori — hero i tregimit me të njëjtin titull. Nuk ka në këto fjalë, aq më pak në tregime, ndonjë ndjenjë ngazëllimi të papërligjur dhe eufori. Është realiteti i sotëm parë nën prizmin e krahasimit me të kaluarën dhe me botën borgjezo-revizioniste që na rrethon, krahasim që përmbahet gjithandëj, në nëntekstin e tregimeve e disa herë bëhet shprehimisht. Është, gjithashtu, prirja e shkrimtarit, për të parë e, «transplatuar» poezinë e jetës për të përçuar te lexuesi, para së gjithash, atë që është vërtet e bukur, e pastër, njerëzore, fisnikëruese.

Ndonëse subjektet janë më konkrete e më të detajuara, në tregime ruhet po ajo atmosferë poetike, po ajo frymë në konceptimin e përgjithshëm e në përshkrime. Ndryshojnë vetëm ngjyrat, që bëhen më të ndezura e më të çelta. «Te stacioni në Manëz» jëton Brahuşh Cana, që merakoset pse trenat nuk ndalin më në stacionin e tij. Po trenat tani, venë larg dhe Brahuşi vendos të udhëtojë një herë me ta.

«Kur u kthye të pasnesërmen, Brahuşi ishte i mbushur i tëri male, i tëri shkëmb të përhimë, i tëri dhe të kuq, i tëri tunele, i tëri Shkumbin, plot sirena në shpirt, plot shina në mendje, shina kryq e tërthor nëpër tërë Shqipërinë, me Shqipërinë që i udhëtonte e tëra nëpër këmbë, me trena, me gra me bohça në duar, me cijatje fëmijësh».

Përparon vendi, zgjerohet bota shpirtërore e njerëzve, lartësohet dinjiteti i tyre. Ata që thonë «tani të rroj!» doemos janë dhe ata që thonë: «Jam gati të jap dhe jetën për këtë vend e për këtë jetë!». Në këtë kupim tregimet e Dhimitër Shuteriqit shëmbëlajnë me

vjershat e tij, me copëza të një poeme të gjerë për Shqipërinë dhe për shqiptarin, për socializmin. Pavarësisht nga rëndësia e faktit dhe nga përmasat e heronjve, në çdo tregim ndihet koncepti i përgjithshëm për historinë e popullit tonë — tabani i njëjti ku rrojnë e veprojnë heronjtë, fizionomia e përbashkët e tyre. Është ky koncept, humanizmi i shëndetshëm dhe prirja ndaj së bukurës e së madhërishmes që përcaktojnë në themel këtë veçantë» e shkrimtarit dhe frymëmarrjen e veprës së tij për letërsinë tonë kombëtare.

Shpesh lidhjet historike jepen përmjet një thurrije të shkathët rrëfimtare. Tipik për këtë është tregimi «Fyelli i Tanës», në të cilin legjenda bashkëzanon e ndërthurret me historinë e të sotmen; vihet në lëvizje përfytyrimi për të ardhmen; pranë vihen dukuri shoqërore e estetike, që nga tragjikja dhe e madhërishmja, dramatikja e lirikja, ashpërsia e butësia, ekzaltimi i së kaluarës së lavdishme dhe kthjelltësia e perspektivës. Përshkrimet realiste dhe romantika e vazhdimësisë së idealeve më të bukura e më të shenjta të brezave. E njëjta gjë vihet re dhe në një pjesë të tregimeve kushtuar Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, si një hëllkë me rëndësi e lidhjeve të së kaluarës heroike me të sotmen. Tregime si «Jonuz Ranxha», «Këpucët», «Natë shtatori», «Fluturakja» etj. me subjekte nga periudha e Luftës mbeten në kuadrin kohor të saj, kurse tregime si «Zot e rob», «Nëna e Ethemit», «Nëna», «Kënga dhe pushka», «Shtatë vjet pas» etj., madhështinë e Luftës e japin përmes pasojave të saj politike e shoqërore në jetën e njerëzve, në mentalitetin dhe psikologjinë e tyre. «Lufta e re» bëhej në një truall shekullor luftërash për liri. Po ajo s'kish si të mos trondiste mentalitetin e psikologjinë patriarkale e mikroborgjezë të Jonuz Ranxhës e të mos i çelte sytë tipavë si ai, deri edhe si Uani, që notia e skllavërisë i kishte hyrë gjer në kockë. Letërsia mëson nga historia e çila ka drama, konflikte, kontradikta pa të cilat nuk arrihet përparimi. Këto janë kontradikta midis popullit me pushtuesit e huaj, të humanizmit të vërtetë dhe barbarisë fashiste («Natë shta-

tori», «Nëna e Ethemit», «Mora del Ebro») etj., po janë dhe kontradikta të thella klasore («Zot e rob»); kontradikta në mes idealeve të reja dhe mentaliteteve e psikologjisë së vjetër, me ndeshje e forma të mprehta dramatike («Jonuz Ranxha», «Shtatë vjet pas»). Në të gjitha rastët mbi flijimet, dramat dhe mbi vetë vdekjen ngrihet ideali i një jete të re, që realizohet përmes luftës.

«Bir, — i thashë, — erdhe e na gjete në luftë me italianin prapë. Të të them mos merr pushkën, do më mallkosh qumështin që të kam dhënë. Unë s'të kam dhënë farmak. Po kujtimi i tyt eti? Ti prandaj nuk vdiqe atje, në atë të zezë Spanjë, për Republikën, se do të kishe luftë prapë, dhe ja, lufta të priti».

Kështu i thotë e nëna Ethemit, nënë e vërtetë shqiptare, e madhërishtme në thjeshtësinë dhe çlitërsinë e saj. Ndaj dhe shkrimtari, megjithëse nëna e Ethemit ka vdekur, tregimin e vazhdon në ligjëratë të drejtë, sikur ajo të ishte gjallë e të dëshmonte vetë. Një zgjidhje stilistike e gjetur për pavdekësinë e nënave.

Këto nëna janë fatlume që arritën ditët e reja për të cilat lindën e përcollën në luftë, biutë e bijat.

«Nuk e ndiej në shpirt të jem plakur, — thotë heroina e tregimit «Nëna» — dhe s'kam për t'u plakur. Plaket njeriu në kohën tonë?».

Plugu i revolucionit lëron thellë deri në shpirtin e Uanit, të cilin jeta e ka bërë hije të «zotit të tij» — Aspanllan efendiut. Përmbysët, bota, por skllavi Uan mbetet i përvulur ndaj të zotit, pa guxuar të mendojë ndryshe. Po në thellësi e në potencë ka mbetur diçka e gjallë që merr formën konkrete të dhembshurisë e dashurisë për mbesën partizane, të gëzimit që ajo martohet e lind fëmijë. Atë që s'mundi të arrinte Uani — të krijonte familje dhe të jetonte si njeri midis njerëzve — e arriti mbesa e tij me pushkë. Kësaj përtëritjeje i gëzohet Uani. Në shpirtin e tij të skllavëruar hedh dritë revolucionar. Ai nuk është dhe nuk mund të shndërrohet në revolucionar. Sikurse «zoti i tij», edhe ai vetë i përket së kaluarës dhe si kategori shoqërore, si tip e si karakter do të zhdukej bashkë me rendin që e kultivoi dhe e



përdhosi. Por edhe Uani ka të drejtë të kërkojë përvuejtshëm një «të mirë»: të vejë një ditë në qytet dhe t'i gëzohet nipçes së posalindur. Revolta e tij dhe akti kryengritës i vrásjes së Asllan efendiut sa ç'është një shpërthim i vetvetishëm i një shpirti të rebeluar nga përdhosja që i bën atë çast Asllani, aq është përfundim logjik i njësimiit kontradiktór «zot e rob» në rrethanat historike të rënies së «zotërve» dhe lartësimiit të «robërve». Uani vdes me vëgimin e djepit që përkundet, me duar të ngritura e të lëshuara përpara. Ai nuk mund të bëhej qytetar i botës sonë të re. Kjo botë i takon mbesës së tij dhe foshnjës së porsalindur.

Kësaj bote të re i kushtohet një pjesë e mirë e tregimeve të Dhimitër Shuteriqit. Në realitetin e sotëm shoqëror shkrimtari prirët të zbulojë materializimin e idealeve humanitare revolucionare, bukurinë dhe lumturinë njerëzore.

Në tregimet kushtuar kësaj periudhe zotëron tërësisht fryma afirmuese, edhe kur në disa prej tyre bëhet fjalë për ndeshje dramatike në valët e revolucionarizimit të gjithanshëm të jetës. Poetizimi i realitetit socialist bëhet për autorin qëllim kryesor në krijimtarinë që pasqyron aktualitetin socialist.

A ka të drejtë shkrimtari ta shtrijë aq gjërë këtë prirje poetizuese, duke lënë disi në plan të dytë konfliktet gjatë luftës për këtë afirmim? Ai nisët nga mendimi se në kohën tonë, në vendin tonë socialist, ekziston mundësia objektive për të qenë të lumtur një-rëzit, të cilët me prirjen e vullnetin e mirë mund ta çojnë edhe më përpara jetën dhe shoqërinë tonë të re. Ky na duket se është nënteksti që ndihet, motivi që frymëzon autorin. Ndaj vëmendja e shkrimtarit përqendrohet në ata tipa e karaktere shoqërore që përfaqësojnë njeriun e ri, tanimë të formuar, që bartin e shprehin sigurinë dhe përkrahjen e gjithanshme të realitetit të sotëm shoqëror.

Pra, shkrimtari bëhet përcues i së resë, nxitës i mëtejshëm i faktorit subjektiv, për të qenë në lartësinë e rendit shoqëror, për t'iu përgjigjur kërkesave aktuale e

të zhvillimit. Për këtë, dëshmojnë krijime të ndryshme në vëllimet «Kënga dhe pushka», «Këngë në minierë» dhe «Një mal me këngë», disa tregime në të cilët përthyerjet nga realiteti i sotëm shoqëror e politik paraqiten si faktorë përcaktues në shndërrimet e mentalitetit e të psikologjisë së karaktereve, si elementë objektivë kryesorë që i japin drejtim e kuptim jetës së tyre. Edhe kur shtrati i tregimeve është i tensionuar («Shtatë vjet pas», «Shkallët e gurta», «Ndershmërisht», etj.) në shtjellimin e subjekteve, në fthillin dhe zgjidhjen e konflikteve, ndihet fuqishëm atmosfera e kohës. Kjo atmosferë kërkon të shikohen në lidhje, të ngushtë tiparet e karaktereve dhe rrethanat shoqërore që i bëjnë, ata të veprojnë. Ndër këta faktorë Shuteriqi ka vlerësuar, para së gjithash, zhdukjen e pronës private («Shkallët e gurta»), demokracinë socialiste («Shtatë vjet pas»), figurën morale të njeriut të ri («Kujtime stanesh», «Dispeçerja», «Ndershmërisht»), revolucionarizimin e marrëdhënieve shoqërore e familjare («Tetë letrat e Valtit»). Këta faktorë bëjnë që në tregime të zotërojë atmosfera e gëzuar, dhe optimiste, të ngadhënjëjë gazi dhe entuziazmi që, megjithatë, nuk e përjashtojnë dramacitetin që mbartin zgjidhjet e konflikteve apo fjala e ngjeshur poetike e autorit.

Në tregimin «Shtatë vjet pas» flitet për dorëzimin e tre vëllezërve të arratisur në mal (Sadikut, Jasharit dhe Zijait). Viktima të propagandës antikomuniste, inatçorë dhe kryeneçë ata asgjë nuk i bashkon me të huajt e me reaksionin. Ata i kthen forca e së vërtetës dhe drejtësia e rendit tonë shoqëror, prandaj rrëfyesi i historisë së tyre ka arsye të arrijë në këtë përfundim:

«Të them të drejtën, rrallë e kam ndier veten aq të lumtur se jam, bir i këtij vendi, sesa gjatë atij dorëzimi. Mendoja: «I thyem! E pohoi vetë» dhe s'isha i lumtur aq për vete, sa për ata që u thyen. Atëherë e kam kuptuar thellë se ç'do të thotë të fitosh një njeri».

Marshimi i revolucionit «thyen» dhe fiton edhe Jonuz Ranxhën, xha Demin në tregimet me emrin e tyre në titull, Nikollën e Përgjokajve («Shkallët e gur-

ta»), djemtë dhe vajzat e Valtit, letrat e të cilave Martini i përhap në malësi siç hare të jetës së re, krejt ndryshe nga çdo të ndodhte kohë më parë po të prisheshin kaq fejesa njëherësh.

Ide tjetër poetike që përshkon tregimet është forcimi i ndjenjës së solidaritetit dhe shtimit të dashurisë së njeriut për njeriun, e shprehur kjo sidomos në tregimet «Trandafilat ndër avllija», «Qafemali», «Ndershmërisht». Një për të gjithë e të gjithë për një në brenge e në gëzime! Në «Qafemali» kjo del prekshëm në interesimin dhe sakrificën e të gjithëve për nusen shtatzënë, sidomos po të mbajmë parasysh se kemi të bëjmë me një grup njerëzish që vetëm ai udhëtim i vështirë i ka lidhur me njëri-tjetrin.

Është kjo një ndjenjë e psikologji që ndihet gjithandej. Poezi të vërtetë përcjell ideja dhe çdo hollësi në tregimin «Këpuçët». Në spitalin partizan fryn era për tëritëse e dashurisë për njeriun, që edhe vdekjen e bën të lehtë, siç ia bën Palit (heroit të tregimit):

«Pali buzëqeshi dhe mbylli sytë, duke parë buzëqeshjen që u duk në sytë e saj. Ndjeu në ballë dorën e saj, i çeli pak sytë dhe pa se dielli kishte nisur të ngjitej mbi mal, i shtrëngoi dorën, mbylli sytë, ndjeu një boshllëk të madh tek i cili po binte, po binte, dhe dorën e saj në ballë, që po bëhej e lehtë, e lehtë fare. Ç'mër që kishte dhe që atij i dukej se e kishte dëgjuar gjithmonë! Mendimi iu këput te kjo fjalë dhe vari kokën».

Shikojmë portretin e njeriut të ri në fytyrën e Haritisë e të Vjeros («Kujtime stanesh»), të dispeçeres e të shoferit Fan («Dispeçerja»), të dy artistëve të rinj («Një shfaqje e jashtëzakonshme») dhe ndiejmë se autori i gëzohet njeriut të ri si gjësë më të bukur të kësaj bote, i jep formimit të tij rëndësinë që ka historikisht.

«— Ka njerëz më të mirë se ne, more Petrit? — dhe më shtrëngoi fort krahun».

— Ne jemi një premtim i madh, — pëshpërita unë».

Me këtë adhurim e vetëdijë shkrimtari ka sfiduar të kaluarën e errët, botën e sotme borgjeze e revizioniste

dhe çdo gjë që rreh të shëmtojë e të përdhosë njeriun e jetën vetë. Te: «Venusi i Alpeve», «Vila me trëndafila», «Shefert», «Rendët e gjelit», «Baltrave të Myzeqesë» dhe një pjesë e rrëfimeve të përmbledhjes «60 tregime në një» ai nuk e ka kursyer urrejtjen, përbuzjen e fshikullimin satirik ndaj shfaqjeve të shëmtuara e të ulëta të «botës së vjetër», sado që në tregimet e mirëfillta satirike e humoristike nuk ka arritjen e pjesës tjetër të krijimtarisë. E shkurtër, simbolike, kuptimplote është skica «Një njollë e verdhëreme». Një përshtypje e rëndomtë në të parë. Një grup gjeologësh që ngjitinin «...të përpjetën për në pllajat e larra të Fanit» dallojnë mbi një shkëmb të përhimtë diçka të verdhëreme e vezulluese. Ishte një pjellë nepërke, që sapo kishte dalë nga veza. Njëri prej gjeologëve e yret.

«— Çudi, e bukur ishte nepërkeza, — ia bëri Artani.  
 — Bukuri e rrallë ndofta. Po bukuria, kur fsheh aq pabesi është e shëmtuar, — tha Batoja».

Edhe në tregimet me tema e motive nga jeta e sotme, sado që zotëron fryma poetike dhe një ndjenjë gati e përhershme ngazëlluese, spikat e në ndonjë rast, del dhe në krye pirja e novelistit në portretizimin e karaktereve të forta dhe pasqyrimin e dukurive të madhërisme. Në këto tregime, ngaqë subjektet janë më konkrete, e madhërishtëja zakonisht përmbahet në idenë që i përshkon ose jepet e shkrirë me elemente lirike e dramatalitetin e tregimeve për evenimente të mëdha e figura historike të së kaluarës.

Të madhërishtëm në jetën e sotme shkrimtari e gjen dhe në bëma vetëmohimi burrëror («Leksi i Gogos»), për perspektivat e zhvillimit, në tiparet e njerëzve të thjeshtë të ditëve tona, në idealet që i udhëheqin ata. Në tregimin «Dashuri e parë» është shprehur mendimi se «guximi është jeta në çdo çap», vihet theksi te guximi dhe heroizmi si tipar dallues i popullit dhe i epokës sonë. Agroni — heroi i tregimit kujton:

«— Unë e admiroj guximin, — vazhdoi im atë. — Po

të flisja për jetën time, do ta quaja një jetë guximi. Po të flitnim për socializmin, do të flitnim për një guxim të përhershëm».

### III

Tiparet e veçoritë e Dh. Shuteriqit si novelist kanë të bëjnë me formimin ideoartistik si dhe me vetë materialin që i ka ofruar atij historia dhe aktualiteti ynë. Në harmonizimin e këtyre dy anëve, në përshtatjen e konceptimeve dhe figurave artistike të vërtetës së jetës, te gjetja në brendi e në formë të atij këndvështrimi dhe atyre mundësive e mjeteve shprehëse, që janë organiksht të tijet, qëndron forca ideoemocionale dhe mjeshtëria e autorit.

Sigurisht, tregimet nuk janë të gjitha të një vlere, as të një karakteri. Dallojnë tregime me frymë epike monumentale («Ditët e sprasme të Gjorg Golemit»), të tjera që mbështeten në portretizimin psikologjik të karaktereve të forta me dramë vetjake («Xha Demi») e në situata të mprehta e delikate («Shtatë vjet pas»), copëza poetike të jetës («Kujtime stanesh»), rrëfime<sup>1)</sup> («60 tregime në një»), hedhje përshtypjesh nga realiteti në formë gati publicistike («Nga Tirana në Valbonë»), përjasje episodesh jetësore e legjendare («Një natë në Rogozhe»), tregime të gjatë («Këngë në minierë») dhe rreke për krijime humoristike e satirike të mirëfillta («Pendët e gjelit», «Baltrave të Myzeqesë»).

Me gjithë këtë, ndodh që në të njëjtin tregim të ndeshim elementë të rrëfimit të shtruar, të konceptimit monumental, të shtrirjes epike, të elementëve publicistikë etj. «Fyelli i Tanës» dhe një pjesë e tregimeve

1) Në shënimin që mbyll përmbledhjen «60 tregime në një» Shuteriqi shkruan se ato «s'janë rrëfime, veç ndonjë rasti», duke pasur parasysh, me sa duket, të dallojë veten prej heroit. Nëse, me gjithë këtë i quajmë rrëfime, ne nisemi nga forma e tyre.

që pasqyrojnë realitetin e sotëm janë shembuj të një ndërthurjeje të tillë.

Në tregimin «Nga Tirana në Valbonë» një prej personazheve i thotë rrëfyesit: «Kam vënë re se natyra të pëlqen shumë dhe po kështu ngjarjet e jashtëzakonshme». Duket se këto fjalë janë thënë për vetë Dhimtër Shuteriqin, i çili dhe diku gjetkë flet për ngjarjet e jashtëzakonshme dhe rreh të bindë lexuesin se ato nuk janë aq të jashtëzakonshme sa ç'mund të duken.

Në këtë rast të pëlqyerit e ngjarjeve të jashtëzakonshme dhe tërheqjen pas karaktereve burrërore Shuteriqi e lidh me gjendje që shprehin vitalitetin kombëtar popullor dhe me fuqinë e pamatë të njeriut me ideale të larta.

Në përgjithësi, tregimet kanë në qendër nga një karakter të përcaktuar mirë në rrethana e situata prove për cilësitë e brumit me të cilin ai është gatuar. Edhe në rastet kur zotëron ngjarja, kjo e shpie lexuesin në zbulimin e karaktereve të tilla si në tregimet «Shtatë vjet pas» drejt karakterit të nënë Nifës dhe tre bijve të saj kaçakë, «Shkallët e gurta» me portretizimin e Davës, «Kujtime stanësh» me figurat e Veros, të Haritisë, mësuesit etj.

Edhe të pëlqyerit e natyrës nuk mund të vlerësohet në vetvete. Joshja e shkrimtarit nga natyra, nga bukuritë dhe veçoritë e vendit, s'është ndjenjë e papërcaktuar romantike, që ka të bëjë thjesht me ndjeshmërinë e një shpirti poetik. Shuteriqi ka përshkruar bukurues në tregime, sa shprehje e atdhedashurisë së shkrimtarit, një që ai e përdor efektshëm për të forcuar këtë ndjenjë edhe të lexuesit.

Fushë e zhvillimit të ngjarjeve dhe e veprimit të heronjve të Shuteriqit është gjithë Shqipëria, nga Labëria deri në Elbasan e në Pogradec, nga Mirdita gjer në Valbonë e më tej akoma. Përshkrimet janë ndër më të goditurat në letërsinë tonë. Madje, ashtu siç do besuar shkrimtari për vërtetësinë e fakteve që përmend, po aq

do besuar dhe në përshkrimin e saktë të vendeve ku zhvillohen ngjarjet.

Joshja prej bukurive të natyrës është, më në fund, shprehje e prirjes së shkrimtarit për të zbuluar e për të pasqyruar të bukurën në jetë, shenjë e dukshme e karakterit poetik romantik të prozës së tij. Në përshkrimin e bukurive të natyrës, si pjesë të bukurisë së jetës, ndeshim po atë pasion të shkrimtarit për të kapur e fiksuar çdo vezullim bukurie të pamjes e të botës së brendshme të njerëzve.

«...Çdo gjë e jashtëzakonshme që ju kam treguar, — lexojmë në tregimin «Kujtim i paharruar», — e kam marrë nga jeta, ka ngjarë».

Ka në këtë pohim një thelb të vërtetë të historisë së popullit tonë, siç shprehet e përligjet në to natyra e vetë shkrimtarit, që i gjurmën dhe i lakmën ngjarjet e jashtëzakonshme. Historia e popullit tonë është vërtet e jashtëzakonshme, prandaj ai është mësuar ta jetojë të jashtëzakonshmen, të mos habitet e të mos stepet para saj, po ta përballojë, madje të ngrejë dhe këngë për të. Për në është e kuptueshme qëndresa e një grushti shqiptarësh rën Skënderbeun për njëzet e pesë vjet me radhë, kur Evropa dridhej nga frika e «turkut». Çdo hallkë e së jashtëzakonshmes: guximi i Pjetër Budit kundër Vatikanit, vetëmohimi i Dhaskal Todrit për shkronjat shqipe, qëndresa e sopotarëve në kohë të Gjorg Golemit, rebelimi krenar i Ali Tepelenës, historitë e Haxhi Alisë e të Haxhi Qamilit janë në logjikën e historisë sonë, të karakterit të shqiptarit. Të tilla ngjarje pasojnë njëra-tjetrën aq sa mund të quhen të zakonshme. Është, pra, kjo histori kombëtare që e bën të jashtëzakonshmen të ngjarje e të jetë e vërtetë, të duket e zakonshme, duke i dhënë të drejtë shkrimtarit ta tregojë e ta përshkruajë, pa pasur frikë se nuk do ta besojnë. Sepse edhe lexuesit e tij janë nga i njëjti brumë, kanë lindur e janë formuar në këtë kohë «të jashtëzakonshme», janë mëkuar me historinë e vendit të shqipeve.

E jashtëzakonshme nuk do të thotë aventurë ma-

rramendëse, ngjarje për të pataksur njerëzit me qenie e bëma mbinjerëzore. Asgjë e tillë nuk gjendet në tregimet e Dhimitër Shuteriqit. E jashtëzakonshme në të është forca e së vërtetës jetësore e pazmadhuar artistikisht, janë fakte të pahiperbolizuara. Nga këto ngjarje lindin dhe përfytyrime e mendime poetike që të ngrenë peshë.

Në tregimin «Kujtim i paharruar», në fakt, nuk ka asgjë të jashtëzakonshme, në mos marshim për të tillë praninë e Selmanit në shtëpinë e Nasit, asaj nate kur ai thurr këngën për Sofinë, nusen e vet, dëshmore, bijën e Nasit e të Katerinës:

«Të gjithë këndojnë. Zëri askujt s'i dridhet, po u dridhen mishrat e faqeve... Vështroj me radhë njerëzit. Vetëm Selmanin s'e shoh dot mirë, se kam qëndruar ca ters dhe ai më ka kthyer gati shpinën.

Nënë Katerina ka mbyllur sytë. Zëri i saj i hollë dhe i ashpër i përshkon isot e rënda, si ajo vija e kuqe, që përshkon tejdanë qilimin e errët mavi mbi të cilin jemi shtruar. Ka në fytyrën e plakës një shtrëngim, që ia bën damarët të tillë. Ka aty një trishtim të mpiksur nëpër kocka, që nuk mund ta marrësh me mend po nuk dëgjove dhe zërin e saj.

Xha Nasi këndonte me fuqinë e pakë që i ka tepruar. Syri i tij i venitur herë shket mbi të shoqen, herë mbi të nipin dhe herë mbi të mbesën, sidomos mbi të mbesën, së cilës i lëmon gërshetin e gjatë. Wajza këndon edhe ajo me zë të ulët e me sy përdhe. Ngjet shumë me të gjyshen dhe ka freskinë e ngjyrat e ëmbla pesëmbëdhjetëvjeçare. faqet e bëshme tërë shëndet.

Nëpër atë këngë dhe duke parë ato dy femra plakën dhe vajzën, një mendim kisha: njeriu nuk vdes kurrë vdekje s'ka».

Ky mendim i fundit, «i jashtëzakonshëm», plotësohet në fund të tregimit me këngën që improvizon Selmani në kujtim të Sofisë:

Këtë ndjenjë e mendim përjetësie përtëritëse e gjejmë të përshkojë të gjitha tregimet e Dhimitër Shuteriqit si një fill i pakëputur dashurie më njeriun, besimi në



të ardhmen e njerëzimit, optimizmi historik dhe urimi të dalë nga zemra për lumturi. Kjo është sfida që i ka bërë populli, tok me të dhe shkrimtari, vuajtjeve, gjemave, luftërave e pushtimeve, vdekjes vetë.

Te «Dy letra» bëhet fjalë për një mysafir të huaj në kullën e malësorit shqiptar, që diversantët sapo i vranë djalin e vetëm. Malësori i pret mysafirët me përzemërsi, u shtrori sofrën, ia merr dhe këngës. Ata, mysafiri i huaj dhe shoqëruesi i tij, vetëm të nesërmen, nga diskutimet, mësojnë se në atë kullë ku bujtën asaj nate kishte ndodhur një gjëmë:

«... U kthyem e vëmë të ngushëllojmë babanë që kishte humbur të vetmin djalë... — shkruan heroi i tregimit. — E kisha humbur fare. Vetëm kaq kujtoj t'i kem thënë malësorit, se e respektoja si babanë tim, se nuk do ta harroja kurrë, kudo që të jem, se do ta kujtoja gjithmonë.

Unë qaja, kurse ai më vështronte me një sy mirënjohës e ngushëllues, sado të vrenjtur!... Kokën e kish-te mbështjellë në një shami të kuqe gjak. Tek qëndronte këmbëkryq pranë vatrës, dukej si një shkëmb, të cilin një dorë vigane e kishte sjellë e vendosur aty».

Nuk kemi të bëjmë këtu me një normë kanuni, po me formimin shpirtëror të popullit tonë, me aftësinë e tij të jashtëzakonshme që të lartësohet mbi çdo gjëmë.

Kuptohet se nuk kemi të bëjmë as me ngjarje të jashtëzakonshme po, sidomos, me karaktere të plota, të forta, tipike, që kanë të bëjnë me karakteristika e veçori shoqërore e psikologjike të demonstruara në «majat» e tyre, gjë që është një tjetër element romantik në prozën e Shuteriqit.

Historia jonë e re ka gjithashtu ngjarje e ritme të jashtëzakonshme, heronj të vetëdijshëm që qëndrojnë në lartësinë e situatave e të rrethanave. Në këtë rast, përfytyrimet e figurat epike heroike, aq sa është e mundur, njësohen me idealet e shkrimtarit. Por ka dhe tipa e karaktere dramatike. Në këto raste gjatë tregimit qëndrimi i shkrimtarit diferencohet nga ai i personazheve, me prirjen e afrimit dhe të përkimit në

zgjdhjen e konflikteve. «I jashtëzakonshëm» duket xha Demi përballë thjeshtësisë dhe qartësisë së personazheve të tjera, si më kokëngjeshuri ndër kokëngjeshurit. «Të jashtëzakonshëm» ngjajnë tre bijtë e Nifes në tregimin «Shtatë vjet pas», si më kryenegët ndër malësorët. «I jashtëzakonshëm» është Uani i tregimit «Zot e rob», si më skllavi ndër skllëverit. Po çado që duken të rrallë, këta janë tipa jetësorë, Fjala e Partisë, durimi, mbajtja parasysh me urtësi e veçorive individuale, ua zbutin atyre dramën shpirtërore, u kthjellojnë shikimin dhe ua lehtësojnë vendimin për kthesën që duhet bërë.

Tjetër veçori e tregimeve të Dhimitër Shuteriqit është të konceptuarit poetik të realitetit në trajta monumentale, pa detaje të shumta. Ky të konceptuar ka të bëjë me prirjen e shkrimtarit për të zbuluar dhe pasqyruar, së pari, ato dukuri të jetës njerëzore e të historisë së vendit, në të cilat spikatin më dukshëm castet e madhërisme, dramat e forta, bukuria e jetës dhe e njeriut vetë.

Monumentaliteti në tregime si: «Ditët e sprasme të Gjorg Golemit», «Ura në Tepelenë», «Farë trimash», «Natë shtatori», «Mora del Ebro» etj. nis me konceptimin e përgjithshëm epik heroik, mishërohet në tiparet e heronjve e në mënyrën e skalitjes së tyre, duket në zgjedhjen e casteve e nyjave më shprehëse të subjektivit dhe shtrihet deri në trajtimin e hollësive karakterizuese për rrethanat e për personazhet, në drejtimin që marrin mendimet e ndjenjat e tyre, në ekzaltimin e shkrimtarit para shfaqjeve të madhërisme të historisë e të genies njerëzore.

Tipik për këtë konceptim është tregimi «Ditët e sprasme të Gjorg Golemit», që pa u tepëruar, mund të quhet poemë në prozë, për konceptimin e përgjithshëm e për ritmet e tregimit, ngjyrat e theksuara, ngjeshjen e materialit, shkrirjen po aq poetike të elementëve heroikë e dramatikë. Pasi ke lexuar tregimin, të mbetet në kujtesë përfytyrimi i «kështjellës» shqiptare, i atij grushti burrash që luftojnë me një hordhi. Shikon madhësitinë dhe dramën e madhe kombëtare, në ngjarjet

dhe në ndjenjat e mendimet e rrëfimtariit kërenar, dhe mbjethellë e plot optimizëm. Po kaq natyrshëm kalohet, si në poezi, nga konstataimi i një hollësie konkrete në përgjithësim simbolik që i shkojnë për bukuri idesë së tregimit, sintaksës poetike dhe stilit:

«Atë çast, kur të njëqind topat e turkut gjëmonin e krisën si njëqind rrufe, majë një bregu, mbi një lirish-të, dy kalorës njëri mbi një kalë të bardhë e tjetri mbi kalë të zi, u vërsulën mbi shoqi-shoqin. Unë së ndjeva se çeliku i dorës sate, vo vëlla, po më thyente kokkat e krahut».

— Miloshini! — më mërmërite tja.

Dhe shpatat e tyre flakëruan, kuajt shingëllinë e u lëshuan si vetëtimat, shqytet u përplasën sikur njëqind topa të kishin plasur, kali i zi u vërvit përpjetë e u shemb dhjetë pashë tutje me të zotin nën vetë, që mbeti në vend, kurse kali i bardhë ra së lart mbi gjunjë, suçua dhe një herë kas përpjetë, shingëlliu dhe, me sa fuqi pat, kaptoi tatëpjetë me një turfullimë e is'upa më».

Ky ritëm këmbëhet më së një herë me bashkëbisedimin e brendshëm të rrëfimtariit me heronjtë, me monologun e tij të pandërperë dhe me përsëkrimet e ngjeshura të gasteve të madhërisme, siç është ndër të tjera fundi i kapedan Petroshtit, që turqit e kapën rob dhe e shpunë para sulltanit.

«Sulltan qeni desh të dëgjojë prej gojës sate atë që burrë e grua Arbëri të vërtetë si e thotë kurrë».

— Thuaj si unë: «Fet ollidi!» (u pushtua!).

Ti tunde kokën tënde dhe vure buzën më gaz në dhimbje dhe the:

«Fet ollmandi!» (nuk u pushtua!).

Dhe gjashtëdhjetë shigjeta të mbërthyen, në sy, në zemër e kudo, pasi atij artiri ku ishte lidhur».

Në «Zot e rob», me gjithë fundin tragjik të Uanit, poetike e madhërisme dhe konceptuar monumentalisht është ideja e çlirimit shpirtëror të njeriut, e vetë revolucionit që rriton madhësinë e vjetër të «zgërbonjës» së përfaqësuar nga Asllan agai.

Çastet e kthesës së Uanit janë të karakterit lirik

dramatik. Si shërbëtor i përlur, ai është mësuar të flasë pak, po të bluajë shumë me mend, ta jetojë vetëm me velveten çdo gëzim, e çdo dhembje. Dashuria për jetën është brenda tij si një dritë e ngazëllim lirik që rritet:

— «Po sikur të bëjë një djalë? — mendonte Uani për të mbesën.

Si Stefani kish për të qenë ai djalë! Dhe ëndërronte plaku djepe...

Uani kishte mësuar edhe t'i këndojë «llaj-llaj» djalshit. Dhe ja kjo këngë sikur po i zgjohej tani në fund të zemrës bashkë me tik-takun e djepit. Dhe ndiente sytë që i njomeshin, e pastaj i shpërthente me vrull ngashërime, që dëshit i copëtonte krahërorin...

Te «Xha Demit» është vetë karakteri i fortë, i rreptë dhe i vështirë i heroit, që është daltuar ashpër pa trajta të lëmuara. Ka punuar vetë jeta dhe përvoja historike në të biluzionet dhe zhgënjimet, padituria, varfëria dhe lakmia për pronë, dëshira që të ndihej zot i vetes. Mirëpo rreth e rrotull tij — një det me tallaze të mëdha Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare. Përpjesëtimet e saj vijnë e rriten. Idetë e komunistëve dhe heroizmi i tyre përfshijnë shumicën. Ndër ta dhe nipin e xha Demit, Hasimin, që bie dëshmor. Përmes episodesh të mprehta dramatike, shikojmë si e trahineq tallazet shkëmbin xha Dem dhe si e lartësojnë atë Madhështia e Luftës dhe kontradiktat e xha Demit ndërthuren në nyja të forta. Edhe kur i thotë të nipit partizan: «Sytë mos t'i pafshal», dhe kur ngujohet në kullë e kulla i bëhet burg apo i trandet si nga një tërmet i madh prej mandatës për Hasimin (të nipin), edhe kur shqyen xhamadanin e këmishën dhe i bërtet Telës: «Pse s'më bie me pushkë, mor qerrata!; edhe kur i kanoset ballistit: «Të mos të të kisha në vätër time të kisha vrarë! Ti s'je shqiptar! Ti je rezill», — xha Demit është konceptuar si një figurë dramatike monumentale, që priret përpara me vështirësi, duke mposhtur sedrën dhe skepticismin.

Si në tregime të tjera të kësaj natyre, episodet kyç

janë paraqitur shkurt, situatat të mprehta dhe dialogu i prerë. Vetëm në përsiatjet e xha Demit mund të kuptohet ç'ndodh në shpirtin e tij. Në çastet e dhëna tallazet e shpirtit përlligjin shpërthimet e forta, që e bëjnë atë të verë dorën mbi armë dhe ballistët të dalin nga kulla e tij «si armiq». Kështu bëhet një më madhështinë e Luftës Nacionalçlirimtare dhe i tillë mbetet në kujtesën e lexuesit.

Bukuria e trimërisë, e heroizmit, e karaktereve të forta e krenare parakupton bukurinë e jetës, se është pjesë e saj. Dhe nuk ka gjë më të natyrshme për një shkrimtar sesa t'u këndojë njëherësh si epikës së historisë, dhe bukurisë lirike të qenies njerëzore. Është ky një tipar i prozës së Shuteriqit, që të kujton vetë historinë dhe shpirtin e popullit tonë, të rreptë në lufte dhe krenar para armiqve, sa dhe delikat në të ndierit e bukurisë e të poezisë së jetës, si në përjetime më rëndësi, dhe në gazin që të fal bulëzimi i gjethit të ri apo rrezja e diellit që bie maleve.

Tregimet më subjekte lirike, sado të kenë shkëndijime të madhërisë, vijnë në tërësi më të shtruarra, pa kontraste të forta.

Në përgjithësi këto tregime zbulojnë para lexuesit anët e ndritura e të pastra të jetës, të ndjenjave e të mendimeve të njerëzve tanë. Ndër më interesantët në këtë drejtim është tregimi «Kujtime stanesh», në të cilin shkrimtari i këndon punës së lodhshme gëzim-plote, jetës në ndryshim si pranverë në lulëzim: shpërthimit të vrullshëm të një vajze të re, pastërtia dhe gjerësia shpirtërore e së cilës sfidon dhe zmbrafs çdo të keqe e çdo hije ndjenje e mendimi të përdhosur.

Ngado në tregime të pushton ndjenja e gëzimit për gjithëcka të bukur në botë, para së cilës shkrimtari ngazëllet e drithërohet. Ashtu si në tregime të tjera përcjell me patos ndjenjën e krenarisë kombëtare e të dhimbjes: këndon trimëritë dhe heroizmat në prirjen ndaj së bukurës ai i shembëllen fort skulptorit të tregimit «Tani të rroj».

«Një mijë ide i lëvrinin në kokë, një mijë emociione

ia mbushnin kraharorin. Ndiante gishtërinjtë në punë, ndiante çekanim në dorë. Dhe këto s'ishin iluzione, aspak, po jetonte me një gjallëri të jashtëzakonshme në të ardhmen e mundshme. Jeta e tij zgjatej përmes ideve, emocioneve, punës...

Është jeta vetë që e frymëzon, i jep gjallëri dhe optimizëm të tillë skulptorit plak e të sëmurë, të cilët nuk i mungon patosi i brendshëm heroik. Edhe në të bukurën e jetës e të njeriut shkrimtari ka parë gjallërinë e brendshme, dinamizmin, hovin për fluturime, për punë e për heroizëm, që kënga të mos shuhet kurrë dhe jeta të buisë. Në tregimin «Si goja zemra»:

«I qëllonte kështu shpesh babait të nisë një këngë të vështirë, të bëjë shpenjë që unë t'i vete pas në çastin më të vështirë të këngës, kurse ai, tamam në atë çast, ta ulë e ta fikë zërin, të më lerë vetëm e të më japë zemër ata ndjek këngën vetë». Dhe merr fluturimin jo vetëm kënga, por dhe guximi e heroizmi, që lindin këngën dhe janë të lidhur me dashurinë. Lirizmi në këto raste merr nota të theksuara epike heroike, si tek «Kujtim i paharruar» apo «Leksi i Gogos», i cili vetë-sakrifikohet, duke u hedhur tok me automjetin... «Ushtrinë Leksi e kishte bërë në një kafen dhe atëherë kishte mësuar edhe më shumë gjëra nga jeta, nga atdheu, nga detyrat. Po edhe për vetë detin. Sidomos i kishte zbuluar më mirë brigjet toña, nga të cilat, përpara, shumë rrallë ishte larguar me varkë. Kishte gëzuar bukuritë e tyre. Kishte gëzuar shpejtësinë e madhe që mund të arrihej dhe përmbi ujëra, guximin e shpejtësisë, të hovit të papërmbajtshëm» — lexojmë në tregim, ku heroi flijohet për të shpëtuar njerëzit.

Atmosfera gjallëruese dhe frymëzuese e cilat nis edhe nga guximi që të jep dashuria («Dashuri e parë») bëhet tipar i përgjithësuar i historisë kombëtare dhe i kohës së Partisë. Edhe kur tregimet duken të qeta, përbrenda mbajnë gjallëri, dinamike të mendimit e të hoveve revolucionare socialiste.

Tipar tjetër i përbashkët i tregimeve të Shuteriqit është karakteri rrëfyes që s'mund të shkëputet prej

formës së përgjithshme të konceptimit poetik dhe prej lidhjeve me jetën popullore. Zakonisht, dikush tregon, si dëshmitar ngjarjesh, si njeri që merr pjesë në to, si hero a personazh i tregimit. Edhe kur tregimet shkrohen në vetën e tretë, janë të shumta rastet, kur heroi, a njeri prej personazheve kryesore shpreh botën e vet me anë të rrëfimit a të monologut të brendshëm.

Rëndësi ka se ç'karakter merr rrëfimi, a është ai mjet i zbulimit të vetvetes, apo, përkundrazi, mënyrë me anë të së cilës autori «mbulon» vetveten prapa një personazhi. Autori shfaqet dhe pa fjalë, në përmbajtjen e asaj që tregon, me qëllimin pse e tregon, me intonacionin që i jep të treguarit etj.

Ky personazh-rrëfyes i Dhimitër Shuteriqit nuk ka ndryshime thelbësore nga tregimi në tregim. Po, të lëmë mënjanë Nikodimin e tregimit «Ditët e sprapsme të Gjorg Golemit», që dallon disi në mënyrën e të treguarit si klerik popullor me kulturë kishtarë, gjithë të tjerët, pavarësisht nga ndonjë hollësi, janë një intelektualë të sotëm, me formim botëkuptimor revolucionar të lidhur me popullin, me aspirata socialiste e komuniste, madje dhe me të njëjtën prirje lirike romantike në vlerësimin e mjediseve, të ngjarjeve e të karaktereve. Të shumtën e herës midis personazhit rrëfyes dhe shkrimtarit nuk ka ndonjë dallim të dukshëm, ndonëse edhe njësim të plotë nuk ka.

Kjo afërsi është një mjet i njohur për t'ua bërë lexuesve më të besueshme atë që tregohet, për t'u dhënë ngjarjeve vlerën e të vërtetave autentike. Dhe Shuteriqi shtyhet edhe më tej: u jep disa herë tregimeve formën e përshtypjeve të udhëtimit.

Personazhi-rrëfyes është një tip i përmbajtur, flet pak për vetën dhe shumë për të tjerët, sado që nuk mungon të shprehet në formë aforizmash e përfundimesh të bukura poetike.

Formën e rrëfimeve kanë përfunduar të gjitha tregimet e Dhimitër Paskos (Mitrušić Kutešić). Ka diçka të përbashkët në mes dy shkrimtarëve në formën e rrëfimit, në afërsinë me tregimtarinë popullore dhe në

ndijshmërinë poetike. Por tregimet e Dhimitër Shuteriqit asnjëherë nuk të lënë përshtypjen e regjistrimit të një rrëfimi gojor. Në gjuhë dhe në stil ndihet mënyra e përpunuar popullore e të konceptuarit dhe e të pasqyruarit në tregime me elemente të theksuara refleksive.

Futja në tregime e personazhit a heroit rrëfyes sjell me vete veçori në ndërtimin strukturor të tregimeve, gjersa ai ndërhyt si një përbërës ndërmjetës midis shkrimtarit dhe realitetit të pasqyruar. Kështu elementi subjektiv në vlerësimin e dukurive përfaqësohet jo aq nga ndërhyrjet e shkrimtarit, sa nga përthyerja e rrjedhës së ngjarjeve në vetëdijën e në kujtesën e rrëfyesit.

Një veçori e individualitetit krijues të Shuteriqit është prirja për t'ia nënshtuar çdo gjë arsytimit. Jeta rrjedh dhe njeriu arsyeton, analizon, nxjerr përfundime, bën përgjithësime. Është plotësisht e mundshme që kjo ngarkesë mendimesh e vlerësimesh të rrjedhë natyrshëm përmes materialit jetësor dhe qëndrimit ideo-emocional ndaj tij. Por, edhe i pohuar shprehimisht, kur ky pohim buron si nevojë e brendshme, nuk ka gjë të keqe.

#### IV

Artikulli «Drejtime të reja letrare», në revistën «Bota e Re» dhe vjershat e asaj kohe dëshmojnë se Dhimitër Shuteriqi e filloi veprimtarinë letrare si poet dhe si studiues i letërsisë. Edhe më vonë ai u mor me po atë pasion si me studime, edhe me krijimtari artistike dhe në të dyja fushat dha ndihmesë të çmueshme, si personalitet i shquar i kulturës shqiptare.

Në vjetët e parë pas Çlirimit ai hartoi disa tekste mësimore të domosdoshme.<sup>\*)</sup> Zgjerohet vazhdimisht sfe-

\*) «Histori e letërsisë shqipe», «Folklori shqiptar», «Metrika shqipe» etj.



ra e interesimeve të autorit, thellohet përmbajtja shkencore e qhulumtimeve, përsoset metodologjia dhe lartësohet niveli i kësaj pune shkencore. Shkrimtari ndërmerret studime të gjera për probleme të folklorit, për autorë të shquar të letërsisë së mëparshme shqiptare, gjurmon fakte e dokumente për trashëgiminë e lashtë; mbledh, zgjedh e boton këngë popullore, jep ndihmesë edhe në trajtimin e çështjeve të zhvillimit të letërsisë shqiptare të realizmit socialist etj. Ai sjell fakte, dokumente dhe lëndë të re të panjohur ose të harruar; e sistemon atë mbi baza metodologjike shkencore; e trajton dhe e interpreton në prizmin e botëkuptimit e të teorisë marksiste-leniniste. Në këto drejtime ai është ndër nismëtarët e veprimtarët më të shquar e më të palodhur të shkencës sonë të re.

Interesimet shkencore, pasioni për gjurmime historike, kulturore e gjuhësore; për personalitete të shquara të së kaluarës; përpjekja për t'i studiuar çështjet në gjithanshmëri etj., janë kurorëzuar në studime e botime me vlerë dhe i kanë shërbyer në mënyrë të ndijshme autorit në krijimtarinë artistike, në tematikën e veprave letrare dhe në disa veçori stilistike, sic ka ndikuar në këto drejtime edhe pasioni i shkrimtarit për njohjen e vendit dhe veprimtaria publicistike etj. Pasuria gjuhësore e tregimeve të Shuteriqit është ndër më shembullore në letërsinë tonë të sotme. Ai nuk i ka për zemër neologjizmat e bujshme, por, sic ka synuar të dërdhë në veprën historinë, jetën dhe shpirtin e popullit, pë ashtu ka arritur të përthithë gjuhën, popullorë, ngjyrimet dhe mundësitë shprehëse poetike të saj. Fjalori i pasur — fryt i një qëmtimi të pasionuar e të vëmendshëm, — është vetëm një prej vlerave të mëdha gjuhësore të tregimeve. Tjetër vlerë po aq e madhe e tyre është harmonizimi në sintaksën poetike i formave të të folurit popullor me brendinë e pasur intelektuale, gjë që vërehet në krijimtarinë artistike, por dhe në artikuj e në kumtime shkencore të autorit. Ndërtimi i frazës; muzikaliteti i shprehjes, përdorimi i frazeologjisë e mënyrave të të thënit po-

pullor në veprën e Shuteriqit janë elementë me rëndësi që bëjnë përfundimë fizionomikë kombëtarë popullorë të veprës letrare.

Le të kujtojmë dhe këngën popullore. I dhënë pas folklorit dhe duke qenë një folklorist në zë, shkrimtari ka nxjerrë përfundime të mëdha nga krijimtaria poetike e popullit, jo thjesht në shfrytëzimin e elementëve stilistikë, zbukurues, se në konceptimin e frymën epike, në procedimin strukturor, idëri dhe në evokimin e citimit e efektshëm e me mjeshteri të këngëve popullore. S'mund të shkëputen nga interesimet e shkrimtarit për folklorin «Fyelli i Tanës» dhe «Ditëti e sprasme të Gjorg Golemit», që e marrin temën nga legjenda e kënga popullore, as «Një natë në Rogozhë» apo «Kujtim i paharruar», që e përfshijnë këtë këngë në subjekt apo në atmosferën ideomocionale të tyre.

Në krijimtarinë letrare të Dhimitër Shuteriqit ndihet gjerësisht ndikimi i frytshëm i studiuesit të traditave historike e kulturore të kombit. Disa prej tregimeve më të mira janë fryt i studimeve historike e historike-letrare. Për të njëjtat evenimente e personallitete shkrimtari ka botuar dhe studime me vlerë ose është njohës i mirë i tyre: «Tek «Viti më 27»», «Metë nga jeta e Marin Barletit», «Kishin kaluar 150 vjet», «Ura në Tepelënë», «Një ditë te Naimi», «Mbi të Turbullin Danub», «Farë trimash» etj. Urrrikthehen lexuesve në formë figurash artistike humanisti e atdhetabi i epokës së Skënderbeut — Marin Barleti, gjuhëtar i Kostandin Kristoforidhi, Pjetër Budi, poeti «apostull i shqiptarizmit» Naim Frashëri, Elena Gjika e lidhur pasionalisht me dheun e të parëve, fshatari kryengritës Haxhi Qamili, Ali Tepelena — sfidues i sultanëve dhe arkitekti popullor Petro Korçari. Në të tilla tregime në sytë e lexuesve parakalon historia me zëdhënësit e saj. Domosdo, shkrimtari nuk ka shkruar histori, por e ka rikrijuar historinë artistikisht; duke përdorur fantazinë në thurjen e subjektit, në zgjedhjen e hollësive shprehëse, në portretizimin e heronjve e të personazheve. Por, me gjithë këtë, si shkrimtar ai

ka punuar kurdoherë me përgjegjësinë e historianit, duke treguar se historia, sikurse aktualiteti, po të njihet mirë, jep material të pasur që i kalon kufijtë e fantazisë më të begatë.

Puna e studiuesit ka hedhur reflekset e veta edhe në formën e tregimeve, dhe në stilin e shkrimtarit, në natyrën e përmbajtur të shprehjes së ndjenjave dhe në njëfarë racionalizmi e intelektualizmi si në konceptimin e realitetit, dhe në parashtrimin letrar të materialit. Edhe e anasjellta është e vërtetë: ndikimi i shkrimtarit mbi studiuesin, sidomos në parashtrimin e fakteve e të argumenteve shkencore. Kjo veçori e individualitetit krijues të Dhimitër Shuteriqit, sado kudo, e vështirëson komunikimin e tij me lexuesin e rëndomtë. Por, ndërkaq, duke bërë këtë konstatim, vërejmë se letërsia jonë ka ç'të përfitojë nga puna serioze e me përgjegjësi për zotërimin shkencor të materialit dhe për ngritjen e nivelit intelektual të brendisë e të formës së veprave, pa u shkëputur nga tradita popullore, e cila edhe në këtë anë përmban mundësi të mëdha.

Vepra e Dhimitër Shuteriqit, për këto arsye, është një shembull i punës së shkrimtarit, me pasuri mendimesh e dijesh, me njohje e zotërim të përkryer të gjuhës amtare dhe të mjeshtërisë së fjalës letrare.

1981

## TRI NOVELA TË ZIHNI SAKOS

Zihni Sakoja, i njohur si letrar që gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, fill pas Çlirimit hyri në radhët e shkrimtarëve, të cilët hodhën themelet e letërsisë së realizmit socialist. Pas përmbledhjes «Nga jeta në luftë» (1947) dhe ndonjë tregimi të botuar në revistën «Letërsia jonë» («Medalja e trimërisë»), ai u paraqit edhe si poet (poema «Komisari») e si një ndër autorët e parë të letërsisë së re për fëmijë, me disa botime në vargje, në prozë dhe me ndonjë pjesë për teatër. Më vonë, pa lënë pas dorë krijimin letrarë, iu kushtua studimit të folklorit. Krahas ndihmesës së tij në këto fusha, veprat që e përfaqësojnë më mirë si shkrimtar janë tregimet e gjata: «Bereqeti» (1951), «Ditë të gëzuara» (1953) dhe «Buka jonë e përbashkët» (1955), të përmbledhura më 1977 në vëllimin «Novela».

Duke i rilexuar këto tregime shumë kohë pas botimit të parë, të ngjallin interes dhe të bëjnë të mendosh e të reflektosh për rrugën e ndjekur nga populli ynë dhe për proceset e zhvillimit të letërsisë shqiptare të realizmit socialist, veçanërisht të prozës. Në të dyja këto drejtime lexuesi, veçanërisht studiuesi i letërsisë, ka ç'të mësojë prej tregimeve të Zihni Sakos, jo thjesht në rrafshin e vlerave njohëse, por edhe për disa karakteristika e veçori ideoartistike, që me kohë u bënë mbështetje për përparimin e mëtejshëm të prozës sonë. sidomos asaj që u kushtohet jetës e problemeve të fshatit.

Kur u botua tregimi i gjatë «Bereqeti», proza jonë e

re sapo kapërcente kufirin e skicave e të tregimeve të shkurtra, ku kishin debutuar Dhimitër Shuteriqi, Shevqet Musaraj, Nonda Bulka, Fatmir Gjata dhe vetë Zihni Sakoja. Vetëm disa vjet pas Çlirimit, mbështetur kryesisht në shpatullat e shkrimtarëve të rinj, letërsia jonë kish njohur suksese të dukshme në lëmin e poezisë ku, krahas me «Epopenë e Ballit Kombëtar» (Sh. Musaraj) u rëndësishën «Prishtina» (Ll. Siliqi), «Ashtu Myzeqe!» (A. Çaçi) etj., kurse në prozë u bënë përpjekjet e para për të kaluar në lloje më të gjera, si tregimi i gjatë (novela, siç është bërë zakon të quhet ndër ne) dhe romani. Njëri pas tjetrit u botuan «Bereqeti» dhe «Ditë të gëzuara» (Z. Sako), «Uji flë, hasmi s'flë» dhe «Tana» (F. Gjata), «Fusha po zgjohet» (R. Nepravishta) dhe romanet e para: «Çlirimtarët» (Dh. Shuteriqi), «Ata nuk ishin vetëm» (S. Spasse). Sot kaq vepra botuar në dy tre vjet duken pak, ndërsa atëherë, kur shkrimtarët numëroheshin më gishtat e dorës, çdo titull i ri pritej me entuziazëm, sidomos kur në vepra pasqyrohej Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe realiteti i ri shoqëror e politik që sapo ishte bërë objekt i krijimtarisë artistike.

Një botë e re, që nxirrte bisqe e filizë mbi gërmadhat e së kaluarës e përmes ferrave e drizavë të reaksionit, duhej parë e pasqyruar me syrin e shkrimtarit militant, në mënyrë të re, me vërtetësi, pa zbukurime, me optimizëm revolucionar. Këtë drejtim zgjodhi për krijimtarinë e vet edhe Zihni Sakoja. Si njohës i mirë i fshatit dhe i psikologjisë së fshatarit, i orientuar nga direktivat dhe programi i Partisë, ai iu vu punës të sjellë në letërsi jetën në fshatin e sapoçliruar shqiptar dhe të vizatojë në një dritë të re karaktere fshatarësh në rrjedhën e shndërrimeve ekonomike, politike e shoqërore, shndërrime që përmbysnin marrëdhënie shekullore, hidhni poshtë botëkuptime e mentalitete të vjetëruara, ndikonin në përparimin e mënyrës së jetesës, kërkonin një zhvillim moral e psikologjik me drejtim socialist e komunist. Partia kish hyrë në jetën e popullit si një forcë jetike e madhe, roli i saj udhëheqës e

ndikimi i punës së gjithanshme të komunistëve rritej përherë e më tepër, duke bërë që të çelikosej uniteti i saj me popullin dhe të ecej drejt hedhjes së bazave të socializmit. Veprimi i elementit të ndërgjegjshëm e pararojë dhe drejtimi e parashikimi shkencor i proceseve të zhvillimit ishin një gjë e re në jetën e popullit dhe po kaq e re edhe për letërsinë. Është meritë e shkrimtarëve tanë pionierë të realizmit socialist, që, duke pasqyruar atë luftë të ashpër klasore dhe vështirësitë e mëdha, vunë në themel të veprave të tyre bindjet komuniste, vështrimin perspektiv, besimin në të ardhmen.

Duke rilexuar novelat e Zihni Sakos pas kaq vjetësh mbetesh me përshtypjen se ai iu vu punës krijuese për ta parë e pasqyruar realitetin e asaj kohe me saktësi realiste, përmes ngjarjesh e hollësish të vërteta, me vështrim të mprehtë klasor, në dinamikën e perspektivën e zhvillimit tonë shoqëror. Nga kjo pikëpamje, të tria novelat janë ndër veprat e para të letërsisë sonë që shquhen për vlera njohëse, në drejtimin kryesor ideor e problemor dhe në paraqitjen e tablove reale nga jeta e fshatit, në vizatimin e karaktereve autentike të fshatarëve dhe në morinë e hollësive interesante nga mënyra e jetesës, nga punët dhe natyra e fshatit dhe e fshatarit.

Në tregime, në kuptimin e episodeve e të hollësive që janë përfshirë në to, ke përshtypjen se ka më shumë mbresa e vrojtime jetësore, sesa një sajim të qëllimtë letrar. Nga kjo pikëpamje proza e Zihni Sakos është e afërt me atë të Shevçet Musarajt, në të cilën, po ashtu, i jepet më tepër rëndësi dëshmisë jetësore, saktësisë së paraqitjes dhe hollësive, sesa formulimit racional të materialit apo futurimeve të lira të fantazisë e patetikës letrare. Këtu kemi, së pari, një veçori shprehje dhe jo, aq të metë a dobësi artistike.

Zihni Sakoja në qendër të çdo novelë ka vënë një problem me rëndësi, që shërben si organizues i materialit, vendoset në boshtin e subjektit e të veprimit dhe synon të tregojë rrugën e zgjidhjes reale të tij në rrethana të përcaktuara, si në kuptimin e përgjithshëm

historik (etapa e zhvillimit të vendit, veçanërisht të fshatit shqiptar pas Çlirimt), ashtu edhe në vërtetësinë e rrethanave e të mjediseve, në të cilat shtrohen problemet dhe veprojnë personazhet. Në «Bereqeti» shtrohet problemi i grumbullimit të drithërave të bukës dhe, lidhur me këtë, ngritja e vetëdijës politike të fshatarësisë, nevoja për shtimin e prodhimit e për përparimin e përgjithshëm të fshatit. Në novelën «Ditë të gëzuara» si problem themelor të cilit i «nënshtrohen» ngjarjet, është reagimi ndaj futjes së teknikës dhe agroteknikës në bujqësi, si faktor me rëndësi për rritjen e prodhimit, të nivelit të mirëqenies, për ndryshimin e mënyrës së jetesës e të psikologjisë së fshatarit gjatë hopit të rëndësishëm drejt kolektivizimit. Përpjekjet për formimin e një kooperative në një fshat malor, dikur të varfër e të prapambetur, përbëjnë objektin e tregimit. «Buka jonë e përbashkët».

Pra, kemi të bëjmë me një shkrimtar, i cili, në mënyrën e vet, përpiqet të tregojë ç'probleme shtron realiteti, duke u munduar t'u dalë përpara proceseve të zhvillimit, orientuar prej direktivave të Partisë dhe perspektivave të ndërtimit të socializmit. Në tregimet e Zihni Sakos rijeton vështrësitë nëpër të cilat kalonte fshati shqiptar, masat e Partisë për përmirësimin dhe përparimin e gjendjes, luftën e ashpër dhe të gjithanshme klasore kundër kulakëve, ndjenjës së pronës private etj. Lexuesi gjen në to jehonën e ligjeve dhe urdhëresave të pushtetit popullor për grumbullimin e prodhimeve bujqësore, për sistemin e shitblërjes, orientimet për futjen e teknikës e të agroteknikës në prodhimin bujqësor, për zgjerimin e strukturave të prodhimit, për stacionet e makinave e të traktorëve, për ngritjen e nivelit kulturor të jetesës, për luftën kundër mentaliteteve të prapambetura, për kolektivizimin e bujqësisë etj. Në to pasqyrohen efektet gjallëruese të Kongresit të Parë të Partisë, jehona e Letrës së Hapur të shokut Enxer Hoxha «Mbi disa probleme në fshat» etj.

Vlera njohëse e veprës së Zihni Sakos nuk kufizohet vetëm në pasurinë e hollësive jetësore që i përkasin

asaj periudhe, por, para së gjithash, në pasqyrimin përgjithësisht me vërtetësi të problemeve të kohës dhe në përthyerjen besnike të atmosferës e të reagimeve të ndryshme ndaj çështjeve që shtroheshin për zgjidhje, në përpjekjen sado fillestare për ta parë jetën në zhvillim, për të rrokur proceset e ecjes përpara, sado që në mjedise të ngushta e, deri diku në mënyrë të sipërfaqshme.

Vënia në themel të çdo tregimi e një problemi kyç, që bëhet, si të thuash, bërthamë e subjektit dhe shtrat i konfliktit themelor, është karakteristikë që i afrojnë tre tregimet. Shkrimtari, duke i qëndruar problemit kryesor dhe duke treguar rrugën e zgjidhjes së kontradiktës, bën përpjekje të pasqyrojë cilat janë ato shkaqe e faktorë gjithfarësh që ndezin luftën dhe ndryshojnë gjendjen në kah përparimtar, socialist. Në çdo tregim sajohen tre grupe personazhesh, që mbajnë qëndrime të ndryshme ose të kundërta ndaj problemit dhe, për shkaqe që i kanë rrënjët në interesat e fizionomitë e kundërta e të ndryshme shoqërore, klasore, hyjnë në konflikt ndërmjet tyre.

Kështu, në tregimin «Bereqeti» rreth çështjes që trajtohet sajohen tri grupe të tilla personazhesh me lidhje të ndërsjellta, që i kalojnë caqet e problematikës themelore, por nuk janë të shkëputura prej saj. Në një grup hyjnë komunistët dhe njerëzit revolucionarë të fshatit Përroi i Thatë: Beshoja, Minoja, Notia, Peti etj., të cilët përfaqësojnë të renë, atë forcë të vetëdijshme që e shpie fshatin përpara duke i dhënë një kuptim të ri politik detyrimit ndaj shtetit popullor, marrëdhënieve fshat-qytet, lidhjeve të fshatarësisë me socializmin. Në grupin e dytë hyjnë fshatarë si Grigori (basho Gori), e shoqja Grigoria, dhe Lekja, të cilët paraqesin fshatarin e rënduar nga mentalitete e vese të shoqërisë së vjetër që nuk arrin të bëjë dallim të qartë në mes të kaluarës e realitetit të ri, nuk kupton përkohësisht ku duhet të mbështetet, ç'qëndrim duhet të mbajë në interes të tij e të shtresës që përfaqëson. Ndër ta Grigoria, si grua punëtore, që ka mbi shpatulla barrën e shtë-



pisë, meqë basho Gori është dembel e llafazan, pothuajse që në krye anon nga grupi i parë dhe shpejt vihet në radhën e të përparuarve, siç bën dhe Lekja hallemadhe, kur e kupton se mbështetje për të mund të jenë vetëm komunistët dhe pushteti popullor. Grupi tjetër përbëhet nga Tenoja, kulak dhe armik, nga Titka i Seve dhe nga Naqia e familja e tij; Dadia (e ëma) dhe e shoqja. Në këtë grup vëmendja e shkrimtarit është përqendruar te Naqia, i cili, pasi provon dhe në kurriz të vet dinakërinë e Tenos, çlirohet prej skllavërimit shpirtëror të tij e prej egoizmit të pronarit dhe merr rrugën e afrimit me fshatin e me komunistët. Në këtë mes luan rol dhe ndikimi i të birit, Petit, i cili i kujton udhën e nderit. Ndërmjet dy grupeve antagonistë vërtitet basho Gori, të cilin veset e pengojnë të pajtohet shpejt me realitetin e ri shoqëror e politik. Ai urren, së pari, punën, ndaj u kundërvihet urdhëresave për grumbullimin, tallet me drejtuesit e fshatit, mban lidhje miqësore me Tenon e me Naqen dhe, me dashje ose pa dashje, bëhet altoparlant i pikëpamjeve reaksionare, zëdhënës i mendimeve dhe i qëndrimeve që ata vetë e kanë vështirë t'i shpallin hapur.

Tregimi «Ditë të gëzuara», që me fizionominë e personazheve të kujton më tepër një fshat të Labërisë, se sa të Myzeqesë, ka në qendër fshatarin Mitër Shtëmbari, që përfaqëson kategorinë e fshatarit punëtor, të ndershëm, të lidhur me pushtetin popullor, që u gëzohet të mirave të fituara nga Reforma Agrare, por nuk do të shkëputet nga prona e tij. Është kjo ndienjë e spikatur me ndjeshmëri nga shkrimtari, që e bën Mitër Shtëmbarin t'i kundërvihet futjes së teknikës moderne në bujqësi, pa e kuptuar që ky qëndrim do të ndikonte për keq, do të shfrytëzohej prej kulakëve në interes të synimeve të tyre armiqësore, do të vihej kundër aspiratave të vërteta, edhe të vetë Mitrit. Në ndryshim nga basho Gori, Mitër Shtëmbari karakterizohet nga virtyte të lavdërueshme dhe nuk ka asnjë lidhje me grupin e antagonistëve. Ndikim për mirë ushtron mbi të e bija, Gjena, e cila tok me Vathin, Bredhkë Çerepin, Tonçin

etj., janë pararoja e fshatit dhe entuziastët e vënies së bujqësisë në baza të përparuara. Grupi antagonist përfaqësohet në tregim nga kulaku Kore Sykja, nga Kusja (e shoqja) dhe Zarja (e bija) si dhe nga Memë Deneku, i cili, më në fund, arrin të kuptojë tatëpjetën në të cilën e' shpinte miqësia me Kore Syken dhe bashkohet me shokët. Njëfarë basho Gori në miniaturë është Çukja llafazane, që vërtitet në fshat duke nëpërgojur njërin e tjetrin. E re në këtë tregim (gjë që përsëritet edhe te «Buka jonë e përbashkët») është vizatimi i portretit të oportunistit; të njeriut me dy fytyra. Lelia, i cili, si-kurse Razim Gjika i tregimit tjetër, formalisht është në Parti, se, në fakt, mban anën e kulakëve, u kundërvihet direktivave të Partisë dhe komunistëve të vërtetë; hyn dhe në lidhje krushqie me elementët armiq. Në pikë-pamje të përmbajtjes, të sferës së pasqyrimit, por dhe në pikëpamje të hetimit e të tipizimit të kategorive të reja shoqërore, gjendemi para një meritë të Zihni Sakos, i cili me këtë paraprinte në letërsi. Duke futur në tregime një tip si Lelia e Razimi, autori gjallëroi edhe strukturën e veprave, kaloi në ndërtime kompozicionale më të ndërlikuara e më të zhdërvjellta.

Tregimi «Buka jonë e përbashkët», duke pasur në themel problemin e ngritjes së kooperativës bujqësore e të përparimeve të para të saj, dëshmon se shkrimtari është interesuar, në radhë të parë, të paraqesë njerëzit të cilët objektivisht janë të prirë drejt kolektivizimit. Kjo rrethanë ka bërë që në tregim të zotërojnë edhe numërikisht elementi përparimtar, të zbehet e të mos dalë aq në pah plani i ndërmjetëm dhe vëmendja e shkrimtarit të përqendrohet kryesisht në procesin paracës, në njerëzit që e shpien përpara gjendjen. Por, edhe këtu, si në dy tregimet e tjera, personazhet përbëjnë tri grupe të diferencuara, prej të cilëve dy janë antagonistë: Bejkushi, Cañi, Nuredini, Esmakua, Hëna, Kameja, Shkurta, Bilushi dhe në anën tjetër Xhezair Kokëziu, Malo Bonjaku, Çania, Larushja. Në mes të këtyre dy grupeve vërtiten përkohësisht Duro Çalamani me të kumatën, Elmanë, dhe xha Sopi — një tjetër karak-

ter i ngjashëm me basho Gorin e tregimit «Bereqeti». Ndërlidhjet në mes grupeve përcaktohen nga ndeshja e ballafaqimi me problemin kyç, janë efektive dhe kanë ndihmuar në zbulimin më të gjerë të realitetit. Përmendim këtu, sidomos, të vëllanë e Malo Bonjakut, Dinon, që pushtohet nga idetë dhe idealet e një jete të re dhe, në të kundërtën, rënien gjithnjë më poshtë të Razim Gjikes apo përpjekjen e Malos ndaj Elmasë.

Ecuria e personazheve në përputhje me perspektivën që dikton zhvillimi shoqëror për secilin tip e kategori, lartësimi i njerëzve të përparuar dhe degradimi e shkatërrimi i antagonistëve nën goditjet e luftës klasore përputhen me synimin e autorit për të shtruar e zgjidhur problemin themelor që e ka interesuar. Ky problem i dukshëm dhe i qartë, vihet praktikisht në rend të ditës dhe bëhet strumbullar rreth të cilit shtillen të gjitha çështjet e tjera, aspekte që kanë të bëjnë me jetën intime, me gjendjen, psikologjinë dhe veçori karakteri të personazheve të ndryshme. Veç, sidoqoftë, problemi kryesor mbetet shtytësi më i rëndësishëm i veprimit.

Zihni Sakoja, duke zgjuar që në fillimin e tregimeve interesin e lexuesve, i rrok problemet në një çast vendimtar. Kur është e pamundur që ndokush të mbetet mënjane. Do të shlyhen apo nuk do të shlyhen detyrimet; do të futet teknika e re dhe, agroteknika në bujqësi, apo do të vazhdohet me të vjetrën; do të ngrihet kooperativa, apo do të ruhet prona private në fshat? Këto alternativat historike shtrohen nga vetë rruga në të cilën hvri vendi e fshatarësia pas Çlirimit, por faza e dhënë kërkon të vihen praktikisht në rend të ditës edhe për fshatarët e Përroit të Thatë («Bereqeti»), të Drizës («Ditë të gëzuara») dhe të Këmbëzës («Bukajonë e përbashkët»). Shkrimtari shfrytëzon në çdo rast një episod që tërheq vëmendjen dhe bëhet nxitës për gjallërimin e gjendjes. për hedhjen në veprim të forcave shoqërore. Sedrën e Beshos, kryetar i këshillit popullor të fshatit, e sëmbon fakti që në tabelën e emulacionit të lokalitetit e kanë hipur mbi breshkë, si të prapambetur në shlyerjen e detyrimeve; në Drizë

venë traktorët e parë, dhe kërkohet zbatimi i rregullave agroteknike; në Këmbëz, me vajtjen e Bejkush Konit, çështja e ngritjes së kooperativës del nga caku i diskutimeve dhe bëhet problem i ditës për të gjithë.

Përmes pasqyrimin të kësaj gjendjeje, me skicime të shpejta, me përshkrime të shkurttra, me episode të shumta e karakterizime konkrete, autori arrin të paraqesë jetën, gjendjen dhe natyrën e fshatit. Ajo që ka më tepër rëndësi është se ai portretizon me sukses personazhet kryesore, karakterizon tipat dhe zbulon veçoritë e karaktereve në mjediset konkrete e lidhur me problemin bazë. Ndërthuren në botën e personazheve e kaluara dhe bashkëkohësia, aspiratat, bindjet e qëndrimet politike dhe interesat imediate e të ngushta, dëshirat dhe lufta për realizimin e tyre, tiparet e shtresës e të klasës shoqërore dhe veçoritë individuale, konsideratat e përgjithshme dhe qëndrimet konkrete, veprimtaria shoqërore, çaste të jetës intime etj.

Si në çdo gjë, edhe në të menduar ata janë konkretë, larg abstraktiveve intelektuale dhe emfazës letrareske. Duke ndjekur këtë prirje, shkrimtari ka mundur të portretizojë tipa e karaktere që mishërojnë tiparet e fshatarëve të asaj kohe që viheshin në ballin e saj: djem e vajza të reja me pak shkollë e me pak përvojë jete, të lidhur me fshatin, që aspirojnë përparimin e tij dhe zbukurimin e jetës së bashkëfshatarëve. Problemet e përgjithshme, parimet, idealet në të shumtën e herës rrjedhin si nëntekst, — përmbahen në atmosferën dhe në informacionin e kursver të autorit. Në atmosferën e kohës dhe në rrethanat historike në të cilat vendosen ngjarjet lexuesi hvn, kryesisht, përmes bisedave e përthyerjeve emocionale të personazheve. Gjiithcka ndjek rrjedhën e natyrshme të jetës së fshatit. Asgjë nuk thuhet, në përgjithësi, e megjithëkëtë, e përgjithshmjia, atmosfera e kohës, konceptet e qëndrimet klasore shfaqen mirë në përjetime e synime karakteresh të vecanta. Kujtojmë bisedën e Tenos me Gorin në tregimin «Bereqeti»:

«Teñoja dhe gratë e tij shqydheshin së qeshuri. Qenë ngritur më këmbë dhe po bënin sehir Sullën që vinte rrotull si ë marrë. Nga fundërat e shamisë leshrat i vareshin kalivare-kalivare, si bishtat e fishkur të qepëve. Ngandonjëherë çirte faqet dhe si ujë i tërbuar u lëshohej dhive me shkop.

— Me hak korba, me se të kthehet, — tha nusja e Tenos.

— Mos, moj Sullë! Ç'ke me to! Ç'faj të kanë bërë? Ç'do t'i bësh? Me qeverinë duhet të jesh në rregull. Dorëzoi mish dhe pastaj merr një shkop në dorë dhe shpëto një herë e mirë... një shpirt ka për të dalë...

— Atë që të bën qeveria, s'ta bën as përëndia... Qeveria të ngordh fare. Ti e mban mend vjet Zeren?...

— Po thoshin që qe kulak, së bënte ca marifete... Kishte fshehur bereqet..., — ia priti basho Gori.

— Kështu është me qeverinë e sotme, Gori. Nga një çikë e nga një çikë, sot të kërkon vezë, nesër lesh, pasnesër të thonë kulak. Ku ka kulakë në fshatin tonë?... S'guxon t'i qash hallin të ziut popull, se të thonë kulak!

— Mbushma dhe një herë... E di, kur është rakia e mirë, edhe një okë të pi, s'më zë fare». (f. 12-13)

Duke e mbajtur debatin politik dhe diskutimin parimor të lidhur kurdoherë me gjendje imediate e karaktere të zakonshme, autori mbase e kufizon gjer në njëfarë mase rezonancën e tyre, por, nga ana tjetër, jep një provë të lidhjes së pashmangshme të kujtdo me politikën dhe të ndikimit të shtresave shoqërore në atmosferën e përgjithshme dhe në rrugën që merr zgjidhja e problemeve. Zgjimi i vetëdijes politike revolucionare të masave është parë prej shkrimtarit si faktor e kusht themelor për përparimin e vendit në rrugën e socializmit.

Xha Sopi i tregimit «Buka jonë e përbashkët» vendos të mirëseardhë Xhezairin, kulakun që është kthyer në fshat më shpresë se punët kanë për të ndryshuar. «Mirëpo tamam në këtë kohë, — lexojmë,

— erdhi Bejkushi ta merrte e të shkopin një herë në shtallën e gjedhëve...

Xha Sopi, duke u munduar ta fshehtë mërzitjen që ndjeu, hapi gojën për të qeshur e për t'i thënë «si urdhëron», po në vend që të qeshte e të fliste, gogësiu dhe mërmëriti nëpër dhëmbë[...]

— More Bejkush, po ç'do të jetë kjo punë ... Atij kaq kohë s'i dukej as nami as nishani në fshat... se sikur thonë që tani, pas vdekjes së Stalinit, ca punëra do t'i shikojnë... se mos janë bërë gabim. Thonë sikur do t'ia heqin kulakllëkun, se qenka bërë gabim.

— Gabim?

— Gabim... Mos e di unë? Po si thonë...

— Kush thotë?!

— Thonë.., — dhe xha Sopi, meqë e humbi e s'dinte ç'të thoshte, kroi kokën, e duke zvogëluar sytë, bëri sikur po mundohej të kujtonte gjëkafshë... — Ah, ç'u plakëm, o Bejkush!... E di sa haraq jam bërë?... Tani të më thuash një gjë, mënjëherë e harroj...» (f. 312-313)

Të tillë shembuj nuk janë të paktë.

Tregimet e Zihni Sakos kanë sjellë diçka të re, të freskët e mbi të gjitha, konkrete në letërsinë e viteve '50 dhe kanë qënë një hap i mirë fillestar drejt konceptimit dhe pasqyrimit realist të jetës. Në to asgjë dhe askush nuk idealizohet, përveçse ngrihen lart idetë dhe aspiratat socialiste. Dallon deri diku tregimi «Ditë të gëzuara», në të cilin shkrimtari është prirë drejt një pasqyrimi të ndritur e pa kontraste të forta të realitetit. Ndërsa lëkundjet e Miti Shtëmbarit, i ka zbehur e i ka reduktuar në mëdyshje që zgjidhen fare lehtë, Gjenën — heroinën e veprës, e ka paraqitur larg të vërtetës së kohës, si një njeri që nuk lë hije ngado që ta shikosh.

Në planin e ndërmjetëm në tri novelat shkrimtari bën diferencimin në mes njerëzve deri diku të kompromentuar e të lidhur përkohësisht me palën antagoniste (Naqia te «Bereqeti», Memë Denëku te «Ditë të gëzuara», Duro Çalamani te «Buka jonë e përbashkët») dhe elementëve që, më tepër për cene morale, anojnë nga antagonistët, duke turbulluar gjendjen me qëndri-

met e tyre të papërcaktuara dhe me fjalët që hapin, pa menduar thellë se ku godasin ato. Në këtë kategori hyjnë basho Gori si më tipiku («Bereqeti»), Çukja («Ditë të gëzuara»), xha Sopi («Buka jonë e përbashkët»). Sidomos i pari dhe i fundit janë karaktere të portretizuara me mjeshtëri, tipa realë fshatarësh të asaj kohe, të cilët zënë vend mirë në subjekte, pa arritur të bëhen figura kryesore.

Kur u botua tregimi «Bereqeti», autori jo pa të drejtë u qortua për vendin që i kishte dhënë basho Gorit. Por shkrimtari, siç del duke e gjykuar çështjen më gjerë, është nisur nga një dukuri shqetësuese, siç ishte aspirata mikroborgjeze e një kategorie fshatarësh që nuk i ishte nënshtruar drejtpërdrejt shtypjes së çifligarëve dhe, pas Reformës Agrare, aspironte sido kudo «të vinte dhjamë» e dhënë pas pronës së vogël.

Në rrethanat e reja historike mbi vetëdijën dhe qenien shoqërore të fshatarit nisin të veprojnë faktorë të rinj ekonomikë, shoqërorë, politikë dhe ideologjikë. Në ndërgjegjen e fshatarësisë në tërësi theksohen ndjenjat e patriotizmit popullor dhe të dashurisë e të besimit në Partinë, formohen koncepte e bindje më të qarta klasore dhe shfaqen perspektiva për zhvillime më të mëdha. Personazhet me karakter të dyfishtë, të cilët lëkundën në mes forcave kundërshtarë dhe aspiratave të kundërta, që ruajnë individualizmin dhe skepticizmin e rrënjosur me shëkuq, nuk janë trillime të fantazisë së shkrimtarit. Ata ia ka sugjeruar atij vetë realiteti. Në kundërshtim me këtë do të kishte qenë zotërimi, si frymë, i personazheve të lëkundura ose mosparaqitja e tyre në shndërrim e sipër nën ndikimin e vetë realitetit, të punës së komunistëve e të njerëzve të pararojës. Autori, edhe me ndihmën e tipave të tillë, ka pasur mundësi të paraqesë më natyrshëm e deri diku «nga brenda» fizionominë moralopolitike dhe synimet e njerëzve të deklasuar e të atyre që degjenerojnë në armiq të rendit të ri shoqëror, të tregojë ç'pasoja rridhnin nëse fshatarësia nuk do t'u vente pas komunistëve, nuk do të udhëhiqej e nuk do të edukohej prej tyre.

Rrafshin e ndërmjetëm shkrimtari e ka parë në lëvizje, në dinamikën e zhvillimit e të lartësimit jo vetëm përmes riedukimit të tipave të përmendur, por dhe me anë të përfshirjes së tyre në ndryshimet që ndodhin. Përmes këtyre personazheve, shkrimtari, mbase më tepër me intuitë, ka ditur të tregojë se çdo njeri i ndershëm e i vetëdijshëm s'ka rrugë tjetër veç asaj që përcaktohet nga Partia. Peti i «Bereqetit» dhe Dinua i «Buka jonë e përbashkët» janë dy prej këtyre njerëzve të rinj, që e shpjen jetën përpara, kurse Grigori dhe Lelia në tregimin e parë janë ndër personazhet më të spikatura të kësaj kategorie.

Në të tri tregimet shkrimtari ka shtruar problemin e mprehtë politik të luftës kundër oportunitizmit dhe sektarizmit, duke paraqitur rrezik, më të madh dhe më të dukshëm frymën pajtuese me elementin e dekluar dhe qëndrimet zbutëse ndaj mentalitetit mikroborgjez e shfaqjeve të tjera të dëmshme. Ndërsa te «Bereqeti» ky problem sapo është cekur me ndonjë kritikë të padrejtë që u bëhet Beshos dhe Minos — dy komunistëve të vendosur të fshatit, te «Ditë të gëzuara» dhe «Buka jonë e përbashkët» ai ka zënë vend me rëndësi në përmbajtjen ideore të tregimeve dhe në subjekt. Lelen («Ditë të gëzuara») dhe Razimin («Buka jonë e përbashkët») ai i ka denoncuar si tipa me mentalitet e psikologji mikroborgjeze, ambiciozë e karrieristë, njerëz me dy fytyra, imorale, që flirtojnë e lidhin krushqi me kulakët dhe, gjoja në emër të ligjshmërisë, mbrojtjes së interesave të fshatarëve, të demokracisë, u kundërvihen komunistëve duke synuar me djallëzi të shfrytëzojnë çdo pakënaqësi të të tjerëve. Demaskimi i këtyre tipave dhe zbulimi i shkaqeve që shpjen në oportunitizëm si dhe vizatimi me vërtetësi i karaktereve e plotësojnë më mirë tablonë e jetës së fshatit në vitet '50.

Sado vend që zënë në subjekte personazhe të grupit të ndërmjetëm, drejtimin ideoemocional tregimeve ua japin figurat që përfaqësojnë të renë, bartin veprimin që shpie në shndërrime revolucionare, të cilat sjellin edhe zgjidhjen e konfliktit artistik në vepër.



Bie në sy që shkrimtari, sido që anon me tendencë ideoartistike ndaj tyre, e ka në natyrë dhe, me sa duket, ka bërë përpjekje të vetëdijshme që, duke paraqitur tipin e luftëtarit të pararojës, të mos mbetet, siç ndodh jo rrallë, në karakterizime të përgjithshme, po të arrijë nga karakteri i veçantë të tipi shoqëror. Ata kanë me vete të drejtën dhe janë të qartë për gjendjen e për perspektivën, por nuk janë të gjithëpushtetshëm, as të imunizuar prej dobësive, sado që për këtë më tepër pohohet ndonjë veçori individuale. Flitet, për shembull, që Beshoja është ca ekstremist i majtë dhe Minoja — e rrëmbyer («Bereqeti») por këto opinione nuk konkretizohen në subjekt apo në aspekte të veçanta të tregimit. Kjo e metë vërehet ndonjëherë dhe në paraqitjen e virtyteve të disa personazheve, të cilët, si të thuash, deklarohen: «I zgjuar dhe trim, po edhe i fjalës e i kalemit». (f. 155)

Protagonistët janë njerëz të zakonshëm në jetëshkrimin dhe në virtytet e tyre. Bejkushi, për shembull, para se t'i ngarkohej detyra për të ngritur kooperativën, ka qenë magazinier në ekonominë ndihmëse të një reparti ushtarak. Kështu dhe të tjerët. Veprimtaria e tyre në pasqyrimin e gjithë jetës së fshatit ndërthuret me qëndrimet e veprimet e fshatarëve të tjerë, prandaj është një e vërtetë artistike e besueshme. Rrallë ndodh që shkrimtari ta përqendrojë vëmendjen krejtësisht në këta heronj, në përjetimet, mendimet dhe vlerat e tyre. Për ta flitet shkurt, me thjeshtësi, kurdoherë me vend.

Tregimet kanë dhe ngjashmëri të tjera në strukturë dhe në ndërtimin kompozicional, në thurrjen e subjekteve dhe në procedim. Në secilin prej tyre ka nga një çift të rinjsh të dashuruar që janë në pararojë të punëve të fshatit apo që krijojnë lidhje në mes protagonistëve dhe rrafshit të ndërmjetëm si dhe nga një krushqi a flirrt në mes oportunistëve e antagonistëve të deklasuara. Përmendim: Minoja-Peti («Bereqeti»); Vathi-Gjena, Lélia-Zarja («Ditë të gëzuara»); Bejkushi-Esmakua, Razim Gjika-Larushja («Buka jonë e përbashkët») etj.

Këto ngjashmëri sjellin monotoni dhe njëtrajtshmëri

në ndërtimin e tregimeve, njëfarë skeme të pasqyrimin të jetës në tri blloqe kryesore, duke futur në mes tyre ndonjë personazh komik. Por, përfundimisht, mbetesh me përshtypjen se ata nuk janë përsëritje e njëri-tjetrit dhe se jeta nuk është thjeshtëzuar në mënyrë skematike, sepse autori sjell përshtypje të gjalla e të shumta dhe material jetësor interesant.

Zihni Sakoja parapëlqen shtrirjen në gjerësi. Ai duket sikur nuk interesohet posaçërisht për linjat kryesore të subjektit, madje, nuk thellohet aq në interpretimin e asaj që ndodh. Në stilin e tij, si të thuash, ka njëfarë rrëfimi të thjeshtëzuar e komunikues, karakteristikë e tregimtarisë popullore, me të cilin shkrimtarin e lidhin shumë elemente. Kjo lidhje spikat në konceptimin tërësor të subjekteve (përjashto «Ditë të gëzuara»), në mënyrën e fütjes së personazheve në subjekt si njerëz të njohur që më parë nga lexuesi, në karakterizimin e tyre dhe në ndërtimin e frazës, përdorimin e frazeologjisë dhe të figurave stilistike popullore.

Mbi shtratin e linjës kryesore të veprimit ai sajton natyrshëm mikrolinja, që kanë të bëjnë me veçoritë e fizionomisë së personazheve të ndryshme dhe hedh dritë në aspekte të shumëllojta të tablosë së jetës. Linjat kryesore të veprimit që duken e zhduken në morinë e episodeve mbeten përcaktuese, por megjithëkëtë Zihni Sakoja është orvatur të gjejë mundësi e forma për një pasqyrim të gjithanshëm të jetës, qoftë dhe me kalime të shpejta dhe me episode anësore.

Për stilin e Zihni Sakos nuk janë të huaja edhe përshkrimet, karakterizimet, e efektshme ideoemocionale dhe ndërhyrjet e shpejta e me vend. Konkretësisë së paraqitjes, që është, së pari, konkretësi e përjetimeve e mendimeve të personazheve, shkrimtari i pranëve hera herës edhe përshkrimet, arsyetimet, dialogun dhe skemat karakterizuese, arrin në alternim dhe shkrirje të natyrshme të realitetit objektiv me përthyerjet subjektive të marrëdhënieve shoqërore dhe lidhjet e zakonshme midis njerëzve.

Në tregimin «Bereqeti», përmes përshkrimit të go-ditur, jepet ky karakterizim psikologjik i Tenos — kula-kut të shpronësuar:

«Kur doli sipër në sheshin mbi korije, ia zbriti mush-kës. E lëshoi atë për të kullotur dhe vetë u fut në korije për të bërë gjethe. Në fillim u ul, bëri një cigare dhe e piu ashtu shpejt e shpejt. Sa herë që e thithte, e nxirrte tymin me duf. Mendonte kohën e parë, kur gjithë fshati e pyeste për çdo gjë. Mendonte kohën e parë, kur ia kishin kërkuar, kaq e kaq djem vajzën. Tani ai e ndiente vetën vetëm. Ata, që dje i kishte nën thundër, qenë në krye të punëve në fshat. Kur i zuri Reforma arat, dhe iu duk dhe s'iu duk. «Baltë është, nga vendi nuk e heqin dot. Këtu do të mbetet!». Me këto mendje tapitë e vjetra një natë fshehurazi i vuri në një vrimë muri, dhe atë natë e piu kushëdj, sa herë pagurin, po që i bëhej ujë fare. Kur i shtetëzuan dhentë, u bë helm e pikë.  
...Burrë e grua, me plakën bashkë, kthenin filxhanët e kafesë.

Fjalët e miqve të tij, që dëgjonte në qytet, i tirrte nëpër mend ashtu si i dukeshin më bukur. Arat e tij, që Reforma ia kishte dhënë «botës», i mbeteshin ndër sy dhe i ngjallnin në zemër një ndjenjë të egër për të nesërmen...» («Novela» f. 41-42).

Më shpesh përshkrimet e karakterizimet ndërthuren me dialogun, me anën e të cilit kalohet në një rrafsh më të gjërë shoqëror:

«Duke ardhur nga fusha, Minoja kishte marrë udhës një degë dredhël plot me lule të bardha, që ishin ende të ngrohta nga dielli. Ngandonjëherë i merrte erë dhe kë-naqej. Era e tyre i dukej sikur e çlodhte. Nganjëherë e hidhte atë degë me lule radhë-radhë rreth gushës e gëzohej si ndonjë vajzë e vogël.

— E shëh sa më kanë hije lulet?... Kështu më pëlqen, që këto lule t'u shkojnë të gjithëve. — Pastaj ia merrte me gëzim këngës që i pëlqente më shumë...

Notja, sado që qe i lodhur, atë ditë, nuk mërzi-tej hiç nga, ato që i thoshte Minoja. Atij i dukeshin ato fjalë

tjetërsoj... S'e kishte dëgjuar Minon të fliste aq bukur. U mat një herë ta pyeste se ku i kishte mësuar ato, po i erdhi rëndë mos e merrte, për keq. Ai druhej nga Minoja se, kur merrte inat, bëhej si e xhindosur e s'dinte se ç'fliste.

— Ej! Note, nuk jam Minoja e parë... Më ka hyrë një dashuri e madhe për jetën, që nuk di se ç'do të bëj për të... Ë? Si thua ti? Nuk është e bukur jeta?... S'ke ç'i thua. Tani di pse rron njeriu...» («Novela», f. 60-61)

Dialogu, siç mund të vihet re dhe në copëzën e mësipërme, jep mirë përjetimet, lëvizjen e ndjenjave dhe është i mbushur me asocione e përfytyrime konkrete. Ja një çast nga tregimi «Buka jonë e përbashkët»:

«Kames i dridhej dorë. Buzët i ishin bërë pëlhurë dhe çibuku në dorën e mëngjër i qe shuar.

— Mirë, — dhe filloi të shkruajë emrin. — Po lopën do të ma lini?

— Posi, — i tha kryetari.

— Baliken? Ë?

— Atë që ke.

— Mirë, — dhe mori të firmosë, por prapë ngriti kokën. Kishte shkruar dy germat e para të emrit, por edhe ato nuk kuptoheshin mirë.

— Zotrote sikur e ke bërë kursin kundër analfabetizimit? — i tha Cane Vojka.

— E, po tani ai mbaroi, more djalë. Unë e kalova moshën. Në e pranoni kështu, mirë, në mos po vë gishtin... Po desha të pyes, kur sëmuret njeriu, a ma jep kooperativa një mushkë sa të vete te doktori?

— Pse mendon të sëmuresh?

— Epo, njerëz jemi... Unë s'mund të them se s'do të sëmurem hiç... Unë jam edhe nga veshkat pa qejf... Nuk ma këndon dhe një herë, ti djalë, këtë lutje?» (f. 275-276)

Megjithëkëtë, si refleks i vetë gjëndjes së prozës sonë të asaj kohe, por edhe i disa kufizimeve dhe i një prirjeje thjeshtëzuese të shkrimtarit, në tregimë hasim të paraqiten në formë të thatë e të zbehtë, relatuese, disa anë të veprimtarisë politike e shtetërore, dhe një-

farë përpjekje për të qenë sa më tepër instruktiv, përshejtime të papërligjura, në pasqyrimin e shndërrimeve që ndodhin në jetën e fshatit, karakterizime të jashtme e paraqitje disi të ngurta të personazheve.

Informacioni në disa raste, megjithëse i nevojshëm, nuk gjen shprehjen e përshtatshme artistike. Po kështu, dëshira për sqarime të rëndomta, jashtë rrethanash të vërteta artistike, e pa forcë shprehëse për çështje politike, të luftës kundër bestytënieve e paragjykimëve, për agroteknikën (p.sh. si kryhet çekanka e pambukut), për higjienën etj., e ulin emocionalitetin dhe mbingarkojnë pa dobi tregimin.

Ndërsa në tërësi dhe në hollësitë e zgjedhura vërehet një sens i shëndoshë realist popullor, në zgjidhjen e disa problemeve, sidomos në tregimin «Ditë të gëzuara»; ka përshejtime që marrin ngjyrën e lustrimeve të realitetit. Kjo duket në përparimin e personazheve (Gjena) në shndërrimin e menjëhershëm të fshatit pas lërimit me traktor, apo në mbushjen e dyqanit me mallra sapo thuhet një fjalë... Nga dëshira e mirë për të bindur lexuesit, shkrimtari, pa e kuptuar, bie në kundërshtim me atë frymë të përgjithshme vërtetësie që vërehet në tregimet e tij.

Përshejtimi në zgjidhjen e subjekteve ndodh edhe për shkak ngushtimi të këndvështrimit të problematikës themelore. Gjatë parashtrimit të materialit ietësor, tregimet kanë frymëmarrje të gjerë e përfytyrime deri diku të shumanshme të jetës, por nuk ndodh gjithaq dhe me detajimin e konfliktit sa herë shkrimtari mjaftohet me demaskimin ose me ndëshkimin e antagonistëve dhe me evoluimin pozitiv të personazheve të lëkundshme. Ngushtohet kështu sfera pasqyruese dhe skematizohet subjekti, krijohet edhe iluzioni se mjafton të zhduket një pengesë që gjithçka të shkojë mbroth. Për të ngjallur këtë «optimizëm», shkrimtari përdor ndonjë flagrancë armiqësore, e cila shërben që t'u hapen sytë të lëkundurve dhe të shtrohet udha e perspektivës së zhvillimit.

Te «Buka jonë e përbashkët» subjekti jep dorë për shtrirje të mëtejshme: ngritja, zgjerimi dhe forcimi i kooperativës së re nuk është vetëm çështje e luftës kundër kulakut, por edhe e thyerjes së koncepteve të fshatarit-pronar të vogël, e çrrënjosjes së psikologjisë mikroborgjeze dhe e kapërcimit të prapambetjes. Por në pjesën e dytë, në të cilën përgatitet zgjidhja, vëmendja e autorit është përqendruar kryesisht në demaskimin e kulakut dhe të qëndrimeve oportuniste ndaj tij, e domosdoshme si linjë — por nuk ka mundur të ruajë gjerësinë e pasqyrimin, të përballojë gjithë temën, e zgjedhur.

Të metat e përmendura nuk e zbehin aq ndihmesën e dhënë nga Zihni Sakoja në fillimet e prozës sonë të realizmit socialist. Tregimet e tij ruajnë vlera të dukshme, jo vetëm si tablo autentike të jetës së fshatit shqiptar në vjetët e parë pas Çlirimit, por edhe si përvojë e vlefshme për të gjithë prozatorët tanë, të cilët e shpjen përpara letërsinë, besnikë të parimeve që udhëhoqën pionierët e realizmit socialist në punën e tyre të frytshme për t'i hapur udhë një krijimtari më të begatë, stileve më të larmishme e më të përpunuara.

1983

## TIPARE DHE VEÇORI TË NJË PROZATORI

(Vështrim kritik për romanet e Ismail Kadaresë)

### I

Ismail Kadareja është ndër-shkrimtarët më në zë të kohës sonë, sa poet aq dhe prozator, që ka realizuar vepra të shquara në të dyja këto fusha dhe ka dhënë ndihmesë shumë të çmueshme në zhvillimin dhe fuqizimin e letërsisë së re shqiptare, të letërsisë së realizmit socialist. Romanet dhe poemat e tij më të mira janë mirëpritur dhe janë bërë të dashura për lexuesit. Ato, për vlerat e tyre ideoartistike, i kanë kaluar kufijtë kombëtarë dhe kanë patur jehonë në shumë vende, të botës. Vepra e tij, e lidhur ngushtë me historinë dhe bashkëkohësinë shqiptare, e përshkuar prej ideve të revolucionit e të socializmit, mbështetur në mënyrë krijuese në traditën letrare kombëtare e botërore të së kaluarës e të kohës sonë, është manifestim i një talenti të shquar. Autori ka qenë dhe është në kërkim të vazhdueshëm dhe ka pasuruar mundësitë e mjetet shprehëse artistike për pasqyrimin sa më me efekt të kolizioneve të mëdha e të konflikteve të rëndësishme, të epikës heroike dhe të dramacitetit tronditës, të dinamikës së zhvillimit dhe të lëvizjes në botën e brendshme, në psikologjinë dhe në fizionominë morale të njerëzve tanë. Veprat e Ismail Kadaresë janë fryt i qëndrimit veprues ndaj realitetit bashkëkohor edhe kur i bëhet jehonë realitetit historik të kohëve të shku-

ara apo ritrajtohen tema legjendare. Ato kanë peshë të ndijshme ideore, intensitet mendimi, diapazon të gjerë pasqyruës dhe thellësi analize, ndonëse forma e paraqitjes së tyre është, zakonisht, sintetike, me priene jo aq epike sesa refleksive. Për këtë arsye, si dhe falë mjeshtrërisë së shkrimtarit, lexuesi, është apo nuk është kurdoherë në një mendje me të, lloshet prej çdo veprë dhe, ajo që është kryesore, vihet të mendojë për ç'ka lexuar, të diskutojë me vetveten e me të tjerët, të përcaktojë qëndrimin ndaj dukurive të pasqyruara, ndaj këndvështrimit e mënyrës si është parë e pasqyruar realiteti.

Duke qenë një prej poetëve që dha ndihmesë të veçantë në përparimin dhe revolucionarizimin e poezisë së sotme shqiptare, në themel ai mbetet poet edhe në prozë. Ai nuk i duron patetikën dhe stilitë e frazës, që do të linin përshtypjen e lidhjeve me poezinë, por që nuk kanë të bëjnë vërtet me të. Veçse në të konceptuarit e përgjithshëm të realitetit, të temës e të figurës ndihet pushteti artistik dhe mjeshtëria e poetit të talentuar. Duke parapëlqyer format sintetike të pasqyrimin dhe të organizimit të materialit, shkrimtari arrin në përfytyrime përfshirëse, në struktura e ndërtime të zhdërvjellta e me mundësi pasqyruëse të mëdha, në një frazë të shtrirë, pa zbukurime, sa paraqitëse aq dhe të ngarkuar ideoemocionalisht. Nga kjo pikëpamje, ndërsa në ndonjë autor vihet re rivaliteti poet-prozator, në veprën e Ismail Kadaresë, si një arritje me vlerë e me origjinalitet, ecin dorë për dorë poeti dhe prozatori; poezia dhe proza sajojnë një unitet të pazbërthyesëm, saqë është vështirë të kërkojë e të gjesh ku nis njëra e ku mbaron tjetra.

Romanet e Ismail Kadaresë,\* marrë në lidhje me

---

\*) Në këtë studim, përveç tregimeve «Komisioni i festës» dhe «Emblema e dikurshme», gjithë veprat e tjera që janë analizuar janë quajtur romane. Jemi nisur kryesisht nga struktura dhe kompozicioni i tyre që i kalojnë caqet e tregimit të gjatë e të novelës.



realitetin e pasqyruar në to, formojnë një gjerdan me tri hallka (një «urë me tri harqe») prej të cilave e para përfaqëson të kaluarën legjendare dhe historinë e së kaluarës, e dyta — Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, e treta — kohën e sotme, epokën e ndërtimit socialist dhe të luftës kundër imperializmit e revizionizmit. Në të tre rastet shkrimtari ka ndjekur pikësynime kryesore të njëjta: pasqyrimin e qëndresës shekullore shqiptare, zbulimin e rrënjëve të saj dhe domosdoshmërinë e vigjilencës, të herëzimit e të vendosmërisë për të mbrojtur fitoret e arritura dhe për të ecur përpara fitimtarë.

Për t'ia arritur këtij qëllimi, shkrimtari është përqëndruar në momente, në tema e në subjekte me rëndësi historike. Veprat e tij më të mira kanë tingëllim të thellë kombëtar dhe janë pasqyruese të denja me forcë përgjithësuese të së kaluarës e të bashkëkohësisë shqiptare. E ka pasur apo nuk e ka pasur shkrimtari pretendimin e krijimit të një cikli veprash për të ndërtuar një «urë me tri harqe» kjo nuk ka aq rëndësi. Rëndësi ka që ky rezultat është arritur dhe meriton të shqyrtohet e të përshëndetet. Romanet, me platformë të përgjithshme të përbashkët, janë vazhdim e plotësim i njëri-tjetrit në tematikë dhe në ide. Shpesh në romane lidhjet legjendë-histori-bashkëkohësi si dhe të përmasave të së njëjtës kohë (e kaluar-e sotme-e ardhshme) shkrihen gjer në atë shkallë, sa krijojnë unitete ideoartistike me koherencë të madhe përmes paralelizmash, bashkëveprimi e kontrastimesh domethënëse, që u japin subjekteve legjendare e historike tingëllim bashkëkohor, mbështetin dukuri tipike, pozitive bashkëkohore dhe u theksojnë perspektivën. Sigurisht, do të kishte qenë e dëshirueshme që realiteti bashkëkohor ta kishte interesuar më tepër shkrimtarin, por edhe kjo mangësi do gjykuar e vlerësuar në bazë të asaj që është dhënë realisht.

Më konkretisht lidhjet në mes veprave vërehen në përsëritjen e disa ideve e motiveve nga njëri roman të

tjetri dhe në shtegtimin e disa personazheve që vijnë duke u theksuar.

Me gjithë veçoritë që i dallojnë, sepse Kadareja kërkon gjithnjë që ndryshimeve në përmbajtje t'u përgjigjen ndryshime në formë, romanet kanë tipare ideoartistike të përbashkëta. Por, para se të kalohet në shqyrtimin e tyre dhe pa hyrë në analizë të hollësishme, fillimisht është e nevojshme të paraqitet shkurt brendia e çdo romani, edhe pse për secilin nga ta nuk janë të paktë recensionet e artikujt në shtypin letrar. Shumë është shkruar sidomos për «Kështjellën», «Gjeneralin e ushtrisë së vdekur», «Dimrin e madh», «Kronikë në gur» si dhe për «Dasmën», kurse për përmbledhjet «Ura me tri harqe» dhe «Gjakftohtësia» jehona e diskutimeve ka ardhë disi e vonuar dhe vlerësimi i tyre ka mbetur në kuadrin e disa artikujve recensionues. Vrojtme dhe vlerësime me interes janë bërë për këto prej D. Shapllós, Xh. Abazit, Xh. Lloshit, K. Kodrës, P. Jorgonit, në librin e A. Uçit «Mitologjia dhe arti» e përmbledhtas në referatin e mbajtur nga D. Agolli në plenumin e L.SH.A. (mars 1982).

«Kush e solli Doruntinën» — pyet shkrimtari që në titullin e veprës, duke debatuar me baladën e famshme popullore të një rëndësie botërore, që shumëkush e ka çmuar si kryevepër poetike autentike shqiptare e për të cilën vetë Ismail Kadareja më se një herë ka shprehur admirimin (romani «Muzgu i perëndive të stepës», libri «Autobiografi e popullit në vargje»).

Balada popullore, në të gjithë variantet e njohura, ngre Kostandinin nga varri. Kadareja, me pretekst artistik realist, e mohon këtë mundësi, duke e çliuar nga forma tradicionale e saj, po dhe duke ndryshuar, historizuar dhe zgjeruar përmbajtjen e subjektin në një ndërthurje konfliktesh politike e shoqërore që e kalon trollin e jetës kombëtare. Sipas shkrimtarit, (përmes Stresit) thelbi i përmbajtjes së romanit, në të cilin përthyeren dhe shqetësime aktuale, është ky:

«Çdo popull, përballë rrezikut, mpreh mjetet mbrojt-

tëse dhe kryesorja krijon mjete të reja. Duhet të jesh dritëshkurtër që të mos kuptosh se Arbri ndodhet përpara dramave të mëdha. Herët a vonë ato do të mbërrijnë në kufijtë e tij, në mos kanë mbërritur. Atëherë del pyetja: në këto kushte të reja të keqësimit të klimës së përgjithshme në botë, në këtë kohë provash, krimesh e pabesish të lemerishme, ç'fytyrë do të ketë njeriu i Arbrit? Do të njëjësohet ai me të keqen, apo do t'i vihet përballë asaj? Me një fjalë, do të shfytyrohet për t'iu përshtatur maskave të kohës, në mënyrë që të sigurojë mbijetesën e vet, apo do ta ruajë fytyrën të pandryshueshme, duke rrezikuar të tërheqë mbi vete zemërimin e kohës? Për Arbrin po afron çasti i provës, i zgjedhjes midis dy fytyrave. Dhe, në qoftë se populli i Arbrit ka filluar të përpunojë në thellësitë e tij struktura të tilla sublime, siç është besa, kjo tregon se Arbri është duke e bërë zgjedhjen e vet. Këtë mesazh u ngrit për t'i sjellë Arbrit dhe gjithë botës, nga fundi i gropës, ku qe shtrirë, Kostandini». («Gjakftohësia», f. 175-176).

Kjo besë, siç tregohet në roman, paska lindur diku në një fshat të një shteti të papërcaktuar arbër, por feudalët nuk e lënë të përhapet se cënon interesat e tyre. Ajo ka ideolog dhe ithtar të zjarrtë Kostandinin. «Ai, — siç dëshmojnë shokët e vet, e quante besën një nga gjërat më sublime dhe kishte mendimin se kur ajo si dhe të tjera ligje të ngjashme me të, do të përhapeshin e do të merrnin në dorëzim të gjitha fushat e jetës, atëherë ligjet e jashtme, bashkë me institucionet e tyre, do të binin vetvetiu, siç bie lëkura e vjetër e gjarprit» (Po aty, f. 163) «Me një fjalë, — thoshte ai, — Arbri duhej të ndryshonte ligjet e veta, zyrrat, burgjet, gjyqet e gjithçka tjetër, t'i bënte të tilla në mënyrë që të mund t'i merrte ato nga bota e jashtme e t'i strehonte brenda njerëzve kur të afrohej stuhia. Ai duhej ta bënte këtë, ndryshe do të fshihej nga faqja e dheut. Kështu fliste Kostandini. Dhe ai mendonte që kjo strukturë e re do të fillonte nga besa». (f. 165)

Siç shihet, shkrimtari disi në frymë voluntariste, i ka dhënë legjendës tronditëse përmasa kombëtare në një epokë parakombëtare dhe ka përfshirë në intrigë krerët e fesë, luftën fetare në mes Bizantit e Romës, ka sajuar mbi Kostandinin një pandehmë incestare ndaj motrës dhe i ka dhënë romanit një zgjidhje që nuk është zgjidhje (fjalimi i Stresit për besën) në një kohë kur jo Stresi a dikush tjetër, as Doruntina, po Kostandini, si predikues parimesh të reja e parashikues utopist strukturash të ardhshme, duhej të kish qenë heroi kryesor. Nëse me besë nënkuptojmë, sipas Kostandinit, shokëve të tij dhe Stresit të bindur prej tyre, bashkimin (të mos themi unitetin) përballë rrebesheve që i kanosen Arbit «...shtrënguar si në darë midis dy feve, të Romës e të Bizantit dhe midis dy botëve, Perëndimit dhe Lindjes» romani, përveç deklaratave të bëra nga Stresi e shokët e Kostandinit, në asgjë nuk flet për këtë çështje, po për episode të largëta, në mos dhe të kundërta me të. Gjatë merret autori me «thashemnaja» në stil tregimi policor dhe me ndjenjën incestare (në të vërtetë balada është protestë kundër ekzogamisë), intrigën e kryedhespotit dhe askush nuk dëshmon asgjë të sigurt.

Kush e solli Doruntinën? Nëse kjo nuk ka rëndësi, atëherë humbasin rëndësinë dhe ato që thuhën për të. Fjalimi i Stresit mund të bëhej me çdo pretekst tjetër.

Në baladën e vjetër popullore i vdekuri domosdo do të ngrihej nga varri për të shprehur idenë se besën nuk e tret as dheu; madje, kjo «ringjallje» në të jepet si diçka e kobshme, si mallkim për krushqinë me njerëz të largët dhe për besën e shkelur. Kjo do të thotë se konvencioni ka qenë fryt i një mënyre të caktuar të menduari artistik. Vendosja e subjektit në një kuadër historik dhe trajtimi realist i tij do të kërkonte detyrimisht shndërrimin e strukturës së legjendës, e cila s'mund të krijohet gjatë një vajtimi, po në dhjetëvjeçarë. Autori, duke hequr dorë nga konvencioni i ringjalljes e duke iu larguar kështu trajtimit që i bëhet temës së njohur në baladë, s'ka arritur të japë një alternativë tjetër të de-

një artistike, ndaj vërtitet në arsyttime e përsiatje racionaliste.

Ndërsa në romanin «Kush e solli Doruntinën» shkurorëzohet legjenda në vështrim çmitologjizues pa arritur të trajtohet historikisht subjekti i saj, në «Ura me tri harqe», sado në formë të lirë, në të kundërtën, flitet për shfrytëzimin e legjendës në përligje të një krimi të shëmtuar, që lind nga konkurrenca ndërmjet dy sipërmarrjeve «kapitaliste». Fantazia e shkrimtarit në këtë vepër është më e lirshme me preokupimin që të krijojë paralele e kontraste në mes asaj epoke të hershme feudale artistikisht të modernizuar dhe epokës së ekspansionit ideologjik dhe ekonomik imperialist si përgatitje për agresionin ushtarak.

Si në romanin e parë, po të lëmë mënjanë te ky hollësitë, fati i Arbrit dhe rreziqet që i kanosen përbëjnë thelbin ideor të veprës, me ndryshimin se këtu ndër shkaqet e rënies së mundshme në të ardhmen llogaritet edhe egoizmi i feudalëve, të cilët flijojnë interesat e vendit për fitime vetjake etj. Përsëri po ajo ide: Arbri dhe bota me synimet e lakmitë e saj, në disa përfytyrime, që pak të shtyjnë të pandehësh se e tillë paska qenë e vërteta historike. Me gojën e murgut Gjon Ukcama, që na hedh përtej mjegullave pelazgjike, shprehet racionalisht po ai shqetësim i Kostandinut dhe i Stresit.

«Truallit të Arbrit, — shkruan ai, si autor i kronikës, — i ra fati të ndodhet në udhëkryq të historisë, midis Perëndimit dhe Lindjes. Kthe kokën nga Perëndimi dhe midis llogarive dhe përqindjeve të tyre do të shohësh gjak, kthe kokën nga Lindja dhe gjaku skuq gjithë horizontin». («Ura me tri harqe» f. 108)

Në meditimet e murgut, më tepër se në përfytyrime artistike të mishëruara në figura ekspresive, janë hedhur në roman dhe të tjera mendime për pavdekësinë e popullit të Arbrit që «ka lindur bashkë me perënditë», për dhembjen («si do të bëhesh Azi, ti, që je kaq i bukur, Arbri im!», diçka për mosmarrëveshjet e brendshme të kryezotërve që bien ndesh me domosdonë

historike të formimit të një shteti në një kohë kur kombësia ka historinë e vet, goftë dhe të trupëzuar në epokë në lëgjenda. Kanosjet e osmanëve, të cilët gjithçka ngjan e zvarrur, përgjumëse, e papërcaktuar, kurthore, ndodhin në një kohë (1379) kur kapitalizmi sapo shfaqej në trevat evropiane, duke përfshirë dhe Shqipërinë (kujtojmë bankat e jetën tregtare të Durrësit, sipas shkrimtarit). Por jo, as kjo nuk duhet, as ky fat nuk i shkon për shtat Arbrit. «Ai rendi i ri... — mediton murgu, — ai rendi juaj i bankave e i përqindjeve, që do ta çonte një mijë vjet përpara botën, ka gjak në themele, ashtu si rendi barbar dikur, si rendi i skllëvërve, si rendi i sotëm i princave e zotërinjve. Ka gjak, veçse ai gjak rrjedh ndryshe, nëpër llogari, nëpër shifra... Llogaritë tuaja janë plagë të tmerrshme, përpara të cilave çarjet e heshtave e të sëpatave duken si gërvishje kalamajsh. Mjerë bota që ju polli ju!» (f. 90)

Kështu mendon e paramendon murgu Gjón Ukcama në kohën kur borgjezia në botë sapo ka nisur të thotë fjalën e vet, që vërtet do ta çonte jetën «një mijë vjet përpara». Po murgu si murgjit, sado i përparuar, i emancipuar, i kulturuar e atdhetar, idealist se idealist do të mbetet: as zhvillim kapitalist, as ura, as pushtime të huaja, as afrim me Lindje a me Perëndim. Diçka tjetër: një konstitucion, një strukturë të brendshme shpirtërore të denjë për këtë popull të lashtë, që gjithçka e ka menduar, e ka bërë, e ka jetuar ndryshe, gati me një ligjësi «të veçantë» historike. Kurse shkrimtarit në pasqyrimin e konkurrencës në mes dy sipërmarrjeve (të huaja), të krimit të muosjes së Murat Zenebishës, të ecejakeve të grupeve «turistike», të dervishëve endacakë, të konflikteve në Orikum etj. dhe në fjalët e murgut, duke modernizuar historinë, më tepër i rreh mendja për kohën e sotme, sesa për atë epokë tanimë të largët. Në fjalët e cituara kemi më tepër pretencën e imperializmit të sotëm se gjykimin e borgjezisë që sapo çelte hapësirë të reja të historisë së njerëzimit. Modernizimi i historisë

dhe zotërimi i aludimeve për kohën tonë ka sjellë avancimin e personazheve, duke u atribuar atyre mendime disi intelektualiste të autorit. Arbri hesht fatkeq në «kryqëzim të historisë», kurse princat bëjnë jetë princash, kryezotësh. Te «Pashallëqet e mëdha» admirimi i shkrimtarit për ta është i përligjur, sepse vetëm përmes zgjerimit të principatave e jo ndryshe do t'i çelej udha krijimit të shtetit kombëtar.

Jetë e ngurtësuar. Edhe rrugët e urat — arterie të bashkimit, edhe nxjerrjen e serës etj., janë të huajt, imperialistët (në kuptimin e hershëm të fjalës) që i realizojnë. Arbri, populli i Arbrit (anonimati i madh i romanit), ai që edhe flitë i ka bërë për ndërtime e jo për fushata luftash e krimesh (f. 68) sipas autorit, shikon apatik si vijnë nga larg të huaj «një palë nga ujërat, të tjerët nga stepat» (f. 87) dhe turqit pas tyre. Ai vetëm dëgjon përdhosje legjendash e baladash të sajuara nga rapsodë të shitur, uron bashkë me murgun «Ardhtë dita e Arbrit!» dhe pret shpëtimtarin, prijësin. «Qysh tani koha do të fillojë të mbrujë udhëheqësin e ardhshëm, — shkruan Gjon Ukcama. — Do t'i duhet ndoshta pesëdhjetë vjet për ta nxjerrë, ose pesëqind vjet për ta përsëritur, kjo s'ka rëndësi. Ai do të vijë. Do t'i vijë Shqipërisë.

Ai që do ta kthejë mbrapsht munxën e tmërrshme që na dërguan të huajt. Ai që do të kthejë përpara akrepat e kohës».

Prapë murgu-murg, sado shqiptar, po romantik idealist, adhures i kultit të heronjve, i parë nga shkrimtari si njeri më i përparuar se koha e vet, më afër ideve të Rilindjes Kombëtare, që krijon përfytyrimin e një historie kombëtare pa lëvizje të brendshme përpara, me dëshira utopike bashkim kryezotësh e me një «fron» të supozuar të Arbrit, të cilin pas Karl Topisë — pretendenti i fundit i denjë, s'ka kush ta marrë. Duhet prituri... Skënderbeu. Të gjitha këto në një kohë kur vendi ynë, principatat e fuqishme shqiptare, që trashëguan nga antikiteti, po të perifrazohet Engelsi,

qytete të rënuara dhe kristianizmin, hynte jo më pas të tjerëve në epokën e ndritur të Rilindjes. Me gjithë veçoritë dhe origjinalitetin e një populli që kish pasur historinë dhe jetën e vet të veçantë, ai nuk mbeti kurrë i mbyllur, enigmë, në një botë të huaj dhe veçoritë e zhvillimit të tij kanë qenë jo e kundërta, po shprehje e ligjësive të përgjithshme.

Në të dyja romanet afëria e autorit me pikëpamjet e shprehura prej personazheve përfaqësuese dhe me qëndrimet që ata mbajnë (Stresi, Gjon Ukcama) është e dukshme dhe përbën, mund të themi, bazën e asaj platforme ideore që është shfrytëzuar për përjasje të subjekteve legjendare me rrethanat historike dhe problematikën e epokës sonë. Synimi është i drejtë dhe, në aspekte të veçanta e në imtësira, është sjellë material artistik me interes, është hedhur dritë në kënde të parrokura gjer tani nga letërsia jonë. Me gjithë këtë në vazhden çmitologjizuese të letërsisë realiste botërore, autori, i vënë para vështirësish serioze ideoartistike, nuk i ka përballuar kurdoherë me sukses. Në rrafsh historik, i prirë nga çmitologjizimi, ai i ka vendosur subjektet legjendare në epokën kur pandehet se kanë marrë formën e njohur baladat popullore, por, duke iu larguar trajtimit legjendar, nuk është kujdesur në masën e nevojshme për një argumentim historik të domosdoshëm gjatë ritrajtimit realist. Pa dashur të bëjmë krahasime, kujtojmë këtu, si shembull, romanin e Brehtit «Çështjet e zotit Jul Qezar». Autori i këtij romani ka pasur qëllim t'i heqë Jul Qezarit breroren e heroit të madh e të virtyshëm që i ka vënë historiografia borgjeze dhe ka treguar se «heroizmat» e tij janë nxitur e udhëhequr prej interesave skllavopronare dhe janë ndërthurur me lakmitë, intrigat dhe barbarizmat karakteristike për epokën. Aludohet në roman dhe për konkurrencën dhe karakterin gjakatar të kapitalizmit, por pikënisje mbetet epoka e skllavo-



pronarisë dhe çdo paralelizëm me epokën imperialiste rrjedh vetvetiu, siç është e domosdoshme për një trajtim realist të temave legjendare e historike.

Mbetesh me përshtypjen se Kadareja ndjek rrugën e anasjelltë: niset nga e sotmja dhe rreh të gjejë ose të sajojë subjekte legjendare e historike, të cilat t'i japin mundësi të paragesë, do të thoshnim në formë disi alegorike, preokupimet dhe gjykimet e veta për epokën tonë. Për këtë arsye, ai është i interesuar, së pari, për konsekuencën logjike të subjekteve dhe jo aq për vërtetësinë historike të tyre, megjithëse mbështetja më e gjerë në materiale historike duket shumë e mundshme dhe do të kish qenë dobiprurëse si për t'iu shmangur trajtimeve tepër të lirshme të historisë, edhe për ta mbajtur brenda caqesh më realë e më bindëse tingëllimin aktual të veprave.

Afëria e tepruar e autorit me personazhet përfaqësuese të dy romaneve (ndryshe: shprehja përmes tyre e pikëpamjeve të autorit) lë, disa herë, shteg për ekuivoqe ideore e për diskutime, si për trajtimin e lëndës legjendare të historizuar disi në plan intelektualist, edhe për aludimet e përqsasjet që bëhen me epokën tonë. Pa u munduar të pikëzojmë për çdo rast, ku synon autori të bëjë përqsasje me kohën tonë e ku jo, na duket se as në rrafsh historik, as si aludime për kohën tonë nuk i qëndrojnë kritikës pikëpamjet e autorit për një ligjëtori të veçantë zhvillimi të kombit shqiptar. (e ndeshim këtë pikëpamje dhe në disa historianë të huaj), për kërkimin e një «rruge të tretë» përparimi, për heqjen dorë prej ligjeve, drejtimit e administratës shtetërore, duke ngritur një tempull ligjshmërie në ndërgjegjen e secilit apo me konceptin idealist të kultit të heroit që ardhka në jetë një herë në disa shekuj. E, natyrisht, ne e kuptojmë protestën ndaj organizimit shtetëror antinjerëzor të asaj kohe.

Mendojmë edhe se zor është të hiqen vija paralele në mes rivalitetit të dy superfuqive të sotme dhe konflagracioneve të epokës feudale, të rrethanave në të

cilat ndodhet vendi yt sot, kur ndërton socializmin në rrethim imperialist revizionist dhe atyre kohëve të largëta, kur ende nuk kishte një shtet kombëtar përfaqësues, as një aspiratë që do të tejkalonte centralizmin shtetëror feudal apo edhe hyrjen në rrugën kapitaliste. Nga ana tjetër është e provuar historikisht se pikërisht ai stad zhvillimi ekonomik, shoqëror, kulturor, ajo vetëdijë kombësie e kultivuar në popull nga lashtësia ilire, ato aspirata humanitare të Rilindjes (Evropiane, domosdo, edhe Shqiptare), ajo ndjenjë sigurie e besimi në sfidimin krenar të çdo kanosësi e dhunuesi të huaj ish-in terreni i begatë për epokën njëzetepesëvjeçare të Skënderbeut, gjatë së cilës u ndesh jo vetëm një popull që donte të rronte i lirë me ata që donin ta robëronin, as thjesht kristianizmi me myslimanizmin, po edhe bota e re, Rilindja, me kalbësinë mesjetare anadollake. Ky është Arbri i bukur, i ndritur, i prirë dhe i vënë në udhën e përparimit. Mesjeta orientale e pushitimeve barbare vihej përballë zgjimit të kombeve, agimeve të një rendi të ri shoqëror e të një qytetërimi të ri. Këtë, sado jo me aq qartësi e aq plotësisht, e patën kuptuar edhe De Rada me Naimin, siç del nga veprat kushtuar epokës së Skënderbeut. Këtyre u shtohet papajtueshmëria në jetën shpirtërore, në mënyrën e jetesës, në zakonet, në gjuhë, në ato që përmbledhtas quhen «veçori kombëtare» të popujve. Dhe kështu, mbi dasitë feudale, si shprehje e aspiratave popullore dhe bashkim i përkohshëm princash e kryezotësh, u përtërinë themelet dhe mori formë «Kështjella» shqiptare, hyri në skenën e historisë Skënderbeu.

Me romanin «Kështjella» nis trajtimi i temës së vërtetë «historike» nga Ismail Kadareja, në atë kuptim e shtjellim të lirshëm që i bën ky shkrimtar kësaj teme, ndryshe nga shkrimtarët tanë të tjerë (Sterjo Spasse, Dhimitër Shuteriqi, Sabri Godo, Mirosh Markaj, Sulejman Krasniqi, Skënder Drini etj.). Në përgjasim me vepra e individualitete të njohura, koncepti i Kadaresë për të parë brenda temës kryesisht logjikën historike

është i afërt me konceptin e Shekspirit e të Brehtit. Krahasimi mbase çalon por të dy rrugët kanë në themel diçka të përbashkët: synimin që veprat letrare mbi materiale historike t'i largohen «historisë së letrarizuar», ta çlirojnë shkrimtarin nga frika e qortimeve të historianit pedant dhe t'i japin krahë për fluturim, kur ka krahë dhe di të fluturojë. Është fakt i bukur për t'u shënuar që në botimin francez «Kështjella» («Daullet e shiut») është shoqëruar me një pasthënie të shkruar nga historiani ynë i shquar Aleks Buda. Nëse historiani dhe shkrimtari do të bënin të njëjtën gjë, vetëm me ndryshime formale ndaj objektit të përbashkët, njëri prej të dyve duhej të hiqte dorë, pa keqkuptime.

Që të mos zgjatemi, Ismail Kadareja, nisur nga historia dhe besnik ndaj saj, (jo skllav i hollësive dhe i datave) në një strukturë artistike jo të panjohur në letërsinë botërore, po thellësisht shqiptare në thelb, me romanin «Kështjella» — më e përsosura vepër e tij nga forma dhe stili — i ka ngritur një përmendore letrare qëndresës shqiptare.

Forca ndikuese e këtij romani qëndron në faktin se ideja e mishëruar në strukturë dhe fryma që e përshkon shprehin një nga ato të vërteta të përjetshme, të provuar qindra herë nga epokat dhe historitë e popujve. Rrethimet e Krujës, Shkodra e rrethuar, Oso Kuka, Perlat Rexhepi me shokë, Heronjtë e Vigut, Shqipëria e rrethuar... Sa histori, sa legjenda gojëdhëna, këngë popullore për qëndresën në rrethim! Ç'parrullë luftarake, mobilizuese, tendosëse: «Të punojmë e të jetojmë si në rrethim!»

Një kritik i huaj, jo pa bazë, mund të gjejë ndonjë përgjasim me vepra të tjera. Përgjasime ka, po kompozicioni dhe struktura e veprës i është sugjeruar autorit nga gjithë historia shqiptare e jo vetëm nga betejat për mbrojtjen e kështjellave tona. Këtu ka përgjasim me një veçori kompozicionale të pikturës e të skulpturës sonë në tëmë nga historia luftarake e popullit. Të bën përshtypje që në shumë tablo piktorësh e grupe skulp-

turorë figurat e luftëtarëve vështrojnë e shtijnë mbi armiqtë nga lart-poshtë, të vendosur mbi shkëmbinj e shkropa malesh, gjithnjë në qëndresë, kurdoherë të bukur, sikur diçka kanë marrë nga hijeshia, ashpërsia, patundshmëria dhe madhështia e maleve. Kurse për të sotmen: relievi i vendit, majat e larta të historisë ku jemi ngjitur, ndjenja e një populli krenar, hovet e reja të shqiptarëve që fluturojnë lart dhe armiqtë, të egrit, të neveritshmit, sado të përbindshëm po kurdoherë rrëshqanorë, kurdoherë diku poshtë janë vërtitur, atje, diku poshtë, ku historia u ka lënë vendin e merituar.

Kështu dhe «Kështjella» — sikurse «Gjenerali i ushtrisë së vdekur» — është kompozim e strukturë e gjetur në historinë e popullit. Është historia e rrethimit dhe e qëndresës së shumë kështjellave, po simbolikisht është historia e qëndresës shqiptare. Muret dhe kullat e kështjellës — lart e mbi to kështjellari sogjetar, që vrojton nga lart poshtë hordhitë osmane, mizëri laramane e zhurmëmadhe, që ngjallin shqetësim, që shkaktojnë fatkeqësi, që japin munxa, po mbeten prapëseprapë të urrejtur e të përbuzur, të detyruar të jenë atje, poshtë dhe të rrëshqasin sërishmi si zvarranik i përbindshëm andej nga kanë ardhur, nën goditjet e trishtueshme të «dauleve të shiut». Kështu ndodhi në epokën e Skënderbeut me ushtritë e sulltanëve osmanë. Kështu ka ndodhur në Shkodër, në Dibër, në Kosovë, në Martanesh, në Kurvelesh e Mallakastër, në Plavë e Guci, në Lëkurës, në Bozhigrad e Trestenik.

Duke e parë qëndresën shqiptare në plan monumental, autori ka synuar një gjuhë lakonike, një shkurtësi sintetike të kronikës dhe përsiatjeve të kështjellarit në fillim të çdo kapitulli. Ato, si tërësia e vepërës, janë një mësim nga historia, nga realiteti i kohës dhe paralajmërim për të ardhmen.

Aludimet për situata aktuale dhe për fundin e turpshëm të çdo agresioni të mundshëm janë pothuajse të dukshme.

«Në të dalë të dimrit, — thuhet në kronikën e kështjellarit që në hyrje të romanit, — kur delegatët e sulltanit i larguan, ne e kuptuam që lufta ishte e pashmangshme. Ata na bënë gjithfarë presionesh që ne të prananim vasalitetin. Në fillim përdorën lajkat dhe premtimet, pastaj na akuzuan si rënegatë dhe mosmirënjohës. Më në fund, na kërcënuan hapur se do të na mposhtnin me anë të luftës. Ju u besoni shumë mureve të kështjellave tuaja, na thanë ata, por edhe në qoftë se ato mure janë vërtet të papushtueshme, atëherë ne do të bëjmë që ju të dorëzoheni nga uria. Ne do të bëjmë që sa herë të vijë koha e korrjeve dhe e ditëve të lëmit, ju të shikoni qiellin sikur të ishte fushë e mbjellë dhe hëna t'ju duket si drapër...

Nuk kaloi as një muaj kur të gjithë vasalët e sulltanit, pasi morën letra prej tij, njëri pas tjetrit i pranë marrëdhëniet me ne» («Kështjella» f. 3).

Më tej, nga fundi i romanit:

«Ata provuan çdo gjë kundër nesh, duke filluar nga topat gjigantë gjer te minjtë e infektuar. Ne qëndruam dhe po qëndrojmë. E dimë që kjo qëndresë po na kushton shtrenjtë dhe ndoshta do të na kushtojë edhe më shtrenjtë. Por dikush duhet të qëndrojë. Në rrugën e hordhisë së çmendur gjithmonë duhet të çohet dikush dhe këtë herë koha na zgjodhi ne. Koha na vuri përpara dy rrugë: rrugën e lehtë të nënshtimit dhe rrugën e rëndë të luftës. Ne zgjodhëm të dytën. Ne mund të zgjidhnim të parën, në qoftë se do të mendonim vetëm për veten tonë. Ne mund t'i ngrysnim ditët tona në paqe, pranë parmendës dhe ullinjve, — por kjo do të ishte paqe e vdekjes». (f. 213).

Dhe, në kronikën para kapitullit të fundit bien daullet e shiut. Kampi i tyre i zhurmshëm merr pamje tepër të zymtë: «Ja, pra, kjo është ushtria më e madhe e botës së sotme. Ajo rri aty nën këmbët tona, duke u qullur në shi. Ata që do të jetojnë më vonë mbi këtë tokë do ta kuptojnë se ne nuk e patëm të lehtë të ngriheshim në këtë luftë vigane kundër për-

bindëshit më të madh të kohës. Ne nuk do të lëmë pas statuja dhe kolona madhështore. S'patëm kohë dhe, me sa duket, në pushimet midis rrebesheve që do të vijnë, s'do të kemi kohë t'i bëjmë ato. Në vend të tyre po lëmë këta gurë të rëndë muresh që po i lag këtë mëngjes të vrenjtur ky shi i luftës» (f. 231-232).

Kjo është njëra anë, njëri kënd shikimi: i madhërishëm, monumental e solemn, aq sa mund të jetë solemne një «stinë» lufte, jeta e një populli të tërë e kaluar në luftë e në rrethime.

Ana tjetër, një rrafsh tjetër shikimi, është epika e luftës, përplasja e hordhive të përbindshme valë pas vale në muret e kështjellës, përpjekja për t'u ngjitur në bedena dhe sprapsja, përvëlimi, gjakosja, shembja e tyre; ekspeditat ndëshkimore në malësi dhe kthimi i ushtrisë së shpartalluar në kamp; orvatjet me armë hata, me minj përhapës kolere, me llagëme të nëndheshme e me gjithfarë dredhish; sulmet rrufe të reparteve sulmuese të Skënderbeut, që përhapin panik dhe vdekje. Monumentalitetat kështjellor ja lë vendin epika e veprimve luftarake, e reflektuar në disfatat dhe në gjendjen shpirtërore për herë më të rënë të ushtrisë armike, në egërsinë hakmarrëse, në nervozizmin e krerëve, në demoralizimin e ushtarëve, në varret e përbashkëta të taboreve, në rënkimet e lemerishme të atyre që mbetën në llagëmin e nëndheshëm të shembur, në ëndrrat e projektet e ekspertëve për armë e metoda më moderne lufte. Gjithçka në këtë epikë luftarake shikohet nga poshtë-lart dhe, me gjithë dinamiken e përshkrimit të orvatjeve të armikut për pushtimin e kështjellës, origjinaliteti i vërtetë i Kadarës është në përthyerjen e flakëve të luftës në vetë kampin armik, në dhënien e gjendjes shpirtërore dhe fundit të kryekomandantit të tyre, Ugurhi Tursun pašait. Ka diçka në këto përshkrime e tregime nga historia e shekullit të pesëmbëdhjetë, si dhe nga logjika, realiteti dhe historia, e të gjitha luftërave imperialiste prej lashtësisë deri në ditët tona, siç ka diçka nga ma-

dhështia e të gjitha luftërave çlirimtare të popujve dhe disfatat e turpshme të agresorëve.

Ndërsa në fillim të romanit kronikani Evlia Çelebiu vret mendjen të gjejë epitetet më të bujshme për të karakterizuar lavdinë osmane dhe poeti Sadedin në ekstazë jeton ëndrrën e hartimit të një poeme të madhe epike, nga fundi ky poet endet i qorruar dhe «i lumtur» që s'është në gjendje të shikojë katastrofën; kronikani mendon trishtueshëm mbi fletët e kronikës së vet shumë të vështirë përlavdëruese:

«Ja ç'do të mbetet më vonë nga ky gjak i derdhur nën këtë diell përvëlues, nga këto dhjetëra mijëra plagë të frikshme, nga këto gjëmime topash, nga pluhuri i verdhë i marshimit të mundimshëm, nga kllapia e hipjes dhe e zbritjes së vazhdueshme nëpër muret e kalasë, kur kacaviresh përmes ziftit dhe shigjetave gjer lart dhe andej zbret prapë poshtë për t'u kacavjerë përsëri përkrah shokut, që nuk të njeh më, sepse fytyra të është ndryshuar nga plagët. Ja ç'do të mbetet nga lëkura e zeshkët e ushtarëve, nga ato mijëra pashë lëkurë, mbi të cilin metal i mprehtë, gjaku i piksur, pas mbarimit të luftës, vazhdonin të ndryshonin vetë pamjen, sikur të ishin të gjalla. Dhe, më në fund, ja ç'do të mbetet nga kjo mizëri çadrash, të cilat, kur të shkuleshin pas disa javësh, do të linin në këtë fushë mijëra gjurmë, sikur të kishte kaluar një mizëri kafshësh të çuditshme. Dhe këto gjurmë, siç tha kryeveqilharxhi, do t'i sheshonin dalëngadalë era dhe shiu i dimrit dhe në pranverë mbi to do të mbinte bari, mijëra fije të vogla dhe indiferente, që s'dinë asgjë nga ato që ndodhin në këtë botë» (f. 214-215).

Kështu ndodh. Hordhitë barbare dhe agresorët, sado lakenj të penës së blerë, sado kolosal ta kenë aparatit e propagandës e çfarëdo kërkimesh të bëjnë për sajime epitetesh, metaforash e simbolesh, art të vërtetë e të madh nuk mund të krijojnë. Arti i vërtetë nuk mund t'i këndoje robërisë, shkatërrimit dhe vdekjes, të jetë i shitur dhe i gënjeshtër. Eposin e madh frymëzues e kanë lindur

luftërat çlirimtare dhe revolucionet. Pjellë e agresioneve është apologjetika false dhe dekadenca e pashmangshme.

Romani «Kështjella» në shumanshmëri e me një thjeshtësi e qartësi të rrallë flet shumë edhe për këtë gështje.

Këndi tjetër i shikimit është paraqitja mjaft e hollësishme e gjendjes së hordhive osmane e, përmes tyre, e rendit ekonomik, shoqëror e politik të Perandorisë Osmane në atë kohë (shek. XV).

Për vërtetësinë e hollësive ekonomike, politike, administrative, ushtarake historianët mund ta thonë më me kompetencë fjalën e tyre, por për ne ka rëndësi se në drejtimet kryesore autori i përmbahet së vërtetës historike dhe e ka pasqyruar atë me shprehimësi të madhe artistike, deri dhe me nuanca të gjendjeve psikologjike e morale.

Në një artikull kritik është thënë se në romanin «Kështjella» janë zbuluar «rrënjët e qëndresës shqiptare». Do të ishte e udhës të thuhej që, më gjerë se kjo e përballë saj, në roman janë zhbiruar rrënjët e disfatës së pushtuesve osmanë dhe të agresionit imperialist përgjithësisht.

Ismail Kadareja është nisur nga mendimi se në agresion e në aventura ushtarake kundër popujve hidhen ato forca e ato shtete reaksionare që ndodhen në krizë të brendshme dhe kanë hyrë në fazën e dekadencës. Ethet e luftës, militarizimi i jetës, demonstrimi i forcës janë orvatje për të dalë nga kriza, pa i shpëtuar as degjenerimit të mëtejshëm, as korrupsionit, as fundit të pashmangshëm. Me vizatime karakteresh e gjendjesh shpirtërore, shpresash për karrierë, ëndrrash për një copë tokë të huaj, rivalitetesh e zilish, frike e kanosje të ndërsjellte nga padishahu e Tursun pashai deri te graduatët më të vegjël, raprezalje për të zotëruar gjendjen, propozime e fjalime prapa të cilave fshihen interesa egoiste, burokratizëm i përbindshëm feudal, ethe lufte, shpikjesh monstruoze, variantesh luftimi — shprehje të politikës imperialiste, po dhe të frikës së ndëshkimit, — të gjitha



këto lëvrijnë, në fushimin e ushtrisë, në mbledhjet e shtabit, në bisedat intime. Lexuesi mbetet me përshtypjen se ato, si insekte brejtëse, e mikrobe shpërbërëse janë përhapur në të gjithë hapësirën e pamatë të perandorisë, gëlojnë kobsjellëse prapa pompozitetit të jashtëm, mëndafshit të flamurëve, emblemave, uniformave të pohëshme, tamtameve, paradave etj. Tursuni i plotfuqishëm jeton me ankthin e dorëzimit në Stamboll të kokës së vet të prerë, teksa të tjerët, «përgjegjësit» e vdekjes, zhvatës të haraçit të të vdekurve (komandantë, kryeveqilharxhë, arkitektë, shpikës armësh etj.) përpiqen të veçojnë fatin e tyre nga disfata. Kjo do të thotë, siç konstatojnë vetë Tursun pashai, se «kanë humbur krejtësisht shpresën për fitore» (f. 227).

Shkrimtari shpesh, në formë sentencash të goditura, që kanë domethënie të gjerë, me ngjyra të thekshme ka arritur që të paraqesë në mentalitetin, të menduarit, ndienjat dhe aspiratat e njerëzve, përthyeriet e çnjerëzishme të tyre, të paraqesë tiparet e një shteti imperialist, militarist, burokratik. Këtu shtet s'mund të thotë fjalë të re në histori. Pikërisht për këtë arsye piell vetëm monstruozitete e tragjedi, siç ndodh edhe në kohën tonë me shtetet imperialiste, me ethet luftënxitëse të tyre, me krimet, me agresionet barbare e disfatat e turpshme, me skandalet e buishme, me absurditetin e nëritur në sistem. Këtu është një prej «sekreteve» pse i vogli mund viganin dhe i shtypuri tiranin. Tmerre e gjakderdhje pa mbarim, po ashtu disfatë pas disfate — kjo do të jetë deri në fund historia imperialiste, derisa Fxherët të dështojnë piniollin e fundit të vandalizmit. Por do thënë se si të «Kësh-tiella», dhe në romane të tiera të Kadaresë, edhe në pikëpamiet që shprehin antagonistët gjen përthverie të mendimit e të vlerësimeve të autorit, gjë që sikur i shmangë sadopak këto personazhe nga tendencioziteti i natyrshëm dhe i shndërron aty këtu në dëshmitarë e gjykatës objektivistë.

Ndjekja e dy këndvështrimeve që përmendëm i ka shërbyer autorit edhe për një interpretim filozofik më

të gjerë së lënda historike e përfshirë në vepër si dhe për theksim më të dukshëm të ngjasimeve mes qëndresës shqiptare në shekullin e 15-të e qëndresës së sotme heroike të vendit tonë e të çdo vendi tjetër kundër imperializmit dhe socialimperializmit.

Duke i dhënë rëndësi problemit të ekzistencës kombëtare dhe rrugëve e mjeteve që e sigurojnë atë, ai është shtrirë edhe në çështjet «ekzistenciale» individuale përmes përpjekjes për të depërtuar në mikrobotën e çdo personazhi të kombit osman. Ky trajtim është i përligjur historikisht dhe arrihet me realizëm, sepse në epoka kur vihet në diskutim ekzistenca kombëtare dhe kalitet ndërgjegjia e qëndresës heroike për sigurimin e saj, çështjet e «ekzistencës» individuale kalojnë në plan të dytë, i nënshtrohen të përgjithshmes e marrin theksin prej saj. Në të kundërtën, siç provohet dhe nga kaosi në botën borgjeze e revizioniste, në periudha rënie e shturje, «ekzistenca» individuale shfaqet me agresivitet, me intriga e pabesi; me rrudhje në guaskën egoiste, kurdoherë me kujdesin për të shpëtuar veten edhe me bjerjen e cilësive morale.

Në përqasje me epokën tonë, «Kështjella» është një vepër polemike, sidomos kundër teorizimeve e predikimeve revizioniste. Autori, herë përmes përfytyrimesh reale, herë me konvencionalizëm, sjell jehonën e polemikave të ashpra të fillimeve të viteve '60 mbi luftën dhe paqën, mbi rolin e njeriut e të armës në luftë, mbi qëndrimin e popullit e raporteve të ekonomisë, deri dhe mbi kuptimin e raporteve të ekonomisë me politikën, mbi rolin dhe përcaktueshmërinë shoqërore të artit etj. Do të ishte pa vend që çdo episod dhe hollësi konvencionalë të përdorur të ipej interpretim përgjasues bashkëkohor, siç u bë ndonjë përviektje fill pas botimit të romanit.

Ndërsa «Kështjella» është vepër me përmbajtje atdhetare për qëndresën shqiptare dhe kuptimin historik të saj tej kohës e vendit. «Pashallëzet e mëdha» (përmbledhja «Ûra me tri harqe») deri diku dhe tragjimi «Nëpunësi i pallatit të ëndrrave» (përmbledhja

«Gjakftohtësi») e trajton materialin historik ca më ndryshe, jo aq në rrafsh të përgjithshëm sesa në prirjen atdhetare, dënon vese të despotizmit feudal të huaj e vendës. Në këtë vepër, stilistikisht të bukur, vlerësimi i figurës së Ali Pashë Tepelenës zë vend qëndror në hapësirën problematike historike, me aludime të shumta për epokën tonë.

Historiografia jonë, po edhe letërsia artistike, populllore e kulte e Rilindjes dhe e kohës sonë, kanë bërë përpjekje jo të pakta për trajtimin e kësaj figure. Ndër veprat më të plota dhe më me vlerë është libri «Ali Pashë Tepelena» i Sabri Godos, shkruar me aftësi, njohje të thellë e me mjeshtëri. Edhe të huajt, sipas të dhënave bibliografike, nuk kanë shkruar pak për Ali Pashë Tepelenën, doemos sipas koncepteve dhe qëllimeve politike të shteteve që kanë përfaqësuar. Lexuesi i di këto, prandaj mjaftohemi të përmendim tingëllimin e njohur të Zef Serembes, ku sintetikisht dhe drejt është shprehur pikëpamja e gjithë Rilindjes Kombëtare për këtë figurë të madhe kontradiktore, si vetë koha që e lindi: madhështori dhe despot.

Po le të gjykojmë sipas Ismail Kadarese. Si fill të subjektit të veprës ai ka zgjedhur fundin e Ali Pashë Tepelenës dhe dërgimin e kokës së tij në Stamboll për t'u ekspozuar në «kamaren e turpit» («ibret tashé»): Mund të duket se, në këtë fill, subjekti fshihet vetëm një dëshirë për paracitje, episodesh, të iashtëzakontë, sensacionalë dhe makabër, ka shmangie nga epika e qëndresës së gjatë, të zgjuar e burrërore të tepelenasit të famshëm, denoncim më tepër se vlerësim realist të figurës së tij. Dicka të vërtetë ka në këtë mes. Por romani nuk është kv, as qëllimi kryesor i shkrimtarit. Mbi këtë fakt bazë e përmes përsiatiesh mbi ngjariet, si ndodh dhe në vepra të tiera të Kadarese, shkrimtari ka synuar të krijojë një përfytyrim të gjerë e të ngjeshur mbi atë periudhë të trazuar, shumë të ndërlikuar, të paqëndrueshme, ku janë ndërthurur e ndeshur forca e rryma nga më të ndryshmet. Idetë dhe lëvizjet e çlirimit kombëtar e shoqëror në atë

kohë janë ndeshur me përpjekjet për ruajtjen e gjendjes së pushtimeve të vjetra e për pushtime të reja, ndërsa përballë perandorive të vjetra feudale imperialiste vihej me agresivitet brutal imperializmi si rend shoqëror. Në këtë përfytyrim artistik, plot fantazi, Ali Pashë Tepelena është vendosur në një kuadër të gjerë historik, që përfshin Shqipërinë dhe gjithë Perandorinë Osmane. Mbi këtë kuadër shkrimtari është përpjekur të japë gjykimin e vet, jo aq për Ali Pashanë, sesa për Shqipërinë, për Perandorinë Osmane, për fatin e popujve të robëruar, të nënshtruar ose të shkom-bëtarizuar.

Është koha kur idetë e Rilindjes Kombëtare bëjnë përpjetë. Në këto ideja e bashkimit kombëtar është thëlbër dhe zë kreun e vendit. Ky bashkim s'kërkon pashallarë, despotë, po prijës, siç thotë atdhetari i masakruar nga Ali Pasha. Por ky atdhetar është më tepër idealist iluminist, sesa vlerësues objektiv i situatave, i mundësive dhe i rrugëve të realizimit të idealeve kombëtare. Ajo kohë nga radhët e krerëve feudalë lindi Bushatllinjtë dhe Ali Pashë. Pastaj populli nxori Gjolekë e Rrapo Hekalë, më vonë Naimë dhe Ismail Qemalë.

Në «ibret tashë» ekspozohet edhe koka e Ali Pashait, edhe ajo e Hurshidit me shokë, po motivet që frymëzuan secilin janë të ndryshme, të kundërta. Edhe qëndrimi ideoemocional s'mund të jetë po ai, madje as diçka që përgjason. Në këtë drejtim romani nuk i shkon deri në fund çështjes, shikimi i shkrimtarit nuk është i shumanshëm sa ç'do të kërkohej nga një vepër realiste. Në eposin e Ali Tepelenës — aq real e dhjetërvajçar — si dhe në dramën e tij ka diçka me rëndësi nga eposi dhe drama e Shqipërisë së asaj kohe, sikurse në despotizmin e tij gjejmë reflekse të feudalizmit shqiptar dhe ato të feudalizmit ushtarak turk. Për rebelimin sulltani kërkon kokën e Ali Pashait, ndërsa Shqipëria vajton fundin e tij. Për të dytat Seremlja e zhyt «në llum» despotin dhe shpreh kështu

protestën e vegjëlisë. Çështja kombëtare, qoftë dhe në suazën e një principate feudale, si ato që krijuan Bushatllinj të dhe Ali Tepelena, nuk mund të njësohet me rivalitetin feudal në përgjithësi, as me rebelimin e feudalit më të vogël ndaj kryefeudalit. Kur shtrohet çështja kombëtare (objektivisht ata e ndihmuan këtë çështje dhe u mbështetën në aspiratat e traditat kombëtare të popullit) simpatia u takon «rebelëve», edhe kur nuk përfaqësojnë aspiratën për një rend shoqëror më të përparuar. Ndaj zor të pranohet pohimi mbi indiferentizmin e popullit, kur thuhet: «Ata që gjithë jetën kishin shkuar në luftë më lehtë dhe më natyrshëm se në dasmat e vjeshtës, tani s'lëvizën. Le të grindeshin tirani me tiranin. Le t'i nxirrnin sytë e t'i shkullnin mjekrat njëri-tjetrit, atyre aq u bënte». (f. 202)

Në kapitullin e pestë — kapitulli më përmbajtësor i romanit — është bërë përpjekje për portretizimin e Aliut prej Vasiliqisë, të burgosurit, shkrintarit dhe vetë Aliut të zhytur në një meditim të gjatë e plot trazime. Pashai mund të krijojë një pashallëk po jo shtetin shqiptar — bën cilësimin e vet i burgosuri, pionier i Rilindjes. Madhështor, që shkakton mahnitje admiruese e të frikshme është për Vasiliqinë. Kurse vetë ai (dhe këtu ka prapë diçka nga gjykimi i shkrintarit), vënë përpara provës së fundit dhe ndërgjegjes së vet, përvijon një autoportret, deri diku të çiltër, me shumë dhembje, inat, krenari, burrëri, pendim, etje lavdie, smirë për më të famshmit e së kaluarës e të së ardhmes, për ligje të egërsisë. E, në të gjitha: inatçor, rebel, i zgjuar, makiavelist, përbuzës, gjokshapur e kryelartë edhe para më të fuqishmëve, po i dobët deri në rraskapitje para popullit dhe Shqipërisë.

Përmbi gjithë ngjyrat, përmbi gjithë luhatjet e dritëhijeve, në një sfond tragjik (kombëtar e vetjak) vjen ky pohim: «Për Shqipërinë i bëra të gjitha, paçka se edhe mund ta kem dëshpëruar ndonjëherë, po kush mund të thotë se desha ndonjë vend tjetër më shumë se atë? Por tamam në kohën që dukej se po ia mbyllte gojën grindësit të padukshëm... një zë i vogël i tho-

shte që brenda tij: s'të thotë njeri që s'e ke dashur Shqipërinë, Ali, sepse shqiptar ishte dhe ti, por puna është se e ke dashur jo aq sa duhej. Dhe, ta doje atë jo aq sa duhej, për ty ishte njëlloj sikur të mos e doje. Dashurinë shkel e shko të një tjetri mund ta pranonte ajo, por tënden kurrsësi, sepse nga ti ajo priste shumë.\*) (f. 222).

Kjo përsiatje, e mbështetur fort në gjithçka bëri Ali Tepelena, shpreh njëherësh dhe dëshirën e pamotivuar të shkrimtarit që Aliu të kishte bërë më shumë, gjë historikisht e pamundur, ndaj s'mund të përligjet plotësisht as trajtimi makabër e pa dhembshuri i fundit të tij.

Dhe diçka tjetër. Në tregimin «Nëpunësi i pallatit të ëndrrave» flitet për familjen e madhe feudale të Qypriinjve të fuqishëm, që i kanë shërbyer perandorisë, po e kanë harruar Shqipërinë dhe janë harruar prej saj. Për më keq, pati feudale mercenarë që shtypën popullin në emër të sulltanëve e të Perandorisë Osmane. Para tyre Ali Tepelena është vërtet madhështor, sado edhe mizor e i mbërthyer në prangat e koncepteve feudale, përzier këto me ide që vinin nga Përndimi demokratik borgjez, pra, ide të reja.

Më në fund, filli i subjektit është shfrytëzuar me mjeshteri nga autori, kësaj radhe jo për të dëshmuar po për të treguar se në ato treva ku s'ka pasur rebelim dhe shpirt kryengritës zotëronte nënshtrimi, përgjumja dhe shkombëtarizimi i plotë i arritur sipas «doktrinave» të përpunuara nga Arkivi Qendror (!) i perandorisë. Në Shqipëri asnjë prej «doktrinave», (aq më pak ajo që është quajtur «kra-kra» d.m.th. shkombëtarizimi i plotë) nuk kishte patur sukses. Jo për «forcë të kujtesës» po për shkak se ishte mbajtur gjithnjë ndezur zjarri liridashës e atdhetar, në lufta të pandërprera, ndaj dhe në legjenda, gojëdhëna e në këngë em-

---

\*) Të vërehet këtu kalimi nga arsyetimet e Aliut të mendimi i shkrimtarit.

rat e luftëtarëve të shquar «ishin shndërruar tani në lugina, shkëmbinj, fusha, prozhme e ujëvara» (f. 246). Heronjtë popullorë, nga të cilët Ali Pasha është mjaft larg, edhe po t'ua vesh kokën në «kamaren e turpër», ikin në të ardhmen dhe që andej përqeshin armiqtë; historikisht të liqtë, të mundurit, të turpëruarit. Dhe jo si paracaktim, po si vazhdim i historisë, popujt presin diçka, prijësat e vet dhe, «kur një popull pret diçka, kjo do të thotë se në thellësi të tij ai e mbrun atë që pret». (f. 247).

Kapitulli i gjashtë i romanit krijon një lidhje deri diku shpjeguese ndërmjet asaj që përshkruhet, tregimit mbi shtegtimet e Tunxh Hatait (kokambartësit), gjendjes së Shqipërisë dhe vështirësive të perëndorisë për të vendosur ç'masa duhen zbatuar kundër saj. Kjo lidhje e një përfytyrim më i plotë i viseve shqiptare, jo indiferentizmi po kundërshtimi popullor ndaj pushtesve të huaj (ata nuk donin vetëm kokën dhe thesarin e Aliut, por: edhe ato i donin për të nënshtruar vendin) ishin plotësisht të mundshme dhe do t'i mishëronin më mirë idetë në tablo, do t'i bënin ato historikisht më konkrete e më të vërteta.

Në romanin edhe një herë gjen rast të shpërthejë mllefi i Ismail Kadaresë kundër politikave perandorake imperialiste me aludime të dukshme, sidomos kundër socialimperializmit sovjetik, dhe për krizat ekonomike, shoqërore e politike, që çojnë drejt luftërave imperialiste e kolonializimit. Veçse në këtë drejtim është zgjedhur rruga më e lehtë: të kaluarës i atribuohen dukuri të jetës moderne, kur ajo vetë (e kaluara), në lakuriqësinë e vërtetë të saj, do të jepte po aq mundësi që t'i arrihej këtij qëllimi në mënyrë më realiste. Skllavopronaria, feudalizmi, kapitalizmi, si «parahistori e njerëzimit», me gjithë veçoritë dalluese, kanë të përbashkët skllavërinë, agresionin, obskurantizmin, ndaj po të paraqiten me realizëm, domosdo të kujtojnë në thelb njëri-tjetrin.

Ajo që ka mbetur mangët në «Pashallëqet e mëdha» — përmasat e gjera të «rebelimit», si një epilog i për-

gjakashëm, është plotësuar deri diku në tregimin «Komisioni i festës», ndonëse, me gjithë faktin shumë të njohur historik, shkrimtari ka ndjekur më tepër rrugën e rikrijimit të lirë artistik. Shpirti i pashuar kryengritës dhe liridashës shqiptar, siç e sheh dhe arsyetohet Nuh efendiu i tregimit, është i shpërndarë, i gjallë e shqetësues kudo.

«Nuh efendiu, vinte e vinte nëpër dhomën e tij, me duart pas shpine. Në sy sepse i vinin vazhdimisht veshjet e mysafirëve. Ato fustanella të bardha borë dukeshin sikur ishin bërë enkas për të sjellë mendjen vërdallë. Nuh efendiu e kishte ditur se Shqipëria, përveç pashallarëve të mëdhenj, ka pasur përherë prijës më të vegjël, madje një mik i tij i kishte thënë para ca kohe se pikërisht këta të vegjlit e vinin në lëvizje rrebeshin e Shqipërisë më tepër se vezirët e famshëm. Këta ishin prijësa të një lloji të veçantë. Shumica e tyre ishin bërë të tillë vetvetiu, duke fituar autoritet në popull [...] Një pjesë e tyre rridhnin nga familjet e vjetra gjysmëlëgjendare të kryezotëve të dikurshëm[...] Të tjerë ishin kapedanë të rinj, të lindur gjatë furtunës së fundit[...] Këta prijësa ishin një forcë e madhe, pothuajse e paprekur gjatë sherrit dyzetvjeçar midis sulltanit dhe pashallarëve rebelë.

[...] Sado kokëshkretë të ishin, të veshur me xhybe osmane, ato xhybe të bekuara prej mëndafshi, që derdhnin përgjumshëm mbi trupin e njeriut ngjyrat e tyre parajsore: jeshile e thellë, bojë qielli, jargavan, pra, sado famëkëqinj të ishin, ata do të dukeshin më të pranueshëm me ato xhybe shtetërore. Kurse kështu, me rrobat e tyre të çmendura, ata të kallnin datën. Tani e kuptonte Nuh efendiu përse padishahu i madh kishte caktuar specialistë që merreshin kryesisht me thjeshtësimin dhe me zhdukjen e veshjeve kombëtare. Veshjet e shqiptarëve e kishin rebelimin në çdo mëngë e në çdo tegel të tyre, për të mos zënë ngoje palat e fustanellave, që dukej sikur i frynin njëra-tjetrës si dallgë deti, dhe sidomos ato xhufka të kuqe mbi opinga, me të



cilat dukej sikur ata do t'i vinin zjarrin perandorisë» (f. 334-336).

Tregimi i zgjatur dhe i shpërndarë në hollësitat e përgatitjes së «gostisë së pajtimit» («mysafirë të Makbethi»), as përshkruan masakrën, as na jep gjë të madhe nga «biografia» e personazheve të kësaj tragjedie. Kur e mbaron së lexuari, gjithçka në dukjen e përshkruar zbehet dhe merr kuptimin e vërtetë të «djallëzive të Azisë», siç do të thoshte Naimi, të fshehjes së krimtë prapa fasadës së festës, të çkërmitjes së egër prapa buzëqeshjes, të helmit prapa «bashbakllavasë», të kasaphanës në vend të paradës. Historia ia ka dhënë popullit tonë edhe këtë mësim dhe ia ka përsëritur jo një herë, prandaj ai është fiksuar në kujtesën kombëtare, ka gjetur (si çdo gjë e përsëritur) edhe shprehjen proverbiale: «Festë e osmanllisë, helm i Shqipërisë», «Darovë e armikut, o helm, o thikë» etj. Kjo përvojë ka mprehur vigjilencën e popullit dhe vlen të mbahet parasysh nga kushtudo. Këtu qëndron vlera e tregimit.

«Pashallëqet e mëdha» dëshmon dhe prirjen me përparësi të Kadaresë për t'u marrë me figura kontradiktore e me dramë të brendshme. Këtu në parim s'ka gjë për t'u diskutuar: zgjedhja e heronjve të veprave, sikurse e temave dhe e mënyrës së trajtimit, kur në drejtim kryesor përputhen me pikësynimet tona ideologjike dhe kërkesat tona ideoestetike, është një e drejtë e autorëve. Në ka diçka që lë shteg për diskutime e sugjerime, është se personalitetet kontradiktore dhe karakteret me dramë të brendshme, si mishërues krizash shoqërore, politike apo morale nuk japin në vetvete mundësinë e afirmimit të drejtpërdrejtë e të qartë të një ideali pozitiv dhe të prirjes së zhvillimit perspektiv, mbartëse të të cilave janë ato forca që kapërcejnë krizën dhe çelin shtigjet e zgjidhjes së kontradiktave të maisura. Rolin e këtyre forcave, siç dëshmon dhe romani i Kadaresë, vështirë ta luajnë përsiatjet e personazheve, ndërhyrjet e aludimet e autorit, sado të mençura e të mprehta të jenë këto. Aktualiteti ynë, po

edhe historia, sugjeron zgjedhje më të efektshme përmes të cilave edhe figurat kontradiktore do të kuadroheshin më realisht e më bindshëm në rrethanat e kohës dhe në vijimësi historike.

Parë në rrafsh artistik, ky roman, si dhe vepra të tjera të Kadaresë, është tregues i përpjekjes së autorit për ndërthurje të pasqyrimin në përgjasim me realitetin dhe konvencionalizmit të prozës moderne botërore. Prova është interesante. Përmes kësaj ndërthurjeje krijuese shkrimtari ka synuar të shtojë mundësitë dhe të përsosë e të pasurojë mjetet e shprehjes artistike, të bëjë me ndihmën e lëndës historike dhe përqasje të efektshme me kohën tonë. Por, si në çdo gjë, dhe këtu, teprimi ka qenë i dëmshëm. Së pari, me gjithë aftësitë e shkrimtarit dhe zhdërvjelltësinë ndërthurëse në subjekt, nuk ka dyshim se pjesët më kuptimplote dhe artistikisht më shprehëse e më të arrira janë ato ku zotëron mënyra e pasqyrimin në përgjasim me realitetin. Konvencionalizmi i tepruar, sado që krijon iluzionin e zgjerimit të përmasave pasqyruese dhe të rritjes së peshës së mendimit, le kurdoherë shteg për largim nga figura e njeriut si mjet shprehës i letërsisë dhe për interpretime të diskutueshme.

Përmbledhtas do të shtonim se të gjitha veprat e përmendura, si një cikël konceptesh e përfytyrimesh epiko-tragjike ndërthurur me elemente tregimtare e përshkruese të kursyëra e të goditura, përshkohen nga ndjenja e krenarisë kombëtare. Në këtë ndjenjë të fuqishme krenarie nuk ka vetëmburrje kombëtare. Përkundrazi, qëndresa shqiptare dhe rrebeshet që ka përballuar populli ynë në shekuj janë parë e trajtuar nga shkrimtari si shembull tipik që marrin vlera simbolike. Në të veçantën, në kombëtarin ai është përpjekur të zbulojë e të theksojë atë që ka vlerë edhe për të tjerët, që merr kuptim të përgjithshëm, që meriton vëmendje për çdo vend e çdo kohë, gjersa ekziston imperializmi dhe luftat imperialiste kundër popujve, veçanërisht kundër vendeve të vogla.

Në këtë frymë dhe atmosferë të përgjithshme të

Veprave, në të cilën krenaria kombëtare parakupton respektin për gjitne popujt e tjere, tungëllojnë të çudisime e të huaja ato traza të shpërndara tutje tëhu një ironi e perqeshnje për natyrën, traditën dhe gjunen e popujve të tjere, sidomos të popujve të vegjël dhe të atyre që sapo kanë hyrë në udhën e qytëterimit.

Një kritik i huaj dikur ka shprehur mendimin se arti kusntuar episodeve historike dhe heronjve kombëtare nuk i kaion dot caqet e interesimit të bashkëkombësve, mbetet sidoqoftë i ftohtë dhe i huaj për publikun e vendeve të tjera. Ky është një mendim i gabuar, i pavërtetë. Krahas shembujve të artit botëror, atë e hedh poshtë edhe vepra e Ismail Kadarese.

Arti i vërtetë domosdo do të pasqyrojë jetën e popullit që i përket, historinë dhe heronjtë e tij. Ai nuk ka vetëm vlerën e njohjes me historinë, me psikologjinë, me mënyrën e jetesës dhe me veçoritë artistike të popujve të ndryshëm, po edhe atë të shprehjes së ideve përparimtare e revolucionare, bërëuar nga një material konkret i veçantë historik kombëtar.

E huaj dhe jo vetëm e huaj, po e përbuzshme dhe e neveritshme për popujt e tjerë është letërsia «kombëtare» që ngjall urrejtje e armiqësi në mes popujve, që pararend luftërat agresive ose që si diversion ideologjik shtron terrenin për nënshtrimin para fuqive të ndryshme imperialiste, nën çdo maskë, me çdo formë e pretendim.

Në «Pashallëqet e mëdha» gjejmë këtë frazë të thjeshtë: «Skënderbeu nuk kishte vërtet shumë pajisje, para dhe topa, por ai kishte ide të mëdha» (f. 221).

Këtë ka synuar të hetojë e të gjejë autori në histori-në tonë kombëtare, këtu gjen një prej arsyeve më me rëndësi të qëndresës shembullore shqiptare deri në ditët tona. Idetë e mëdha, të përçafuara nga forcat më të gjalla të kombit, të kanalizuar në lëvizje të fuqishme, e hedhin popullin në luftë, e në beteja dhe bijtë e tij «e bëjnë vdekjen si me le». Dhe e kundërta: idetë reacionare, ato të despotizmit e të pushtetit personal, ne-

net e paragrafët e anakronizuar të kanuneve (kjo e fundit të «Prilli i thyer») ideologjia e supershteteve me superstrukturën e tyre janë ide të zvetënimit, të disfatës dhe të rënies së tyre, ndonëse dhe shkaqe tragjedisht për popujt, njerëzimin.

Në luftërat e qëndresën shqiptare shkrimtari, duke u ngritur me mjeshtëri mbi hollësitë e tepërta, pikërisht si në eposin popullor, ka bërë drejtim kryesor ideoartistik të veprave edhe këtë ndeshje të së drejtës me padrejtësinë, të përparimit me reaksionin. Ai ka ripohuar me forcë se lufta popullore është e pamposhtshme, një ndër rrugët kryesore të çlirimit të popujve e të njerëzimit, të shembjes së superfuqive dhe të vetë imperializmit si rënd shfrytëzimi e skllavërimi. Asgjë ngushtësisht kombëtare nuk ka në këto ide. Kombëtar është materiali historik nga burojnë e vërtetohen ato.

Veprat që u përmendën në këto shënime janë frymëzuar nga legjendat dhe e kaluara historike shqiptare: shekulli i katërbëdhjetë deri në fillim të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Mirëpo në to nuk ka as vjetërsi, as ngushtësi «historike». Në frymën që përshkon veprat, në nëntekstin e tyre të gjerë, në aludime, paralelizma, kontraste, konvencione artistike e simbole, disa herë thujse fare hapur, ndihen shqetësimet e kohës sonë. Kësisoj, me prirje të vijueshme shkrimtari e ndihmon lexuesin të krijojë shoqërime historike dhe të forcojë bindjen se në «botën e vjetër» asgjë nuk ka ndërruar. Vetëm format kanë ndryshuar, janë rafinuar, por thelbi që ato veshin është më i rrezikshëm, burim të këqijash e fatkeqësish të reja për popujt.

«Siç duket, — thotë kështjellari në shënimin para kapitullit të fundit të romanit «Kështjella» — po mbaron kjo stinë e parë e luftës. Stinat e tjera i kemi përpara. Qielli është i mbushur me re. Qielli ynë i madh». (f. 232).

Të nxjerra nga konteksti i ngjarjeve të romanit, këto fjalë tingëllojnë plotësisht aktuale.

## II

Epopeja shqiptare njohu faqe e shkallë të reja si Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare, epoka e ndërtimit të socializmit, ndeshjet heroike me imperializmin, me revizionizmin titist, me socialimperializmin sovjetik e, vjetët e fundit, me socialimperializmin kinez. Këta janë kapituj të rinj, dallgë tronditëse dhe madhështorë, ku bashkohet edhe rrjedha e mëparshme historike. Në këtë kuadër e ka parë edhe Ismail Kadareja epikën dhe dramacitetin e fuqishëm, real në romanet «Gjenerali i ushtrisë së vdekur», «Kronikë në gur», «Nëntori i një kryeqyteti», e, sidomos në veprën «Dimri i madh».

Në to, krahas heroikës të shprehur me tone të përmbajtura, urrejtjes për pushtuesit fashistë, parashtrimit, shkrirjes historikisht të vërtetë të atdhetarisë së flaktë me internacionalizmin proletar, zënë vend, kryesisht, analizat shoqërore, pamje të luftës së klasave në terren kombëtar e ndërkombëtar, përthyer me mjeshtëri përvoja e hidhur e ish-vendeve socialiste.

Ndërsa në veprat kushtuar historisë shkrimtari ka shtruar dhe është zotuar të përballojë artistikisht e me mjete të tjera detyrën e tingëllimit aktual të temave e të subjekteve nga epokat e së kaluarës deri në kohën tonë, te këto ndihet vazhdimësia historike dhe kujtesa kombëtare shërben si forcë e si mësim, si motiv e shembull për luftërat e reja. (Vija e pandërprerë e vazhdimësisë historike, një epos i ndarë në këngë e në cikle, po me të njëjtin shtrat e të njëjtën frymë, vjen e përforcohet nga koha në kohë.)

Por ravgimet dhe përthyerjet e së kaluarës në këto vepra hedhin edhe hijet e tyre, pasqyruar përmes ekzistencës fizike, ideologjike, morale, zakonore të elementeve të botës së vjetër; mentaliteteve, psikologjisë dhe faktorëve të tjerë, që i mbajnë gjallë ato dhe i shfaqin në forma të moderuara në gjithfarë mënyrash konservatore e liberale.

Kuptohet që, për këto arsye, në pajtim me të vërtetën historike, me theks, nderje dhe shpalosje drama-

tike, në këto vepra ka gjetur pasqyrim lufta e sotme klasore në shumë prej fushave dhe formave të shfaqjes së saj, që nga ndeshja në mes klasave antagonistë për jetë a vdekje gjer te format e luftës kundër elementit të degjeneruar antisocialist, oportunist a sektar, shfaqjeve të burokratizmit, karrierizmit etj. Të gjitha këto janë pasqyruar në sfondin e përgjithshëm të luftës popullore për çlirim kombëtar e shoqëror, për ndërtimin e socializmit dhe kundërshtimin e imperializmit e të revizionizmit.

Në veprat mbi të kaluarën zotërojnë kryesisht idetë e atdhetarisë e të denoncimit të karakterit agresiv e të shturur të Perandorisë Osmane, ndërsa në veprat me tema nga bashkëkohësia (përfshirë ato që i kushtohen Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare), krahas afirmimit të atdhedashurisë e të heroizmit popullor, denoncimit të fashizmit e të tradhtisë së klasave shfrytëzuese, zë vend e zgjerohet trajtimi artistik i shndërrimeve socialiste, theksi klasor e politik aktual bëhet më i mprehtë. Këto lënë gjurmë në brendinë e në strukturën e veprave, në mbizotërimin e frymës epike, në veçoritë e stilit, në nervin e gjallë ngacmues të shprehjes poetike.

E përbashkët për veprat kryesore të Ismail Kadarësë, të prozës, e një pjese të krijimtarisë poetike, është rrokja e problematikës jetike për fatet e popullit e të vendit, kapja e momenteve kyçe të historisë e të bashkëkohësisë dhe, në këtë kuadër, e vetëm brenda tij — vendosja e çështjeve të jetës intime, të njerëzve. Të «Dimri i madh» e gjetkë nënvizohet bindja se koha jonë është një kohë e madhe, me probleme, me halle, me shqetësime, me drama të mëdha kombëtare e ndërkombëtare dhe se me këto tema ia vlen e duhet të merren, në radhë të parë, letërsia dhe arti i vërtetë.

Tri veprat kushtuar Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare («Kronikë në gur», «Nëntori i një kryeqyteti» dhe «Gjenerali i ushtrisë së vdekur»\*) lidhen me dy fa-

\*) Nëse nuk mbahet renditja sipas kohës së botimit, kjo bëhet për të përvijuar tablo vazhdimësie historike që është qëllim i kapitullit të studimit.

zat kryesore të kësaj lufte dhe me epilogun e saj. Çdonjëra nga këto faza dhe, për meritë të shkrimtarit, çdonjëri nga romanet, ka problematikën dhe veçoritë e veta.

«Kronikë në gur». Kohë e turbullt, plot trazime, shtrëngesë ekonomike, pushtime, burgime, pushkatime, bombardime, qyteti shesh lufte. Një qytet i lashtë, i gurtë, me fizionomi të çuditshme, me jetë shoqërore në të cilën përzihen epokat. Gjithë kjo tablo e ngjeshur shoqërore e politike me «reliev të aksidentuar», ku gjithçka lëviz, rroposet, përtërihet, kërleshet, flakëron, shkrihet me enigmat e befasitë e saj para shikimit e arsytimit naiv të një fëmije dhe nën gjykimin e autorit. Kjo në tërësi është një zgjedhje interesante dhe e përligjur në pikëpamje psikologjike e kompozicionale, me kalime nga heroi letrar të autori, me përzierje të aftësive konceptuale të fëmijës me shikimin e mëvonshëm përkujtues të autorit që gati njehet me këtë herq.

Ç'po ndodh? Përmes batërdisë dhe rrebesheve, me dhembje po lind diçka e re, e panjohur mirë, që shumica ende nuk e përfytyron plotësisht; diçka që po vë në lëvizje qytetin, si një vërshim i nëndheshëm, si tërmet. Heroi njomëzak i romanit shikon atë që duket, ndjek bisedat e shpësthuara e përherë me të shqetësuar të plakave, mundohet të depërtojë në hallet e burrave që flasin aq shumë «...për shtrëngesën ekonomike, për shlyerjen e borxheve, për çmimet e ushqimeve e për të tiera gjëra të bezdisshme, kurse, po të binte fiala për gjëra të ndritshme e zbavitëse, njerëzit bëheshin befas si të shurdhër» (f. 106). Ndonjë rreze drite vjen nga fialët e Javerit e të Isait (dy ilegalëve komunistë), por edhe ato duken të çuditshme e të parrokshme plotësisht. «Ju nuk mund ta kuptoni dot se ç'do të thotë qytet i lirë, sepse ju po rriteni në robëri, — më tha një ditë Javeri, kur e pyeta për këtë gjë. — Unë e kam vështirë të ta shpjegoj këtë gjë, më beso. Atëherë çdo gjë do të jetë kaq ndryshe, kaq e bukur, sa që në fillim me siguri të gjithë do të hutohen». (f. 24)

Autori synon dhe ia arrin që përmes përshtypjeve e përjetimeve fëmijërore, ngjarjeve që ndodhin rreth heroit letrar, valëve nëpër të cilat e përplas atë jeta, përpjekjeve ngulmuese e të mundimshme për t'u gjetur fillin kronikave të shkëputura, jetës, bëmave e tregimeve të të moshuarve, të tregojë se si formohet dalëngadalë njeriu i kohës së luftës, një dëshmitar i ri i historisë së popullit, njeriu që do t'i përkasë botës së re. Përmes së dukshmes, perceptimit konkret-vizual të fëmijës dhe gjykimeve të tij, në të cilat ndihen dhe ndërhyrje të befta të shkrintarit, lexuesi depërton në thelbin e dukurive, në kontradiktat dhe konfliktet e kohës, në shndërrimin e mentaliteteve, në logjikën e ashpër të luftës së klasave, në përforcimin e kahjes progresive dhe revolucionare të zhvillimit.

Edhe në fjalorin e plakave hyjnë fjalët trakt, komunist, komunizëm, luftë e klasave dhe, tok me to, diçka nga koncepti për luftën e klasave dhe për komunizmin. Në Tiranë Enver Hoxha ka themeluar Partinë Komuniste dhe është vënë në krye të Luftës... Të gjitha këto në vetëdijen e heroit të romanit si dhe në atë të shtresave të popullsisë, janë përthyerje të flakëve të atij zjarri të fuqishëm që përfshiu gjithë Shqipërinë...

Me ardhjen e pushtuesve hitlerianë, ndër viktimat e para është Kako Pinoja, ajo që gjithë jetën kishte stolisur nuset. Ky është një detaj kuptimthellë në mbyllje të romanit.

«Luftë e madhe do të bëhet! — tha gjyshja, duke më vënë dorën mbi kokë». (f. 228).

«Kronikë në gur» është kompozuar nga një mori pafund episodesh e gjendjesh bashkëkohore dhe me jehonat e legjendave e të historisë së lashtë me luftëra, me zinxhirë e bodrume të errëta e të lagështa kështjelle; në një larmi shfaqjesh të bukura, shëntimesh, tragjesh dhe elementësh komikë, të madhërisëm e qesharakë, gjykimesh seriozë e naivitetesh, idesh të reja e paragjykimesh të vjetra. Kjo larmi e pasur e kjo kundërvënie e vijuar përbën një tërësi kompakte kundruar mirë në vend dhe kohë. Në dobi të këtij kompaktësimi



është përdorur shikimi i heroit dëshmitar e, mbi të gjitha, aftësia e shkrimtarit për të krijuar e gjallëruar një protagonist të madh poliedrik, siç është qyteti i gurtë me historinë, jetën dhe diçka nga aspirata e banorëve të tij. Dëshmitari rrëfimtari është vetë pjellë e këtij qyteti dhe përfshihet në tërësinë e fizionomisë së tij e të kohës që jeton. Kjo përmbajtje e gjallë shumëpamjesh është ndërthurur me drejtimin kryesor ideopolitik e shoqëror të veprës. Ky drejtim kryesor, që tregon edhe kahun e lëvizjes së jetës, është trungu mbi të cilin gje-thojnë episodet e tjera jo aq të lidhura në shkakësi, në natyrë e në pasoja me të. Po përsëri është e pamundur t'i ndash këto dy rrafshë përmbajtjeje. Një «ngurtësi» që gjallërohet, një jetë e amullit që trazohet e vihet në lëvizje, shtresa të gjëra popullore që përfshihen në vorbullën e kohës, teksa janë ngacmuar disa pika nevralgjike që kanë të bëjnë me veprimtarinë jetike të qytetit e të të gjithë vendit.

Në morinë e episodeve të jetës familjare e të lidhjeve intime veçohet e flet aq shumë me heshtjen e thjeshtësinë nusja e bukur e Nazos, një bukuri e papërllyer, një jetë që zien përbrenda e s'mund të shpërthejë, një mundësi dashurie e lumturiq e penguar të kthehet në realitet. Ajo kalon si një vegim bukurie, me buzëqeshje të përmbajtur, të trishtuar, qesëndisëse, sikur e ka lëshuar veten krejt në valët e jetës. Dhe ja, nga fundi i romanit:

«...në kalldrëm... qe shtrirë një njeri. Te koka një pellg gjaku. Mbi gjoks një fletë e shkruar. Nazua lëshoi një ulërimë të mbytur. «Maksut». Nusja vështroi me indiferencë trupin e të shoqit, duke shkelur përbri tij me kujdes sikur të kishte frikë, se mos spërkatej nga gjaku. S'më hiqeshin sytë nga fleta ku ishte shkruar «Kështu vdes një spiun». Atë shkrim të përkulur përpara, sikur vraponte midis erës dhe shiut, unë e njihja. Ishte shkrimi i Javerit.

— Hataja do të bëhet, — tha Xhexhua dhe iku tutje sokakëve.

Të gjithë u shpërndanë. Nazua me nusen filluan të tërheqin trupin drejt portës së tyre» (f. 227-228).

Gjejmë këtu atë që zien përbrenda nxitur nga flakët revolucionarizuese të Luftës, neverinë e ligjsime për pasqesnortin impotent e njeri të ulët, që kërkon të snuaje një sniprt, të snterpezojë vetë jeten; mllëim kundër zakoneve e mentaliteleve poshtëruese, urrejtyen për rashizimn dhe krupen për spiunin; desmren për permbysje, joshjen ende të paveiedijsnme ndaj asaj jete që do të undte.

Karakterit deri diku reflektiv, me largim disi të paramenduar e jo fort të natyrshëm nga psikologjia e rëmjës, i këtij romani pasohet nga epika dramatike e «Nëntorit të një kryeqyteti», kushtuar ditëve të fundit të Luftës Antirashiste Nacionalçlirimtare dhe të parave ditë të jetës së lirë të kryeqytetit tonë.

Situatat, duke u acaruar, janë qartësuar. Lufta jonë, duke përparuar, ka përfshirë masat, ka diktuar vija të dukshme demarkacioni. Janë aktivizuar klasat, grupimet politike. E ardhmja e atdheut është në rend të ditës, në duar të popullit të udhëhequr prej komunistëve. Lufta Nacionalçlirimtare ka thelluar karakterin e vet si revolucion popullor. Në masat popullore idealet socialiste janë fuqizuar, forca e popullit dhe e ushtrisë së revolucionit po imponohet ngado. Klasat shfrytëzuese, nga gjiri i të cilave kanë dalë gjithfarë grupesh e personatitësh kolaboracioniste, bëjnë rezistencen e fundit, kanë shpresë të hedhin një kartë të fundit në lojën e tradhtisë; përfshihen nga paniku, marrin arratinë. Mbeturinat e armiqve të brendshëm orvaten të gjykojnë situatën e re dhe të vazhdojnë luftën për rivendosje të privilegjeve e të pushtetit të humbur, duke hedhur përsëri në ankand fatet e vendit. Po nuk është më Shqipëria e dikurshme, kur populli mbillte e nuk korrtë, ndërsa pasunarët mbushnin hambarët dhe merrnin pushtetin. Ndihet plot dinamizëm se po lindte një Shqipëri e re, një shtet i ri shqiptar, një pushtet i popullit; epoka e drejtësisë popullore. Përmbysja që po kryhej do të ishte e thellë, e gjithanshme dhe krejt tjetër do të ishte jeta

që po niste! Këtë, në mos e kuptonin plotësisht, e ndienin të gjithë: pushtuesit nazistë, fuqitë imperialiste, që donin t'u zinin vendin, klasat që përmbyseshin, masat popullore të zgjuara nga Partia e të lidhura me të. Shqipëria e re; sovraane, thotë autori, do të kishte zërin e vet, do të thoshte fjalën e vet të pavarur në botë. Historia e këtyre 40 vjetëve të fundit e ka treguar më së miri rëndësinë dhe madhësinë e këtij fakti.

Nën dritën e kësaj historie shkrimtari mendoi si qendër të romanit aksionin për marrjen e radiostacionit dhe vënien në funksionim të tij.

Njësi partizan, i ngarkuar të pushtojë radiostacionin, nuk na zbulon vetëm veten, veçoritë e çdonjërit prej pjesëtarëve dhe epikën e veprimeve luftarake, po na jep edhe një tablo të gjallë të ashpërsisë së luftës e heroizmit për çlirimin e Tiranës.

Shkrimtari krijon raste nga më të ndryshmet për ta shtrirë shikimin dhe në të tjera pamje, duke shfrytëzuar kronika, mbishkrime në mure, episode, copa bisdash, retrospektiva. Me të tilla mundësi, romani, sado i rrafshit epik, është i kursyer në paraqitjen e ngjarjeve e të veprimeve luftarake, po gjithsesi me peshë në dhënien e atmosferës, në kapjen e çasteve më shprehëse, në zbulimin e kuptimit historik të asaj që po ndodh.

Për shkrimtarin çështja e çlirimit kombëtar, me bëtejat dhe sakrificat që kërkon ende, ka marrë udhë. Problemi që del tashmë është krijimi i shtetit të ri, fizionomia e shoqërisë së re. Përjetimin e përfytyrimin e tij autori i jep në një varg personazhesh. Personazhet e romanit «patjetër që do të hutohen», siç thotë Javeri i «Kronikës në gur»: «A ishte e mundur që bota që do të vinte të ishte kaq e pastër, siç ishte ky fillim i kësaj dite, në male» — mendon Sherif Gorenj. (f. 29) Poja, ata fshatarë, punëtorë, intelektualë popullorë të rëndomtë, të ardhur nga anë e anës, zbritur nga malet, po marrin në dorë pushtetin e ri, po vihen në qendër të jetës shoqërore e politike.

«...Era e ngrirë dimërore zvarriste copëra afishesh

nga shfaqjet e fundit të një rendi, urdhra qeverish, orare tashmë të vdekura, lajmërimet për shtetrrëthim». (f. 12).

Në rrebeshin e luftës e në ashpërsinë e betejave, njerëzit e vetëdijshëm e kanë të qartë rrugën që do të ndjekin: forcat ushtarake gjermane rezistojnë egërsisht, partizanët sulmojnë gjithandej, kuislingët përgatiten në panik të arratisen. Pasunarë, që u dhimbet pasuria më tepër se jeta, vendosin të qëndrojnë në qytet, të gjejnë një mënyrë mbase shpëtojnë diçka, mbase «të kuqtë» nuk do ta kenë të gjatë. Ndërsa Radio Tirana flet me zë të lartë, lëvrijnë hanëmet e zonjat që përhapin me frikë e iluzione lajme, kthejnë filxhanë, diçka duan të para-shikojnë, të shpresojnë përtej kohës së tyre të perënduar. Dëgjohen këngë të reja, për të cilat bankieri Rrokaj thotë se «s'janë muzikë, po ekonomi politike». «Dhe vërtet, më tepër se këngë, ato ishin shpallje ligjesh të reja, afate ultimatimesh e shtetrrëthimesh, dekrete, programe ekonomike, tarifa, orare, itinerare internimesh, kryqëzimesh, harrese. Ata i dëgjonin me vëmendje, i analizonin një për një rreshtat e tyre, i kthenin në shifra, vite burgimesh, tatime, nganjëherë breshëri plumbash të skuadrës së pushkatimit.» (f. 89)

Po ka dhe njerëz të ndodhur në udhëkryq ose që do të ishin gati t'i shërbenin rendit të ri. Këta janë sidomos intelektualë, si shkrimtari «zemërthyes» Adrian Guma dhe Mirjam Morina — spikerja kryesore e radios. Adriani, i nderuar nga çdo regjim i mëparshëm dhe i vetëkënaqur për këtë, mendonte me mburrje se kishte qëndruar jashtë klasave, kishte kërkuar një kohë të vetën, «një kohë të tretë» më të përgjithshme dhe eterne, «që qëndronte sipër pasioneve dhe batërdisë». «Ai ishte i bindur se kjo ishte koha e vërtetë. Të tjerat ishin shi, kërrleshje resh, bubullima dhe gjurulldi, po kurrsesi kohë». (f. 31).

Po koha që është një, në çastet vendimtare i ndan njerëzit në dy palë, nga të cilat çdonjëra i jep kohës emrin dhe qëllimet e veta. Ky «mbikohor» ndodhet midis kuislingëve që arratisen dhe partizanëve që për-

faqësojnë botën e re. Revolucioni është i huaj për të («lirën nuk e jap»), kurse arti i tij është i pavlefshëm për revolucionin. Përmbysja përfshin kështu edhe sferat e superstrukturës ideologjike e të jetës shpirtërore, kërkon të përqafohet një drejtim i ri.

Ndryshe Mirjami, «nepërka që villte helm» përmes radios. Në ekzistencën e saj vanitoze ajo s'ka forcë të ndjekë rrugën e dashnorit të vet (Adrianit). Revolucioni e flak atë, si diçka të përdhosur e pa vlerë, përballë saj autori vë çiltërsinë e Teutës partizane.

Grupi i fundit: grupi i të përmbysurve të mbetur, mbushur me helm e frikë. Ndër ta spikat Mukadesi. Frikën e të tjerëve ajo e quan turp. Është aq e egër sa dhe Majnuri i «Kronikës në gur» dhe po me aq shpresa sa Nurihani i «Dimrit të madh» (në të tri romanet është dhënë përparimi e thellimi i revolucionit dhe fizionomia e qëllimi i të deklasuarve në çdo periudhë kthese të vështirë). Në logjikën e arsytimeve të Mukadesit, si dhe në të tjera raste, lë vulën e vet shpresa që ka ushqyer reaksioni në vendet ku është restauruar kapitalizmi, një shpresë së cilës i priten rrënjët te ne.

«Një urrejtje e gjatë shpesh ka prirjen të përfundojë në dashuri, — tha ajo me zë të ngadaltë. — Pasi të na kenë përmbysur, të na kenë poshtëruar, të na kenë zhbërë, ata papritur do t'i zërë malli për ne... malli për zotërinjtë e përmbysur është në natyrën e njeriut... Do të vijë një ditë, kur pas shembullit tonë, pas fytyrave tona të masakruara, ata do të përpiqen të krijojnë zotërinjtë e tyre. Kur atyre t'u vijë një dëshirë e tillë, kjo do të jetë shenja e parë që ata do të kenë marrë fund. Atëherë ne do të rikthehemi» (f. 144).

Mukadesi, një Mukades real, mbase nuk ishte në gjendje të mendonte kështu në fund të vitit 1944 dhe as të «parashikonte» kaq larg, por të drejtën e këtij «avancimi» shkrintarit ia jep përvoja historike. Në veprat e Kadaresë, ashtu si e kaluara merr vlerën e shembullit për të sotmen, edhe e sotmja, fiton të drejtën të hedhë dritë në ato dukuri e procese të së kaluarës që në po-

fencë e kishin këtë logjikë. Një theksim i tillë është në natyrën e artit realist.

Dhe, më në fund, epilogu; një prift dhe një gjeneral, një gjeneral dhe një kryetar bashkië, që vijnë nga traktati agresiv i NATO-s të marrin në Shqipëri eshtrat e ushtarëve të vrarë-relikte të kobshme (mbi varret e të cilëve, sa herë ka qenë e mundur, nga të huajt është vënë shtampa hipokrite e cinike: «Ka rënë për atdhe»).

Ky fakt i njohur është në themel të romanit «Gjenerali i ushtrisë së vdekur»<sup>\*</sup>). Me armiqtë shqiptari ka folur kurdoherë me gjuhën e pushkës, në emër të jetës, të lirisë e të dinjitetit të vet. Barbarë dhe kriminelë ndaj popullit tonë dhe ndaj popujve të tjerë janë ata që kanë shpërthyer luftëra imperialiste, na gjakosni, na grabisnin, na shtypnin.

Romani i Ismail Kadarese është një ndër shembujt e dalluar të trajtimit origjinal të temës aq të lëvruar mbi luftërat imperialiste dhe pasojat e tyre. Çifti makabër prift-gjeneral është përfaqësues i këtij imperializmi, armëmbajtës i politikës së tij agresive.

Asnjë emërtim zyrtar në nisje («detyrë e shenjtë», «punë fisnike») nuk mund t'ia heqë këtij misioni trishtimin, turpin e të mundurve, cinizmin e vrasësve të vërtetë, pështrësinë e qëmtuesve e të mbledhësve të kokave të të vdekurve pa lavdi. Prifti i përmban këto ndjenja dhe ngjan i padepërtueshëm, ndërsa gjenerali i shfaq. Të dy janë imperialistë, por jepen me veçoritë e karakterit dhe filozofinë «individuale»: ndërsa gjenerali ka kthjelltësinë dhe praktikitetin e ushtarakut, e kupton disfatën, mundohet të zbulojë «gabimet» e atyre që e hodhën ushtrinë në katastrofë dhe përpunon plane të reja, prifti operon me argumente mbi «egërsinë» dhe «barbarinë» e shqiptarëve, shfaq një urrejtje gati patologjike për popujt në përgjithësi dhe për shqiptarët veçanërisht. Përmes mbledhjes së «ushtrive të vdekura» dy të huajt ndeshen me kujtimin e hidhur të disfatës dhe reali-

---

<sup>\*</sup>) Kemi parasysh «Gjenerali i ushtrisë së vdekur», botimi i tretë, T. «Naim Frashëri», 1971,

tetin e sotëm shqiptar, përfshihen në lojën prej të dehurish: hedhja e «ushtrive të vdekura» në luftë — shprehëse e dëshirave të tyre. Përballë, kësaj loje, si finale e fuqishme, vihet parada e ushtrisë shqiptare — një ndër shprehjet e vendosmërisë luftarake të popullit tonë.

Flet gjuha e fakteve të pakundërshtueshme: varret e ushtarëve fashistë, terrori i famëkeqit «Batalion Blu», dhembja e nënave italiane për bijtë e vrarë («Ai ra si trim» — Ç'trimëri zeza!» f. 35), dezertimet, shpartallimi dhe degjenerimi i plotë, kafshata e bukës e fshatarit shqiptar për ta, italianët që u hodhën në radhët partizane, «gjeneralët budallenj», oficerët sadistë si koloneli Z... Zbulohen varre, sillen ndër mend ngjarje, bëhen përqasje... Një ushtri e futur në thasë nailoni — akti i fundit i dramës së të mundurve — dhe Shqipëria me historinë e lashtë, me vigjilencën, jetën e re, besimin në forcat e saj.

«Në një barakë, pranë qendrës së një lokaliteti, shiteshin gazeta. Njerëzit ishin grumbulluar te dritarja e vogël. Disa lexonin në këmbë, disa i shfletonin gazetat duke ikur.

— Shqiptarët janë një popull që lexojnë shumë gazetën, — tha gjenerali.

Prifti lëvizi në qoshen e tij.

— Kjo ndodh sepse ata interesohen shumë për politikën. Pas grindjes me Bashkimin Sovjëtik ata kanë mbetur në Evropë krejt të vetmuar.

— Si gjithmonë.

— Tani ata janë në bllokadë.

— Një vend kaq i vogël e i varfër në bllokadë... Çudi?» (f. 38)

Gjenerali pi «...duke imagjinuar vazhdimisht gjënë më të pamundur: kthimin e disfatave në fitore». Ai do të largohet nga Shqipëria dy herë i mundur: si një prej atyre që pësuajnë disfatën në luftë dhe tani i thyer shpirtërisht nga misioni që kreu. Tek ai dhe sipas fjalëve të tij, «në fillim iku krenaria, pastaj solemniteti». (f. 132)

Nga ndërtimi kompozicional romani «Gjenerali i

ushtrisë së vdekur» mbështetet në shtegtimin e dy «zbuluesve të varreve». Por nga bredhjet nëpër Shqipëri (deri diku dhe shikimit të Shqipërisë së sotme me syrin e tyre) janë të shpeshta shtegtimet në kohë (në të kaluarën) dhe endjet në një hapësirë jo të vogël mendimesh e meditimesh për të kaluarën dhe për aktualitetin. Në këtë «trinitet» (kohë-hapësirë-mendim) është realizuar, dhe mbase mund të realizohet më me intensitet, më me gjerësi dhe në çaste dramaciteti dhe epizmi më të fuqishëm, fundi i agresorëve dhe karakterizimi i dy personazhëve kryesore, sepse ndonjëherë i është atribuar gjeneralit një kënd shikimi realist, që nuk i shkon për shtat tipit shoqëror të një ushtaraku armik. Por, heroi i vërtetë i romanit, i shkrirë e i bërë një me historinë, është populli shqiptar. Kurse tingullin kryesor veprës ia jep epika e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare e pasqyruar jo drejtpërdrejt, po kryesisht në pasojat e saj, në bilancin e disfatave që u janë shkaktuar armiqve. Përmbi trishtimin e kockambledhësve, në roman, mbi çdo episod dhe mendim, ngrihet madhështia e Luftës dhe heroizmi popullor, paralajmërimi kategorik për çdo agresor.

Në romanet kushtuar Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, ndryshe prej atyre për të kaluarën historike dhe me motive nga legjenda, trajtimi i subjekteve është më i lirë. Në asnjërin prej tyre nuk është vënë në qendër si herë ndonjë figurë historike, por në penën e autorit edhe ky trajtim ruan vlerën njohëse historike.

Edhe në romanet me lëndë legjendare ose nga e kaluara historike ndeshen karakterizime të shpejta të gjendjes e herë herë edhe një konkretësi raportesh shoqërore. Por, ndërsa në to s'mund të themi se është arritur plotësisht një vlerësim konsekuent klasor proletar i historisë kombëtare (theksi kryesor i tyre mbetet atdhetar, dhe jo rrallë personazheve u vishen mendime të autorit), në veprat kushtuar Luftës Nacionalçlirimtare analizat dhe vlerësimet klasore, paraqitja e luftës së klasave zenë vend të spikatur e me peshë. Përplasja e interesave klasorë, krahas çështjes së çlirimit kombëtar, përbën një nga



kriteret kryesore të konceptimit e pasqyrimit ideoemotional, një prej burimeve e shfaqjeve të fuqishme të dramacitetit tronditës. Thellimi i revolucionit popullor dhe perspektivat e tij theksojnë vetëdijen dhe luftën për jetë a vdekje si të popullit të ngritur në kryengritje të përgjithshme, dhe të reaksionit të egërsuar. Do të mjaftonte të sillnim ndër mend dy episode tipikë: dervishin në romanin «Kronikë në gur», që nxjerr sytë pse nuk do të shohë komunizmin, dhe fundin e romanit «Nëntori i një kryeqyteti» me marshimin e reparteve partizane drejt betejave të reja («Ju, borgjezët e fëlliqur, ja ku vjen, ja ku po vjen...»)

### III

«Dimri i madh»\*) shquhet deri tani si një pasqyrë e shumëanshme kushtuar bashkëkohësisë shqiptare, ku del me forcë epika dhe madhështia e luftës së Partisë së Punës të Shqipërisë me shokun Enver Hoxhë në krye kundër revizionizmit modern dhe për revolucionarizimin e jetës së vëndit. Në të është arritur një shkëlqim organik, e natyrshme e së vërtetës historike me trillimin artistik. Nga pikëpamja e llojit letrar në të është synuar të arrihet një vepër me përmasa epike, të mirëfillta e të gjera, sado që është e ndijshme edhe prirja e njohur refleksive.

Në kuadrin e romanit janë përfshirë aq shumë probleme, janë pasqyruar aq shumë pamje të jetës dhe janë hedhur aq mendime (disa dhe të diskutueshme), sa në këtë drejtim janë të rralla në letërsinë tonë krijimet që mund të krahasohen me të. Nëse për romanin ka patur diskutime, kjo tregon se, kur letërsia pasqyron jetën e gjallë dhe shkrimtari merr pjesë gjallërisht në të, kur ai ngrihet në lartësinë e shtrimit e të zgjidhjes

\*) Kemi parasysh «Dimri i madh» (botim i dytë) T. «Naim Frashëri» 1977.

reale historike të problemeve, vepra e tij do të ketë jehonë të gjerë dhe do të nxitë mendimin e lexuesve. Ky është një tregues i suksesit të letërsisë sonë në tërësi, i krijimtarisë së Ismail Kadaresë dhe këtij romani në veçanti. Edhe në pohimin e autorit, dhe në frymën e veprës ndihet kërkesa për forcimin e frymës militante dhe afirmuese të letërsisë sonë, përmes pasqyrit të gjerë e të drejtë të kontradiktave, të konflikteve politiko-shoqërore dhe të luftës për zgjidhjen revolucionare të tyre. Jeta zien dhe ngjall debate. Ato reflektohen në ndërgjegjen e artistit dhe në veprën e tij. Diskuton shkrimtari me vetveten, shkrimtari me lexuesin, lexuesi me shkrimtarin, e, më në fund, lexuesi me vetveten, për t'u dhënë përgjigjen më të plotë problemeve të përmbajtjes e të formës dhe çështjeve të tjera ideestetike që shtrohen nga autorët. Prej vërejtjeve dhe sugjerimeve të lexuesve e të kritikës autori përfitoi dhe mori ç'ju duk e arsyeshme, duke i sjellë romanit përmirësime të ndijshme ideoartistike.

Për «Dimrin e madh» është shkruar shumë si në shtypin tonë, dhe në gazeta e revista të huaja. Është shkruar më tepër se për çdo vepër tjetër të Ismail Kadaresë. Dhe kjo ka arsye.

Lexuesi shqiptar bashkëkohës i ka jetuar e po i jeton situatat, e përshkruara në roman, është njohur nga shumë burime (sidomos nga dokumente të BPSH e nga veprat e shokut Enver Hoxha) me karakterin dhe historinë e luftës së papajtueshme me imperializmin e me revizionizmin e sotëm. Shumëkush në «llogorën e vet», i frymëzuar nga mësimet e Partisë dhe qëndrimi i saj heroik, ka marrë pjesë vetë në këtë ndeshje, është përfshirë në valët revolucionarizuese të jetës së vendit. Të flasësh për «Dimrin e madh», si për çdo vepër tjetër serioze kushtuar aktualitetit, do të thotë të flasësh për jetën tonë, për veten tonë, prandaj dhe ç'vokimi i kalon caqet e një debati ideoestetik të zakonshëm.

Edhe lexuesit e huaj përparimtarë e dashamirës e kanë pritur romanin me interesim të posaçëm. Ata ishin njohur dhe më parë me forcën e penës së Ismail Kada-

resë, sidomos të «Kështjella» dhe «Gjenerali i ushtrisë së vdekur». Tani, të informuar për luftën e Partisë sonë dhe për qëndresën heroike të Shqipërisë socialiste, ata shikonin një tablo të gjerë letrare për të, njiheshin me botën e brendshme të njeriut shqiptar, me forcën shpirtërore që sillte ky mesazh artistik aq aktual. «Sfida shqiptare» tanimë ishte njohur në gjithë botën. Dhe një vepër që i kushtohet asaj, duke pasur në qendër figurën e Enver Hoxhës, do të pritej veçanërisht me interes edhe si një mundësi njohëje më nga afër, të njëjës prej ngjarjeve më dramatike të historisë moderne, që nxori në vijën e parë të luftës një popull të vogël të udhëhequr nga ide të mëdha. Mirëpritja e romanit nga lexuesit e vendeve të tjera përfshin admirimin për Shqipërinë, nderimin për PPSH dhe për shokun Enver Hoxha, aspiratat revolucionare në përtëritje dhe vlerësimin e talentit të shkrimtarit, talent i fuqizuar pikërisht në këtë periudhë kthese të madhe historike.

Historia edhe një herë hodhi poshtë shumë mite superfuqish. Shqipërisë ato, me gjithë shantazhet e bllokadat, nuk arritën t'ia heqin hapësirat e mëdha, siç thotë në veprat e Kadarese një përfaqësues i Perandorisë Osmane. «Zogu i shqipës» nuk përplasi krahët e përgjakur në kreshtat e maleve shqiptare, po fluturoi lart nga mund të shihen më qartë horizontet, të parashikohen stuhitë dhe të duken agimet e revolucioneve.

Përfshirja e jetës politike shoqërore në përmasa aq të gjera, rrokja e një problematike themelore, të mprehtë dhe më rëndësi kombëtare e botërore, pjekuria ideologjike e guximi politik në trajtimin e tyre, ndriçimi artistik i një personaliteti të madh marksist-leninist, si Enver Hoxha dhe mjaft vlera të tjera, e bëjnë këtë vepër një arritje të shënuar, tregues të talentit e qëndrimit qytetar të shkrimtarit, shembull të frymës krijuese të metodës së realizmit socialist.

Në entuziazmin tonë asgjë për t'u çuditur nuk ka. Në Shqipëri, ku edhe qytetari më i rëndomtë (kujtojmë, për shembull, Rëm Hutën — fshesarin e «Dimrit të madh») jeton me politikën e shtetit dhe shqetësohet

për fatet e vendit, shkrimtari i vërtetë i realizmit socialist e ka për detyrë qytetare të merret me çështjet e mëdha dhe të japë gjykimin e vet të partishëm për to. Sendërtimi i kësaj kërkesë është arsyeja e rritjes së prestigjitetit të letërsisë e të arteve tona sot. Nëse ndeshen edhe vepra të rëndomta, të zbehta, nanuritëse ose dhe të një fryme euforike, këtu kemi të bëjmë me formimin e pamjaftueshëm të krijuesve të veçantë jo thjesht si talent, mjeshtëri, por së pari, në konceptet shoqërore e artistike të tyre. Por fizionominë e një letërsie e përcaktojnë kurdoherë veprat e mëdha përfaqësuese.

← Meritë e dukshme e Ismail Kadarese është se ka gjetur një strukturë që jep mundësi të mbahet vëmendja e përqëndruar në drejtimin kryesor — në luftën kundër revizionizmit hrushovian dhe, në këtë kuadër, te roli dhe figura e flamurtarit të saj, Enver Hoxhës. Ndërkaq kjo strukturë ka lejuar të përfshihet sa më gjerë jeta e vendit, forcat shoqërore e politike që veprojnë, lufta klasore revolucionare dhe prirjet e të deklasuarve për t'u hedhur në veprim, jeta familiare dhe intimitetet njerëzore, karaktere nga më të ndryshmet; një pleksje e shkathët e mbresëlënëse e situatave ndërkombëtare dhe problemeve të vendit, fateve të revolucionit me shqetësimet e jetës së përditshme, gërshetim i tensionit dramatik me rrjedhën e zakonshme të jetës, ngjeshur e shkri-rë të gjitha për të dhënë tablone e madhe të ebokës e të vendit tonë. Përkimin e Mbledhjes së 81 Partive në Moskë me faktin e dimrit, stinë në të cilën ajo u mblodh, autori e shfrytëzon për një domethënie simbolike, për të theksuar një tipar dallues të situatave në të cilat u ndodh Shoipëria për shkak të qëndrimit të vet të guximshëm, parimor dhe sovran. Që të përballonë aqarin dhe rrebeshet. Shqipëria mobilizon të gjitha forcat morale e materiale: u hapën tokat të reja për të siguruar bukën në vend, u gjallërua mendimi novator i punëtorëve, u rrit gatishmëria e masave dhe fryma vetëmohuese të ushtarët e rinj dhe komandantët, u vu në lëvizje gjithë potenciali revolucionar i shoqërisë, mënçuria e Partisë dhe energjitë e militantëve të saj. Shqipëria mobilizon kuj-

tesën kombëtare, heroizmin dhe shpirtin partizan, thjeshtësinë proletare, artin dhe këngët. Ajo tendos çdo nerv, çdo muskul, ndjek e preokupuar e vigjilente çdo situatë, çdo provokacion, pa e humbur toruan, pa u ligështuar. Doemos, sepse «për këtë përballim të madh Shqipëria kish kohë që kish nisur të përgatiste vetveten... qysh një mijë vjet më parë Shqipëria kish nisur përgatitjen e gjeneratës njerëzore, që do të mbante mbi shpatullat e saj ngjarjen epokale» (f. 592); sepse ndeshjet me armiq të mëdhenj, të egër e të pabesë, perandorë e ëndërrues perandorish (Çezarë, Muratë, Hrushovë) «ia kishin rritur përmasat edhe atëherë kur dukej se trupi i saj që mpakur nga goditjet». (f. 590)

Romani ngjan si një shkrirje tregimesh epike-dramatike të forta, të lidhura në një të tërë nga idetë e veprës, të konkretizuara në personazhe e në lidhje kompozicionale, disa herë dhe në kalime fare të lira. Shikimi i shkrimtarit, si nga një fluturim në lartësi, kap e fikson një relief me maja e fushëfirë, me gremina e zona moçalore, në të cilin enden heronj që të kujtojnë epusin e kreshnikëve, qytetarë të zakonshëm, por dhe njerëz tinzarë e zvarranikë klasash të përmbysura, hije deviatorësh, njerëz të lëkundur etj. Ç'ka shkruhet në pankarta dhe pllakate: «Jo shantazheve të BRSS», «Të shpartallojmë bllokadën!» — në roman nuk mbeten elemente të thjeshta agjitacioni e propagande. Është ndërgjegja e fuqizuar dhe tërësisht e aktivizuar e popullit, e klasës, është realiteti vetë. Si në veprat e tjera të mira dhe në këtë roman, Ismail Kadareja u është ruajtur emfazës, patetikës së jashtëme, skenave sentimentaliste, pseudorevolucionare dhe euforisë së bujshme. Ai i kumton lexuesit se gjendja është tepër e rëndë, dramatike, e rrezikshme. Në themel vepra ka jo deklarata, por ka të mishëruar idenë e madhe të luftës dhe luftën vetë. Shoqëria shqiptare, siç ka shkruar me të drejtë një publicist i huaj, duke u nisur nga veprat e artit të sotëm, është «...shoqëri që nuk ka nevojë për artifice...».

Lexuesi i romanit «Dimri i madh» patjetër duhet të vërë në lëvizje njohuritë e tij historike dhe ideologjike

për historinë e Partisë së Punës të Shqipërisë, mbi kthesën kundërrevolucionare në kampin socialist dhe në lëvizjen komuniste botërore në fillim të viteve 60, mbi parimet e socializmit shkençor dhe gjendjen ekonomike, shoqërore e politike të Shqipërisë në periudhën e përsëhkruar.

Me gjithë gjerësinë e problemeve dhe pamjeve që ndërthën romanin Ismail Kadareja, duke shfrytëzuar dokumentet e PPSH dhe veprat e shokut Enver, duke përdorur çdo mundësi, herë në formë informative, herë në stil publicistik, e ndihmon lexuesin të krijojë një përfytyrim sa më të saktë të rrënjëve të vërteta politike dhe ideologjike të konfliktit të madh të dramës, ndër heronjtë kryesorë të së cilës janë Shqipëria dhe Partia e Punës e Shqipërisë. Rëndësi të veçantë për këtë ka sidomos kapitulli i nëntë i romanit. «Ne, — i thotë Enver Hoxha Hrushovit, — u mallkuam si heretikë, sepse nuk iu bindëm urdhrit tuaj [...]. Ju e dini se ne prej kohësh nuk jemi dakord me ju për një sërë çështjesh...» (f. 170).

Lexuesit i kujtohet po kështu kapitulli i nëntëmbëdhjetë, në të cilin, në përjasje me ndodhi historike dhe me logjikën e ngjarjeve politike që përsëhkruan, autori krijon një përfytyrim letrar rreth meditimeve të Enver Hoxhës pas Mbledhjes së Moskës, na informon mbi problemet që ai ngriti me guxim e vendosmëri. Hall i madh «të nxjerrësh një popull nga bllokada» (f. 428), të vazhosh me konsekuencë revolucionin, të mbrosh sovranitetin kombëtar dhe, duke pranuar çdo sakrificë, t'i qëndrosh besnik betimit: «Internacionale do të jetë bota e re!» Ky kapitull me peshë, i shkruar përgjithësisht në stil publicistik, është thelbi i një akti të ri të dramës së madhe: «Bllokada do të jetë e plotë, e pamëshirshme, mesjetare» (f. 435).

«Ai fërkoj sytë menduar dhe qëndroi ashtu, me bërryla të mbështetur mbi tryezë. Rubla, zloti. Përfytyrimi i tyre lidhej tani njëfarësoj me prarimin e kupolave të Kremlinit... Ato ngjarje, ajo sallë ishin të largëta tani si nga një kohë tjetër. E megjithatë, u kthye me mend atje. Ata ishin të gjithë atje, rreth e rrotull tryezave, ashtu si dy muaj më parë; tundnin me zemërim grush-

e zbehta nga plagët, të bëra gropa gropa prej urisë» (f. 260).

Partia është në këmbë. Autori na jep tensionin e veprimtarisë të udhëheqës së saj e të komunistëve për çdo situatë të re që krijohet, për çdo problem jetik që del. Fryma revolucionare përfshin këdo, deri dhe të rinjtë e shkujdesur të «Rrugës së Dibrës». Atë që i jep tonin e përgjithshëm atmosferës së romanit e shprehim dhe mund ta përmbledhim me fjalët «heroizëm popullor», «unitet i popullit me Partinë». Autori shikon se si ndjenja e detyrës, qëndrimi ndaj gjëndjes depërton edhe në jetën intime të njerëzve, shkakton kthesa, ndeshje drama. Atmosfera e ngjarjeve të mëdha, e dramës tronditëse, e heroizmit, siç pohon shkrimtari Skënder Bermeja, endet kudo.

I. Kadareja në konkretizim të problematikës shoqërore e politike të kohës, e ka përqendruar vëmendjen sidomos në familjen e veteranit Xhemal Struga, të cilin e ndeshim si personazh episodik në «Nëntori i një kryeqyteti», në rrethin e gjërë familjar të Bermemëve, e cila i ka dhënë revolucionit e fidërtimit socialist luftëtarë dhe kuadro me rëndësi; në familjen Krasniqi — familje e re e një mjeku radiolog etj. Rruga e jetës, mënyra e jetesës, psikologjia, interesimet e pjesëtarëve të këtyre familjeve, që, siç shihet, janë të sferave intelektuale e nëpunësore, qëndrimi ndaj ngjarjeve të kohës dhe pjesëmarrja në to, tregojnë si përthyes rrethanat, situatat politike dhe hallet e vendit në çdo qelizë të shoqërisë e në psikologjinë e çdo individit. Pritja e shqetësuar e Xhemal Strugës që të marrë vesh ç'po ndodh, kujtimet e heroizmit partizan në seancat e mjekimit, gëzimi i tij që djemtë u rritën, «njëri u përlesh me Hrushovin atje në Moskë, tjetri po shkonte të përlesh atje në Pasha Liman» (f. 444), veprimtaria e Besnik Strugës si përkthyes i delegacionit e si gazetar, kthesa e Arbënit, sidomos pas bisedës me Besnikun, nëveria për «kompaninë» e qejfeve dhe qëndrimi burrëror në bazën ushtarake detare; pastërtia dhe gazi ri-

nor i Mirës, stoicizmi i Rabos-motrës vetëmohuese të Xhemal Strugës tregojnë në formë të prekshme emocionale ku i ka rrënjët forca e qëndresës, deri në ç'shikallë, në ç'thellësi ka depërtuar te masat ideologjia dhe politika e Partisë, qëndrimet parimore të saj.

Rrethi familjar i Bermemëve përbën një degëzim me interes në këtë drejtim. Figura e shkrimtarit Skënder Bermema është e mbujtur me shqetësimin e krijuesit militant, që synon të shkruajë «romanin e kohës», mundësisht, me të gjitha përmasat dhe pejzat e saj. Por në këtë rreth familjar autori ka spikatur dhe zyrtarizmin e Kristaqit, Ilafazanërinë dhe dëshirën për t'u dukur të Lirisë, dramën e Zanës, e cila ftohtësisë enigmatike të Besnikut i përgjigjet duke flirtuar me Markun, mendjelehtësinë dhe dëshirën për komfort të Ana Krasniqit («vetëm kursim të mos ketë»), «shpirtin e kontradiksionit» të Fredit ndaj kthesës politike etj. Sado ngjeshur e disi në formë konstatauese, në këto pamje e episode shkrimtari ka vërejtur se dhe në jetën tonë socialiste diçka ka depërtuar nga e keqja revizioniste; se duhet t'i pritet rruga rrezikut të restaurimit kapitalist, të luftohet për t'u çrrënjësuar me kohë, me largpamësi e keqja që ka zënë vend në disa sfera e individë.

Nga këto «kyçe» të strukturës e të kompozicionit të romanit, pjesërisht përmes Besnik Strugës, por edhe pavarësisht prej tij, autori e ka hedhur shikimin deri diku dhe në jetën e masave popullore, në ata që është bërë zakon të quhen «njerëz të thjeshtë». Kështu kolektivi i uzinës «Frederik Engels» lufton të arrijë standardet ndërkombëtare në prodhim; në digën e Zabzunit mijëra njerëz luftojnë kundër përmytjes; Xani fotograf përpiqet të zbulojë «hallin» që ka Enver Hoxha përmes fotografive. Viktor Hila hakërrehet, bie në eks-tremizëm, por i vë shpatullat punës për të zëvendësuar specialistët sovjetikë të larguar arbitrarisht. Komandanti i shtabit të aksionit kundër përmytjes jepet si mishërim i vendosmërisë për të përballuar një betejë të rëndë. Belul Gjonomadhi-mishërim i gatishmërisë popullore,



i atdhetarisë e humorit të fshatarësisë labe, dhe Nik Ukcama, që parandien rrezikun e zbret nga bjeshkët që të takohet me Enver Hoxhën. Dhe, me radhë pas-taj Maksi Bermema i «kompanisë» së Arbenit, Iliri — koleg i Besnikut, deri te fshesari Rrem Huta, me nu-hatje të mprehtë e me një dritë komizmi. Por mbase romani mund të ishte më i pasur me episode karakteri-zuese mbi heroizmin popullor, mbi rendin tonë shoqë-ror, gjë për të cilën jepte dorë edhe struktura e veprës.

Romani nis e mbaron me detajin e preokupimit të njerëzve për rregullimin e antenave të televizorëve. Shqisa e popullit është mprehur në kulm. Të gjithë duan të jenë në gatishmëri para çdo të papriture, para çdo prove, sado e rëndë që të jetë ajo.

Përmes një morie hollësish shpërndarë në disa qindra faqe, shkrimtari i jep lexuesit natyrshëm të dhëna për jetën e vendit, për mënyrën dhe nivelin e jetesës etj., krijon atmosferën e domosdoshme që ngjyron objektin themelor, kohën vetë.

Nëpër dallgët e saj përplasat edhe komunisti i ri Besnik Struga që formohet si revolucionar dhe jep «pro-vën e tij» («kjo është prova ime» — mendon ai) në gaste dhe evenimente nga më vendimtarët e historisë. Ai lufton të bëhet i denjë për emrin komunist dhe pë-son ndryshime në konceptet; fiton pjekuri, forcon mi-litantizmin. Drama, para së cilës ndodhet thaujse i pa-përgatitur në Mbledhjen e Moskës, dhe gjithçka që pa-son e tronditin, e bëjnë të harrojë vetveten, «harron» dhe Zanën. Martesa dhe vetë dashuria në këtë kohë i duken meskinitet. Po ai di të lartësohet mbi këto tron-ditje. Ai — lexojmë nga fundi i romanit, «...në ditët e rënda të këtij dimri kishte kujtuar se jeta po kall-kanosej. Kjo kishte qenë prova e tij. Kishte kujtuar se në çastet kur vdekja tregon dhëmbët, jeta duhet të pushojë përkohësisht. Por nuk ishte ashtu...» (f. 608).

Meritë e romanit është se në të janë parë të shkrirë e të bashkërenduar fronti i jashtëm me frontin e brend-shëm të luftës së klasave e, lidhur me këtë, pasqyrimi

i punës për pastrimin e gjithçkaje që pengon revolucionarizimin e mëtejshëm, që të mos vazhdojë e të për-tërlhet si në Bashkimin Sovjetik, në Kinë e gjatë «Epopeja e Rëngjakshme e Mbivlerës» (f. 429).

Zhgani i mbeturinave të reaksionit i bëri veshët pipëz. Po kështu lëvrijnë dhe ato «forca të errëta» që nxjerr revolucionin në sipërfaqe, siç nxjerr lumi kalbë-sirat. Të tjerë duan të rrëmbejnë flamurin e «miqë-sisë» me Bashkimin Sovjetik dhe të «unitetit» të lëviz-jes komuniste. Nëpër qoshe ushqejnë shpresa karrie-riste të ndryshëm, të përfitojnë diçka me perifrazime hipokrite, me përgjigje të paprincipa, me ekzagjerime, shpifje e intrigime, disa dhe me laiktime e me bujë, sikur janë ftuar në dasmë e jo në një dramë me për-masa bëtërore e me reperkusione epokale.

Gërshetimi i kontradiktave dhe i luftës së klasave është parë përgjithësisht si një konflikt i mundshëm ndërmjet frontit të unitetit popullor të udhëhequr nga Partia e mbeturinave të reaksionit dhe elementëve kur-dërrevolucionarë, që kërkojnë të kundërvihen qsmail Kadareja është përjekur, dhe përgjithësisht ia ka arri-tur të bëjë një «autopsi» të këtyre elementëve dhe, përmes episodeve, tipave, karaktereve, reflektimeve, përfundimeve të nxjerra këtu për të brekshme tezën dhe të vërtetën e njohur se gjatë gjithë epokës së kalimit nga kapitalizmi në komunizëm lufta e klasave është një forcë kryesore lëvizëse. Si luftë i një mës dy rrugëve (socialiste e kapitaliste) ndhe kjo është arsyeja për të cilën fitoria e socializmit mbi kapitalizmin nuk mund të konsiderohet e arritur përfundimisht, mundësi e res-taurimit të kapitalizmit mbetet në rënd të ditës. Po nuk u ruajt dhe nuk u forcua diktatura e proletarietit.

Problematikën themelore të vështirë me përmasa të gjera mund dhe duhet ta realizojë plotësisht letërsia e një vendi, e një epoke. Në një roman si «Dimri i madh» kjo problematikë ka mundur të masqyrohet në momentet më spikatëse, disa herë e pakonkretizuar ar-tistikisht në gjithçka, më tepër si e parashtruar sesa e

mishëruar në konflikte konkrete e të shtjelluara. Shkrimtari, nga vetë detyra që i ka vënë vetes, nuk mund të mos synonte të ishte sa më tërësor, qoftë dhe duke anuar ndonjëherë nga publicistika dhe arsyetimet racionale. Si një zgjidhje të konflikteve që vetëm ekspozohen ai sjell udhëzimet e preokupimet e Partisë për rrugën që duhet ndjekur në revolucionarizimin e jetës së vendit, hetimin e gjendjes dhe aspiratat e klasave e të grupeve shoqërore: kritikën ndaj prirjeve antisocialiste në individë të ndryshëm dhe me të gjitha këto nënizon kërkesën për vigjilencë, që vibrën në frymëmarrjen dhe çdo qelizë të veprës.

Autori dëshmon se si kundër revolucionit kanë prirjen dhe gatiten të vihen, në radhë të parë, mbeturinat e klasave të përmbysura shfrytëzuese, me nostalgjinë e së kaluarës dhe me dhembjen e plagëve që u shkaktoi përmbysja revolucionare, po edhe me pritjen e rastit për tentativë e veprim për restaurimin kapitalist. Në këtë gjendje shpirtërore dhe me të këtilla aspirata jetojnë Nurihan Kryekurti — gërdalla e së kaluarës; Hava Fortuzi, që ndjek me interesim çdo situatë dhe ruan gjallërinë për t'u hedhur në veprim në çastin e volitshëm; Ekrem Fortuzi, Musabëlliu, Rrok Simonjaku etj. Është vazhdari i të përmbysurve që nga «Kronikë në gur» dhe «Nëntori i një kryeqyteti». Gjendja e tyre ka ndërruar. Ajo karakterizohet nga një roitje hamendjesh, gëzimi cinik për çdo vështirësi e rrezik që i kanoset vendit, shpresa të turbullta, gatishmëri për terror kundërrevolucionar, orvatje për t'u organizuar duke përdorur së pari lidhjet familjare e miqësore, ankth e frikë, dëshpërim, orvatje për të gjetur, sidoqoftë, një mënyrë jetese («kush i hyn këneçës tani» — thotë një që e ka mësuar rusishten në burg dhe tani pandeh se do t'i duhet të përkthejë nga kinezçja...). Të gjitha këto janë mishëruar mëprehtë e me ngjyresë në faqet e romanit. Po tre momente kanë rëndësi për karakterizimin e tyre: vdekja e Nurihanit, që simbolizon shndërrimin e dëshpërimit në ankth vdekjeprurës; liri-

mi i doktor Faikut nga burgu, pasuar nga qortimet e rrepta të së shoqes që «të mbyllë gojën»; mendimi brejtës i Mark Kryekurtit: «Ti do t'i bësh violines për këtë botë...» (f. 605).

Në sens të kundërt aktivizohet çdo forcë shpirtërore dhe çdo cilësi pozitive e njerëzve tanë. Arben Struga, që gjer në atë çast e kemi njohur moskokëçarës, me priirje parazitare, reagon ndaj thashethemes keqdashëse se «do të bëhemi prapë vend kapitalist» (f. 278).

Episodi i dytë lidhet me lajthitjen e Zanës, që në çast angushtie flirton me Markun:

«— Me siguri që ju atje poshtë bisedoni, keni shpresa, — tha ajo e habitur edhe vetë që mund të fliste.

Ai ngriti sytë...

— Po, — tha ai. — Kanë ca ëndërrime, ca shpresa të marra.

— Shpresa të marra, — përsëriti Zana përhumbshëm» (f. 403).

Episodi i tretë na kujton një përsiatje e përjetim të Besnikut për të deklasuarit, duke dalë nga dyqani i antikuarëve:

«Besnikut iu duk se edhe pak dhe ata do të qëllonin që brenda dyqanit, duke nxjerrë tytat e automatikëve midis të çarave të manteleve e të frakëve të modës së vjetër, që hallakateshin në kremastare bronzi» (f. 529-530).

Edhe pse në ndonjë rast si ky gjejmë nota të pa-nevojshme deklarativizmi apo makabriteti të supozuar, me rëndësi është të vërehet po ajo dukuri: lidhjet e thella e të qëndrueshme deri në vdekje me revolucionin, me socializmin, me Partinë: «Unë jam komunist», «unë jam gati» — thoshte ai me vete si në çastet e provës vendimtare...

Është ky një tjetër front lufte, një tjetër rrezik për revolucionin, një ndër preokupimet kryesore të Partisë, një ndër shqetësimet e thella të Besnikut, një prej anti-pative më të hapura e më të ashpra të Ismail Kada-

resë. E kaluarë është përmbysur, po fantazmat kanë mbetur, në një kohë kur «...shtetin socialist nuk e ndanin veçse pak vite nga paraardhësit e tij.» (p. 428). Një prej këtyre fantazmave e zedhënësve ishte Koci Xoxe, kurse hije e tij është Aranit Corraj, i përafërt me të është Raqi, shefi i kuadrit të organit të shtypit ku punon Beshniku.

Përmes jetëshkrimit të Aranit Corrajt dhe fundit të tij, denoncimit të zilive e të pergjimeve të Raqit (në tip si ky gjejmë dhe në tregimin «Gjaktohtësi») dhe, veçanërisht, përmes kujtimeve dhe arsytimeve të Enver Hoxhës, jepet thelbi i dukurisë armiqësore dhe metamorfioza e armiqve në faza të ndryshme të revolucionit. Jo, — thotë ai vendosmërisht kundër gjithçkaje e kujtdo që «në emër» të revolucionit, përpjet ta pronësojë, d.m.th. ta vdesë atë.

Nisur nga përvoja e pasur e luftës së Partisë kundër burokratizmit, sektarizmit, recidiveve trockiste etj. dhe nga orientimet e saj për forcimin e demokracisë socialiste e të diktaturës së proletarietit, autori, si përmes Aranitit, dhe me anë përsiatjesh e arsytimesh, ka synuar të zbulojë thelbin antisocialist të tyre, të nënvizojë me forcë rrezikshmërinë e tyre për revolucionin e socializmin.

Janë vizatuar mirë, si me karbon, profile, si Araniti, Raqi, ndonëse tipi shoqëror që ata përfaqësojnë në roman e ka të zbehtë forcën karakterizuese e konkretizuese të autorit: në rrafsh të parë del një mllëf shoqërisht i përligjur, por i pamotivuar plotësisht nga ana artistike.

Ndër figurat që shpikat në këtë vërtitje «forcash të errëta» është ajo e anëtares së Byrosë Politike, paraqitur me shprehimësi si një prej shfaqjeve të metastazës kundër-revolucionare. Përmes figurës së saj tepër të perceptueshme, shkrimtari ka materializuar artistikisht lidhjen e pashmangshme të frontit të jashtëm me frontin e brendshëm të luftës, përpjekjen e forcave të errëta për «ricorganizim» dhe thelbin e përbashkët të qëlli-

meve e të shpresave të tyre. Ajo, «heroina e ditës», «lavdia e martirës» së historisë krahasohet me një flutur natë... «Ajo ndjeu një lloj krenarie dehëse kur përfytyroi ato dhjetëra mijëra fytyra të shtangura në castin që do të degjonin se si ajo kishte pasur guximin të denonte gjithë veprimtarinë e delegacionit të Parisit në Moskë. E dinte se mbi të do të shpërthente rrebeshi. Në të vërtetë ajo do të priste me kënaqësi një rrebesh të tmerrshëm sesa atë vështrim përbuzës të Enver Hoxhës dhe fjalët e tij të hidhura...» (f. 272)

E me gjithë këto, «do të priteshin kreditë, do të fillonte bllokada ekonomike. Ajo ndjeu një gëzim të egër tek kaloi nëpër mend fjalën bllokadë. Ishte një fjalë mbi të cilën mund të shpresoje» (f. 272-273).

Dallime fare pa rëndësi vihen re në mes saj e Njeriut të Komisionit të Revizionimit nga njëra anë dhe të deklasuarve e mbeturinave të reaksionit atje «poshtë», në dhomën e Kryekurtëve e gjetkë nga ana tjetër.

«C'dimër që ish!» Shqipëria, me fundin e këtij «dimëri» kish përballuar me sukses një rrebesh të historisë dhe kishte fituar përmasat e saj ishin mritur edhe më. «Zëri i shqipes», siç thotë kënga e popullit ishte ngritur lart. Po romani «fund të lumtur» nuk ka. Në skenën botërore po luhën akte të reja të dramës së njerëzimit. Eposit shqiptar i janë shtuar e do t'i shtohen këngë të reja lufte heroike e fitoresh.

#### IV

Nga rikujtimi i brendisë së romaneve të Ismail Kadarese shikojmë se si përmes veprash të veçanta, me pikësnyime që sa venë e bëhen më të vetëdijshme, më të konkretizuara, shkrimtari ka synuar të japë një pasqyrë «të shtegtimit», të kombit shqiptar në shekuj të dramave e të epikës shqiptare, lidhur ngushtë me atmosferën e historisë botërore, me kushtet e përgjithshme historike.

Çdo roman i Ismail Kadarese i kushtohet një fakti, një rasti a një periudhe historike me rëndësi. Dhe, ndonëse skenat e veprimit të masave popullore janë të rralla, hero kryesor i të gjithë romaneve pohohet populli, forcë e pamposhtur, krijues i vërtetë i historisë, mbantës i heroizmeve të madhërisme dhe i dramave të rënda, ai që mund të përballojë rrebeshe e stuhi të përbindshme, të përtërijë jetën dhe të ruajë etatë zhvillbje gjithë ç'është kombëtare dhe përparimtare. Nëse kombi shqiptar ka mbijetuar duke sfiduar fuqi të mëdha dhe invazione nga më të tmerrshmet, sipas shkrimtarit, kjo ka ndodhur për meritë të popullit, i cili u ka qëndruar stuhive të historisë, siç u qëndrojnë malet tona rrebesheve të motit. Nuk është nënshtruar e zhdukur, por në të kundërtën, ka «rritur përmasat», ka dalë prej çdo myqyre e ndeshje me armiqtë më i fuqishëm, më madhështor. Ky është një ndër përfundimet kryesore, një prej vlerave kryesore ideartistike të këtyre romaneve.

Ndërsa ndodh që vëmendja e disa shkrimtarëve përqëndrohet në evenimentin e pasqyruar, në portretizimin e heronjve dhe në detajimin e subjekteve brenda kornizës së figjarjeve, në romanet e Ismail Kadarese synohet tek elementet thelbësore të jetës kombëtare, të karakteristika kryesore e kohës. Hollësitë kalimtare dhe detajimet e tepërta nuk kanë rëndësi për autorin. Rëndësi të dorës së parë merr ideja dhe konceptimi poetik i realitetit, fryma që përshkon veprat dhe kalon caqet e subjektit, nervi i shprehjes tendencioze e të qëllimshme. Ai arrin të japë përmes veçorive më gjenësore të saj, frymën e kohës, të qëndrësës e të heroizmit, forcën dhe madhështinë e popullit; në to mishërohet karakteri i vërtetë popullor i veprave. Nuk do të ishte e udhës të hartohesh, siç bëhet rëndomë në kritikë, një listë personazhesh me prejardhje popullore, që nga Ajkunë e «Urës me tri harqe» deri te Belul Gjonomadhi i «Dimrit të madh», sepse në romanet e Kada-

resë nuk janë këta personazhë, as skenat e veprimeve masive parësore për veçoritë e pasqyrimin të frymës kombëtare të popullorë. ... Ne mund t'i pushtojmë kështjellat e tyre, — thotë kryeveqilharxhi në romanin «Kështjella» gati me gjuhën e autorit, — por në fund të fundit ato janë një grumbull gurësh që ata mund të na i marrin përsëri, ashtu siç ua morëm ne. Lufta do të jetë më e gjatë dhe më e ngatërruar se një sulm te muret e kalasë. Kia gjëra të tjera që duhet t'i sulmojmë qindra herë, qindra vjet me radhë, për t'gjymtuar sado pak» (f. 113).

Te «Gjenerali i ushtrisë së vdekur» në fundin e armiqve kemi një konceptim tërësor të gjerë e tron-ditës poetik, si në një vepër simfonike ku ndeshen e përplasen tema të forta dhe vjen e zgjerohet, plotësohet, konkretizohet në çaste e figura të goditura historia, heroizmi dhe shpirti popullor si jonet që mbushin atmosferën. Po, cilatdo qofshin episodet, vëmendja e shkrimtarit është vatëruar në atë mësublimen: në monumentalitetin e popullit, që si çdo gjë e madhërishtme (fjalë të një personazhi) përmban në vetvete dhe shumë dhembje, dramë. Ndryshe, për ç'madhësi do të bëhej fjalë? Kuptimplote është skena e dasmës dhe tronditja e thekshme dramatike e Niçës (f. 182-198). Përsëri kemi përpara figurën e popullit në gjerësi, epike e pasuri ndjenjash, fytyrën përtëritëse të ngulitur në këngët e lashta, në heroizmat e komunistëve, në patosin atdhetar që përshkon romanin.

Në rastet e tjera, ndonëse më rrallë, populli është përfaqësuar në figura të përgjithësuara e simbolike, ose, përndryshe, ai lëviz në morfë e episodeve dhe të personazheve, aty-këtu jepet dhe mes lëvizjesh masive, si në «Nëntori i një kryeqyteti» (ndërtimi i barrikadave, veprimet e «guërljeve», brigadat e zbuluesve të spekulatorëve) dhe në «Dimri i madh» (demonstratat masive kundër shantazheve sovjetike, aksioni për zhdukjen e pasojave të përmbytjes, veprimi revolucionar i pimetorëve të uzinës «Frederik Engels»). Po, në për-



gjithësi, pasqyrimi i detajuar i kësaj lëvizjeje e shkonat masive janë ose diçka e rrallë, ose e dhënë me ndërmjetësi, më tepër përmes kuptimit dhe efektit të tyre, sesa si fakte jetësore e shogërore të zhvilluar.

Në këtë dhe në pafajitjen jo gjere të veprimtarisë së organizuar të masave është një mangësi në veprat e Kadaresë kushtuar aktualitetit. Hapi përpara i realizmit socialist lidhur me pasqyrimin e historisë përbën domosdo analizën e re logjike dialektike shembjen e miteve dhe «kulturësimit» e heronjve të pamëritur të historiografisë e të letërsisë së mëparshme. Po në thembet të të gjithë këtyre, kthesa rrënjësore në historiografinë marksiste-leniniste dhe në letërsinë e realizmit socialist ka të bëjë me njohjen dhe pasqyrimin gjete e drejtpërdrejt të polit të masave në proceset e zhvillimit, me pranimin dhe pasqyrimin e luftës së klasave si «motor të historisë». Në krijimet që shqyrtojmë «koncepti përgjithësues poetik i Ismail Kadaresë, me tablotë e krijuara, nuk i shkon deri në fund këtij pikësynimi, edhe pse në meditime personazhesh e në përthyerje racionale të shkrimtarit këto pohohen më se një herë. (1) Simbolikisht monumentaliteti i qëndresës, i atdhetarisë, i epërsisë morale mbi agresorët, i gjykimet të mençur, i shpirtit të paqur dhe i largpamësisë «popullore është shprehur më mirë se kudo në figurën e kështjellarit në romanin «Kështjella». Në kronikat shumë të kursyera të kështjellarit (shkrimtari ka dhënë madhësitinë e popullit, përvojën historike të luftërave kundër agresorëve, përgjasimin me situatat aktuale nëpër të cilat kalon dhe qëndron heroikisht populli shqiptar. Shikimi vigjilent nga lart poshtë dhe vërtetimi i parashikimeve të kështjellarit nuk ka të bëjë vetëm me subjektin e romanit, por është edhe përgjithësim simbolik i qëndresës shqiptare. Skulptorit Mujo Gabrani të romanit «Dimri i madh», duke ndjekur nëpër rrugët e Tiranës malësorin Nik Ukcama, i ka lindur një shqetësim i përafërt: të shprehë në materialin e fortë të gurit frymën shekullore të kësaj qëndrese.

Synime e përpjekje të ngjashme, me sa u tha, ndihen edhe në «Ura me tri harqe» dhe në «Kush e solli Doruntinën», në të parin me figurën e kronikanit, Gjonit, të birit të Gjorg Ukcames, dhe në të dytin me «rikrijimin» e figurës së Kostandinit përmes dëshmave të shokëve, ndonëse figurat e pararendësve të vetëdijës atdhetare e të aspiratës për bashkim kombëtar janë disi të shkëputura nga trolli historik e mjedisi popullor i paraqitur e që përfaqësojnë.

Me arsyetimet, gjykimet, shqetësimet, aspiratat dhe parashikimet e veta, murgu Gjon Ukcama troket në dyert e Rilindjes dhe ngrihet mbi bedenat e principatave për të parë «gjithë Shqipërinë», si një pararendës i atij ideali e programi kombëtar, që do të synonte e realizonte më vonë Skënderbeu. (Nga kjo pikëpamje figura-simotër e murgut të «Ditëve të sprasme të Gjorg Golemit» të Dh.Shuteriqit, është më koherente dhe më e realizuar.

Kostandini, në dëshmitë e shokëve, del si arkitekti i një «strukture» të re shpirtërore kombëtare, që i kalon kufijtë e kohës. Ndryshe nga heroi i baladës, ky, përfaqësues i një familjeje fisnikësh, nuk mund të ngjitet ku e ngre shkrimtari në ato pak faqe nga fundi i romanit. Ose, po të ngjitej, në pajtim me prirjen objektive të zhvillimit, do të kërkonte një shtjellim e procedim tjetër. Kështu siç është paraqitur (kryesisht përmes fjalëve që u thoshte shokëve) mbetet më tepër një ide e shkrimtarit. Dukuritë e formimit të bashkësisë shpirtërore të kombeve nuk lindin me «eksperimente» diku në një fshat, as brenda një dhjetëvjeçari, po përmes një lufte të gjatë, nga më të ndërlikuarat e më të vështirat. Ideja e shkrimtarit nuk ka gjetur artistikisht heroin e gjallë dhe nuk ka mundur të mishërohet në të. Edhe pikëpamja e Kostandinit se Arbrit, të ndodhur në kryqëzimin e udhëve midis Lindjes e Perëndimit, për të ruajtur vetveten i duhet të krijojë një «strukturë të re shpirtërore», është disi jashtë realitetit të veprës e nuk mban sa duhet parasysh kuptimin dhe veprimin e

ligjësiive të përgjithshme historike në trollin kombëtar.

Ndeshemi edhe me disa heronj e mjaft personazhe të masës që pasqyrojnë lëvizjen historike e shoqërore. Ndër më të populluarit me ta janë «Kronikë në gur», «Nëntori i një kryeqyteti» dhe «Dimri i madh». Ata jepen jo më simbolikisht si të «Kështjella», as përmes arsytimeve e parashikimit të masave të dëshiruara ndëshkimore të armiqve («Pashallëqet e mëdha», «Komisioni i festës») as përmes veprimeve atdhetare vetmitare si ai i Nik Martinit («Gjenerali i ushtrisë së vdekur»), por në aksion; me mentalitetin, psikologjinë dhe shpirtin veprues luftarak e të çiltër që karakterizon popullin. Në këto raste populli nuk është më një objekt meditimesh, një personifikim, po, mishëruar në figura konkrete, vjen realisht, veprimtar. Kjo «zbritje» në truallin konkret popullor lidhet me shikimin e ngjarjeve në këndvështrimin e personazheve popullore, «autorë dhe aktorë» të fateve të veta dhe me shtrirjen epike të subjekteve.

Karakteristike në rastin konkret, por edhe në përgjithësi, është se atje ku materiali jetësor është i pamjaftë, u lihet më tepër vend arsytimeve, abstrakte, përshkrimeve të gjata, perifrazimeve, persiatjeve, situatave eterike, zgjidhjeve jo bindëse, shfrytëzimit pa kriter të gjendjeve jo normale (të dehur, të shkrehur nga nervat) si dhe elementëve jo të rrallë psikopatologjikë.

E përgjithshmjia është se Ismail Kadareja e ka parë popullin si forcë vendimtare, si faktor themelor për fatet e atdheut e revolucionit dhe njëherësh dhe si masë në revolucionarizim e sipër. Ai pikëzohet edhe në portrete që duket sikur kanë dalë në skenën e historisë fill nga eposi i kreshnikëve, për t'i shtuar këngë të reja atij (Nik Martini, Nik Ukcama). Ja si rrëfen prifti i fshatit për Nik Martinin:

«Ai qiti pushkë një orë rresht. Qëllonte rrallë dhe plumbat fishkëllenin në ajër të vetmuar. Xhadeja nxinte nga trupat dhe ai qëllonte dhe s'ish e mundur të shkulej që andej. Vetëm kur e goditën me mortajë.

— E vranë?!...  
Ashtu kujtuam dhe ne në fillim kur pushka  
e tij hesht! Por në vonë mëmë vesh se dhjetë kilo-  
metra më tutje Nik Martini kish dalë përsëri në një  
brëg dhe kish qitur pushkë përsëri një orë e ca...»  
(p. 147).

Nik Ukcama dhe Belul Gjonmadhi («Dimri i madh»),  
në të parë në historinë e jetës dhe në shqetësimin  
tronditës që i sundon, po ashtu kanë diçka nga eposi  
heroik popullor. Përmes syrit të skulptorit del në pah  
edhe ecja dinjitoze, edhe madhështia dhe shqetësimet  
e kohës, ajo diçka që hyn nga eposi në hapësirat e jetës  
bashkëkohore. Vërejmë groteskun humoristik dashami-  
rës në portretizimin e tyre, diçka në qëndrim e në men-  
tallitet që i shkëput, i lidh më tepër me kohën e «pri-  
llit të trimërisë» se tyre sesa me aktualitetin. Nik Uk-  
camës nuk i pëlqejnë automatiket e shkurtër, që i  
lëshojnë plumbat brëshëri si «llafe grash». Ai do push-  
kën e gjatë tradicionale, që i lëshon krismat një nga një  
e në shenjë si fjalë burrash në kuvend.

Edhe Belul Gjonmadhi, një ndër trimat e Luftës së  
Vlorës përbuz telefonat dhe ka inat radarët: nuk bëhet  
lufta me telefona. Me telefona bëhet vetëm dashuri.

Nga gjiri i popullit ka nxjerrë shkrimtari edhe he-  
ronjtë e pararojës, edhe luftëtarët e vetëdijshëm të re-  
volucionit, pa i zhveshur nga ngjyresa karakteristike e  
shtrësave që përfaqësojnë. Na kujtohen mjedisët dhe  
karakterët e shumta popullore në «Kronikë në gur»,  
Sado të mbështjellë me misterin e ilegalitetit (bukur  
e ka dhënë shkrimtari), ata janë filizat e rinj të një  
rrapi shekullor, me të cilët mund të sajohet një pyll  
i tërë Javërin e takojmë përsëri në «Nëntori i një  
kryeqyteti» tok me Dino Sinoimerin, me Sherif Gorenin,  
me Teutën... Përtëritje... Dikur kolona të holla par-  
tizane që zbrisnin në qytetin e gurtë («Kronikë në gur») tani — një forcë e madhe, që tund Shqipërinë. Bijë e  
madhe e popullit dhe vetë Partia, bij të thjeshtë e të  
vendosur të tij komunistët dhe si mishërim i tyre udhë-

heqësi Enver Hoxha. Kjo forcë e re jo vetëm e përtërin popullin, duke e zgjuar prej përgjumjes shekullore, po edhe fut në jetën e në vetëdijen e tij idetë e luftës së klasave, të revolucionit e të socializmit. Roli udhëheqës i Partisë në veprat e Kadarese është dhënë më tepër përmes frymës luftarakë të saj, përmes konceptimeve poetike dhe arsyetimëve, sesa përmes paraqitjes së drejtpërdrejtë aksionesh revolucionare të udhëhequr nga komunistët.

Lidhur ngushtë me konceptimin popullor të historisë, që edhe kur s'është mbartur si duhet në figura konkrete kryesore ndihet i sigurt në themel të romanëve e në personazhet, është «kompozimi i hapur» i veprave, përfshirës në gjerësi i kushteve e rrethanave historike në të cilat shtjellohet drama njerëzore, ngjizen fatet e popujve, vepronë tipa e karaktere. Këto romane edhe në këtë drejtim sjellin një përvojë të re të vlefshme për letërsinë tonë, ndihmesë krijuese për të rritur mundësitë shprehëse në trajtimin e temave mbi fatet e atdheut e të popullit e në këtë kuadër, mbi fatet e individëve të iverçantë.

Zakonisht, në themel të çdo romani vihet një fakt a një eveniment historik nga kuota e të cilit shkrimtari ka mundësi të përfshijë në gjerësi periudhën historike, forcat që vepronë, të pasqyrojë kontradiktat e konfliktet më tipike dhe, duke iu larguar hollësisë të panevojshme, t'i japë faktit a evenimentit vlerë ideobemionale përgjithësuëse, disa hërë simbolike. Kyjttojmë rrethimi i kështjellës dhe dështimi i rrethuesve për shkak të qëndresës heroike të të rrethuarve dhe shturrjes së brendshme të kampit armik («Kështjella»); një gjeneral dhe një prift mbledhës eshtrash të ushtarëve të mundur prej popullit tonë («Gjenerali i ushtrisë së vdekur»); mundet Ali Pashia, rebel, që gati një çerek shekulli i ka nxjerrë telashe pushtetit qendror të sulltanit e nuk arriti të bëhet prijës i popullit. («Pashallëqet e mëdha»). Flakte artistike a historike të kësaj natyre përbëjnë majanë e brendisë së romaneve «Ura me tri harqe», «Kush e solli Doruntinën», «Prilli i thyer». Edhe romani «Dimri

i madh», që ka shtrirjen më të gjerë epike, në thelb, është i ndërtuar po në këtë mënyrë: prishja e marrëdhënieve sovjet-shqiptare, që përqendrohet në Mbledhjen e Moskës (1961) dhe, lidhur me këtë, sfida e qëndrësia shqiptare, shantazhet e bllokada sovjetike, s'evolucionarizimi dhe mëtejshëm i jetës së vendit.

Kjo mënyrë ndërtimi, nga pikëpamja e formës, ka të bëjë me natyrën e konceptimit poetik që përfshin përmasa të mëdha të realitetit. Ismail Kadareja prozator nuk shkëputet nga Ismail Kadareja poet. Lexuesi me kalimin e kohës mund të harrojë hollësitat, por do ta kujtojë, kurdoherë, faktin bazë e bërthamën e subjekteve, prirjen që përmbahet në të.

Nuk është nevojja të ripohohet e vërteta e njohur mbi procesin historik si një vazhdimësi hallkash a shkallësh, po e themi se të vepra e tij prirja historike del më në pah e më në intensitet në «momentet kyçe», në periudhat e kthesave të mëdha rrënjësore, në ballafaqime thellësisht kontradiktore, në hope të ndijshme cilësore, në ngjarje që kërkojnë një aktivizim të gjithë forcave të kombit dhe që mbeten përjetësisht në kujtesën e popujve e të njerëzimit. Në këto momente dalin në skenën e historisë forcat e reja, lindin idetë e mëdha dhe personalitetet, e shquara që i përfaqësojnë ato, nënvizon autori. Nga ky përvijim del bindshëm se mënyra e ndërtimit të veprave të Kadaresë, jo vetëm është e përligjur nga përvoja historike, por është dhe një prej mënyrave më të efektshme artistike në letërsinë e sotme për të kapur thelbin e dukurive, për të përgjithësuar artistikisht procesin e zhvillimit, duke ruajtur e krijuar rezonancën me dukuritë e, problemet e reja aktuale.

Me zgjedhjen e «momenteve kyçe» dhe të fakteve me forcë të madhe shprehëse shkrimtari siguron jo vetëm momentin, por edhe këndin më të përshtatshëm të shikimit, për të mos i shpëtuar asnjë nga tri përmasat e kohës. Në këtë drejtim ai i ngjan piktorit që «e ndal» dukurinë në çastin që dëshiron e që përmban të koncentruar gjallërinë dhe lëvizjen në çastet e shpërthimit më të vrullshëm të saj, duke dhënë mundësi për depërtim në

thelësi të proceseve dhe shikimi në gjerësi hapësinore e kohore. Këtej rrjedh forma tepër e ngjeshur, largimi i tij nga ajo tregimtari e zgjatur, e detajuar, sipas një kronologjie të mërzitshme.

Para shkrimtarit janë shtruar për zgjidhje origjinale tre probleme ideoartistike: pasqyrimi i rrethanave historike dhe mishërimi i tyre në konflikte e figura artistike; përvijimi i fazave të zhvillimit; ndërtimi i subjekteve. Në të tre këto drejtime, përmes përthithjes krijuese të përvijimit së prozës bashkëkohore, autori e ka pasqyruar letërsinë tonë me arritje të çmuëshme.

Në romanet më të arrira ndihet mirë tabani i fortë i rrethanave historike në të cilat vihen të veprojnë personazhet dhe secili prej tyre luan dramën e vet si pjesë të dramës së madhe të kohës, pa ndenjur duarlidhur e i mënjanuar edhe kur pandeh se është i tillë. Nëse Kadareja, po të huajmë një term të kinematografisë, nuk përdor dëndur «planin e madh» në portretizimin e heronjve e të personazheve, kjo ndodh sepse ai nis të tregojë individët duke farketuar e interpretuar vetveten në skenën e madhe të historisë. Këtu, domosdo, ata do të paraqiten e do të vlerësohen në raport me përmasat e gjera të rrethanave e fateve të vendit dhe të njerëzimit në disa raste.

Në «Dimri i madh» edhe në personazhe episodike, në ngjarje, në biseda, në çdo hollësi ndihet forca vepëruese e rrethanave historike dhe veprimi i njerëzve për t'i përballuar e për t'i shndërruar ato. Janë njerëzit e vetëdijshëm që arrijnë t'i njohin, të veprojnë në këto rrethana, të çelin perspektiva për revolucionarizimin e tyre. Në këtë mënyrë është vizatuar në vepër figura e madhërishtme e Enver Hoxhës në sfondin epik e dramatik të epokës sonë.

Në rastet më të suksesshme shkrimtari, pa iu shmanhur reflektimeve e arsytimeve, në përgjithësi, nuk i ka pozuar ato në mënyrë abstrakte, por ka bërë që lexuesi të jetojë atëkohshëm në çdo episod, në çdo personazh, pavarësisht nga prirja që përfaqëson dhe karakteri i çdo njërit prej tyre.

Zakonisht romanet përfshijnë periudha tepër të shkurtura, që nga disa ditë («Kush e solli Doruntinën», «Prilli i thyer», «Pashallëqet e mëdha», «Nëntori i një kryeqyteti») deri të një vit e ca më tepër («Gjenerali i ushtrisë së vdekur», «Dimri i madh», «Kështjella»). Ca më tepër shtrihen në kohë ngjarjet e romanit «Kronikë në gur». Po të lihet mënjanë «Prilli i thyer», në të cilin mbi kohën, d.m.th. mbi zhvillimin, shkrimtari shikon rrasën e rëndë, të ngurtë të kapunit, në veprat e tjera caqet kohore nuk kanë ngushtuar pasqyrimin e proceseve të zhvillimit, përmasat e veprimit, shtrirjen e ngjarjeve në vend e kohë.

Në romanet e Ismail Kadarese, zakonisht, koha nuk jepet në rrjedhën e vet paraecese, po në një ndërthurje shtresash, ku gjëmon bashkëkohësia, vijnë nga thellësitë jehona të së kaluarës dhe ndihen zërat e tingujt e agullimeve të reja.

Në marrëdhëniet e psikologjinë shoqërore, në qëndrimin ndaj dukurive të kohës ndeshen me mprehtësi e ashpërsi dramatike e kaluara, aktualiteti dhe e ardhmja, ashtu si edhe mbështesin njëra-tjetrën. E, me gjithë këtë, rrallë gjen në romapet e Kadarese digresion të gjatë e aq më pak për çikërrima sado joshëse të jetës vetjake të individëve.

E kaluara në romane paraqitet si shtresë themelore e ngjarjes aktuale dhe vepron me forcë mbi të (p.sh. «Gjenerali i ushtrisë së vdekur»); ajo përtërihet në çaste vendimtare për t'iu nënshtruar gjykimit të historisë («Pashallëqet e mëdha»); ndërthuret me aktualitetin për të treguar fizionominë e kohës dhe veçoritë e ecjes përpara («Kronikë në gur»); përmbahet si një moto në natyrën e rëndit shoqëror regresiv («Kështjella» «Pashallëqet e mëdha», «Prilli i thyer»); përtërihet në ngjarje të mëdha historike si forcë mobilizuese e frymëzuese («Dimri i madh»); shfaqet në veprimin dhe aspiratat e forcave që aspirojnë kthimin prapa («Dimri i madh», «Nëntori i një kryeqyteti») etj. Mjeshtër i realizimit të tablove komplekse, Kadareja depërton në kuptimin dialektik të vazhdimësisë së jetës.



Autori e jep dhe e vlerëson kohën jo shkëputur prej faktorëve të tjerë siç janë ritmët e zhvillimit, gjendjet shpirtërore, vepra që do kryer etj., sidomos në pamje dhe pjesë të veçanta të veprave. Me interes do të ishte për këtë «Prilli i thyer», në të cilin në sfondin e një ngurtësimi shekullor (koha ka rrjedhur, jeta ka ngëcur në vend) shtjellohet drama e Gjörg Berishës, vrapimi i shpejtë i muajit prill si caku i fundit i jetës së djaloshit. Fshatra të rënuar e të ngujuar, zotërimi absolut i kapidanit, ekzaltimi intelektual i «zakonit të maleve» dhe, vetëm aty këtu, ndonjë shkëndijëz kundërshtuese dhe një joshje magjepsëse gati ireale. Kanuni si dhe episode të «Shtojcës» së Shtjefën Gjeçovit që ngjishen në frazat e në fletët e romanit, është paraqitur si një forcë zakonore fatale, pa zbuluar thellë rrenjët shoqërore historike të tij: («qehajaj i gjakut» mund të jetë vetëm një figurë simbolike, që nuk e përfshin gjithë të vërtetën), kurse malësorët — viktimat «vetëdashëse» të zakonit të egër të gjakmarrjes, qoftë dhe për arsyen më absurde. Ndryshe nga veprat e tjera, ku, sado në formë të lirë, shkrimtari ka vënë në themel rrethanat historike dhe ato e kanë prirë në zbulimin e karaktereve, të botës shpirtërore e të çdo gjëje ideale, në «Prilli i thyer» jeta është përmbjllur brenda kuadrit të formave të superstrukturës ideologjike e juridike të asaj kohe, prandaj është varfëruar, skematizuar, shkretëtuar (as një plakë ulokë s'ka kush ta ndihmojë, se gjithë fshati është i ngujuar). Kurse duhej që, sidomos nën prizmin e së sotmes, të zbulohesh e të paraqitej ajo forcë reale, qoftë dhe në potencë, që do të tentonte t'i kundërvihesh logjikës jetështruese të kanunit, ato rrjedha të nëndheshme që lëvrinin në zemrat, në mendjet e në jetën e malësorëve të varfër, nga të cilët buronte edhe forca e bashkimit të tyre kundër armiqve dhe rrezikut të zhdukjes së kombit, siç nuk mungon të pohohet në ndonjë rast.

Në romanet e I. Kadarese, në paraqitje gjeografike pa aq «të lira» sa dhe të ngjarjeve historike, përfshihen shpesh treva të mëdha, gjithë vendi, deri kontinente. Kjo nuk mund të kuptohet jashtë synimit të shkrimtarit për një paraqitje sa më tërësore të ngjarjeve, me rrezatimin e ideve, me vetë gjerësinë e temave që trajtohen.

Si, në çdo vepër proze, edhe në romanet e Kadarese ka një fill të dukshëm subjekti dhe disa personazhe që i përshkojnë ato nga fillimi në fund, pa qenë den- gur heronj a personazhe kryesore. Këto personazhe, sado që kanë fillin e jetës së tyre, mbeten me detyrën e tregimtarit (Gjon Ukcama në «Ura me tri harqe» dhe heroi anonim i romanit «Kronikë në gur»); personazhe vepruese po deri diku dhe ndërlihdës subjekti (Besnik Struga në «Dimri i madh»); të tjerë që mbartin mbi vete drama e turpe të së kaluarës, që zbulohen përmes peripeçive (gjenerali e prifti në «Gjenerali i ushtrisë së vdekur») si dhe personazhe vepruese pa ndonjë funk- sion të posaçëm për strukturën dhe kompozicionin e veprave.

Shkathët e me efekt ndiqet e na jepet filli i jetës së personazheve, përplasja e tyre me ngjarjet, lidhjet me rrëthanat e mjedise shoqërore. Ndodh që këto per- sonazhe lihen mënjanë dhe, pa ndonjë ndërthurje të tipit «klasik», shkrimtari, me lidhje të nënkuptuara, na çon në mjedise e ngjarje në të cilat ata s'mund të fute- shin. Shfrytëzohen për këtë pjesë kronikash, njoftime për ngjarje të jetës shtetërore e politike, të dhëna të njëkohshme për personazhe e kategori të ndryshme sho- qërore, deri dhe fjalët e këngëve që dëgjohen udhëve e shesheve, parullat në mure etj. Sa më të gjëra të jenë përmasat e ngjarjeve në roman, aq më të shkathtë e të shpështa bëhen kalimet, aq më i gjerë e shumëkën- dësh shtrati i subjektit. Shembull për këtë janë «Dimri i madh» dhe «Kronikë në gur» e, pas tyre, «Nëntori i një kryeqyteti».

Struktura e romanit «Dimri i madh» ka qenë ndër

më të vështirat dhe është ndër, më kompaktet. Realiteti i atij dimri ishte me ngjarje dramatike për botën, për lëvizjen komuniste botërore, për vendin tonë në veçanërisht. Qëllimi i shkrimtarit ka qenë të pasqyrojë reflektimin e këtij realiteti në jetën e Shqipërisë dhe të ritheksojë meritën e Partisë së Punës të Shqipërisë me Enver Hoxhën në krye për demaskimin e shpartallimit e revizionizmit hrushovian, rëndësinë kombëtare e ndërkombëtare të kësaj detyre e veprë historike, vetëdijën e përgjegjësinë e thellë me të cilën u kryen ato.

Shkrimtari është përqendruar në momente me rëndësi vendimtare, për të treguar të vërtetën, për të krijuar atmosferën dhe për të ndriçuar logjikën e ngjarjeve, për të përligjur të drejtën morale të protagonistëve të romanit. Me hollësi shprehëse është pasqyruar qëndrimi i PPSH në Moskë, përballimi i «natës së zimave të zinj», atmosfera e rëndë dhe e tendosur e Mbledhjes së Moskës; mbërmbja në Kremlin, e zhurmshme, festive në dukje, po e ngarkuar me ndërhyrje me presione me provokacione; takimet e shokut, Enver me Hrushovin dhe udhëheqës të tjerë hrushovianë, largimi i delegacionit tonë — shprehje e shkëputies së vendosur të PPSH nga rruga që ofronin revizionistët, rruga e nderit dhe e sakrificave që zgjodhën në etj.

Kësaj është momenti i parë përcaktues për strukturën e romanit.

Momenti i dytë me rëndësi pasqyron veprimtarinë e udhëheqjes së PPSH për të përballuar rrebeshin, shantazhet politike, bllokadën ekonomike, agresionin e mundshëm ushtarak socialimperialist apo imperialist; mobilizimin i forcave morale e materiale të popullit, ruajtja e gjakftohësisë, vigjilenca për të mos rënë në kurthin e provokacioneve, goditja e çdo deviacioni kapitullues. Ky moment nuk është dhënë me vazhdimësinë dhe plotësinë e të parit, po është shtrirë e ndërthurur gjatë veprës me jetën e gjallë të vendit në ato situata. Shkrimtari shkëputet kur gjen rastin, nga rrjedha e jetës së personazheve, për të na dhënë njoftime me rëndësi të veprimtarisë së udhëheqjes së Partisë e të shtetit, të

informimit të masave dhe të arritjeve në frontet e ndryshme. Në momentin e tretë, që ka të bëjë me çështjen e vazhdimit konsekuent të revolucionit, jepet Enver Hoxha në çaste përsiatje, i ndodhur para raportimeve për prirjen e ndihmave të kredive, po dhe të letrave kurajoze e frymëzuese të komunistëve, të kolektivave punonjëse, të revolucionarëve të vërtetë në botë. Në këtë kapitull kryesisht në formë arsyetimesh e përfundimesh, është përvijuar, përmbledhur programi i revolucionarizimit të mëtejshëm të jetës së vendit që mori hov më pas me Letrën e Hapur të KQ të PPSH dhe me Kongresin e 5-të të PPSH (1966).

Tek momenti i katërt (ndeshja në bazën ushtarake të Vlorës), gjithçka lihet të nënkuptohet dhe nënkuptohet qartë. Dërgimi i Zhelezovit dhe, në fund, urdhri që vjen nga Moskë për tërheqje, tregojnë se dhe në fushën ushtarake ka ngadhnjyer politika e urtë parimore e largpamëse e PPSH.

Një çështje tjetër e strukturës ka qenë përthyerja e këtyre situatave në kategori të ndryshme shoqërore, në individë të veçantë dhe reagimi i njerëzve ndaj situatave e pasojave të tyre, duke shfrytëzuar me mjeshtëri çdo mundësi, duke krijuar lidhje të natyrshme ndërmjet ngjarjeve mbi veprimtarinë e udhëheqjes së Partisë dhe jehonës së tyre në masë. Kjo lidhje është paraqitur poetikisht në formën e një epilogu (në këta vjetë lindi dhe shprehja e re proverbiale «Çdo popull bën Partia — ç'thotë Partia bën populli»).

Shkrimtari përmes episodeve e personazheve të shumta, këmbimesh e kalimesh të shpejta (kapitujt të ndarë në püntata e episode të shumta gati paralele) autori pasqyron pa thjeshtëzime gjendjen dhe prirjet më kryesore. Simultaneizmi, paraqitja e njëkohshme e disa gjendjeve, e ka pasuruar stilin e romanit dhe prozën tonë.

Megjithëse në dukje një stil konstatues i përmbajtur, tendencioziteti është i qartë, me shprehje të hapur, më se një herë të drejtpërdrejtë. Nëse romani në këtë drejtim

ka mungesë e dobësi, kjo vjen ngaqë shkrimtari nuk ka arritur, në gjerësinë e thellësinë e duhur të paragesë e individualizojë, më me detaje, forcën masive shoqërore që e shpie e do ta shpjerë revolucionin përpara. Këtë të vërtetë jetësore letërsia duhet ta pasqyrojë më plot, më thellë, më një afirmim më entuziast, sidomos përmes figurash përfaqësuesish të klasës më revolucionare e pararojë, të klasës punëtore.

Në romanin «Kronikë në gur» struktura dhe kompozicioni origjinal e funksional i shërbejnë pohimit të zhvillimit revolucionar në kushtet e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare në një mjedis të prapambetur e të amullt shoqëror, ku depërtojnë idetë e revolucionit dhe spikatit tiparet e njeriut të ri, fryn era e epokës komuniste që po afrohet.

Zgjedhja si personazh organizues kompozicional i një fëmije, në kujtesën dhe në karakterin e të cilit lënë vulën e vet rrethanat dhe mjediset e kohës, është çelësi i strukturës së romanit, filli pas të cilit kapet lexuesi. Ky hero rrefimtar nuk jepet i kristalizuar. Ai ecën tok me zgjerimin e kuadrit nga autori. Por, në thelb, element përcaktues në tërësinë, ideoemocionale të romanit është veprimtaria e komunistëve, prania e Partisë si forcë politike udhëheqëse në jetën shoqërore. Me anë të heroit ka pak mundësi që si lexues të njihemi nga afër me këtë forcë. — Pjesërisht ai njih vetëm Javerin dhe Isain — po forca e re ndihet kudo: në bisedat e njerëzve, në traktet që shpërndahen, në djegien e ndërtesës së bashkisë («u dogjën tapitë»), në atentatet kundër gjerrakëve fashistë, në ndëshkimin e spiunëve e të kolaboracionistëve, në frymën e re, që sado me vështirësi, po depërton në mentalitetin e njerëzve, në terrorin fashist kundër antifashistëve, në urrejtjen e pasunarëve për ta (kujtojmë zonjën Majnur), më në fund, në vetë rrugën që marrin ngjarjet si afirmim i ideve dhe i programit të kësaj force të re. Nën këtë ndikim rriten vetë heroi i romanit dhe shoku i tij i fëmijërisë — Iliri.

Për të qenë kuadri më i plotë, në disa raste, në rrë-

famin e heroit kapërcehen caqet e naivitetit famijeror\*) Po për këtë qëllim janë shfrytëzuar dhe fragmente kronikash, që dalin jashtë rrjedhës natyrore të kompozicionit.

Gjallërimi i figurshëm i qytetit dhe përfshirja e tij në atmosferën e kohës është një element tjetër përcaktues në strukturën e veprës. Në të operohet me kalime të shpejta në ngjarje e mjedisë të ndryshme, bëhet pasqyrimi në gjerësi dhe paraqitja dinamike e periudhës së përshkruar. Ndonëse në qendër është vënë një person me përjetimet e tij, romani është larg kësaj autobiografik. E re dhe me vlerë në të është se autori përdor si kamerë syrin e heroit letrar, për të përçuar prijet e vet ideore, për të përdorur reagimet psikologjike e mendore disi të çuditshme e naive në shërbim të një analize të mprehtë e mendimi me peshë, që pa kuptuar, shkallë-shkallë arrin në përgjithësim filozofik e artistik.

Afëri me kompozicionin e «Kronikë në gur» ka edhe «Gjenerali i ushtrisë së vdekur», me ndryshim se tek i dyti kemi ndërthurrjen e shtresave kohore (periudhës së Luftës dhe «vitit të zhvarrimit») dhe të grupeve njerëzore, si: të të vrarëve, të zhvarrosësve dhe të popullit shqiptar. Në vështrim të sipërfaqshëm romani duket që merret me peripecitë e zhvarrosësve, por në thelb boshtin strukturor të tij e përbën forca ndëshkuese dhe madhështia Antifashiste Nacionalçlirimtare, triumfi i popullit në fuqi.

«Nëntori i një kryeqyteti» është romani me elementin rrëfimtari më të zgjeruar të autorit e ku më tepër se në çdo veper tjetër të tij zotërojnë veprimet e personazheve. Luftimet për marrjen e radiostacionit dhe për pjekjet për ta vënë në funksionim atë mbartën edhe fillin ideor të veprës, e cila përçjell mesazhin: Shqipëria duhet t'i flasë botës me zërin e vet të fuqishëm për të pa-

\*) Në dobi të këtij konstatimi është dhe faqja e fundit e romanit e titulluar «memoriale».

varur, Që të arrihej kjo, sipas shkrimtarit, duhej që, tok me dëbimin e pushtuesve nazistë, të realizohej edhe shembja e superstrukturës së vjetër — instrument nënshtimi e shkaktarë. Shqipëria, nuk fliste me gjuhën e vet të vërtetë, me gjuhën e popullit e të revolucionit, («Shqipëria akoma s'ka zë, — tha ai, — Ajo është pa gojë... ose, më mirë, ajo e ka pasur zërin, po gjer më sot atë zë nuk ia ka dëgjuar kush në botë përmes valëve të radios» (f. 21).

Pra, si dhe në raste të tjera, problematika është më e madhe e më e thellë nga ç'mund të ofrojë subjekti në vetvete dhe veprimi bazë i tij.

Romani nuk merret thjesht me historinë e një toge partizane, të një beteje në luftën për çlirimin e Tiranës, por me përmbysjen e një rendi dhe me fillimin e një epoke të re, me shfaqjet me fillestare po rrënjësore të rendit të ri shoqëror e politik.

Në shërbim të këtij synimi, duke u marrë edhe me përshkrimin e veprimeve luftarake, me episode konkrete tipike të betejës shkrimtari shtrin tri linja kryesore: historia e detashmentit partizan në ditët e Luftës së Tiranës; historia e lidhjeve Adrian Guma-Mirjam Morina (filli i jetës dhe fundi i çdo njeri prej tyre) dhe linja e atyre që do të përmbysen në çastet e krizës së pandreqshme të klasave shfrytëzuese (paniku i kolaboracionistëve, gjendja në familjet e të pasurëve). Arahë e veprimit të tyre dhe mjet karakterizimi është zgjedhur sheshi i luftimeve dhe kryeqyteti në ditët e para pas Çlirimit, mjediset e të përmbysurëve dhe «zona e lirë».

Në këtë ndërthurje planesh e ndërluftuesish zotërojnë dy akorde: ndeshja me pushtuesit nazistë dhe shfaqja gjithnjë më e qartë, më e vetëdijshme dhe më e pushtetshme e rendit të ri. Duke u përqendruar sidomos në fazën e ashpërsimit kulmor të luftimeve e të krizës e rezistencës së dëshpëruar të rendit të vjetër si dhe në aktet e para revolucionare që afirmojnë kthesën historike, autori bën më të kapshme dy anët e procesit historik, mëhë drammatizmin, nënvizon logjikën objektive të zhvillimit. Në linjën e parë ai ndërton një kundërvënje të hapur dhe të ashpër të forcave kundërshtarë në rrafshin ushta-

rak, kurse në linjen e përmbysjes revolucionare jepen dy kahjet kryesisht në rrafshin shoqëror e politik. Ë para nis me panikun që mbretëron në «Rrugën mbretërore» (kolaboracionistë, të cilëve veç arratisjes nuk u ka mbetur rrugë tjetër shpëtimi), vazhdon me «takimet» e para me forcën e rendit të ri (detashmenti partizan, që mbledh punonjësit e radiostacionit, «kërkuessit e floririt» dhe gjithë atmosfera e ditëve të para pas Çlirimit) dhe përfundon me pasqyrimin e gjendjes e të aspiratave të të përmbysurve përballë situatës së re.

Pala tjetër jepet edhe më interesante në kthesën historike që po ndodh. Shkrimtari shquan në pasqyrimin e gjendjes e aspiratave të forcave të reja, duke shmangur çdo enfazë e romantikë false, çdo skematizim. Mbi botën e vjetër, të kalbur, mbi egërsinë e armiqve të mundur, ngrihet e pastër, vezulluese, e mahnitur nga agimi i botës së re, pararoja e saj — luftëtarët e revolucionit.

Vjen casti që ata të marrin në dorë shtetin, të bëhen përfaqësues të diktaturës së proletariatit, zëdhënës të Shqipërisë së re. Koha kërkon që Sherif Gorenit me shokë të mendojnë për vazhdimin e revolucionit në kushte dhe etapa të reja, të përfaqësojnë shtetin e ri dhe të zbatojnë ligshmërinë dhe dhunën revolucionare.

Karakteristik është episodi i shkurtër me një rob gjerman: «Pse, mos qeshësh, i tha një partizan i shkurtër nga skuadra e parë, na grive me mitraloz gjithë ditën dhe ne tani të japim të hash. Si marr vesh unë këto rregullat e reja të luftës.» (f. 99). Me efekt është përdorur në këtë rast dhe humori gazmor e i ndritur, për të pasqyruar kthesën në gjendjen shpirtërore dhe në vetëdijen e partizanëve (episodet gjatë transmetimeve të para të Radio Tiranës së re etj.) ose dhe ato që kanë të bëjnë me fillimin e marrëdhënieve të reja intime në mes një-rëzve pas mbarimit të Luftës.

Figura e shkrimtarit «mbikohor» e «mbiklasor» me gjithë shpërniesëtimin që krijon krahasuar me vendin që u është dhënë masave të cilat kryejnë revolucionin, ka



dhënë mundësi të paraqitet përmes kujtimeve e përshlypjeve fizionomia e botës që po përmbysët, tiparët e neveritshme të kolaboracionit, të vendoset një lidhje ndërmjet zonës së luftimeve dhe zonës së çliruarj të tre q gohet shterpësia e ëndërrimeve dhe e aspiratave të humanizmit abstrakt.

Me vetëvrasjen e Adrian Gurnës dhe me fundin e mjerueshëm (të të gjithë jetës plot kotësi) të Miriam Morinës është hedhur poshtë me fakte artistike iluzionin intelektualist i «pavarësisë» nga shoqëria, nga rrëdi ekonomik e politik, janë dhënë forcat intelektuale që nuk janë në gjendje të ngrihen në lartësinë e kuptimit të drejtë të proceseve historike e të korrigojnë në kohën e duhur pozitën ndaj tyre.

Përgjithësisht struktura dhe zgjidhjet kompozicionale që gjen autori, ndihmojnë pasqyrimin në shumanshmëri dhe në shprehien e vetvetishme e të qartë të tendenciozitetit ideologjik. Le të bëjmë një krahasim:

Romanin «Kështiella» e përshkon ideja se nuk ka forcë të mposhtë një popull që është i vendosur të mbrojë lirinë, vetveten, vendin dhe përparimin. Kurse «Pashallëqet e mëdha» mishëron kryesisht idenë që një rebelim sado i fuqishëm e trënditës, nuk është në gjendje të përballojë raprezaliet dhe genocidin e një perandorie dhe pushtuesi, po nuk përfadësoi ky rebelim aspiratat e kombit e po nuk dëti rrënjët në popull. Kjo është arsyeja që, ndërsa në «Kështiella» përballë mureve të kalasë shtrihet ultësira e kampit të pushtuesve, në «Pashallëqet e mëdha» në mes rrafshirës perandorake nerrihet e vetmuar kreshta e rebelimit dhe personaliteti i fuqishëm kontradiktor i Ali Pashës, të cilit në vepër i kushtohet vetëm një kapitull.

«Muret e kështjellës» po afroheshin gjithnjë. Sa më tepër afroheshin aq më e madhe bëhej lartësia e tyre dhe aq më të frikshme bëheshin të qarët e hapura mbi to nga fopat. Sinër tyre bedenat si dhembë të zhveshur të një përbindshi, kishin filluar të bërtvonin trupa ushtarësh. Atje midis atyre dhembëve të pamëshirshme

kishte ngëcur e po përpëlitej i gjakosur fati i tij» («Kë-  
shtjella» f. 224).

Në «Pashallëqet e mëdha» rrethisë çark qëndresës e  
personalitetit të Ali Pashës, mbështetur në disa pika  
kompozicionale (sheshi i «kamares në turpit», kampi i  
Hurshid Pashaft, ekipi i Arkivit Qendror, ecejaket ogur-  
zeza të Tunxh Hatait) shkrimtari ka përkruar mon-  
struozetin e një perandorie me ngrehinën e rëndë bu-  
rokratike, militariste, obskurantiste, e gjakatare. Këto  
shtillen e mbështillen me shumë fije, linja subjekti, fate  
personazhesh, me vvojtime dhe përfytyrime rreth struk-  
turës, politike, ushtarake, ideologjike e morale të pera-  
ndorisë.

Interesant për ndërtimin kompozicional është romani  
«Prilli i thyer». Kësaj here kemi të bëjmë me temë sho-  
qërore: denoncimin e «të drejtës kanunore» të gjak-  
marrjes dhe të forcave shoqërore që e përkrahnin dhe e  
mbanin në këmbë këtë institucion të anakronizuar. Në  
qendër të romanit, ndryshe prej veprave të tjera, është  
vënë figura dhe fati i një heroi tragjik. — Gjorg Berishës,  
një «fajtori pa faj», që në thellësi të vetvetes i është  
zgjatur dëshira t'i shpëtojë fundit tragjik të paracaktuar  
të bjerë nga plumbat e gjaksit. Alternativë tjetër shkrim-  
tari nuk ka dhënë.

Në «kalvarin» e Gjorg Berishës, ndodh takimi me  
ciftin Vorpsi: Besian Vorpsi, — shkrimtar ekzaltues i «za-  
konit të maleve» — me të shogën e bukur, së cilës do t'i  
zbulojë madhështinë magjensëse të «sjetës kreshnike»  
të malësive. Është e njëjta, botë e parë në katër kënd-  
vështrime të ndryshëm: sipas viktimës, që e pret «kulla  
e ngujimit» ose vdekja; sipas mbrojtësve të «kanunit»  
dhe ruajtësve të gjakmarrjes mesjetare — kapidani; sipas  
interpretuesve gjakfjohë të kanunit — Ali Binakut e  
grupit të tij dhe së fundi, sipas romantikut konservator,  
estetizant — Besian Vorpsit. Këto katër këndvështrime  
trazohen, afrohen, kundërvihen dhe largohen nga njëri-  
tjetri, sipas motiveve të secilit grup dhe synimit balla-  
faques apo kontrastues të autorit.

Jeta e malësisë është përshkruar e ngrirë si kufomë, kurse autopsia e saj bëhet formalisht sipas paragrafëve të kanunit. E vetmja gjë e gjallë, e lëvizshme është prinja e ndërsjelltë e Gjorgut drejt «së bukurës» Diana Vorpsi, e cila, e zvetënuar nga jeta boshe «qytetit të asaj kohe, joshet pas «bukurisë tragjike» të jetës patriarkale. Dhe ka vërtet diçka «midis reales dhe ireales» rruga e vizita që bën Diana deri në kullën e ngujimit. Në thelb përshkrimi fluror i këtij çasti konkret (hyrjes në kullën e ngujimit) përfshin poetikisht gjithçka ndodh në shpirtin e Diana Vorpsit të ftohtë me të shodiq, mospërfillëse për përfytyrimet ekzotike të tij, e prapë të joshur nga «bukuria që vret», e kanunit, nga pamja e jashtme e malësorit me pushkë. Autori, duke parë se kjo mund të arrihej në rrugë realiste, ka përdorur teknikën iluzioniste të huajtur nga proza moderniste.

Kemi të bëjmë këtu me një problem tjetër: çrregull u jepet ngjarjeve dhe si zgjidhen konfliktet në këto vepra të Ismail Kadarese?

## VI

Konfliktet në romanet e Kadarese, po të përjashtojmë «Prilli i thyer» dhe «Kush e sollë Doruntinën», janë të përmasave të mëdha, shpërndarë gjithandëj që nga kuptimi i ngjarjeve të shquara deri te ndodhite në dukje të parëndësishme, që nga personazhet që zënë vend kryesor deri te më të rëndomtët e më episodikët, që nga dramat tronditëse e tablote epike deri te gjendjet shpirtërore e përjetimet e çastit, që nga konceptet e aspiratat më rëndësi historike deri te përshtypjet më të zakonata të jetës së përditshme.

Pas leximit të veprave të duhet të sjellësh ndër mend tërë këtë «yllës», për të rikrijuar atë tablo që ka paraqitur shkrimtari, për të zbuluar fijet e ndërthurura të kontraktave e të konflikteve, për të nixjerrë më të plotë kup-

timin dhe për të kapur prirjen e kahjen ideoartistike të gdo krijimi. Në larminë e ngjarjeve e të personazheve ka koherencë logjike, historike dhe artistike, njësim e harmonizim të së tërës me pjesët, të elementëve e pamjeve të ndryshme, të tregimit e të përshkrimeve, të fjalëkëmbimit e të medimit. Sidomos në vepra ku materiali historik e jetësor vërshon më-gjallërisht kjo ndërvarje është më e prekshme. Dallohen për pasuri konfliktesh e larmi tablosh «Dimri i madh», «Kronikë në gur», «Kështjella», «Gjenerali i ushtrisë së vdekur» e ndonjë tjetër. Në disa vepra edhe kur subjektet janë të detajuara («Ura me tri harqe»? më tepër zotëron arsytimi i eseistit.

Mënyra se si i shpërndan autori elementët e konflikteve artistike, «prerja» në të cilën i paraqet, u jep veprave tingëllim të gjerë dhe bën që të mos kufizohen në kontradikta të rëndomta e në mjedise të ngushta. Një parashtrim i tillë i konflikteve, vektor i të cilëve mbetet disa herë ideoja që përshkon veprën, doemos e shtron disi ndryshe edhe çështjen e zgjidhjes së tyre.

Shkrimtari bën përpjekje këmbëngulëse që në veprat e tij «tendenca të rrjedhë vetvetiu», d.m.th. të përmbahet në gjendjet e në situatat e dhëna, në fizionominë dhe në aspiratat e forcave të paraqitura, në prirjet objektive dhe në logjikën e zhvillimit historik e njëherësh pa i fshehur simpatitë, antipatitë dhe idealet e veta. Ai ka synuar t'u japë romaneve një tingëllim sa më «polifonik», duke ruajtur të pacënuar «temën kryesore», që zhvillohet e bëhet zotëruese si në një simfoni. Kjo është një prirje e shëndoshë dhe një prej drejtimeve të ndihmesës së Ismail Kadarese në traditën e letërsisë së realizmit socialist. Për këtë po ndalemi vetëm në dy romane: «Kështjella» dhe «Dimri i madh».

Në «Kështjella» tema (në kuptimin që i japim në muzikë) përshkon veprën me qartësi, intensitet, plot kontraste, nënvizime, me lajtmotive që shtjellohen deri në kurorëzimin në finale. Te qartësia dhe forca e kësaj teme mbartet edhe tendencioziteti ideor. Në kampin e pushtuesve, sipas rëngut, grupeve shoqërore që për-

faqësojnë, mjeteve që përdorin, vendit që zënë në aparatën perandorak apo në hierarkinë ushtarake, dëgjojnë shumë zëra, në dukje me vije «të pavarur». Në të vërtetë ata bashkohen e shkrihen në një tërësi të kuadrur mirë, me gjithë ngjyresat dhe luhatjet, mprehjen apo zbutjen e situatave që përshkruhen. «Këndon» secili në linjën e zërit të vet, që nga Tursun Pashai, Tavxhai, kryeveqilharxhi, arkitekt Kauri, Saruxhai deri te munxadhënësi, Sadedini, Evlia Çelebiu, grupi i vajzave të haremit etj.

Në karakteret e tyre shkrimtari ka nënvizuar atë që i bashkon në «grupin vokal» por njëherësh edhe tiparet e çdo kategorie, karakteri, ata që priren të «shthurin» grupin, pa ndryshuar fizionominë e tij. Jepen karakterizime të forta shoqërore e politike që lidhen sa me gjendjet shpirtërore, aq edhe me rendin shoqëror e politik të kohës. Me tipat që paraqet, me ngjarjet që tregojnë dhe me karakteret që vizaton, shkrimtari arrin t'i japë të kuptojë lexuesit se me ç'rend shoqëror e shtetëror ka të bëjë, të tregojë si të vërtetë objektive e reale rënien e pashmangshme të këtij rendi.

Flitet për një mbledhje të këshillit të luftës, ku Tursun pashai del i pushtetshëm dhe autoritar, i aftë të qëndrojë mbi dy grupet kundërshtarë brenda shtabit të tij. Për njerëzit e shkencës e të teknikës (kryeveqilharxhin, Saruxhanë, Kaurin) ai «duke pasur besim në mendjen e tyre, nuk kishte besim në zemrën e tyre», kurse për komandantët, ushtarakë (Tavxhai, Karra-Mukbili, Kurdisxhiu) «... i besonte më shumë zemrës se mendjes së tyre» (f. 34). Në fund të mbledhjes, pasi pashai jep vendimin dhe të gjithë shpërndahen: «Astrólogu, të cilit i dukej vetja shkaktar kryesor i sherrit që dësh plasi pak kohë më parë, rrëshqiti dhe u zhduk i pari nga grumbulli i atyre që po dilnin. Ai e dinte se njerëzit e fuqishëm, edhe kur, për një çast, pësojnë disfatë, mbeten prapë të fuqishëm në krahasim me ata që kanë nën vete, prandaj preferoi më mirë të zhdukej nga sytë e të gjithëve, sesa të vërtitej midis mbrojtësve të tij, krenar që vendimi u mor sipas parashikimeve të tij» (f. 36-37).

Kështu, në fillim, para se të nistë beteja. Kurse nga fundi i romanit (kapitulli i katërmbëdhjetë) në një tjetër mbledhje: «Tursun pashai nuk dëgjonte ç'thoshte myftiu. Ai vështronte me radhë fytyrat e anëtarëve të këshillit të luftës me sytë e tij të ndriçuar nga një irrimtim i largët. Ai kishte vënë re kohët e fundit se sytë e tyre largoheshin menjëherë posa takoheshin me sytë e tij. Ai e ndiente se kjo heqje sysh ishte shenja e parë, e pagabueshme e ndarjes së fatit të tij nga fati i tyre [...] Ai kish filluar të provonte ndaj tyre një ndjenjë që i afrohej asaj të urrejtjes. Kjo fushatë do të mbaronte dhe sido që të mbaronte ajo, ata do të vazhdonin karrierën e tyre [...] Rruga e tij mbaronte në muret e kësaj kalaje. Tani ai ose do të ngjitej lart ose do të rrokullisej poshtë [...] Ai po e kuptonte se ata donin të ndaheshin prej tij. Ata donin ta linin vetëm. Por ai ishte kryekomandant i tyre dhe nuk do të ndahej aq lehtë me ta. Ai do t'u tregonte se ç'eshtë në gjendje të bëjë një kryekomandant i dëshpëruar...» (f. 221-222).

Midis këtyre dy mbledhjeve shtjellohen motivet e «krenarisë e të lavdisë osmane», të urrejtjes ndaj kësaj «Kështjelle» që u kishte dalë papritur përpara, kur ata i kishin sytë nga Evropa, motivet e egërsisë së armikut, të djallëzive dhe të ethes së shpikjeve shfarosëse, të tërbimit nga gjaku dhe të karrierizmit, të tmerrit të vdekjes, të servilizmit e të miklinit prej lajkave; të «mërzisë së luftës» dhe moskokëçarjes ndaj gjithçkaje; kriza morale dhe fryma e disfatizmit. Një lumë i turbullt prej rrëkesh të ndryshme që e bëjnë më të trazuar.

Pa u shtrirë më në hollësi, del qartë se si autori në gjithë atë mori ngjarjesh e karakteresh, siguron tërësinë, përmes episodesh tipike — vazhdimësinë dhe, duke e rrokur gjerësisht realitetin njerëzor, tregon prirjen e zhvillimit dhe kanalizon përmes saj tendenciozitetin ideologjik të veprës.

Me këtë sy le t'i kthehemi dhe një herë romanit «Dimri i madh», ku kanë «të drejtën e fjalës» grupe e kategori nga më të ndryshme të shoqërisë së sotme shqiptare.

Edhe në këtë vepër, krejt ndryshe nga i ashtuquajtura «polifonizëm» i letërsisë borgjeze e revizioniste, kryesore, që përbën boshtin ideoartistik dhe përcakton atmosferën e përgjithshme, është tema revolucionare e qëndresës dhe e sulmit të PPSH për demaskimin e revizionizmit, e përballimit heroik të bllokadës imperialisto-revizioniste, e masave për revolucionarizimin e jetës së vendit.

Për të theksuar veçanërisht idenë e mbështetjes të veprimtarisë së Partisë nga gjithë masat punonjëse të vendit, shkrimtari vendos si iso një kapitull, por tema kryesore, deri në njëfarë mase është detajuar dhe mbështetet në nëntema e motive që kanë funksion më veprues nga «isoja». Veprimtaria e udhëheqjes së Partisë, qëndresa në bazën ushtarake të Vlorës, aksioni popullor për zhdukjen e pasojave të përmbytjes, atmosfera mbytëse ndaj mbeturinave të reaksionit dhe prirjeve antisocialiste, masat e perspektivave revolucionarizuese e përparuese, kalitja në kudhrën e luftës së ashpër ideologjike e politike — janë disa nga nëntemat kryesore që mbështetin temën kryesore, mbartin e përforcojnë tendenciozitetin ideor të veprës, i nënshtrohen «stilit polifonik» të saj.

Në përmasa e forma të tjera, siç është vënë re, po ky stil është përdorur dhe në «Kronikë në gur», «Gjenerali i ushtrisë së vdekur» dhe «Nëntori i një kryeqyteti». Shkrimtari, duke ndjekur këtë rrugë, ka një koncept të vetin dhe për zgjidhjen artistike të konflikteve, ka kërkuar e ka përdorur në romane mundësi e mjete origjinale, larg stampave dhe skemave të njohura, në kundërshtim me çdo zgjidhje të rastit, me çdo shfaqje sentimentale, me çdo kthesë të menjëhershme të papërligjur, me çdo orvatje për të krijuar artificialisht përshtypjen e zgjidhjeve përfundimtare në çdo gjë e për çdo problem.

Në veprat e analizuara vëmë re se premiset dhe simptomat e zgjidhjeve artistike përmbahen që në parashtrimin dhe prirjen që i jepet temës e subjektit, në mënyrën e karakterizimit të heronjve e personazheve etj. Kjo mbështetet, doemos, nga parashtrimi, së pari, i rrethanave

historike, nga kontradiktat dhe forcat që ndeshen në terrenin e këtyre kontradiktave, nga aftësia për të mbajtur gjallë vëmendjen e lexuesve jo me anë ngjarjesh të papritura në jetën e marrëdhëniet e heronjve e të personazheve të veçanta ose me hamendje të tepruara, si p.sh. te «Kush e solli Doruntinën». Në veprat më të mira nuk pritet fundi për «zgjidhjen triumfale»; po çdo hap përpara, çdo kapitull, çdo pjesë e romaneve shpie drejt zgjidhjeve të ardhshme, zgjidh diçka dhe përgatit terrenin për zgjidhje më vendimtare. Disa herë, nga një paraqitje e tillë e realitetit, është vështirë të dallosh e të ndash parashtrimin nga zgjidhja, jo vetëm në vepra që ndërtohen mbi retrospektivë, po dhe në ato në të cilat shkrimtari ndjek e jep vijimin e ngjarjeve në rrjedhë të zakonshme.

Në «Gjenerali i ushtrisë së vdekur», për shembull, zgjidhja e konfliktit kryesor përmbahet jo në fund, po që të fillim të romanit. Ky është akordi zotëruar. Po, ndërkaq, në pjesët që flitet për të sotmen; shtrohen për zgjidhje edhe konflikte të dorës së dytë; siç është konflikti midis realitetit shqiptar dhe agresivitetit të shteteve që «mbledhësit e kockave» përfaqësojnë. Në konfliktin gjeneral-prift dhe në zgjidhjen skandaloze të tij pasqyrohet nervozizmi që u shkakton atyre turpi i disfatave, kurse ndonjë «çakordim» i gjeneralit ka të bëjë me anën individuale, kalimtare e jo me tipin politik që përfaqëson ai dhe prifti.

Në «Dimri i madh» shtrohen njëherësh probleme të shumta si shprehje e gjerësisë dhe shumanshmërisë së luftës së klasave në terren ndërkombëtar e kombëtar. Kjo mënyrë parashtrimi dhe zgjidhjet në vijueshmëri të konflikteve, karakteristike e stilit të autorit dhe e konceptit të tij dinamik mbi jetën shoqërore, bëjnë që dhe heronjtë të mos dalin lehtësisht si ngadhënjimtarë, po të luftojnë e të fitojnë përmes një tensioni e zotimi të pandërprerë.

Shkrimtari di të shënojë në kohën e në dozën e nevojshme ato hollësi dhe shfaqje fillestare të dukurive shoqërore, që shprehin ose fshehin shpërthimin e konflikteve dhe sinjalizojnë për zgjidhjet e tyre.



Ja fakti: Një korrespondent i AFF-së, endet, fillimisht në Shqipëri, pastaj në Moskë për të zbuluar të çarën në «botën komuniste». Sinjali është dhënë: Shqipëria ka blerë grurë në fermerë francezë. Shkrimtari, duke u kapur pas këtij reagenti, e udhëheq lexuesin drejt «së panjohurës» për t'i bërë të prekshme sesi shfaqet e afrohet kanosja, revizioniste dhe si do, të kundërveprojë pala shqiptare. Këtë mënyrë të zbulimit shkallë-shkallë të së vërtetës autori e përdor disa herë. Dikush ka parë ministrin e bujqësisë që ecte nëpër shi dhe ka dëgjuar diçka që përfliet për të. Më pas e takojmë të vejë i hakërryer në redaksinë e gazetës dhe të largohet i përcjellë nga fjalët e prera «... nuk keni të drejtë». Më në fund ai, tok me njeriun e Komisionit të Revizionimit, pret me ankth të shoqen që vjen e ndëshkuar nga mbledhja e Byrosë Politike.

Këtë mënyrë I. Kadareja e përdor edhe për zgjidhjen e disa konflikteve kryesore në vepra.

Ndërthurja e zgjidhjeve të njëkohshme, ballore me kompozicionin dhe strukturën e romanit ka të bëjë me «subjektet brenda subjektit», si pjesët «Mysafirë në kështjellë» dhe «Pasha Liman», lidhur me degëzime të konfliktit të përgjithshëm, e të shumanshëm.

Ka zgjidhje në kuadrin e së tërës, që shprehin rrugën që marrin «konfliktet e dorës së dytë», p.sh. shkëputja e Arbenit nga «kompania» e Rrugës së Dibrës dhe, më vonë, qëndrimi i vendosur në bazën e Vlorës. Në një kuadër të gjerë revolucionarizues zgjidhet edhe konflikti që lidhet me figurën e Besnik Strugës, zgjidhje që nuk do identifikuar me dramën e jetës së tij intime.

Ka edhe zgjidhje, që nuk janë arritur, po shprehin prirjen e zhvillimit dhe projektohen si perspektivë. Por romani nuk mbaron me ndonjë epilog nanuritës të konfliktit, as atij në arenën ndërkombëtare, as me mbeturinat e klasave të përmbysura dhe elementët e rinj antisocialistë. Shkrimtari nuk thërret «urra!», po i lë përshtypjen lexuesit se lufta vazhdon në të gjithë frontet dhe kërkohet qartësi, vendosmëri, vigjilencë, gatishmëri për të mbrojtur e çuar përpara veprën e socializmit. Ky është

përfundim me rëndësi, realist e mobilizues, revolucionar.

Zgjidhjet që kanë të bëjnë me fatin dhe rrugën e mëtejshme të personazheve përfshihen në zgjidhjen ose alternativën e përgjithshme dhe lidhen ngushtë me rrethanat dhe karakterin e rendit shoqëror. Personaliteti i njeriut, autoriteti i tij, pozita, cilësitë individuale përcaktohen nga përkatësia klasore, qëndrimi i tij ndaj rendit shoqëror dhe rolit që luan. Le të bëjmë me këtë pikësynim përqasjen e Tursun pashait të «Kështjella», Hurshid pashait të «Pashallëqet e mëdha» dhe Zheleznovit të «Dimri i madh». Dy të parët, që e dinë se do të flaken si «limonë të shtrydhur» prej vetë luftës politike brenda vëndit të cilit i kanë shërbyer, vrasin vetën (vetëvrasja, sipas tyre, është më e lehtë se satëri i xhelatit); Zheleznovi, që gjithashtu hedh zarin të rimëkëmbet, largohet duke turfulluar. Nëse Zheleznovi nuk vret veten, kjo ndodh se kësaj radhe del sheshit dështimi i shtetit që ai përfaqëson, i vetë revizionizmit hrushovian që ka mundësi ta përdorë në aventura të reja.

Me fundin e njëjtë të këtyre personazheve, protagonistë të dështuar, shkrimtari ka synuar të tregojë krizën e thellë dhe udhën pa krye në të cilën ka hyrë rendi shoqëror e shtetëror feudal, imperialist e revizionist, me të këqijat dhe anakronizmin e vet absurd. Asgjë të zmadhuar e të trilluar nuk ka në këto zgjidhje, përveç materializme në figura të individualizuara me forcë përgjithësuëse. Që nga lashtësia skllavopronare deri në rendin e sotëm imperialist e revizionist historia botërore, sidomos në periudha krizash të tyre, është mbushur me skandale, me vrasje dhe me vetëvrasje. Mund të bëhet një listë e gjatë emrash të personaliteteve politike, ushtarake etj., që janë zhdukur nga skeña e historisë si «shkaktarë» të disfatave dhe që pasardhësit kanë ndjekur prapë po atë rrugë.

Duket sikur Ismail Kadareja është skeptik, po në të vërtetë ai, në çdo situatë që krijon artistikisht, shtron pyetjen: Cili është problemi themelor që e shqetëson? Në prizmin e këtij shqetësimi ai i është drejtuar historisë dhe aktualitetit, para së gjithash, duke treguar forcën

dhe mundësitë e mëdha të popullit e të faktorit subjektiv, duke denoncuar ato forca që e kanë vënë njerëzimin para alternativash tragjike.

Dihet që gjithë letërsia dhe arti i sotëm botëror, e shtron këtë çështje nga pikënisje e nga qëllime të ndryshme, ndaj dhe zgjidhjet që i jepen janë të ndryshme e kontradiktore, deri në frymë pacifiste e disfatiste; përfytyrime katastrofash, bërthamore e kozmike; shtypje e tjetërsim nën peshën e përbindshme të mendit borgjez, të shtetit kapitalist, të aparatit të tij gjigant të shfrytëzimit e të dhunës; orvatje utopike e sentimentaliste, të pamundshme, për t'u hequr mënjanë me iluzionin e lumturisë vetjake mikroborgjeze. Krahas këtyre, siç dihet, në botë vegjeton dhe infekton edhe një letërsi e tërë konformiste që zbukuron rëndin kapitalist e revizionist, siç ekziston dhe një letërsi denoncuese realiste, që guxon t'i drejtohet realitetit të hidhur, po mbetet pa rrugëdalje, në kllapat e kontradiktave që pasqyrojnë ose ofrojnë rrugëdalje iluzore, sentimentaliste, zgjidhje të pavërteta historikisht. Ka dhe një krijimtari të përhapur mikroborgjeze, që predikon liberalizmin, filantropizmin dhe mëshirën, duke ngjallur dhembshuri për të mjerët dhe duke lëvduar virtytet e shërbëtorëve. Ndërsa letërsia që përshkruan revoltat e kryengritjet popullore, zakonisht, arrin në zgjidhje përgjithësisht tragjike, për vetë mësimet e përgjakshme që jep historia.

Ismail Kadareja e paraqet historinë e deritanishme në një sfond dramatik e tragjik, me kontradikta e konflikte të rënda. Jo më kot ai përmend shpesh personazhet dhe veprat e Shekspirit. Po në themel e në frymën e përgjithshme veprat janë optimiste dhe mobilizuese. Mbi dhembjen tragjike lartësohet zakonisht diçka e madhërishtme dhe sublime, që të frymëzon. Ky mund të jetë një eveniment a fakt historik, një herë, një ideal i madh që hedh rrënjë në trollin popullor, herë tjetër.

Në çdo roman është treguar në rrafsh kombëtar se vetëm qëndresa burrërore dhe bashkimi janë mjetet për të përballuar çdo rrebesh, për t'u ngritur mbi çdo dhembje, për të dalë fitimtar mbi çdo armik. Është vetë hi-

storia shqiptare e derdhur në vepra, që e përforcon këtë besim dhe ngjall optimizëm për të sotmen dhe për të ardhmen. Në horizontin plot re të së kaluarës autori ka parë e pasqyruar kryesisht forcat e përbindshme dhe viktimat e tyre, rrallë jep ndonjë revolucionar të vendosur (Anteos në «Muzgu i perëndive të stepës»), sepse shoqëria që bën objekt pasqyrimi është në krizë, rënie. Kurse në planin e brendshëm shoqëror e politik, krahas afirmimit të natyrshëm e pa bujë të realitetit të sotëm shqiptar, ai dëshiron të mbajë ngaherë të shtruar çështjen, e vigjilencës e të vazhimit me konsekuencë të luftës së klasave në favor të socializmit. Ndryshe: «po na zuri gjumi, revolucionin e socializmin i merr lumi».

Ky optimizëm atdhetar e revolucionar, që ndrit në «... qiellin e mbushur me re» dhe mbi karakterin dramatik-tragjik të epokës, është real. Ka një klasë e forcë shoqërore që e sheh jetën dhe të ardhmen me besim; ky është proletariati, kjo është klasa punëtore; imperializmit dhe socialimperializmit i kundërvihet forca e luftës çlirimtare të popujve; ka një ideologji revolucionare që frymëzon dhe udhëheq proletariatin dhe masat punonjëse; ka një vend në botë që përfaqëson të ardhmen e njerëzimit dhe ky vend është Shqipëria e pamposhtur socialiste. Këto të vërteta të njohura gjallërohen emocionalisht në romanet e I. Kadaresë dhe drejt përfundimesh të tilla lexuesin e çojnë materiali i zgjedhur, mendimi i mprehtë, filozofia e shëndoshë që përshkon përgjithësisht këto krijime. Sa i ka mishëruar shkrimtari këto të vërteta në figurat artistike? Diku i ka hedhur vetëm si mendime e diku i vend për të dëshiruar, sidomos për pasqyrimin më gjerë e më konkretisht të heroizmit të sotëm popullor dhe të aspiratës së popujve për luftë çlirimtare e për revolucion. E sugjeron vetë jeta këtë zgjerim e konkretizim më të plotë artistik, që do të shtonte vlerën njohëse e edukuese të krijimeve. Sepse, në disa prej romaneve është anuar nga pasqyrimi i detajuar i mjediseve kundërshtarë, ndaj dhe tipat e karakteret më të shumta në këto vepra janë bartëse të anëve negative politike shoqërore, edhe kur tema kryesore ose heroi tregim-

tar përbëjnë një fill të shëndoshë, që flet për qëndresën kombëtare e aspiratë revolucionare. Ky konstatim yni do parë lidhur me një problem më themelor ideoartistik: me raportet ndërmjet konceptimit artistik të realitetit në tërësinë e tij dhe shtrirjes epike të pasqyrimeve, të cilat lipset të zgjerohen pa dalë jashtë individualitetit krijues të shkrimtarit.

Si shembull mund të merret «Komisioni i festës» e nga veprat me temë aktuale, deri diku, «Muzgu i perëndive të stepës».

Në të parin ka një kundërvënie të fuqishme dy palësh kundërshtare: nga një anë kurthi e, nga ana tjetër, zhgënjimi tragjik. Kompozicioni i tregimit jepte mundësi edhe më tepër sesa hollësitë protokollare e kulinare të përgatitjeve për «festën» për një konkretizim e paraqitje më të gjallë të «të ftuarve». Mjete ndihmëse për këtë si: këmbimet e pamjeve, kthimet prapa, përsiatjet mbi dukuritë e njerëzit, autori di t'i përdorë me shkathtësi. Kështu që, në mënyrë edhe më ballore e të plotë egërsisë, djallëzisë, cinizmit dhe hipokrizisë osmane do t'i kundërvihet burrëria shqiptare përmes figurash e episodesh që do fuqizonin këtë kahje. Vetë struktura e tregimit lejonte një shtrirje më të gjerë epike të subjektit dhe, me gjithë fundin e përgjakshëm, për një ndriçim perspektiv të dramës historike kombëtare.

Në «Muzgu i perëndive të stepës» dy të huaj — shkrimtari shqiptar dhe greku me pseudonimin Anteos gjykojnë realitetin sovjetik të fillimit të viteve '60. Është koha kur metastazat e kancerit hrushovian kanë lëshuar rrënjë në të gjitha sferat e jetës së Bashkimit Sovjetik, gjë që reflektohet dhe në atmosferën letrare. Denoncimi i këtij realiteti është kategorik. Ndonëse romani përqendrohet në paraqitjen e rretheve letrare dhe të marrëdhënieve intime të rrëfyesit, në mënyrën si është konceptuar jep mundësi për një pasqyrim disi më të gjerë të realitetit, të së kaluarës revolucionare, të prologut të asaj tragjédie, të notave të protestës, deri diku, të një aspirimi për perspektivën e largët e të vështirë, për mbajtjen gjallë

të idealit revolucionar në elementë të shëndoshë. Ky roman, më tepër se çdo vepër tjetër, ka tehua e polemikës letrare që autori nuk ka nguruar ta përfshijë thuasë në çdo temë që ka trajtuar. Por, ndërsa ndaj konformizmit dhe sterilitetit të shkrimtarëve të rëndomtë polemika është therëse, ajo ndaj përfaqësuesve të izmave në zë mbetet evazive, sikurse dhe pohimi për vlerat e traditës së mëparshme revolucionare.

Mundësi për shtrirje epike afirmuese të autorit ka pothuajse në të gjitha romanet, pavarësisht nga koha që përshkruajnë, mbasi në çdo kohë kuadri historik jep material për figura të gjalla, bartëse të prirjes përparimtare të zhvillimit. Një evidentim më i dukshëm i elementit pozitiv, në rastet e përmendura e gjetkë ka të bëjë me përforcimin e mëtejshëm të asaj analize, paraqitje dhe fryme realiste që karakterizon në përgjithësi krijimtarinë letrare të autorit.

Nuk janë të rralla rastet kur në romanet lexuesi ndesh anormalitete njerëzore dhe gjendje jonormale, veprime e përjetime personazhesh më tipare psikopatologjike. Disa herë preokupimi i shkrimtarit për kësi tipash e ngjarjesh ka të bëjë me dhënien e atmosferës, me fizionominë e kohës e të personazheve, me tendencën ideoartistike. Kështu, për shembull, në «Muzgu i perëndive të stëpës» merret gjatë, deri në hollësi natyraliste, me skenën e «dehjes së përgjithshme», me përçartjet, me rrahjet, me deliret e atyre që do të përfaqësonin letërsinë sovjetike pas fillimit të viteve '60. Sado që në roman janë pasqyruar «shkumëzimet» dhe jo aq rrjedha e brendshme që është në bazën shoqërore e në rendin politik, vepra ka frymë denoncuese dhe, në këtë kuadër, skena e dehjes së përgjithshme është shprehje e çoroditjes ideologjike, politike e morale dhe e zhgënjimeve të intelektualëve sovjetikë, rënim i fasadës, zbulim i bufonadës e i demagogjisë. Kurse vetëvraska e Fadajevit shënon fundin e gjithçkaje të mirë, të pastër e revolucionare, fillimin e periudhës kur pluskojnë lirisht e kërkojnë të përfitojnë «dënosçikët» «hallturët», dramaturgët sterilë dhe snobët. Vetëm

tërthoraz, thujse në nëntekst, në roman pohohet se zotërimi i të tilla dukurive është pasojë e mungesës së një gjendjeje revolucionare. Vetë heroi i romanit, del i hutuar prej ngjarjeve dhe ndesh kryesisht me shfaqje të monstruoze të gjendjes, jo në konfliktin revolucion-kundërrevolucion, sa në kapërthimet brenda rrymës revizioniste.

Ose Abdullahi në romanin «Pashallëqet e mëdha», ruajtësi i «kamares së turpit». Ndonëse i papërligjur shoqërisht, Abdullahi është figurë që plotëson kuadrin e dhunës me përkotësinë, frikën mos humbasë vendin e punës, paafësinë për të depërtuar në mistëriozitetin e «perandorisë së madhe», ndjenjën e impotencës, kotësisë e të përlulisë së përvuajtur, deri tek deliri i mohimit të vetes. Gjaksorë, karrieristë të tërbuar, viktimë, po dhe krimba pjell një rend shoqëror në degjenerim. Me gjithë frymën mazohohiste të trajtimit në paraqitjen e Abdullahit, kjo ndodh se, sikurse ushtari që ëndërron për tokë në romanin «Kështjella» dhe trishtimi i vajzave të haremit të Tursun pashait, ai shpreh diçka që ka të bëjë me dramën e madhe të vetë vegjëlisë turke, të shtypur nga rendi feudal ushtarak-despotik.

Edhe në romanin «Kronikë në gur» rastet e anormaliteteve e të gjendjeve psikopatologjike janë përfshirë, si domos në ndonjë rast, si mjete denoncuese (Maksuti) ose për të dhënë «klimën» e thashethemeve e të paragjytimeve në jetën e mbyllur provinciale. Në raste të tjera interesimi i shkrimtarit për anormalitete dhe gjendje të pavetëdijshme lë përshtypjen e një dëshire jo të shëndoshë, edhe sepse ato çka thuhet e përfytyrohen në këto çaste mbetën pezull dhe pa kundërvënie të qarta. (I çmenduri në «Ura me tri harqe», përfytyrimi i kllapishëm i urbanistit dhe i çmenduri i Borovës në «Dimri i madh», disa pohime të të dehurve në «Muzgu i perëndive të stepës»). Teprimet bien më shumë në sy kur absurditeti dhe anormaliteti bëhen faktorë ndikues në rrugën që marrin ngjarjet e në fatin e heronjve të veprës. Në kësi rastesh, pa përjashtuar dhe shembujt që përmendëm,

ka në romane një prirje për t'u marrë me tipa e gjendje psikopatologjike vetëm për të krijuar efekte, gjë që është në dëm të brendisë ideore dhe të qëndrimit humanitar.

Në romanin «Prilli i thyer», kur përshkruhet skena e pajtimit (e faljes së gjakut) dhe po arrihet mirëkuptimi «... një xhaxha plak u bë shkak që të prishej gjithçka... Xhaxhai plak i Gjorgut thirri befas: jo. Ishte një plak i qetë, që s'ishte ndier kurrë në fisin e tyre dhe prej tij më pak se prej kujtdo pritej një gjë e tillë.. Atëherë prifti, që ndodhej atje, si ndërmjetësi kryesor i pajtimit, bëri një shenjë me dorë. «Atëherë gjaku vazhdon» — thërrasi» (f. 217-218). Ky çast absurditeti i një xhaxhai bëhet shkak i akteve të reja të tragjedisë së gjakmarrjes, prandaj do të kërkonte përligje më të fortë, po të duam të mos biem në pozitat e Besian Vorpsit, i cili — shartim i idilistëve të dikurshëm me ekzistencialistët, pohon se «... vdekja e natyrshme prej sëmundjeve apo pleqërisë ishte e turpshme për njeriun e bjeshkës dhe, më në fund, për synimet e malësorit në jetë, i cili nuk ka qëllim tjetër veçse të grumbullojë aq nder në jetë, saqë t'i mjaftojë si kapital për t'i ngritur një monument pas vdekjes» (f. 238), — pra, e ka në gjak edhe gjakmarrjen, gjersa «... kërkesa për pajtim të gjakut, aq e rrallë në malësi, bëri bujë në katund, madje edhe në flamur» (f. 217). Pra, një përfundim e tipizim jo aq realist.

## VII

Kur shqyrtohen veprat e një prozatori e dramaturgu, është e pamundur të mos flitet për heronjtë dhe personazhet e këtyre veprave. Në prozë, siç dihet, përmes tipave dhe karaktereve arrihen në masë shumë të ndijshme pasqyrimi i realitetit, përthyerja e rrethanave dhe e mjediseve në vetëdijën e njerëzve, veprimet dhe idealet e tyre.

Deri tani, përkrah problemeve të tjera të krijimtarisë së autorit, kemi folur edhe për personazhet, tipat e karakteret si shprehës të ideve dhe mishërime artistike



të realitetit. Shikimi i personazheve në tërësinë e përmbajtjes e të fizionomisë së veprave është njëra anë e çështjes. Ana tjetër me rëndësi ideo-artistike është koncepti i shkrimtarit për heronjtë, rruga që ndjek dhe mjetet që përdor për portretizimin e tyre. Edhe në këtë drejtim romanet e Ismail Kadarese ngjallin shumë interes, dallohen për origjinalitet; figurat që krijon ai janë pasurim i ndijshëm i traditës së re të prozës sonë të sotme. Ai është portretizues i talentuar figurash njerëzore në tablo të gjera e sinteza të fuqishme artistike. Por në do të ndalemi në tiparet më përfaqësuese të konceptit dhe mjeshtërisë së tij si portretist.

U konstatua që romanet e Ismail Kadarese, cilat do qofshin temat e përmasat e tyre, i kushtohen çështjeve jetike e historike të popullit e të kombit shqiptar në caste kyçe, që kanë vlerën e shembullit e të mësimit më tingëllim aktual. Edhe në shestimin e përgjithshëm e në frymën që i përshkon, veprat më të mira hero kryesor, hero të gjithpushteshëm, kanë popullin, ndonëse ka edhe ndonjë rast të diskutueshëm.

Nisur nga ky këndvështrim, kuptohet se në themel të veprave janë rrethanat dhe kolizionet e mëdha historike që zgjojnë e tronditin popujt, vënë në lëvizje kombin, shkaktojnë ndeshje e ballafaqime me përmasa ndërshtetërore, hedhin në luftë klasat. Në këtë kuadër autori vendos «shtatorët» e heronjve dhe «bustet» e personazheve, tregon rolin dhe vendin që ata zënë, pozicionin që marrin, kuotën e këndin nga e shikojnë realitetin, vizaton karakteret. Autori ka ndjekur zakonisht rrugën nga realiteti të heroi e personazhi dhe jo të anasjelltën.

Karakteristikë e përgjithshme e shkrimtarit është që në «subjekte të hapura» e në «kompozime të gjera» të krijojë më tepër figura në rrethana e situata të caktuara e jo tipa e karaktere brenda hullive të një problematike të veçantë. Kjo nuk ka shpënë në konvencionalizim dhe, aq më pak, në uniformitetet e në stampa të paracaktuara. Edhe në portretizimin e tipave e të karaktereve shkrimtari i përmbahet një metode realiste. Sipas realitetit të

pasqyruar, problematikës që e ka interesuar, shtrirjes së ngjarjeve në kohë e në hapësirë, ai ka zgjedhur mënyrën e pikturimit të tyre, që i ka dhënë më tepër mundësi për arritjen e pikësnyimeve ideoartistike në secilën vepër ose duke ndërthurur disa mënyra brenda një vepre.

«Liri veprimi» dhe konvencionalizim ideoartistik autori ka synuar kryesisht në paraqitjen dhe përshkrimin e rrethanave e të mjediseve. Ai përqendrohet në idetë që do të përçojë, në zbulimin e konflikteve të thella e të mprehta, në rilëvimin e figurave tipike, në vërtetësinë e problematikës e të thelbit të dukurive së sa në përkrimin e riprodhimin e imtësive dokumentare apo etnografike. Mjediset dhe rrethanat konkrete i «përshtaten» qëllimit dhe brendisë ideore të romaneve, pa e shtrembëruar të vërtetën në thelb. Kjo rrugë që të kujton Shekspirin, është ndjekur jo vetëm në romane me temë nga lashtësia, po dhe në ato që i kushtohen Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe realitetit të sotëm.\*). Dihet, për shembull, që kështjella e Ali Pashës ndodhet në Janinë, qytet i zhvilluar aso kohë, buzë gjolit të bukur me të njëjtin emër. Në romanin «Pashallëqet e mëdha» nuk ka asgjë nga këto. Rreth e rrotull kështjellës shtrihet një shkretëtirë, e kallkanosur ku ngrihet vetmitare figura e Aliut — «gjëmimit që gjëmon» — dhe enden trupat e Hurshid pashait etj. Njihen mirë çastet e fundit të Aliut, por edhe në këtë rast, autori rreh më tepër të zbulojë kuptimin e asaj që ndodh, sesa ta riprodhojë me saktësi ngjarjen. Shkrimtari i ka dhënë liri vetes të krijojë një skenë rrëqethëse si «variant shprehës artistik» të asaj që ka ndodhur historikisht ndryshe.

\*) Në këtë krahasim që «çalon» si çdo krahasim, bëjmë si domos dy dallime: së pari, Shekspiri në një pjesë të mirë të veprave trajton subjekte që s'kanë të bëjnë me Anglinë, kurse Kadareja të gjitha veprat ia kushton Shqipërisë; së dyti, lexuesi i sotëm ka shumë më tepër njohuri për historinë dhe ligjësinë e zhvillimit nga ç'kishte ai i kohës së Shekspirin, gjë që s'mund të mos mbahet parasysh nga shkrimtarët e kohës tonë.

Edhe në romanin «Nëntori i një kryeqyteti» Tirana jepet me frymëmarrje disi të ndryshme e me disa hollësi që nuk përputhen me gjendjen e saj në atë kohë. Duke lexuar romanin, vërejmë se kemi më tepër atmosferën e «një kryeqyteti» se sa Tiranën e atëhershme, në të cilën, për shembull, endja e Adrian Gumës në një natë luftimesh do të kishte qenë e pamundur.

Duke vepruar me elemente e prirje konvencionalizuese përgjithësuese, shkrimtari ka krijuar tipa e karaktere realiste të potente dhe të papërsëritshme. Ndodh gjithashtu që një hollësi e spikatur dhe e përdorur me mjeshtëri, merr vlerë sa nuk kanë dhjetëra faqe përshkrimesh prozaike të hollësishme të rrethanave e të mjedisit. Lexuesit p.sh. i «ngulet gozhdë» në mendje këmisha e përgjakur e të vrarit, e cila mbahet e yarur gjersa ti jetë marrë gjaku viktimit. Kjo është majaja, detaji më domethënës i mjedisit dhe i veprimit të pritshëm.

Sado që më tepër logjike se konkrete historike, kjo mënyrë paraqitjeje e mjedisve dhe e rrethanave bën që dhe tipat e karakteret në veprat e Kadaresë të kenë vërtetësi dhe shprehësi në thelbin e fizionomisë së përgjithshme.

Ata janë heronj tregimtarë, dëshmitarë dhe pjesëmarrës në ngjarjet e historisë, yeshur disa herë edhe me elementë simbolikë. Kështu portretizohen Kështjellari («Kështjella»), Shkrimtari («Muzgu i perëndive të stepës»), djaloshi pa emër («Kronikë në gur»). Në fytyrën e tyre reflektohen përflakjet e historisë, dritëhijet e ngjarjeve që kanë të bëjnë me fatet e vendit e të popullit, ndaj edhe përcaktojnë fizionominë, fatin, mendimet dhe gjendjet shpirtërore të individëve, kalitin karakteret prej atdhetari e revolucionari shqiptar. Këndi i shikimit dhe mënyra si i paraqesin ata rrethanat, gjendjet e ngjarjet bëhet kështu mjet vetëzbulimi. Në rrëfimin e tyre ndihet mirë prirja dhe ideali që përfaqësojnë. Duke synuar të paraqesë përmes tyre tablo përmbledhëse të epokave e të periudhave historike, autori gjen rast të afrohet edhe në intimitetin, përjetimet dhe gjykimet

e heronjve. Rrëfimet janë niëherësh dhe «tablo të gjera tematike» (me gjuhën e piktorëve) dhe autoportrete. Së loku këta «heronj tregimtarë» dëshmojnë sesi nëpër dallgët e historisë shqiptarë është formuar karakteri kombëtar, konstitucioni shpirtëror i shqiptarit, i konkretizuar me veçanësitë e dallueshme në tipat artistikë e karakteret shoqërore e njerëzore. Vazhdimësia historike është mishëruar në vazhdimësinë e brezave me idealet që evoluojnë historikisht që nga lindia e vetëditës së kombësisë. («Ura me tri harqe» dhe «Kush e solli Doruntinën») deri te heronitë komunistë në veprat kushtuar Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe realitetit të sotëm.

Edhe mietet stilistike ndryshojnë sipas qëllimit epokës. Tipit: Kështieitari, siç nënvizuar, simbol i qëndresës, atdhedashurisë dhe epërsisë morale të popullit në mbrojtjen e lirisë. Ai portretizohet në stil monumental. Gjon Ukcama, tipi i murgut kronikan mesjetar, që parandien ngjizjen fillestare të një ideali të ri, vizatohet me shumë hollësi e me ndonjë frazë që i kujton lexuesit fillimin e «Mesharit» të Gjon Buzukut. Për shkak të sistemit shoqëror feudal dhe të pozitës që zë në të, Gjoni nuk mund të jetë vecse kronikan. Janë princat «krvezotë» që bëjnë ligjin, e kjo ndihet mirë në roman. Por, si murg, ai ka armën e kulturës së kohës, që i jep mundësi të jetë i pranishëm në ngjarje të ndryshme, t'i përshkruajë ato dhe të shprehë ndieniat e veta. Ai ka mundësi të shikojë më larg, të spikatë simptomat e para të rreziqeve, të ndiejë thellë tragjedinë e copëtimit feudal të vendit të kanosur nga synimet imperialiste. Pa pasur mundësi e armë tjetër, ai qetëson ndërgjegjen e vet duke hedhur në letër «të vërtetën», që kjo t'u shërbejë bashkëkohësve e pasardhësve.

Në «Kronikë në gur» heroi tregimtar rrëfen për kohën e rrethanat në të cilat i kalon fëmijëria dhe mbetet, sidoqoftë, jashtë ngjarjeve më të rëndësishme. Për këto ngjarje ai as ka mundësi, as është në gjendje të informohet siç duhet dhe shpesh i shikon dhe i komenton me naivitetin e një fëmije kureshtar e me fantazi të zhvi-

lluar, nisur kryesisht nga dukja e fenomeneve, nxitur nga fragmente bisedash, të tërriturve. Duke jetuar moshën e vet, ai merr drejtim në jetë, formohet, bëhet tendencioz, rritet duke fituar dalëngadalë vetëdijë të vërtetë. Nuk kemi të bëjmë me një rrëfyes të thjeshtë, tek i cili vetëm sa reflektohen ngjarjet, por edhe me pasqyrimin përmes tij të periudhës së fillimeve të Lëvizjes Antifashiste dhe formimin në këto kushte të një tipi të ri shoqëror, të një karakteri. «Heroi tregimtar» i romanit «Kronikë në gur» është autoportretizuar deri në hollësi me ngjyra tërheqëse, me nota realiste e romantike, në formim e sipër, përmes ndikimit të mjedisve e gjendjeve më të ndryshme e kontradiktore, që lënë gjurmë në përcaktimin e personalitetit të tij.

Në këtë plan, dhe pothuajse nga i njëjti këndshikim, është portretizuar edhe shkrimtari në «Muzgu i perëndive të stepës». Ai nuk është dëshmitar i thjeshtë, po dhe një ndërgjegje që reflekton, gjykatës i rreptë, një njeri që, duke jetuar në gjendjet e një kthesë historike kundërrivolucionare, shndërrohet dhe në vetvete, çlirohet prej iluzioneve, fiton kthjelltësinë e gjykimit revolucionar.

Në periudhën e hovit të parë të këtij llumi antikomunist, jo dokudo po në atdheun e parë të punëtorëve e të fshatarëve, heroi i romanit, një ndër ata miliona që kanë ëndërruar të shkonin në Bashkimin Sovjetik, ndodhët aty dhe ndien shijën e hidhur të deziluzionit. Në këtë deziluzion nuk ka as shenjën më të vogël të «rishqyrtimit» revizionist të historisë e të idealit socialist me cinizmin kundërrivolucionar të Ehreburgut, të pesimizmit çoroditës antikomunist të Aragonit, të gagarelizmit të Jevtushenkos apo të agresivitetit regresiv të Solzhenicinit. Ky është deziluzioni i një të riu me formim e aspirata komuniste, disi dhe naiv në përfytyrimet e veta. Këtë quajnë socializëm, ky qenka një vend që po ndërton komunizmin? Këta shkrimtarë të paparim e pakarakter, të shkëputur nga jeta e nga populli, skilevër, skemash e stampash mediokër, ambiciozë e intrigantë qenkan ata që përfaqësokan «letërsinë më përparimtare e më të

Ideshme në botë? Jo. Idealët socialistë të heroit të romanit dhe dashuria e tij e pastër për atdheun e Leninit e të Stalinit nuk kanë të bëjnë me këtë realitet të hidhur. Ai shikon se ç'ndodh dhe s'është në gjendje të kuptojë ç'po ndodh më në thellësi, ç'përpjesëtime po merr sëmundja e lahtarshme e degjenerimit. Ky njeri, që vjen nga realiteti shqiptar socialist, bie në deziluzion, por edhe ndihet i lidhur më fort me atdheun e vet. Dhe përballë shqetësimit se mos vallë kaq e shëmtuar dhe e përbuzshme mund të jetë dhe e ardhmja e tij, kundër kthesës kundërrevolucionare është vënë Shqipëria dhe Partia e Punës e Shqipërisë; janë revolucionarët e vërtetë si Anteosi, që rijetojnë tragjedinë e popujve të tyre. Kjo është forca, kjo është kundërvënia reale, ky është besimi në komunizmin. Heroi tregimtar i romanit bëhet dëshmitar dhe denoncues i kthesës revizioniste, në momentet kur vetë po formohet si revolucionar përballë një realiteti të tjetërsuar dhe drame me përmasa botërore.

Vetvetiu tek lexuesi krijohet një lidhje, logjike e historike, ndërmjet Shkrimtarit dhe djaloshit të «Kronikës në gur», Besnikut dhe Skënder Bermemës të «Dimrit të madh»: në ndeshje me imperialistët e revizionistët jeton e përparon Shqipëria socialiste, formohen e kaliten revolucionarët e komunistët shqiptarë.

Ca më ndryshe është konceptuar Stresi në romanin «Kush e sollti Doruntinën»: heton ngjarjet dhe bëhet shtyllë e kompozicionit, ndërlidh të kaluarën me kohën e dhënë, ka marrdhënie me shumë personazhe. Duke hetuar e gjykuar për ngjarjen, (kthimin e Doruntinës), ai vetë bëhet i thfar, i idealit të ri kombëtar dhe i konstitucionit të besës shqiptare, që u kundërvihet pabesive. Ky moment, edhe pse i papërligjgur plotësisht, e shton rëndësinë e kësaj figure dhe e lartëson atë në shtë e lexuesve.

Në «Nëntori i një kryeqyteti» dhe «Dimri i madh» kemi të bëjmë me heronj të mirëfilltë veprues. Në të vërtetë, edhe gjithë heronjtë e përmendur deri tani, pavarësisht nga mënyra dhe mjetet e mishërimit artistik, janë dhënë si tipa ose, si karaktere të plotë, disa herë dhe me hollësi tepër të imta të jetës e të fizionomisë së tyre.

Por, ndërsa portreti i tyre në shumë raste duhet të rilevohet në përfytyrimin e lexuesit, duke i shkëputur e veçuar ata prej sfondit, ngjarjeve, në «Nëntori i një kryeqyteti» dhe në «Dimri i madh» heronjtë dalin në rrafsh të parë si protagonistë dhe ngjarjet jepen në një masë të ndijshme në praninë e përmes veprimit të këtyre heronjve. Është e pamundur në «Nëntori i një kryeqyteti» të përfytyroheshin ngjarjet pa mbajtur parasysh Dino Sinoimerin, Sherif Gorenin, Mete Aliun dhe Teutën. Këtu e paq më tepër në «Dimri i madh» shkrimtari, duke i hedhur personazhet në veprim i shmanget çdo simptome mbinjerëzore në karakterizimin e tyre, ruan raporte realiste ndërmjet sfondit historik dhe karaktereve, nënvizon idenë e përcaktueshmërisë së bëmave, të tyre nga ligjësitë e zhvillimit, pa nënvleftësuar vullnetin e individëve. Duke pasur vend më të gjerë veprimit, personazhet kanë dalë të prekshëm, më konkretë, më të lidhur me shtresën shoqërore, me krahinën, më të dallueshëm ndërmjet tyre, me më shumë veçori individuale. Idetë e shkrimtarit rrjedhin vetvetiu përmes botës së tyre dhe ata nuk mbeten mishërime racionale të këtyre ideve. Edhe mjetet artistike, që nga përshkrimet epike, çastet lirike dhe elementet humoristike i bëjnë heronjtë më të afërt me lexuesin, pa harruar edhe afinitetin e lexuesve me këtë traditë të njohur artistike.

Në përshtatje me synimin «polifonik» Ismail Kadareja krijon «ansamble» personazhesh, ku secili ka zërin dhe fytyrën e vet, e së bashku, të grupuar, apo të kundërt pasqyrojnë të vërtetën e kohës. Brenda për brenda këtyre «ansambleve», ka viza të përbashkëta e koherencë edhe në vetë stilin e autorit. Në grupin e karaktereve pozitive spikat qartë kompaktësia e tij mbi bazën e bindjeve e të qëndrimeve. Në rast të kundërt, vetë realiteti dhe ndikimi shoqëror vepron si forcë shpërbërëse, siç ndodh me shoqërinë e «Rrugës së Dibrës» në romanin «Dimri i madh». Ndiqni me vëmendje si formohet me kohë «kori popullor» aq i gjerë e i nuancuar në romanin «Kronikë në gur», si kalojnë në rrafsh të dytë e të tretë dhe thuhajse harrohen thashethemet, përgojimet, magjitë,

mallkimi i dashurisë-etj., dhe si, edhe mbi hallet e jetës së përditshme, idetë e «komunikatave» e të luftës hyjnë aeri te plakat e rregjuara. Me mjaft interes, për këtë është skena kur zonja Majnur, gjatë polarizimit të forcave, për-  
pjet, te shpifë kundër Luftës Nacionalçlirimtare dhe, ko-  
munistëve. Ajo, ndryshe nga ç'mund ta pandehë, ndesh  
ne kompaktësinë e heshtur e të vendosur të grave të po-  
punit.

«—Si jini, moj gra, ç'bëni? Thashë të kthehem një here. Që nga bombardimet s'ju kam parë.

— Urdhëro, zonja Majnur, mirëse ne erdhe! — tha nëna (...)

— Thonë se andej nëpër male, djemtë e vajzat bëjnë dashuri, — tha zonja Majnur. — Prite, kur të na vijë me kalamaç në duar.

Nëna u pre në fytyrë. Fytyra e zonjës Majnur u bë e egër. Një dhëmb i florinjte në anën e djathtë të gojës sikur buzëqeshte për të gjithë.

— Po tani do t'i kapin të gjithë me radhë, — vazhdoi ajo. — S'kanë ku venë. Kanë mbetur pa ngrënë e pa veshur. Në mes të dimrit dhe të ujërve. Pastaj thonë se shumë prej tyre mezi lëvizin, se helbete... shtatzëna(...)

U bë një heshtje e rëndë.

— Fole hidhur, — tha gjyshja.

Sytë prej xhami të zonjës Majnur u përpoqën të buzëqeshnin, po në këtë kohë gruaja e Bido Sherifit u ngrit me zhurmë nga minderi.

— Shtrigë, — tha ajo dhe iku në dhomën tjetër, atje kishte nëna.

— Kiameti, — ia bëri Kako Pinua, — pa iu drejtuar njeriu.

Zonja Majnur u ngrit e zemëruar. Gjyshja nuk lëvizi nga vendi» (f. 183-184).

Ky episod i thjeshtë dëshmon se «çarja» ka ndodhur në themelet e shoqërisë dhe i ka ndarë preraz njerëzit në dy grupime të mëdha kundërshtarë pa asnjë iluzion e mundësi zbutjeje të kontradiktave. Se si grupohet dhe orvatet të ngrejë «ansamblin» e vet kategoria shoqërore e të deklasuarve është përshkruar bukur në rropatjet e



Mukadesit («Nëntori i një kryeqyteti») dhe me përpjekjet për t'u lidhur me «të përmbysurit» në shtëpinë e Kryekurtëve («Dimri i madh»).

Në vepra të tjera këto «ansamble» jepen të formuara që në fillim. Rikujtojmë grupin e partizanëve («Nëntori i një kryeqyteti») dhe tipat e karakteret e pushtuesve osmanë («Kështjella»). Kjo mënyrë konceptimi dhe pasqyrimi e tipave dhe individualiteteve njerëzore, me ndonjë shenjë prirjeje për sajim të ashtuquajturish «personazhe ide» apo «personazhe simbole», si në rastet që u përmendën, është përgjithësisht realiste. Meritë e shkrimtarit është se vë përballë forca të kundërta shoqërore e politike dhe jo individë të veçantë. «Gjendjeve individuale», kolizioneve dhe konflikteve personale u kushtohet vëmendje vetëm kur ato përfaqësojnë probleme me rëndësi shoqërore. Të tilla janë kolizionet dhe konfliktet në veprat më të mira letrare, të tillë janë heronjtë dhe personazhet e vërtetë artistikë. Në këtë drejtim në romanet e Ismail Kadaresë ka diçka të veçantë, origjinale.

Duke nxjerrë në plan të parë kolizionet historike, kombëtare e klasore, është e natyrshme, që në qendër të veprave të vihen protagonistë e antagonistë, përfaqësuesit e forcave kryesore. Pra, është e domosdoshme që «ndeshjet» ndërmjet këtyre përfaqësuesve të shkaktohen jo nga motive vetjake, po lidhur me probleme me rëndësi të përgjithshme dhe ata të vihen përballë alternativash dhe imperativash historikisht reale. Veçoria e Ismail Kadaresë është se, duke i konceptuar e thurur veprat mbi të tilla themele, zakonisht, në drejtimet dhe linjat kryesore të romanit, në të shumtën e herës nuk vë ndeshje në mes protagonistësh e antagonistësh e më të rrallë përdor ballafaqimet ndërmjet tyre. Megjithëkëtë, veprat kanë ngarkesë dramatike të madhe. Shembujt e sjellë flasin për mjeshtërinë me të cilën Kadareja realizon lidhjen në mes problemeve të mëdha dhe çështjeve vetjake, duke ruajtur e theksuar synimin kryesor ideoartistik gjatë shtjellimit të lëndës dhe idesë bazë.

Konfliktet dhe ndeshjet vetjake në asnjë prej romane-

ve nuk vihen në themel të subjektit. Kadareja vepron disi ndryshe nga mënyra e njohur e mishërimit të së përgjithshmes përmes tipave e bëmave të personazheve e të heronjve të veçantë. Ai parashtron rrethanat e përgjithshme e konfliktet e mëdha dhe, në kuadrin e tyre, integron heronjtë dhe personazhet, thekson fizionominë e tyre, i bën të veprojnë, të shfaqin historinë e jetës së tyre. Pra, nisët nga e përgjithshmja që të tregojë individualen, konkretën, të veçantën, në një mori shfaqjesh, pa mbingarkuar personazhet. Nëpër këtë rrugë janë krijuar vepra të shquara në një sintezë interesante të përmasave epike të veprimit me përjetimet intelektuale të personazheve. Vetëm në «Dimri i madh» linja e jetës së njeriut prej heronjve (Besnik Strugës) përshkon gjithë romanin, duke iu nënshtruar konfliktit kryesor dhe gjithashtu vetëm, në «Prilli i thyer» problematika e madhe shoqërore njësohet me fatin dramatik të heroit (Gjorg Ukcames). Po dhe në këto raste, si dhe te «Lëkura e dautës», linja vetjake nuk përbën një fill të pandërprerë. Shpesh shkrimtari gjen rast ta ndërthurë atë me episode të tjera, që të lënë me përshtypjen e një hapësire të madhe jete shoqërore.

Megjithëkëtë, lexuesi arrin kurdoherë te njeriu konkret, disa herë dhe në intimitetet e tij. I kursyer në përshkrime, autori, nga një anë ruan theksin kryesor të veprave e, nga ana tjetër, u njeh personazheve të drejtën e vetëzbulimit; në pasazhe fare të shkurtra na jep skena e çaste mjaft shprehëse, që nuk cenohen nga bisedat e gjata, përshkrimet dhe teprimet në të ashtuquajturat «analiza sentimentale». Me pak fjalë por me situata plot forcë shprehëse i jepet mundësi lexuesit të përfytyrojë tablo të plota e të qarta.

Të kujtojmë me gëmjete jepet Sherif Gorenit në episodin e marrjes së Radiostacionit. Për portretizimin e tij përdoren që nga përshkrimi i veprimeve luftarake deri te digresionet e kujtimet, përthyerjet përsëritëse, episodet konkrete dhe dialogu me personazhe të tjera në lidhje me luftën, me jetën, me vetveten. Në krahasimin e figurshëm të bunkerit gjerman me Tosum aganë ulok, «...

që i urdhëronte dhe i turturonte të gjithë, duke tundur vazhdimisht me kërcënim një shkop...» (f. 13). shprehen në thelb motivet e rëndësishme që e kanë hedhur Sherifin në luftë. Ai bëhet i afërt, i preکشëm dhe i dashur në thjeshtësinë e çiltër, në trimërinë pa bujë, në ashpërsinë e sedrën, por dhe në shpirtbütësinë e fshatarit, në gatishmërinë për të përballuar çdo vuajtje e për të kryer çdo sakrificë. Ai hidhet nga shakatë e Javerit në sulm; kalon duke mbartur mbi shpinë Teutën e plagosur, apo tek fle përkrafi saj me atë ndjenjën e bukur të ndërshtmërisë popullore e vetëpërmbajtjen e fortë të luftëtarit; e ndëshim tek zbaton dhunën revolucionare, tanimë si përfaqësues i shtetit të ri të diktaturës së proletariatit:

«Dora e majtë e Sherifit mbëriheu njëren dorë të tij, kurse me tjetrën ai nxori prangat.

Gjatë më pak se gjysmë minute që vazhdoi prangimi i duarve, Sherifit iu mbush balli me pika të vogla djerse» (f. 137-138).

Me këto «pika të vogla djerse» fillon një kthesë e ngritje në shpirtin e Sherif Gorenit e në historinë e veçgjëlisë, të popullit, që për herë të parë merr realisht në duar pushtetin.

Duke na çuar të njëri konkret, shkrimtari na jep mundësinë të njihemi me mendimet e personazheve, me gjendjet shpirtërore të tyre, me formimin psikologjik e shoqëror dhe të veçantën e bën të papërsëritshme. Sherif Gorenit nuk ka të bëjë personalisht me njëriun të cilit i hedh prangat, por shkrimtari na bind se në ndeshjen e madhe klasore ata vihen kundër njëri-tjetrit dhe patjetër përplasen, mbeten armiq të papajtueshëm. Vetëm në rastë të rralla ndeshjet kanë të bëjnë me ndonjë fill episodik të subjektit të romaneve të autorit. Peripecitë tragjike përmes të cilave kalojnë bartësit e idealit që po ngjizet e ngadhënjën në epokën e ndritur të Rilindjes Kombëtare, i mishëron i burgosuri i Ali Pashës. Ndeshja ndërmjet pashait të plotfuqishëm dhe të pranguarit është shprehje e materializuar e luftës për pushtet dhe idealit kombëtar popullor. I burgosuri «krejt i shtypur pas murit, ngjante si basoreliev», por në polemikën

midis tij dhe Aliut nënvizohet fizionomia dhe personaliteti i «dyzuar» i pashait:

«— Asgjë s'ke bërë, — përsëriti, — gjersa ke mbetur pasha.

— Po ku e di ti që jam akoma pasha? Mbase jam bërë, ashtu siç thua ti, prijës. — Ai e shqiptoi fjalën e fundit duke e zgjatur i-në me përbuzje. — Priiijës. — përsëriti, — e dëgjon?

Në vend të përgjigjës i burgosuri tringëlliti zinxhirët.

— Pasha, — murmuriti nëpër dhëmbë. — Të ndiej në duar se ç'je... Po Shqipëria s'bëhet ashtu. — Edhe fjalët e tij vinin si nga varri, pa shumë lidhje, si të mbuluara përgjysmë me dhe. — Një pashallëk mund të bësh ti, por jo shtet... S'të vjen pas Shqipëria.... jo.

— Pusho! — thirri Aliu.

— S'është jot' ëmë, Hankua, Shqipëria.

— Gōdite, — thirri Aliu...» (f. 217-218).

Edhe në këtë rast, sado me rëndësi për brendinë e romanit, kemi të bëjmë vetëm me një episod të dramës së madhe, me një konkretizim të linjës kryesore ideoartistike të veprës.

Besniku, ndër personazhet kryesore e në linjën kryesore ideoartistike të romanit «Dimri i madh», paraqitet edhe si dëshmitar evenimentesh historikë, edhe person veprues në jetën politike e shoqërore të vendit, edhe njeri me jetën, hallet dhe dramën e vet e të familjes së vet. Duke pasur rastin e jashtëzakonshëm të jetë i pranishëm në qëndrimin heroik të PPSH në ndeshje me revizionizmin në Mbledhjen e Moskës, ai fiton përvojë e piekuri që e ndihmojnë të ndjekë me vigjilencë situatat, të veprorët me ndjenjë përgjegjësie, të përfshihet veprimtarisht në jetën e vendit, të mbajë qëndrim mospajtuës ndaj meskinitetit mikroborgjez. Tëpër i përmbajtur, gati refraktar ndaj të tjerëve, ai është i vëmendshëm ndaj tyre, i prerë kur është çështja për probleme me rëndësi jetike, i papajtuëshëm me karririzmin, burokratizmin, prepotencën, me ndjenjën e neveritshme të «pronësimit» të revolucionit nga njerëz që humbasin frymën e vërtetë militante. Në llogoren e vet Besniku shfaqet me një patos

heroik e jo më bëma të kësaj natyre; ai e shfaq vetveten më tepër përmes përsiatjesh sesa përmes veprimeve. Megjithëkëtë ai është portreti më i plotë e i gjallë i një heroi të kohës sonë mishëruar prej Ismail Kadaresë. Shkrimtari i ka shmangur «ndeshjet», po lexuesi nuk e ka vështirë të kuptojë qëndrimin e Besnikut ndaj tipave si Raqi Araniti, veçanërisht ndaj të deklasuuarve. Ndërsa në bisedë me Arbeniñ, vëllanë e vet, Besniku formulon këtë mendim e qëndrim:

«Ka disa çaste të vështira kur duhet harruar sadopak vetvetja... me një fjalë, kjo mënyrë jetese boshe që bën ti, e cila është gjithmonë e papranueshme, ka çaste në jetën e një vendi që bëhet krejtësisht e padurueshme» (f. 327).

Kjo ndjenjë gjallon e përforcohet tek ai dhe e bën të kalojë nga kuptimet dashurorë të plazhit të përbuzja për pakënaqësinë meskine të nënës së Zanës dhe vetë kësaj pse nuk u solli nga Moska «... së paku një suvenir...». Dhe, siç ndodh disa herë në romanet e Kadaresë, një rastësi e papritur, bora që po binte jashtë, e ndërpret bisedën me Zanën, dhe, pas borës, ftohja vazhdon të theksohet. Ndërhyrja meskine e Lirisë dhe shpejtimi i pame-nduar i kryeredaktorit e acarojnë Besnikun, që ndërkaq ka filluar të reflektojë në mënyrë autokritike, si del nga pënjimi i hidhur: «E humba Zanën».

Duke mos e përligjur një dozë të tepëruar amblylljeje në vetvetë të Besnikut, lexuesi, sidomos, arrin në përfundimin e rëndësishëm mbi dëmin që shkaktojnë dëshirat për rehati mikroborgjeze në një kategori njerëzish me të dhëna përgjithësisht pozitive, por të paformuar mirë politikisht; që nuk e ndjekin hap pas hapi kohën dhe e ndiejnë pak peshën e saj.

Në portretizimin e personazheve të tërheq vëmendjen karakterizimi i figurave antagoniste. Në disa raste, kur përshkruan ato që quan «forca të errëta» që revolucionin nxjerr në sipërfaqe, shkrimtari nuk e përmban mllëfin satirik e sarkastik. Por, në përgjithësi, në vizatimin e figurave, negative autori është gjithashtu i përmbajtur dhe i drejtpeshuar. Pothuajse në asnjë rast, përveç fi-

gurave simbolike, si ajo e Tosun Agait ulok, autori nuk perdor mjetet e groteskut e të karikaturës, siç nuk përdor për pozitivët brerorët dhe këmbajkat. Se ç'përfaqësojnë ata, del edhe nga vendi që u lihet, nga struktura e romaneve, nga qëndrimet e personazheve ndaj problemeve që shtrohen në vepër dhe jetës në përgjithësi. Ashtu si aktori i vërtetë komik, që nuk ngërdheshet në skenë por ruan «dramën» e personazhit të komedisë, duke e bërë të përbuzshëm e qesharak për spektatorin, po ashtu autori personazhet negative i paraqet të «dënuar nga historia», por edhe me «hall të madh» për realizimin e qëllimeve të tyre. Shkrimtari sikur u thotë lexuesve: Ja, këta janë armiqtë, njihini, urrejini, luftojini! Situatat janë dramatike dhe lufta vazhdon e pandërprerë, e gjithanshme, e përditshme.

Shkrimtari nuk sajon përfytyrime monstruoze mbi armiqtë, por ruan përmasa reale dhe na drejton vëmendjen në fizionominë e vërtetë shoqërore e politike të tyre, në faktin se ata nuk kanë hequr e nuk do të heqin dorë kurrë nga qëllimet reaksionare. Në çdo roman synohet të dalë mirë në pah epërsia e popullit dhe e vendit që lufton vendosmërisht për çlirimin dhe mbrojtjen e vet e të revolucionit; ky synim e udhëheq shkrimtarin edhe në mënyrën e paraqitjes së palës antagonistë e negative. Ballafaqimi, pa qenë nevoja për karikaturizim, i nxjerr armiqtë «lakuriq në sy të botës» dhe i bën ata të urrejtshëm e të neveritshëm. Gjithashtu, në vepra është ndriçuar qartë ç'rend shoqëror e politik reaksionar përfaqësojnë ata, ç'kalbëzim përmban në thelb, edhe kur së jashtmi ky sistem duket kanosës e i tmerrshëm. Këto forca janë shprehje e kontradiktave të këtij rendi, mishërime të shtypjes, dhunës, agresionit, mishërim i djallëzisë e poshtërsisë kundër njëri-tjetrit që nga këshilli i luftës në «Kështjella» deri tek etja për pushtet e udhëheqësve revizionistë sovjetikë në «Dimri i madh».

Por gjatë karakterizimit të përgjithshëm, në bllok, të personazheve negative, shkrimtari shkon dhe më tej në rrugë realiste: Këta, si dhe personazhet pozitive, nuk i paraqet si mall standard. Personazhet negative janë ka-

raktere të përcaktuara, që kanë pasione e synime dhe janë njëherësh fate shoqërore e vetjake, me funde nga më të ndryshimit në procesin e rënies së tyre të pashmangshme. Kështu, në rëniën e në degjenerimin e një rendi shoqëror, si dhe në fazat e shpërthimeve të jashtme të krizës së brendshme, ka më shumë larmi shfaqjesh të karaktereve njerëzore («Kështjella», «Pashallëqet e mëdha» dhe «Dimri i madh»).

Nga një paraqitje e tillë, pa zmadhimë efektuozë komike e groteske, rrjedh vetvetiu prirja e frymë ideopolitike e atdhetare e shkrimtarit, e vulosur nga përvoja e zhvillimi historik, zbulohet natyra dhe fizionomia e vërtetë, e shëmtuar e Hurshid pashëve dhe Zheleznovëve, e Rrok Simónjakëve dhe Mukadeseve e Majnureve.

## VIII

Veprimtaria letrare e Ismail Kadaresë është e gjerë dhe vlerat që përmban u japin veprave të tij vend nderi në letërsinë shqiptare të realizmit socialist. Këto vlera i bëjnë objekt shumë të dëshirueshëm, interesant, po edhe të vështirë studimi veprat e autorit. Është e pamundur të përfshihen në një trajtesë sado të gjerë gjithë çështjet që kanë të bëjnë me përmbajtjen e pasur të tyre, format e zgjedhura dhe veçoritë e nivelet e mishërimit artistik. Po kështu, nuk është lehtë të vihen rreñjesisht në dukje disa probleme që kanë të bëjnë me zbatimin krijues të parimeve të realizmit, socialist nga shkrimtari, me raportet në mes veprës së tij dhe traditës letrare kombëtare, me përthithjen e përvojës së letërsisë përparimtare e bashkëkohore; përgjithësisht, me origjinalitetin spikatës të tij, që e bën, siç është pohuar, një shkrimtar që nuk ka nevojë për krahasim. Më në fund, vetë rruga krijuese e Kadaresë, si në poezi, edhe në prozë, është rruga e një talenti në kërkim të vazhdueshëm, që përpiqet të sjellë me çdo vepër diçka të re në brendi e në formë, të jetë kurdoherë i freskët dhe interesant. Në këto

kërkime e arritje shquan dihmesa e çmueshme që ka dhënë ai në pasurimin e në përparimin e letërsisë sonë, siç ka dhe momente ideoartistike që meritojnë shqyrtime kritike të vëmendshme e të veçanta në rrafsh të përgjithshëm ideoartistik, ose për anë të caktuara të formës, të stilit, të gjuhës etj.

Edhe synimi ynë ka qenë që të përvijohen tiparet dhe veçoritë më dalluese që meritojnë vëmendje e thellim, të jepet ndonjë mendim që mund të ndikojë për mirë në rrugën e mëtejshme krijuese të autorit. Dhe do të ishte gëzim, nëse studimi ynë do të arrijë të nxisë sadopak mendimin kritik e studimor për vlerësime më të plota.

Proza e Ismail Kadaresë shquhet në disa drejtime dhe shtrën disa probleme që meritojnë të theksohen edhe në formë përfundimesh:

1. Në çdo roman është synuar në momente me rëndësi të historisë e të jetës bashkëkohore, të vihen në themel të tyre ide të mëdha e të shprehura mendime të fuqishme. Shkrimtari është interesuar për rrafshe tematike e për subjekte përfshirës hapësirash të gjera të realitetit, të proceseve të zhvillimit, të përvijojë gjendje dhe pritje karakteristike për kohën, duke u dhënë kështu veprave frymëmarrje të thellë e tingull aktualizues. I interesuar, në radhë të parë, për fatet e popullit, e të atdheut, autori jep përfytyrime të gjalla, tablo të pasura dhe tregon në ç'drejtime problemët e mëdha të kohës hyjnë në botën e karaktereve shoqërore përfaqësuese, përthyer në fizionominë e tyre, dhe nga ana tjetër zbulon motivet shoqërore e vërtjete që i shtyjnë individët të veprojnë, duke ndikuar në rrjedhën e ngjarjeve e në fatet e vendit.

I nxitur prej motivesh, shqetësimesh e idesh bashkëkohore, Kadareja u është drejtuar kohës sonë dhe viteve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, historisë e lëgjendave popullore, me synimin që ato t'i dëshmojnë së sotmes e së ardhmes, ka theksuar vijimësinë e luftës e të idealit kombëtar dhe cilësitë e reja që ai fiton, sidomos në epokën socialiste. Pa nënvleftësuar arritjet në



veprat me material historik e legjendar, sukseset më të mira edhe në rrafsh thjesht artistik autori i ka arritur në krijimet që i kushtohen kohës sonë dhe periudhës së Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Përjashtim tematik në këtë drejtim bën «Kështjella», një roman me brendi të rëndësishme e me tingëllim aktual, ndër më të përsosurit në ndërtim e në stil. Pra, mund të themi se joshja për një kohë e shkrimtarit nga materiali legjendar e historik, me gjithë pikënisjen bashkëkohore dhe kujdesin e posaçëm për paralelizma me aktualitetin, nuk është një prirje që do të meritonte të përshëndetej. Çdo kohë i zbulon sheshit kontradiktat e problemet e veta dhe jep material të pasur për mishërimin artistik të tyre. Ndryshe nga më sipër, forca, gjerësia, thellësia dhe konkrëtësia e tablosë së kohës sonë në romanin «Dimri i madh» është arritur jo me aluzione alegorike e metaforike, të cilat sado sugjestionuese qofshin i kufizojnë mundësitë pasqyruese realiste e, ndonjëherë, kur aktivizimi i tyre i tejkalon mundësitë e materialit historik, krijojnë edhe ekuivokë e keqkuptime.

Në të kundërtën, në veprat kushtuar Luftës e realitetit bashkëkohor, historia dhe legjenda përfshihen më natyrshëm dhe po ashtu rrjedh tingëllimi aktual i materialit legjendar, ideomocionalisht më i saktë e më i preksishëm është ky material. Kujtojmë «Kronikë në gur», «Dimri i madh» dhe «Muzgu i perëndive të stepës. Në këto vepra tri përmasat e kohës, përftojnë unitete të qëndrueshme ideoartistike, sepse në themel janë probleme të rëndësishme të kohës dhe jo aluzione për një tjetër kohë e për tingëllim aktual me sforcime të karakterit racionalist. Duke u ndjekur rruga e parë, d.m.th. mbështetja në realitetin e në problematikën tipike të kohës, edhe përvoja e Kadaresë na bind se qëndrimi ndaj historisë është më përfshirës dhe më shprehës, më të mëdha mundësitë si për afirmime e paralelizma të drejtpërdrejta, edhe për konstatime e qëndrime kritike. Kjo vjen sepse evokimet e historisë apo të legjendës diktohen e përliqen nga vetë aktualiteti, nga problematika e trajtuar dhe shndërrohen në elementë veprues për proceset e më-

tejsme të zhvillimit. Janë këto vepra që dëshmojnë mbi të tjerat për ngritje cilësore e përkryerje stili të autorit.

Vërehet, gjithashtu, se vlerë e ndikim më të madh kanë pasur romanet, ku idetë e rëndësishme kanë buruar nga materiali i pasur jetësor, ku raporti realitet-mendim-figurë artistike ka qenë më i harmonishëm, duke iu dhënë përparësi materialit jetësor. «Gjenerali i ushtrisë së vdekur» është kuptimplotë në këtë drejtim, në të kundërt, mossuksesi — «Lëkura e daulles», pikërisht se u është dhënë përparësi elementeve të sajara dhe përsiatjeve racionaliste.

Në këtë studim nuk janë marrë në shqyrtim përpunimet që u ka bërë autori veprave (një temë me interes kjo), por në këtë rast do t'ia vlen të flitej për to. Sepse në romanin «Dasma» kishte shumë shkurmë dhe ndërhyrje lirike e publicistike dhe, ndonëse të «Lëkura e daulles» janë shmangur këto, krijimi përsëri ka mbetur një skelet romani, i cili nuk mund të vihet pranë realizimeve mjeshtrërore të Kadaresë. Kjo dobësi bëhet më e theksuar kur realiteti interpretohet në mënyrë disi subjektivistike dhe jeta njëjësohet me përfytyrimet morale e juridike, në vend që këto të shikohen e të trajtohen si rezultat i proceseve të zhvillimit historik («Prilli i thyer»). Problemi i trajtuar (gjakmarrja), sado i kapërcyer historikisht, përbën objekt veprë artistike, por nevojitet një këndvështrim që të hedhë dritë në rrënjët e vërteta shoqërore të tij, të shmangët vendosmërisht ekzotizmi dhe të ndriçohet rrugëdalja nga kontradikta — populli nuk është aspak i interesuar për nxitjen e gjakmarrjes, si dhe fakti se përparimi shoqëror e ka rishikuar e denoncuar këtë të keqe të kobshme. Në këtë kuadër fati tragjik i individëve do të dilte më me vërtetësi, kurse qëndrimi ideoemocional i shkrimtarit më realist e me pikësnyime më të shëndosha.

2. Sado shtrirje epike të kenë, romanet e I. Kadaresë janë të natyrës sintetike refleksive, mbështetur kurdoherë në një fakt a në një ide të rëndësishme që përbëjnë thelbin e qëndrueshëm të subjekteve. Subjekti i çdo ro-

mani mund të përmblihdet me pak fjalë dhe të nxitë fantazinë. Një gjeneral dhe një prift vijnë në Shqipëri, të mbledhin kockat e ushtarëve të vrarë. Një njësit partizan merr me luftime të ashpra radiostacionin e kryeqytetit dhe e vë atë në funksionim. Ushtritë osmane përdorin çdo mjet e mundësi për të pushtuar kështjellën, por dështojnë dhe largohen nën tam-tamet e daulleve të shiut. Një fëmijë rritet e depërton kureshtar në mjediset e qytetit dhe në realitetin e jetës në luftë.

Duket sikur romani «Dimri i madh» në këtë drejtim ndryshon në themel prej të tjerëve. Por, edhe pse përmasat e realitetit të pasqyruar janë shumë të gjera dhe kërkojnë shtrirje më të madhe epike, është i njëjti konceptim, me ndryshimin, se kemi tri vatra veprimi e tri natika subjekti.

Kjo mënyrë të konceptuari e të pasqyruari, që lidhet me përfytyrimin e figurshëm poetik, i jep prozës së Kadaresë tingëllim të fortë origjinal e veçori dalluese. Procedimi është më afër mënyrave refleksive të trajtimit të subjekteve sesa parashtrimit epik, gjë që vërehet në tregimin e episodeve dhe në kalimet prej një shtuate e rrafshi në tjetrin, pa u ndier nevoja e lidhëseve epike. Madje, sa më e madhe të jetë shtrirja epike e subjekteve, aq më shpesh e më dukshëm përdoren kalimet poetike, duke i bërë disi të panevojshme e të nënkuptueshme hollësitë. Në këtë mënyrë arrihet që tablote të jenë koncize, kurse sfera e pasqyrimit të zgjerohet mes një mozaiku episodesh e larmi ndriçimesh të tyre. Për të zbutur kalimet pa lidhëse epike dhe zbrazëtitë e mundshme gjatë përqendrimit në pikat kulmore, shkrimtari përdor herë-herë ndonjë imtësi dokumentare apo tregim legjendar me po atë kahje kuptimore ose të lidhur me përmbajtjen e romanit. Kështu vepron te; «Kështjella», «Ura me tri harqe», «Nëntori i një kryeqyteti». Ky tregim zakonisht copëzohet, jepet në çaste të caktuara dhe ngjan si një nënshtresë e lashtë e subjektit ose si një element mbështetës për të. Është kjo një mënyrë e cila, kur ka rëndësi të vërtetë ideoemocionale, efektton mirë. Por,

ngaqë është përdorur rëndom, shpesh ka marrë cilësi parafabrikati letrar, është zhvleftësuar. Janë shfrytëzuar pa vend e shpërdoruar frazat e lëna përgjysmë, copat e gazetave, ndërperjet e papritura të fjalëkëmbimeve etj., ndonjë element jashtëletrar si citimi i notave muzikore, vizatimet etj.

Të shumtën e herës dhe në rastet më të mira ngjarjet nuk jepen në mënyrë tregimtare, po, kryesisht, të përthyerë në vetëdijën e njërezve qëndrimet, meditimet dhe arsyetimet e të cilëve dalin në plan të parë. Kjo «ecuri» stili, që ka të bëjë në fund të fundit me vetë natyrën e shkrimtarit nuk e ngushton sferën pasqyruese dhe informacionin, por, madje, brenda shtrirjes së kursyer në episode, jep mundësi të zgjerohen përmasat epike të tablosë së përgjithshme, të ruhet, thuajse ngaherë, lidhja mes paraqitjes së ngjarjeve, rrethanave dhe përsiatjeve të personazheve rreth tyre. Në këtë rrugë është dhënë edhe ndriçimi i thelbit objektiv të tyre, pra, tipizimi realist.

Kjo formë e paraqitjes, në përshtatje me të konceptuarit e përgjithshëm poetik, lidhet edhe me prirjen për të shkruar «me teze». Kështu, sidomos për temat e nxjerrra nga legjendat e nga historia, ka një ngjarje bërthamë të subjektit, por edhe një ide, një pikëpamje themelore, së cilës i përmbahet deri në fund. Në çdo roman, pa rënë në racionalizëm, përmes një brendie të pasur ideoemocionale dhe një formë mjeshtërore, përçohet një e vërtetë, parashtrohet një mendim, një hipotezë apo një teze, të cilat autori përpiqet t'i vërtetojë qoftë përmes vetë logjikës së fakteve dhe realitetit, qoftë përmes përthyerjes të tyre në vetëdijën e personazheve, formulimeve ideologjike, politike apo etike. Prandaj lexuesi, duke riaktivizuar brendinë ideo-emocionale të krijimeve, përqëndrohet jo vetëm në tërësinë e tablos por, së pari, në mendimin themelor që ajo mishëron.

Megjithëse, ndihet të shkruarit «me teze», në romane ka pasuri dhe gjallëri ideore, lëvizje dhe pamje të ndryshme, që e tërheqin lexuesin drejt mendimit që mbështet autori. Si të thuash, shkrimtari e shfaq tezën në in-

terpretim e sipër, kurse lexuesit i ngjan se arrin vetë ta zbulojë e ta formulojë atë. Ky rezultat arrihet mirë në romane, si «Kështjella», «Gjenerali i ushtrisë së vdekur», «Kronikë në gur». «Nëntori i një kyreqytetit». Kurse në «Ura me tri harqe», «Kush e solli Doruntinën» dhe «Prilli i thyer», sado që paraqitja është sugjestionuese, varfëria e materialit jetësor ka bërë që t'u jepet vend i tepëruar përsiatjeve, arsytimeve dhe kombinimeve letrareske; është çënuar realizmi dhe ka rënë vlera artistike.

Të shkruarit «me tezë» ka sjellë në rastin konkret që çdo roman të dallohet në brendi dhe në formë, të mënjanohej përsëritjet në mendime, të zbulohen aspekte të reja, të gjenden struktura e ndërtime në përshtatje me veçoritë e përmbajtjes. Kjo veçori është tepër e dukshme dhe në poemat e Kadaresë, sidomos, brenda një sferë tematike apo në pasqyrime të së njëjtës periudhë historike, si: «Përse mendohen këto male», «Shqiponjat fluturojnë lart». Vitet gjashtëdhjetë, dhe: «Gjenerali i ushtrisë së vdekur», «Kronikë në gur», «Nëntori i një kryeqytetit». Në këto raste, si në poezi dhe në prozë, ka një plotësi ideore e, megjithëkëtë, shkrimtari ruan fushëpamje për krijime të mëpastajme. Vetveten e përsërit vetëm ai shkrimtar që ka pak përshtypje nga jeta, pak ide e mbetet rob i tyre. Njëfarë përsëritje, ndonëse me nuancime të kohës, vihet re tek ky autor në paraqitjen e mjedisëve të të deklasuarve, të cilët mbeten thuajse po ata në fizionomi dhe në trajtim.

3. Mënyra poetike, disa herë dhe metaforike, e konceptimit dhe e pasqyrit të realitetit spikat në mes tërësisë së figurës së krijuar dhe aspekteve të veçanta e hollësive që shërbejnë për konkretizimin, detajimin dhe gjallërimin e kësaj së tëre.

Romanet e Kadaresë shquhen për kompaktësi dhe organizim mjeshtëror. Ndihet gjithandej kujdesi i posaçëm i shkrimtarit për të shmangur çdo gjë të tepërt, për të evituar çdo zgjatje, për shkarkimin e frazes e të figuracionit nga çdo element i jashtëm zbukurues, parazit dhe për të shtuar peshën informative, përmbajtësore dhe ide-oemocionale të shprehjes. Kompozimet janë të plota, ko-

mpakte, pa të çara, pa bërryla dhe paranteza të gjata. Etrjedha logjike dhe historike e ngjarjeve është konsekuente, procedimet — të sigurta, ndonëse për këtë në «Ura me tri harqe», «Kush e solli Doruntinën» dhe «Prilli i thyer» në disa raste janë shfrytëzuar fjalime, deklarata dhe ekzaltime të papërligjura, që çënojnë sado pak vlerën e veprave, të brendisë e të formës së tyre.

Ismail Kadareja tregohet mjeshtër në zgjedhjen dhe në kriteret e përdorimit të hollësive e të detajeve artistikë, synon të shmangë çdo rëdomtësi në tregim, në përshkrim dhe në fjalëkëmbim, e zhvesh hollësinë nga «lëvozhga» që e mbulon dhe lë të nënkuptohen hollësi të tjera mbi lëvizjet e personazheve e arsyetimet e tyre. Në hollësitë jetësore, që kanë të bëjnë me shtresën e dukshme të subjektit, autori tregohet shumë i kursyer, ndalet në çaste me të vërtetë shprehëse dhe i shfrytëzon me efekt, duke ua ngulitur lexuesve në kujtesë. Zakonisht — të kujtohen për këto romani «Kronikë në gur» dhe paraqitja e kampit osman në romanin «Kështjella», — është vështirë të dallohet ku mbaron pasqyrimi i realitetit objektiv dhe ku fillon përsiatja subjektive për të. Kjo mënyrë gërshetimi është hap me rëndësi në prozën tonë, sepse shmang formën tashmë diletante të ndarjes së tregimit epik nga përjetimet në ndërgjegjen e njerëzve, të veçimit të qëndrimit të personazheve nga pozicioni që zë shkrintari. Në fakt, për shkrintarin edhe bota e brendshme e njerëzve është një realitet që ekziston e merr udhë jashtë vullnetit të tij. Këtu nuk është çështja vetëm te mjeshtëria, por, në radhë të parë, te koncepti i përgjithshëm i pasqyrimin, të cilit i shërbejnë këto hollësi.

Trajtimi i temave mbi fatet e kombit e të atdheut kërkon, së pari zbulim të thelbit të dukurive, detajim domethënës, mendim me peshë, paraqitje të asaj që është tipike për epokën, zotëruese në vetëdijën e në jetën shoqërore e intime të njerëzve. Duke vënë në qendër të veprave mbartës të problematikës së rëndësishme të kohës, sigurohet një mundësi më shumë për përzgjedhje dhe tipizim të hollësive. Ndryshe ndodh në disa romane ku rëdomtësia e tipave reflektohet në zotërim hollësish të

zakonshme e të shumta ose, përkundrazi, edhe kur heronjtë janë të rëndësishëm, detajimi i tepruar i subjektit, çikërrimat natyraliste zbehin brendinë dhe sjellin shpërpjesëtime. Por ka dhe diçka tjetër: në një pjesë romanesh të Kadaresë vihet në themel ideja se Shqipëria dhe shqiptarët janë mbartës të një kulture të lash-të e të pasur, kurse aktualisht, janë vënë në rrugën e përparimit të vrullshëm material e shpirtëror. Për këtë arsye, shumë hollësi kalohen lehtë e shpejt, duke e tërhequr vëmendjen e lexuesve në më kryesoret. Por, sidoqoftë, duke vlerësuar mënyrën e zgjedhjes me sqimë artistike, mbetesh me përshtypjen se autori ka më shumë mundësi për tablo edhe më konkrete sidomos të vendit e të përparimeve të tij, sikurse na ka dhënë një varg detajesh e karakterizimesh kuptimplotë e spikatës.

4. Konceptimi sintetik i subjekteve, i cili siguron përqendrimin në problematikën themelore dhe evidentimin e saj, është gërshetuar mjeshtërisht me ndërtimin e hapur kompozicional, i cili ka mundësi të mëdha pasqyruese përfshirëse tablosh të gjera dhe për kalime të zhdërvjellta në episode e personazhe anësore. Shkrimtari, në përshtatje me temën dhe me realitetin që synon të pasqyroj, ka gjetur dhe tipin e efektshëm kompozicional jashtë kornizës së një subjekti të mbyllur. Në këtë mënyrë, të gjithë romanet kanë përmbajtje zakonisht shumë më të gjerë se linjat kryesore të subjektit. Në «Dimri i madh» kjo vlerë është veçanërisht e dukshme; po ashtu në romanin «Kronikë në gur». Në një trajtim të rëndomtë përshtypjet e një fëmije dhe formimi i karakterit të tij në rrethanat e Luftës (ka disa vepra me këtë pikësynim në letrësi e në kinematografi) zor se mund të jepnin mundësi për atë gjerësi mahnitëse të tablosë së krijuar nga Ismail Kadareja te «Kronikë në gur». Sepse ndodh që në vepra me subjekte vijimore, duke u mbivlerësuar disa hallka e disa personazhe përkatëse, hapësira pasqyruese ngushtohet deri në skematizëm ilustrues e instruktiv.

Kadareja nuk i përmbahet ndërtimit thjesht vijimor të subjektit, (ndonëse edhe në këtë rrafsh jep mirë rrjedhën e ngjarjeve), por në çdo roman mund të nxirret pa

vështirësi vijimësia, madje, të konstatohet edhe funksioni organizues që kanë ngjarjet. Ndërtimi vijimor, që shkrimtari e zotëron mirë artistikisht, përdoret, vetëm si mbështetje, si mjet për arritjen e një qëllimi më të madh, pa e varfëruar rrëfimin e rrafshin paraqitës. Kështu historia e formimit të karakterit dhe zgjimit të vetëdijës së heroit përbën vijën themelore që përshkon tërë romanin, pa qenë qëllim në vetvete. Me anë të këtij parashtrimi vijimor, ndërprerë nga episode që s'kanë të bëjnë me të, shkrimtari «hapet» me synimin të përfshijë gati gjithë jetën e qytetit prej guri në vjetë kapërthimesh e shndërrimesh të thella. Kësisoj edhe realiteti i kohës pasqyrohet në shumanshmëri, edhe karakteri i heroit jepet në formim lidhur me ngjarjet e kohës dhe proceset e zhvillimit.

I njëjti rezultat arrihet dhe në mënyra të tjera. Në romanin «Kështjella» kalbësia e rendit feudal teokratik e ushtarak osman do të kishte qenë e pamundur të jepej vetëm përmes figurës së një pashai, pa shkallëzimin e hierarkisë ushtarake rreth tij. Po ashtu disfata e pashait nuk mund të jepej vetëm përmes episodit të tërheqjes. Për ta dhënë sa më të plotë kuadrin historik të perandorisë, shkrimtari i është dashur të pasqyrojë rrymat e prirjet që veprojnë në të, të ndjekë e portretizojë njëherësh disa personazhe kryesore, në të njëjtat rrethana e situata, për pa ndonjë lidhje aq strikte në vijën e subjektit. Frymëmarrja ideomocionale e romanit bëhet kështu më e thellë dhe rezonimi i ngjarjeve më i gjërë, sepse çështja nuk thjeshtohet në dështimin e përpjekjeve për pushtimin e një kështjelle, por synohet në zbulimin dhe përgjithësimin e fizionomisë së rendit politik, ekonomik e shoqëror të Perandorisë Osmane dhe të ligjëorisë së rënies së saj.

«Dimiri i madh» dhe «Nëntori i një kryeqyteti», ku lënda parashtrohet kryesisht përmes theksimit të rrethave e situatave historike, tregojnë se autori përdor thurje kompozicionale pa ndonjë lidhje e ndërvarësi të brendshme të subjektit. Shkrimtari ka synuar gjithnjë të tregojë se lidhjet, marrëdhëniet, kundërvëniet dhe konfliktet në mes personazheve nuk janë rrjedhojë vetëm e karak-



tereve të ndryshme, sepse vetë këto karaktere janë pjellë e rrethanave historike dhe e përkatësisë klasore, ndaj konfrontimet në mes palëve janë të pashmangshme për çështje me rëndësi, për jetë a vdekje. Kjo logjikë bazë dhe gjetja e formës së përshtatshme të organizimit të subjektit është një përvojë krijuese me vlerë.

Ndërtimet e hapur të subjekteve dhe ndjekja ballore e shumë çështjeve ka kërkuar e ka sjellë edhe zgjidhjen paralele të konflikteve artistike, duke theksuar dinamizmin e procesit. Ajo që mund të quhet zgjidhje në kup-timin e ngushtë të fjalës (për shembull: tërheqja e ushtrisë osmane dhe dështimi i Exherit) nuk është zgjidhja e vërtetë dhe e plotë, sado kulmore që mund të duket. Shkrimtari ka ndjekur me sukses një rrugë tjetër, më realiste. Duke mos e lidhur zgjidhjen me fatin e një protagonistit apo antagonistit, me fitoren apo me disfatën e tyre, autori ka fill orientues raportin e faktorëve objektivë e subjektivë dhe rolin e individëve në histori, sipas konceptit të materializmit historik. Ai na bind se, me dështimin a me demaskimin e një antagonistit apo të një grupi personazhesh negative, çështjet nuk zgjidhen përfundimisht, se arritja e një caku kërkon përbalim detyrash të reja që shkojnë më tej kufirit të tij. Kjo i jep krijimtarisë së autorit theks mobilizues e vështrim perspektiv. Shembull tipik: «Dimri i madh».

Në romanin e Kadaresë si parashtrimi i problematikës, edhe zgjidhjet ndiqen e arrihen frontalisht (ndiqet fati i çdo personazhi a grupi personazhesh) duke lënë përshtypjen e vazhdimësisë së ndeshjes. Ashtu si vetë jeta dhe përvoja historike, autori nënvizon se, si në aspektin e luftës kundër revizionizmit, edhe në aspektin e luftës së klasave brenda vendit vazhdon ndeshja dhe dalin objektiva të rinj që duhen përballuar. Është fituar një betejë e madhe, kanë marrë udhë shumë çështje, por lufta do të vazhdojë, ndaj kërkohet vigjilencë dhe vendosmëri për qëndresë e për të ecur më tej, duke zhvilluar me konsekuencë luftën e klasave.

5. Mjeshtëria, e veçanta dhe e reja e Ismail Kadaresë, siç u fol dhe në kapitullin përkatës, vërehen dukshëm

dhe në portretizimin e heronjve e të personazheve.

Vendi që u jepet personazheve e heronjve në romane dhe mënyra e karakterizimit dhe e portretizimit të tyre njësohen me konceptimin e përgjithshëm artistik dhe, si rregull, i nënshtrohen këtij.

Krahas larmisë tematike, në kuadrin e gjerë të pasqyrimit, autori fut një numër të madh personazhesh, të cilët, edhe kur janë të një kategorie e të të njëjtit plan veprimi, kanë larmi veçorish individuale dhe funksion të caktuar në tërësinë e subjektit ose në pjesë të tij. Këta përveç vlerës në vetvete, me jetëshkrimin, me përjetimet dhe me qëndrimet ndaj dukurive, sjellin material të pasur, që e plotëson mirë tablönë, e bën më të besueshme dhe më interesante. Është për t'u vërejtur se sa më e rëndësishme të jetë tema, sa më jetësore rrethanat e situatat, sa më shtrirje të ketë subjekti, aq më të shumta janë personazhet, aq më të spikatur janë karakteret, më realiste mënyra e karakterizimit dhe e portretizimit të tyre. Dhe anasjelltas: sa më konvencionalë të projektohen rrethanat e mjediset, sa më reflektiv të jetë karakteri i veprave, aq më të paktë janë personazhet, aq më tepër ata, nga njerëz të gjallë shndërrohen në shprehës idesh, mbeten brenda funksionit të paracaktuar nga autori. Ky ndryshim duket sheshit edhe prej krahasimit të romaneve «Dimri i madh», «Kronikë në gur», «Gjenerali i ushtrisë së vdekur», «Kështjella», «Nëntori i një kryeqyteti», me romane si «Ura me tri harqe», «Kush e solli Doruntinën» dhe «Prilli i thyer». Pa mohuar vlerën e disa karaktereve të spikatura dhe në këto të dytat, prapëseprapë, vihet re se parashtrimi përgjithësisht logjik i subjekteve dhe konvencionalizimi i mjedisëve e i rrethanave në një formë e ngjyresë deri diku ahistorike, ka ndikuar në atë që edhe tipat të mos karakterizohen plotësisht si individualitete njerëzore, po të mbeten më tepër mbartës të synimeve ideore të autorit. Prandaj, sado që për këtë mund të diskutohet, themi se afrimi më i madh me të vërtetat historike, sidomos me jetën bashkëkohore, është rruga më e përshtatshme për të arritur te karakterizimi

realist i tyre. Për këtë dëshmojnë dhe vetë arritjet më të mira të Kadaresë.

I prirë drejt një proze me dendësi ideomocionale, Ismail Kadareja tregohet i kursyer edhe në mjetet karakterizuese. Protagonistët dhe personazhet e romaneve, me pak përjashtime, janë karaktere të formuara, të vënë përballë rrethanash e situatash serioze e të mprehta, ku zbulojnë vetveten, demonstrojnë cilësitë e veta. Ata hyjnë në skenë në çaste që mbahen mend, pa paraqitjen paraprake të jetëshkrimit apo të portretit fizik të tyre. Ky portret e jetëshkrim vijnë e plotësohen duke mbajtur të gjallë interesin e lexuesit. Çdo e dhënë e re gërshtohet me mjeshtëri gjatë zbulimit të karaktereve me dinamikën e veprimit dhe me realizimin e marrëdhënieve mes personazheve. Qëndrimet dhe pohimet e personazheve janë mjetet kryesore karakterizues për ta, aq sa ndonjëherë bëhet e nevojshme «ndërhyrja» e autorit që ndonjë mendim apo arsyetim i tyre të mos lejojë interpretime të ndryshme, të diskutueshme.

Heronjtë dhe personazhet e romaneve të Ismail Kadaresë, pavarësisht nga kategoria shoqërore dhe nga qëndrimi ndaj tyre, shfaqen para lexuesit kryesisht si mendimtarë e më pak si veprimtarë. Një atribut i tillë vjen edhe si refleks i luftës ideologjike të kohës sonë dhe i angazhimit të shkrimtarit në të. Por, natyrisht, këtu ka pjesën e vet edhe mënyra e njohjes dhe e paraqitjes, prirja racionale që herë-herë del edhe mbi anën emocionale dhe karakteret e gjalla që kërkon letërsia. Por, nisur nga ky pohim e konstatojmë, nuk mund të arrihet në përfundim se romaneve u mungon veprimi. Përkundrazi, në ta ka shumë lëvizje, zhdërvjelltësi, për të kaluar pa u ndier nga përshkrimi i mjediseve e i situatave në rrëfimin e paraqitjen e veprimit, në përsiatjet e aspirimet e personazheve. Shkrimtari e zotëron plotësisht krijimin, po është i vetëpërmbajtur, ka sensin e masës dhe, edhe përmes një episodi të thjeshtë, synon të jetë sa më zhbirues, në botën e personazheve, të bëjë kalime të shpejta nga fakti tek efekti që ai shkaktonte. Kështu në romanet kushtuar Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe në «Dimri» i

madh» materiali jetësor vjen më i pasur, lëvizjet më energjike dhe përsiatjet të lidhura më ngushtësisht e më natyrshëm me gjendje konkrete dhe me aspirata të përcaktuara, ndonëse ka në to dhe ndonjë përjetim apo përfytyrim të pashoshitur mirë nga autori. Këto reflekse ndikimesh letrare, të mënjanueshme lehtë, besojmë të mbeben një dukuri kalimtare, ashtu si dhe ndonjë teprim në mënyrat alegorike, konvencionale apo ndonjë teknike iluzioniste. Po kaq kalimtare besojmë të jenë dhe ndonjë përfytyrim misterioz mbi marrëdhëniet shoqërore, ndonjë perturbacion i «nënvetëdijës» i nxitur nga impulse seksuale, sepse në këtë drejtim do të luajnë më tej rolin e vet pësha dhe thekset zotëruese të temës e të problematikës shoqërore, bashkëkohore, kërkesat për ngritje të mëtejshme të cilësisë ideoartistike.

6) Në këto shënime nuk u fol posaçërisht për vlerat e shumta stilistike të prozës së Kadaresë, të cilat kërkojnë studim më vete, po do të parashtrohen vetëm disa konsiderata stilistike lidhur me karakteristikat më themelore ideoartistike të veprave të tij.

Vërehet se shkrimtari ka bërë përpjekje të vetëdijshme, këmbëngulëse dhe të suksesshme për të arritur që «tendencat të rrjedhë vetvetiu», pa qenë nevoja e nënvizimit të posaçëm, skematizues të pikëpamjes së autorit. Ky tendenciozitet nuk shprehet me fjalë, në mënyrë të vulgari-zuar, po rrjedh i sigurt dhe i kapshëm nga vetë parashtrimi i materialit, nga këndvështrimi i partishëm i jetës. Si pasojë e këtij të konceptuari e të pasqyruari realist, edhe fraza, parashtrimi i mendimeve dhe përskrimet janë të përmbajtur e të drejtpeshuara, karakterizimi i personazheve pozitive bëhet pa ndonjë shkëlqim të jashtëm dhe i personazheve negative pa denigrim subjektivist. Kështu arrihen e ngjallen efekte e ndjenja të ndryshme, i sugjerohet lexuesit një qëndrim veprues ndaj tyre.

Figurat më pak të përdorura në romane janë epitetet, ndërsa përdoren gjerësisht krahasimet, similitudat dhe metaforat. Epiteti i thjeshtë, si figurë që rreh të nxjerrë më në dukje vlerat dhe cilësitë e personazheve apo të lartësojë dukuritë e pasqyruara, nuk i mjafton mënyrës

së të shkruarit të Kadaresë, i cili synon që në plan të parë të dalin vetë vlerat objektive të gjërave dhe jo ato që mund t'u atribuohen. Dhe vërtet, është e dëshirueshme të përshkruhet një ditë e bukur sesa të thuhet: ç'ditë e bukur! Aq më tepër kur është fjala për pasqyrimin e dukurive shoqërore, të vlerave shpirtërore dhe të bëmave njerëzore. Epitetet janë të panevojshme sa herë që shkri-  
mtari, pa ndihmën e tyre, arrin të paraqesë me mjeshtëri madhështinë dhe bukurinë reale të jetës e të njerëzve. Në këtë rrugë, që është më e vështirë por më artistike, Ismail Kadareja ka arritur suksese të dukshme përmes paraqitjes realiste me ngjyra të theksuara e pa zbukuri-  
me.

Krahasimet, përkundrazi, janë tepër të përdorura, sepse me anë të tyre është synuar të bëhen më të prekshme gjendjet dhe të silltë informacion plotësues, përforcues. Në përshkrime janë përdorur efektshëm krahasime nga më të ndryshmet e më «të pakonsumuarat», që dëshmojnë për mjeshtëri, për kulturë dhe aftësi të pashtershme krijuese. Nga krahasimi kalohet disa herë në paralelizma të goditura për situata e për personazhe të ngjashme, gjë që e rrit efektin emocional dhe ndihmon në zbulimin e qëndrimit tendencioz të shkrihtarit. Disa herë këto paralelizma i kapërcejnë caqet e figurës së thjeshtë stilistike, marrin shtrirje më të gjerë dhe më karakterizuese në «Ura me tri harqe», «Nëntori i një kryeqyteti», «Muzgu i përëndive të stepës».

Një vlerë tjetër stilistike është zhveshja e frazës nga çdo element i jashtëm, zbukurues e njëherësh ruajtja e fuqizimi i figurshmërisë së shprehjes artistike. Figurshmëria e shprehjes nuk përmbahet në zbukurimet e jashtme të frazës, ashtu siç nuk e bëjnë të bukur një objekt të formësuar keq elementet zbukuruese që mund t'i vishen. Autori priret t'i japë çdo fjale vlera maksimale kuptimore e stilistike, duke e shkëputur prej lidhiesh të ngurësuar. Gjiithashtu, duke e përqëndruar vëmendjen në atë që do të thuhet, bëhet kudes që të nixirren në pah nësia e informacionit, mendimi e ngarkesa emocionale. Në këtë mënyrë, fraza dhe figura, siç duhet të jenë në

të vërtetë, trajtohen si mjet dhe jo si qëllim, synohet që të tingëllojnë bukur në funksion të asaj që përmbajnë dhe jo për ta mbuluar atë me gjethe.

Në romanet me subjekte legjendare e historike, nga preokupimi për aludime bashkëkohore, janë përdorur me gjerësisht alegoria, simbolet dhe metaforat jo aq si figura stilistike, as si mënyra të konceptuari e të pasqyruari të realitetit. Është e njohur figura simbolike e kështjellës dhe e kështjellarit. Alegorikë janë uJORËT dhe tokësorët në «Ura me tri harqe», zona «kra-kra», pallati i ëndrrave, pallati i gërmërit shekullor etj., kurse në «Pashallëqet e mëdha», heshtja e popullit ndaj thirrjes së fundit të Ali Pashës është shprehur në formën e një metafore me përmasa të mëdha. Duke shfrytëzuar me mjeshtëri mjete të tilla pasqyrimi të figurshëm, Ismail Kadareja i ka pasuruar dukshëm mjetet shprehëse të prozës së sotme, është munduar, përgjithësisht me sukses, që t'i përdorë arrijtjet e prozës bashkëkohore në shërbim të përcimit të një brendie të re. Arrijtjet më të mira janë dëshmi e mundësisë së përdorimit të formave më të ndryshme, brenda parimeve e kërkesave të realizmit socialist. Veçse, siç ka konstatuar me kohë Gëtja, format simbolike, sado interesante, nuk mund të arrijnë atë rezultat përgjithsimi siç arrihet përmes tipizimit artistik realist. Nga ana tjetër, do të ishte gabim të mendohej se tingëllimi aktual i veprave të autorit është fryt i mjeteve figurative të përdorura. Këtë tingëllim e jep vetëm një përmbajtje e pasur dhe e parë nga një këndvështrim me mundësi aktualizimi edhe pa aludime të drejtpërdrejta, të cilat, në fund të fundit, mund të jenë dhe një shfaqje «moderne» e tendenciozitetit vulgar.

Ndijsshmëria ndaj tëndës gjuhësore, begatia e fjalorit, ndërtimi i shkathët dhe ritmi i frazës, figurshmëria e shprehjes, shmangia e përsëritjeve dhe synimi për të krijuar figura të reja stilistike, madje, dhe fjalë sipas modelesh popullore, janë një drejtim tjetër i vlerës së romaneve dhe i ndihmesës së Ismail Kadaresë. Frazja e tij është e pasur në përmbajtje, në ndërtim, në të përshtaturit e saj ndaj qëllimit ideoemocional. Shkrimtari para-

pëlqen frazën e shkurtër, por në romane ndeshen edhe fjalitë mungesore, edhe frazat e gjata me ndërtim të ndërlikuar, që i përgjigjet nevojës për të shtjelluar mendimin e për të zhbiruar gjendje shpirtërore të ndërlikuara. Ndërtimi i frazës përdoret edhe si mjet karakterizimi të personazheve. Bie në sy, për shembull, që personazhet e romaneve «Kronikë në gur» dhe «Nëntori i një kryeqyteti», personazhe me prejardhje popullore, si në fjalëkëmbime dhe në çaste persiatjesh, përdorin fraza të thjeshta që mbartin përfytyrime konkrete. Në përgjithësi, përmes fjalorit si mjet individualizimi, është synuar të zbulohet diçka më thelbësore: mënyra e të menduarit të personazhit përshtatur me kategorinë shoqërore dhe veçoritë individuale. Dhe, meqë pa gjuhë nuk ka mendim, këto veçori reflektohen jo vetëm në mendimet e secilit, po edhe në formën si i shpreh ato, ndonëse nuk janë aq të ndijshme dallimet në mes gjuhës së personazheve dhe asaj që përdor shkrimtari.

Përvoja krijuese e Ismail Kadaresë dhe ndihmesa e tij meriton vëmendje e vlerësim të veçantë. Romanet e tij janë fryt i një pune të palodhur të një poeti të talentuar, mendimtari të thellë, mjeshtri të sprovuar, i cili në vazhden e problematikës bashkëkohore e fuqizimit të shprehjes artistike, do ta pasurojë më tej krijimtarinë e vet dhe letërsinë tonë të realizmit socialist.

1982-1984

II  
SHRINE BRITISH  
PER VERA DETRARE



## TRE HAPA NË UDHËN E NJË POETI

Në dhjetë vjet (1974-1984) Dritëro Agolli, si dhe më parë, është treguar një prej poetëve më prodhimtarë e më në zë të letërsisë sonë të sotme. Gjatë kësaj periudhe ai ka shkruar poemën e mirënjohur «Nënë Shqipëri» (1974), vjershat e poemat e përmbledhjes «Fjala gdhend gurin» (1977) dhe ato të librit «Udhëtoj i menduar» (1985). Në krijimet e përfshira në këto botime, lexuesi takohet sërisht me poetin e njohur e të vlerësuar për frymën popullore, realizmin, militantizmin, lirikën e ndier dhe humorin e këndshëm që përshkojnë gjithë veprën e tij.

Tok me shoqërinë ka ecur edhe poeti e poezia e tij. Në faqet e çdo libri të ri ne takohemi me një të njohur të vjetër që na sjell fjalën e tij poetike, ku spikatin etapë e zhvillimit historik të vendit, përparimet e letërsisë, psikologjia e kohës, kërkimet dhe arritjet në fushë të mjeshtërisë.

«...Ndryshimet në jetën tonë, — vëren D. Agolli, — bëhen me shpejtësinë e rrafesë dhe mes këtij vrapimi të kohës ne ndryshojmë vetveten. Kjo shpejtësi duhet ndjekur edhe në poezi: gjumi në rrugën e poezisë është mbarim. Në rrugën e poezisë nuk ka gjumë, përndryshe poeti vonohet...» («Udhëtoj i menduar» f. 357). Në këtë kuptim, mbasë nuk gabojmë po të pohojmë se me poemën «Nënë Shqipëri» krijimtaria e D. Agollit ka hyrë në një fazë të re zhvillimi, e cila, krahas së përbashkëtës me periudhën e mëparshme (1956-1973), ka dhe veçori dalluese. Këto veçori janë bërë përpjekje të vihen në dukje në shkrimet kushtuar secilës vepër të kësaj faze.

## Poema «Nënë Shqipëri»

Në prag të tridhjetëvjetorit të Çlirimit të atdheut dhe të fitores të revolucionit popullor Dritëro Agolli doli para lexuesve me një vepër të re poetike, me poemën «Nënë Shqipëri», e cila na shembëllen me një banderolë të kuqe në portat e festës së madhe dhe shënon një arritje të re në rrugën e tij krijuese.

Të flasësh për poemën e re të Dritëro Agollit, do të thotë, në radhë të parë, të flasësh për lidhjet e kësaj poezie me fatet e atdheut e ta vendosësh përkrah krijimeve të shquara me temën e madhe të atdhedashurisë e të heroizmit shqiptar, përkrah tablove përgjithësuëse plot përthyerje emocionale mbi historinë e të sotmen tonë.

Tema e fateve të atdheut, e lirisë, e dinjitetit dhe e krenarisë kombëtare, tema e besimit në të ardhmen, e përparimit dhe e perspektivës historike të kombit, tema e mbrojtjes së tokës amtare e të fitoreve të arritura si dhe tema e vendit të Shqipërisë së vogël në botën e madhe e marrëdhëniet e saj me popujt e tjerë nuk janë pa traditë dhe në poezinë tonë të mëparshme patriotike e demokratike si dhe në krijimtarinë popullore të së kaluarës e të kohës sonë.

Në qindra e mijra vargje të mrekullueshme populli i ka kënduar hallemadhes e faqendriturës Shqipëri, kurse poetët kanë thurur për të vjersha e poema të frymëzuara, ndër të cilat dallojmë poemthin e Pashko Vasës «Shqypnisë së robnueme», poemat «Bagëti e bujqësi» dhe «Dëshirë e vërtetë e shqiptarëve» të Naim Frashërit, apo vjershën prekëse «S'na njohu njeri» të Loni Logorit.

Në to e sa e sa krijime të tjera të mrekullueshme, i është kënduar me përkushtim të thellë qëndresës shqiptare në shekuj dhe natyrës së bukur të vendit tonë, mjerimit dhe shpresës e besimit në të ardhmen, krenarisë kombëtare dhe dëshirës për të rrojtur në paqë e në miqësi me të gjithë popujt, janë denoncuar lakmitë imperialiste dhe tendencat shoviniste të rretheve reaksionare të vendeve të tjera dhe është himnizuar atdhedashuria dhe heroizmi i popullit në mbrojtje të atdheut, të lirisë e të dinjitetit të vet.

Po Shqipëria e sotme socialiste nuk ka asnjë shembëllim me Shqipërinë e dikurshme, për të cilën këndonin e vajtonin poetët tanë më të shquar të së kaluarës, që nga Naimi deri te Migjeni. Edhe poezia, si zëdhënëse e realitetit historik, duke ruajtur e zhvilluar traditat më të mira të së kaluarës dhe një shtrat të përbashkët ideo-emocional, nuk mund të jetë në konceptime po ajo që ka qenë në ato kohë. Realiteti i lëvizjes revolucionare dhe i Luftës Nacionalçlirimtare, i luftës së ashpër klasore në terren kombëtar e ndërkombëtar, i ndërtimit të socializmit dhe i thellimit të revolucionit ideologjik e kulturor si dhe lufta e sotme kundër imperializmit e revizionizmit, të para e të pasqyruara të gjitha këto nga pozitat e marksizëm-leninizmit dhe të metodës artistike të realizmit socialist — i kanë dhënë poezisë së sotme theksa të atillë ideoartistikë që na shtyjnë të pohojmë se dhe në trajtimin e temës së fateve të atdheut poezia jonë e re përbën një ndihmesë të shquar e me dallime cilësore në krahasim me krijimtarinë poetike të së kaluarës. Në poemat e Lllazar Siliqit, Dritëro Agollit, Ismail Kadaresë, Fatos Arapit e shumë krijime të poetëve të tjerë është pasqyruar me forcë artistike realiteti i sotëm. Ndaj së kaluarës jo vetëm është mbajtur një qëndrim i ri ideoemocional, por edhe janë zbuluar në atë realitet elemente të reja me rëndësi, që nuk arritën t'i zbulonin e t'i pasqyronin as poetët më të përparuar të asaj kohe.

Në këngët e poemës si dhe në hyrjen e në mbylljen e saj poeti është vënë para detyrës së vështirë krijuese,

të japë në një vepër të vetme një pasqyrim të gjerë mbi rrugën historike dhe realitetin e «dhjetëra viteve — agime» të Shqipërisë socialiste, përjetimet e përthyerjet e tyre në botën e brendshme të njerëzve, në psikologjinë, në mentalitetin dhe në idealet e tyre.

E kaluara është për poetin objekt krenarie, dhimbjeje dhe fshikullimi satirik. Ai krenohet me të drejtë për lavdinë luftëtare që ka ndritur nëpër shekuj, për Nënë, së cilës «iu hollua mesi nga gjerdanët e fishekëve», që iu rruhd e iu lërua balli nga mendimi dhe «iu zmadhuan këmbët nga ecja dhe mundimi»; për Nënë, që mbante fshehur flamurin në sepete dhe priste e përcillte në beteja bijtë e vet pallëvetëtima; vuan për Nënë që ndiente si «kabaja qante në grykë e zalle për botën me halle», «bujkut i vinte dimri në mes të vapës» prej etheve, plakëshin «nuset e djemtë pa vënë kurorë» dhe rrekëshin «kërthinjtë me qafa si kashta e thekrit». Poeti kujton me dhembje kohën kur shqiptari, i detyruar të braktiste trojet e veta, sillte në atdhe vetëm jehonën e këngës së dhimbshme «Mbeçë, more shokë, mbeçë, /Përtej urës së Qabesë». E megjithatë, derteve e halleve të mjerimit u shtoheshin netët pa gjumë të vigjilencës e të gatishmërisë për të zbuluar e për të përballuar me kohë «lakmitë e dhëlpëritë» imperialiste, sido që të paraqiteshin ato; «veshur me mburojë kalorësie, fshehur kokë e turi në helmeta» apo «zbutur me frak diplomacie».

Ndërsa kalon para nesh historia e figuruar në portretin e madhërisëm të Nënës e të bijve të saj heronj, që nga Skënderbeu te Ismail Qemali e Bajram Curri dhe kujtohen me dhembje vuajtjet e hallet e këtij populli të pamposhtur, shikimi i poetit hidhet në pallatin e Zogut që «mprehte thikat në farkë /nga mëngjesi në darkë», te princeshat që «qeshnin me djem/ dhe zbutnin turinjtë me krem», në sarajet e bejlerëve-shushunja, që thërrisnin me makutëri cinike: «Ka para?/Ka allah./S'ka para?/S'ka allah.»

Në qerthullin e kontradiktave, e forcave të kundërta të një realiteti shumëfish të hidhur u rritën bijtë e rinj

të Nënës Shqipëri, që jo prej akademive, po prej librit të madh e të hapur të jetës e të tokës arritën në përfundimin revolucionar se «Do të vijë patjetër një ditë/të kërkojmë shpagim.»

Po historia për poetin nuk është një grumbull datash dhe emrash që i përkasin së kaluarës. Ajo vazhdon. Ajo është një realitet e përpunon karakteristikat dalluese të kombit e të klasave shoqërore që e përbëjnë atë. Ajo, thotë poeti, e ka orientuar shqiptarin të mësojë punën dhe luftën — dy mjeshtëritë e tij të hershme, e ka stërvitur të zbulojë pranverën nën ortekët e borës dhe, nën tingujt dhe ngjyrat e fjalëve të dallojë gënjeshtren nga e vërteta; e ka bërë të shikojë me besim të ardhmen, ta përgatitë këtë me krahët e vet, ose, siç thotë poeti «me plug t'i çelë rrugën pranverës». Kështu, atdheu si koncept gjeografik e politik me atdheun si koncept historik shkrihen e bëhen një në fatet e në tiparet e popullit luftëtar e punëdashës, në konstitucionin shpirtëror të tij. Prandaj, megjithëse kronika historike në poemë mund të kishte qenë më koncize, më sintetike dhe më e përgjithësuar, nuk është kthyer në qëllim më vete, por është në funksion të theksave kryesorë ideo-artistikë të veprës, synimit që të shkëlqejnë «dhjetëra vitet-agime» të Shqipërisë socialiste.

Poeti ka parë konkretizimin e kësaj historie në tiparet e bashkatdhetarëve, në fytyrën, në ecjen dhe në këngët, në vrullet dhe qëndresën, fatet historike, optimizmin dhe besimin e tyre të madh; në thjeshtësinë e trimit e të punëtorit, por edhe në krenarinë e njeriut që e ndien veten zot të fateve të veta dhe shikon se diçka i ka dhënë e i jep njerëzimit.

Historia e popullit, pa e thjeshtëzuar, është parë në poemë si një tërësi, si vepër e popullit, që ka punuar, ka luftuar, ka vuajtur ka menduar e ka vigjëlur për tokën e vet, për atë «pikë të vogël të rruzullimit», nga ka pasur e ka dëshirë të thotë fjalën, e vet, t'u zgjatë dorën e besës e të miqësisë të gjithë popujve, pa u gjunjëzuar para dhunës e shantazhit, pa harruar përrallën e vjetër mbi kecat dhe ujkun...

Lexuesi njej edhe vepra të tjera poetike me meditime për të kaluarën e ndër to ka gjetur vlera të shquara. Po ka ndeshur, gjithashtu dhe në ekzaltime romantike e në pasqyrimë të zymta të së kaluarës. Në poemën «Nënë Shqipëri» janë bërë përpjekje serioze e të vetëdijshme për ta parë si të kaluarën dhe të sotmen e Shqipërisë në shumanshmëri ndeshjesh, në dinamikën e proceseve historike, të cilat ziejnë vazhdimisht dhe janë ngahera shkallë që shpien objektivisht drejt kulmesh të reja. E, mbi të gjitha këto, në poemë shkëlqen heroizmi.

Në poemën «Nënë Shqipëri» epopesë së lavdishme të Luftës Nacionalçlirimtare i është thurur një këngë e re, që mund të krahasohet me më të bukurat krijime për këtë temë. Edhe në këtë rast poeti ka synuar që pasqyrimin e historisë t'ua nënshtrojë ideve themelore të veprës dhe ta përqendrojë vëmendjen, në radhë të parë, në ato tipare dhe aspekte që i shërbejnë më mirë portretizimit poetik të Shqipërisë, idesë së vazhdimësisë historike, theksit aktual dhe kërkesave të perspektivës. Sipas poetit, gjatë Luftës Nacionalçlirimtare «Ne shtruam urat që lidhën brigjet e përrënjtë të kohës / për të kaluar nëna Shqipëri krenare, e madhërisht». Dhe këtë luftë nuk e bëmë ashtu «kuturu, bam e bum në errësirë». po me ndjenjën dhe me idenë e perspektivës, me përgjegjësi për fatet e popullit e të atdheut, të udhëhequr nga mendimi e nga besimi se ura që hidhnim «mbi shtylla të ngulura në zemër të tokës» nuk do të shembej kurrë nga rrebeshët. Kjo u bë realitet, se në tokën e etur për liri, drejtësi e demokraci Partia hodhi farën e ideve e të idealeve komuniste, ndezi në qiellin shqiptar «yllin e kuq», nga drita e të cilit «feksën malet, ngarkuar me muzg e dëborë».

Ky motiv përpunohet e shtjellohet në poemë që nga fillimi i këngës së katërt deri në vargjet e fundit dhe zbulohet nëpërmjet tij natyrshëm ndërgjegjja e re që kultivoi në popull Partia. Prandaj strehët e popullit u bënë «seli e parë e Komitetit Qendror të Partisë» dhe baza të sigurtë të luftëtarëve të lirisë. Populli, siç thotë poeti, nuk u frikësua kur u dogj me bombë e u shpua me bajonetë,

po vështroi mes tymit fundin e pushtuesve fashistë e të satrapëve.

«Strehëz, moj strehëz, / s'ta trembën ëndrrën/zjarri, fitili, qysqia, plumbi... /Sërishmi e sërishmi e ftove të vinte këngën,/ sërishmi e sërishmi e ftove të ngrinte folenë pëllumbi,/ sërishmi e sërishmi përkunde në djepa trima e zana, /sërishmi e sërishmi e përjetshmja nana-nana».

Në këtë burim forcash e vlerash të pashtershme u mëkua dhe u mbështet Partia. Lufta nuk ishte vetëm një ndeshje e madhe, e paprerë me pushtuesit e tradhtarët, por dhe shkollë e madhe e komunizmit për njerëzit tanë, për kuadrot revolucionare: «Në malet gjer në retë e në numërat gjer në zemrën e tokës / mësuan politikën e komunizmit politikanët tanë» — thotë poeti, duke hedhur vështrimin në një rrafsh ende pak të trajtuar. Dhe pas këtyre vargjeve arrihet në një prej kulmeve më të frymëzuara në vargjet kushtuar figurës së shokut Enver, që, sikurse vetë Lufta dhe Partia, hyjnë në vepër me natyrshmëri, me madhështinë e thjeshtë të udhëheqësit të madh komunist, që është vënë në ballë të popullit e të Partisë:

«Me fletore të zhubrosura në fundin e torbës, /me fletore përzier me bukën, kalemrat, fishekët/ ecën anëtarët e Byrosë Politike/ ecën ministrat e ardhshëm, komisarët, strategët, /eci muza jonë poetike.../Eci Ai që ti, Shqipëri, nënokja e maleve, /i thua me fjalën prindërore: bir, /eci Ai që kurrë ndaj halleve /s'ndenji të bënte shir: /që kokën në shekuj mos ulje kurrë, /që ballin ta kishë krenar, / Ai u betua: /«Nderin e nënës do mbrojmë si burra /sikur ta dimë se hamë dhe bar!»»

Këto vargje pohues vijnë si rrjedhim i gjithçkaje që është thënë më parë dhe hedhin dritë e i japin drejtëri asaj që shprehet në këngët e mëpastajme. Partia është vënë në qendër e në kulmin e veprës, pa shenjën më të vogël të hyznizimit, të himnizimit e të kultit të heronjve. E, megjithatë, për të plotësuar e për të qartësuar më mirë idenë e vet, D. Agolli, si poet realist konstaton se «Ne

ishim krah tij bashkë si gishtat e dorës / në akull, pranverë, dritë a terr, / ne ishim krah tij mes skamjes, urisë, dëborës, /dhe ti i thoshe: «Pri, biri i nënës, Enver!», duke na dhënë kështu një konkretizim poetik të unitetit popull-parti-udhëheqës dhe të kuptimit marksist-leninist të raportit hero-masë.

Epika dhe heroika nuk janë veçori vetëm të luftës me armë, të betejave luftarake e të ndeshjeve me armiqtë. Epika dhe heroika janë karakteristika të të gjithë historisë sonë, të tërë jetës shqiptare. Këtë të vërtetë e kanë mbajtur mirë parasysh shkrimtarët, e ka pasqyruar mirë letërsia e realizmit socialist. E gjejmë këtë edhe në poemën «Nënë Shqipëri», ku zbulohet e shkëlqen heroizmi popullor dhe ngrihet lart prej poetit ideali ynë shoqëror estetik. Një poezi e tillë, që e sheh realitetin në sy, s'mund të jetë as idilike, as pompoze. Ajo e pasqyron jetën në bukurinë e ashpër që karakterizon kohën tonë, ngre mbi kotradiktat e mprehta madhështinë e veprës së popullit e të Partisë, u këndon me zëplotë e me gjithë zemër shoqërisë e rendit socialist, ndeshjeve, betejave të fituara, ngjall optimizëm e besim për të nesërmen e atdheut e të njerëzimit.

Lufta e klasave është parë e pasqyruar me realizëm në disa pamje kryesore ku përmbahet dhe një prej elementeve më veprues të brendisë ideomocionale.

Në kohën kur Shqipëria «çapitej nga lufta në punë, nga gjaku në djersë.../me plagë në trup, me besim e shpresë, /me nagant e me kazmë në dorë» «të përmbysurit bejlerë, tregtarë, borgjezë, zhuzhisnin për ne si gjinkallat drizave», ndërsa në anën tjetër «sheshi i Tiranës ziente nga orët e reja, /hidhte Enver Hoxha në ofensivë klasën: /«Proletarë, fshatarë, mësues, poetë, /në rresht për beteja, /që monstra e mposhtur mos ta lëvizë nga varri dërrasën!»

Kjo logjikë e luftës së klasave, pa të cilën as që mund të bëhet fjalë për Shqipëri socialiste, mishërohet në një formë, që si dhe disa pazazhe të tjera të kujton Majakovskin. Ajo përshkon këngët e poemës, që nga demaskimi i



mbretit e i princeshave, që u ranë puplat, «bejlerët, ministrat e gjeneralët» që urdhërohen prej partizanit të hapin kanale, se ndryshe «s'ka bukë», deri te denoncimi i «Traktatit të Varshavës» dhe i tradhtisë e i demagogjisë së krerëve revizionistë për të arritur në vargjet e fundit plot frymëzim, kushtuar solidaritetit ndërkombëtar të revolucionarëve dhe besimit të patundur se «internacionale do të jetë Bota e Re».

Rrafsh tjetër me rëndësi i frymës së luftës klasore është në poemë vendosmëria për të qëndruar pa lëkundje deri në fund në pozitë e vijën e drejtë të Partisë, për pastërtinë e ideologjisë së saj si garanci të ndërtimit të socializmit e të mbrojtjes së atdheut. Përndryshe, vëren poeti, «po luajte një grimëz perin që mban terezinë, /sikur mbi qepallat pak të rëndojë kandari i gjumit, /rrëzohen e shemben mur e godinë» dhe socializmin «e merr lumi».

Është kjo arsyeja që «S'bën socializmi shartime në pyllin e madh të kohës, /siç bën kopshtari në kopsht me fidanët e mitur; /programi i tij me kanunin mjekrosh s'shartohet, /ndaj rrënjë i nxjerr çdo peme me kokrra të hidhura. /Ata që bëjnë shartime dhe ia prishin fidanët /i flak me tërbim si deti në breg leshterikët... I flak se s'do të trokasin nga jashtë, /si ujku në përrallën e Dhisë e Kecave/ me gjuhën e lashtë! të lajkave, dhunave, gënjeshtreve...»

Ideja e atdhedashurisë është shkrirë në poemë me idenë e domosdoshmërisë historike të shndërrimeve rrënjësore të jetës e të ndërgjegjes së njerëzve, të thellimit të vazhdueshëm të revolucionit. Poema përshkohet deri në vargjet e fundit nga ide të qarta e të fuqishme atdhetare. po në të nuk gjejmë asnjë shenjë idealizimi. Shqipëria dhe shqiptari janë portretizuar me ngjyra realiste, në procesin e ndërrimeve të përhershme, që i lartësojnë dhe i bëjnë më të dëlirë e më të bukur. Poeti shkruan:

«S'jam gëzuar veç me paqën e thjeshtë të maleve, /s'jam gëzuar veç me luftën që zoi të huajt e solli lirinë. /gëzohem për shembjen e botës së halleve, /gëzohem për shembjen e shtypjes së njeriut mbi njerinë».

Socializmi, thuhet në poemë, s'ngjitet në male si filladi në bahçe, po në luftë me gjithçka që pengon e frenon zhvillimin, me trashëgimet e këqija të së kaluarës dhe më ndikimet e sotme borgjeze e revizioniste. Ky është një tjetër aspekt i luftës së klasave dhe i mendimit aktiv që zotëron në poemë, megjithëse Dritëro Agolli, me thjeshtësinë që e karakterizon, e ka parashtruar dhe këtë mendim si mësim nga jeta dhe jo si përfundim arsyetimesh apo si thirrje patetike. Nga e sotmja në të ardhmen këtë mendim e shtrin vetë prirja themelore e poemës.

Mendimi se socializmi «i tundi malet me dorën e tij të hekurt, /u ra me kopan siç u biem dyshekëve, /u shkundi pluhurin mbetur nga shekujt, /u qepi arnat dhe u hoqi mykun prej leckave» megjithëse është paraqitur si konstatim për të kaluarën e afërt, ruan karakter veprues edhe për ditët tona, për vazhdimin e kësaj shkundjeje ndaj çdo myku që njeriu i ri përherë në zemër e në mendje të ruajë «shkëndijën që ndezëm në malet e lartë» e në ballë të ketë ëndrrën e ndritur me zjarr komunizmi».

Mendimi i gjallë për realitetin e sotëm dhe për të ardhmen e revolucionit bëhet më i qartë në frymën polemike dhe kritike të poemës ndaj atyre njerëzve që janë gati të hartojnë libra edhe për një ishull sa pjata, po rrinë dhjetëra vjet pa shkuar në vendlindjen e tyre; ndaj atyre që presin me lugë në brez të hanë «tavën që shtron socializmi» «dhe vetë përtojnë të ngrenë një gur para këmbës» si dhe ndaj disave «që fjalë të mençme si lumë lëshojnë, /sikur në një bankë me Marks të kishin mësuar, /pastaj në mes të furtunës krahun e majtë e të djathtë harrojnë, /dhe mbeten në rrugë me shpirt të mjeruar».

Poema «Nënë Shqipëri» ka frymë të thellë afirmuese. Ajo është këngë e frymëzuar për gjithçka të bukur e revolucionare në të kaluarën dhe të sotmen, për njeriun e ri që plot siguri e krenari pohon tok me poetin:

«Të gjitha janë të miat: shkollë, tokë, fabrikë, /dhe unë këndoj, gëzohem e mburr me gjithë zë.»

Nuk është e rastit që perspektivën e atdheut poeti s'e ka përfytyruar me imazhe qytetesh e me oxhakë uzinash.

siç është bërë zakon në poezinë standarde, po me një këngë për rininë, duke theksuar kështu se vazhdimësia njezore është më kryesorja në procesin e zhvillimit, mbasi nëpërmjet saj realizohet vazhdimësia e idealeve revolucionare.

Atdheu dhe bota është një tjetër motiv që përshkon poemën. Është edhe ky një motiv i rrahur me kohë në poezinë tonë, por i përsëritur me freski me origjinalitet dhe me realizëm, duke u qëndruar larg qoftë dhe simptomave më të zbehta të nacionalizmit e të kozmopolitizmit. Këtë motiv nëpërmjet kujtimit të përrallës së dhisë e të kecape — që mbase mund të ishte përmendur më me kursim — si dhe në formë të tjera e gjejmë pothuajse në të gjitha këngët e poemës, po në këngën e fundit ai bëhet motiv zotërues.

Shfletojmë poemën dhe sjellim ndër mend historinë, kujtojmë fjalimet e shokut Enver në Kongresin e FDSH-së e përpara zgjedhësve, na vjen jehona e vargjeve të poemës «Dëshirë e vërtetë e shqipëtarëve» e Naim Frashërit dhe zbulojmë të vërtetën e madhe se populli ynë as ka prekur njeri, as është pajtuar me padrejtësitë; ka kërkuar miqësinë, por i ka mbajtur në grykë të pushkës armiqtë, kurse sot thotë me dinjitet fjalën e vet revolucionare, internacionalistë. Prandaj, si përfundim i historisë dhe i aktualitetit, duke llogaritur situata e koniunktura, miq e armiq, shantazhe e demagogji, poeti thekson me të drejtë e me besim:

«Le të ziejë bota-kazan mbi zjarre /Le të ziejë bota — kazan mes flakës, /mes botës ti, Nënë, qëndron e bukur e krenarë /dhe kurrë nuk rrudhesh dhe kurrë nuk plakesh.

Në botën e madhe mbushur trazira qëndrojmë modestë, / modestë diçka i japim njerëzimit; askënd s'trazojmë dhe jetojmë me djersë /.../ dhe globi ka njerëz që zërin tonë nderojnë, dhe thonë fjalën e ngrohtë «mirë»! /Dhe tok me ne përpiqen, luftojnë, punojnë...»

Për shkrirjen e të gjitha këtyre motiveve dhe të disa motiveve të tjera më pak të rëndësishme, (siç janë motivi i raporteve të poezisë me jetën, i kuptimit të zhvillimit shoqëror e teknik etj.) në një tërësi të vetme poetike, Dri-

tëro Agolli ka zgjedhur formën e poemës lirike-epike, në të cilën janë harmonizuar përgjithësisht me sukses pasqyrimet e realitetit historik e aktual me mbresat, ndjenjat dhe përsiatjet e poetit. Me rëndësi është të shënojmë se edhe në poemën «Nënë Shqipëri», sikurse në veprat e tjera të poetit, ndihet mirë se jeta e gjallë e popullit është burimi i të gjitha frymëzimeve, përjetimeve, figurave, artistike e përgjithësimeve dhe se puna dhe mjeshhtëria e poetit është që këto t'i mishërojë sa më mirë në procesin krijues. Dhe vërejmë se, përgjithësisht, pasqyrimet epike janë dhënë në forma të përgjithësuara, kurse përthyerjet e realitetit në ndjenjat e mendimet e poetit, burojnë natyrshëm prej pasqyrimin të aspekteve më të ndryshme të këtij realiteti.

Në letërsinë tonë të sotme dhe në atë të traditës nuk janë të pakta poemat epike-lirike e lirike-epike. Në lëvrimin e këtyre tipave të poemës kanë dhënë ndihmesë të shquar De Rada, Dara, Mjeda, e në kohën tonë: A. Çaçi, Dh. Shuteriqi, Ll. Siliqi, I. Kadareja, F. Arapi, A. Gjakova, K. Petriti, A. Istrefi, etj. Secili prej këtyre, në përshtatje me temën e zgjedhur e me përveçësinë e individualitetit poetik, e ka plotësuar kuadrin dhe ka pasuruar traditën. Në krijimtarinë e këtyre poetëve dhe në vepra autorësh të tjerë janë përpunuar mënyra e mjete shprehëse për shkrirjen e përfytyrimeve epike me përsiatjet lirike, të personazheve historike e të heronjve të përgjithësuar, të paraqitjes objektive me ndërhyrjet e efektshme emocionale të poetit.

Një formë të tillë poetëve duket se ua sugjeron vetë realiteti dhe dëshira për pasqyrim sa më të plotë të tij në përthyerje ideoemocionale dhe në përfytyrime sa më të prekshme rrafshesh, mjedisesh dhe ngjarjesh. Në këtë traditë «Nënë Shqipëri» vjen e mirëpritur si ndihmesë e re e poetit që gjithashtu e ka lëruar poemën e tipit lirik-epik («Devoll, Devoll», «Baballarët» etj.). Kësaj radhe poeti i ka hapur gjerësisht krahët dhe e ka hedhur më larg vështrimin, për të përfshirë përmasat e kohëve, historinë dhe perspektivën që përgatit e sotmja. Në konceptimin e veprës ka diçka në vazhdim të traditës së përme-

ndur, po më tepër përgjasim ka me poemat «Bagëti e bujqësia» të Naimit dhe «Bukur!» të Majakovskit, me gjerësinë e të parës dhe ritmin dinamik të së dytës.

Përpjekja për të dhënë njëherësh vijimësinë historike, shpalosjen e një problematike të pasur dhe përthyerjet e jehonave të historisë e të aktualitetit në vetëdijën krijuese ka qenë një prej çështjeve më të vështira artistike që duhej realizuar. Historia duhej «treguar» pa rënë në paraqitje kronikale, por edhe përmes përsiatjeve të domosdoshme që shprehin gjendje të larmishme emocionale dhe thellojnë përgjithësimin artistik. Veç kësaj, vijimësia historike, e parë kryesisht në rrafsh ideo-politik s'duhej të bëhej pengesë për gjerësinë e pamjeve dhe problemeve nga historia dhe e sotmja. Nuk mund të thuash se ky pikësynim madhor është arritur përsosmërisht në poemë. Konceptimi tërësor i saj mund ta kishte pasur bazën më të gjerë dhe formën shprehëse më sintetike, siç është, për shembull, përshtat objektit poetik, poema «Bagëti e bujqësia». Me gjithë këtë, edhe rruga e zgjedhur nga D. Agolli i është përshtatur mirë gjerësisë së temës dhe prirjes për ta rrokur realitetin në mënyrë sa më polidrike.

Nga pikëpamja e ndërtimit, vështirësia e përmendur është kapërcyer deri diku duke vënë theksin në secilën këngë (kapitull) në një rrafsh problemor, historik a shoqëror të caktuar, me synim pothuajse shterues. Çdo këngë ka një bërthamë ideoemocionale të vetën, një pjesë e tyre dhe një «mikrosubjekt» që lidhet me tërësinë e poemës nga ideja e atdhedashurisë dhe e vazhdimësisë historike. Në këtë drejtim autori e ka shtrirë mjeshtrisht problematikën në kushtëzim e përshtatje me periudhën a rrafshin historik që përfshin kënga, me synimin që idetë dhe ngjyrimet emocionale të dalin vetvetishëm nga gjendjet. Por kjo është vetëm njëra prej mundësive të shfrytëzuara.

Konceptimi dhe interpretimi i historisë dhe i realitetit bashkëkohor në prizmin dhe frymën e partishmërisë dhe të patriotizmit socialist, është, padyshim, rruga më e frytshme e zgjedhur nga autori për paraqitjen e tipareve

moralo-politike të shqiptarit të sotëm, për të harmonizuar zërin e vet poetik me zërin e bashkëkohësve, për t'u bërë natyrshëm zëdhënës i tyre, i Nënës Shqipëri.

Në çdo këngë çdo pjesë historie shoqërohet me një qëndrim ideoemocional të dukshëm, me një ndjenjë atdhedashurie që derdhet lirshëm nëpër vargje herë me entuziazëm, herë himnizuese, herë të tjera denoncuese apo kushtruese. Në përforcim të këtij tabani ideoemocional, mbase do të kishte qenë e udhës që autori të mos kish lakmuar aq shumë futjen e informacionit historik dhe ndonjë interpretim naiv (p.sh. vargjet për fierin dhe Fierzën).

Figura e vetë poetit dhe ndërhyrjet e drejtpërdrejta të tij janë një element shprehës e organizues për harmonizimin e elementit lirik me atë epik. Është në natyrën e Dritëro Agollit që të shfaqë vetveten edhe pa u njesuar me heroin lirik, pa u «fshehur» pas tij. Që në vargjet e para të poemës lexuesi takohet me poetin, i cili e fton, si të thuash, ta ndjekë në shtjellimin e temës e të motiveve, në punën krijuese për thurjen e vepërës. Gjatë leximit të poemës ai na del shpesh përpara, diku na thërret, diku na zbulon mendimet e përjetimet e veta, diku na tregon ndonjë hollësi shprehëse, duke marrë atribute të një heroi lirik, ndonjëherë edhe komenton. Prania e figurës së poetit shërben jo thjesht si lidhës në mes këngëve, por edhe si mjet që përgjithësisht e ka kompaktësuar poemën, ka gjallëruar atmosferën emocionale, frymën e polemikës dhe të debatit politik e ideologjik.

Përmes këtyre mjeteve shkrirja e elementeve lirike dhe epike është arritur aq natyrshëm, saqë jo rrallë nuk mund të vihet kufi dallues.

«Dhe gratë psherëtinin për burrat e tretur, /gratë tona me duar fisnike, /me sy të mëdhenj si burimet në pyjet e fjetur, /rritur pa kreme, rritur pa kozmetikë, /ato që uleshin, si hanin burrat, në sofër, /pëllumbeshat tona në fundin e odës, /ato që vdisnin sikur s'kishin jetuar kurrrë, /kur gjaku ngadalë, në cep të minderit, u ngrinte në

dej; /ato që mbanin në shpinë vandakët me drurë, /ato që mbanin në gjoks fëmijë të hej si kërcejtë».

Ndonjëherë në pak vargje janë bërë karakterizime aq të plota dhe aq të sakta situatash dhe epokash, që dhe historiani më serioz mund t'i kishte zili, si në vargjet lapidare kushtuar Skënderbeut:

«Mbi vithet e kalit të bardhë rëndonte nata e mesjetës, / mbi jelet e kalit të bardhë binte mëngjesi i Rilindjes, /mbi trokun e kalit të bardhë kushtronte zëri i trumpetës...»

Për harmonizimin e elementeve epike dhe lirike e të motiveve të ndryshme dhe për të krijuar mundësi të gjera shprehëse mbi «tridhjetë vitet-agime», janë përdorur disa mjete stilistike përgjithësuese, si personifikimi i Shqipërisë në figurën e njohur të Nënës. Personifikimi është përdorur mjaft kohë më parë, por asnjëherë nuk ka pasur gjerësi të tillë dhe nuk është gërshetuar me aq mjete shprehëse plotësuese e mbështetëse. Dritëro Agolli ka mundur ta karakterizojë këtë Nënë dhe me dy fjalë («hallemadhja shekullore») apo të japë në mënyrë të prekshme emocionale lidhjet e atdheut me bijtë e tij, të shkrijë në një të vetme tokën me njerëzit, Shqipërinë me popullin shqiptar, në luftë, në brenga, në këngë, në revolucion. Poeti ka kërkuar, krahas personifikimit, figura si strehëza — shtëpia e popullit ka vënë vetë popullin, Shqipërinë në luftë e revolucion. Po ashtu e gjallëron personifikimin përqasja me motivin e përrallës për pabesinë e ujkut. Pra, dy figura që plotësojnë njëra-tjetrën, kanë shërbyer në raste të ndryshme për të njëjtat qëllime ideo-emocionale.

«Poema «Nënë Shqipëri» është vazhdim i traditave më të mira të poezisë sonë popullore e atdhedashëse, një kulm në krijimtarinë poetike të autorit. Jo më kot e rastësisht ky, disa herë me ndonjë teprim, u drejtohet vargjeve të poezisë popullore, që nuk rrinë me zor, por natyrshëm në poemë, mbasi fryma e përgjithshme e vepërës, thjeshtësia dhe qartësia e saj, mënyra e konceptimit dhe e pasqyritit të realitetit janë shumë të afërta me krijimtarinë poetike popullore, janë pjellë dhe vazhdim i

saj, ashtu siç janë shprehje e lidhjeve të gjalla me realitetin e kohës, me jetën e popullit dhe me aspiratat e tij.

Kjo poemë i shtohet vargut të krijimeve poetike të Dritëro Agollit, që janë bërë të dashura, se ato «shprehin ndjenjat e pastra të popullit, janë të lidhura me realitetin, me njerëzit e punës, me baltën, me prodhimet e lulet e kësaj toke, me oxhaqet e mëdha të kombinateve dhe me hallet e gëzimet e njerëzve në vatrat e tyre familjare».\*

«Të dua të çiltër, të dua të pastër, s'të dua të fshehtë, s'të dua të ngathët».

Këto vargje nuk janë një deklaratë e zakonshme poetësh. Ato janë bindje e thellë, që ka gjetur mishërim të admirueshëm e konkretizim edhe në poemën «Nënë Shqipëri».

1974

---

\*) E. Hoxha, Mbi letërsinë dhe artet, f. 479.



## Vëllimi poetik «Fjala gdhend gurin»

Në pashënien e vëllimit poetik «Fjala gdhend gurin», Dritëro Agolli, ndër të tjera, shkruan:

«Evoluimi i ndjenjave, raportet e reja morale dhe etike, botëkuptim i ri për sendet dhe fenomenet që na rrethojnë, meditimi për atë që kemi arritur dhe për atë që do të arrijmë në ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste, janë brumi që gatuan poezia në magjen e madhe të jetës... Mendimet dhe ndjenjat e bashkëkohësit, transformimet në shoqëri dhe proceset historike ajo i jep me koncizitet, me ngjyrën e fjalës së figurshme dhe me heroïn lirik, i cili është motori i poezisë».

Dhe është diçka kuptimplote kur poetët e mbajnë parasysh këtë të vërtetë. Kështu, në vargjet e tyre, si në damarët e jetës dhe në mendjen e në zemrat e bashkëkohësve, vërshon vrulli i pandalshëm i kohës, shtegtimi i mrekullueshëm drejt lartësive. Vërshon, kështu, në vjer-sha e poema mendimi i gjallë revolucionar i kolauduar në farkën e revolucionit, ndjenjat e reja, që lindin nga një botë e re në lëvizje e në transformim të përhershëm, të cilat hedhin dritë të re edhe në të kaluarën dhe e bëjnë më të konceptueshme e më të prekshme të ardhmen, ëndërrën... Dhe ecën kështu poezia bashkë me jetën e me njerëzit, ushqehet prej tyre dhe i ushqen ata, i bën ta kuptojnë e ta çmojnë më tepër të bukurën e të madhë-riushmen, t'i aspirojnë e t'i krijojnë ato, të mbushin me to jetën e tyre... Sa më tepër jetë të ketë në poezi, aq më tepër jetë do të ketë poezia.

Kjo jetë në poezi jepet me koncizitet e me ngjyrën e fjalës së figurshme nga poeti. Ne çmojmë në poezi jo vetëm bukurinë dhe madhështinë e jetës, poetikën e pasur të saj, po edhe mahnitjen e zbulimit të tyre nga poeti, bukurinë e konceptimeve e të pasqyrimeve të figurshme e mjeshtërore. Sepse ka rëndësi jo vetëm brumi, po edhe gatimi, bukuria e fjalës tingëlluese, muzikaliteti i vargut, ritmi i poezisë e i fjalës rrjedhëse, që domosdo duhet t'u përgjigjet ritmeve revolucionare të jetës, dinamizmit të saj, lëvizjes në botën e pasur shpirtërore të njerëzve tanë. Kjo punë nuk mund të bëhet vetëm me mendje, po kërkon edhe zemër, nuk arrihet vetëm me aftësi natyrore, po do kulturë, mjeshtëri për të ndjekur jetën për të hetuar ndryshimet që ndodhin në të dhe për t'ua përçar ato të tjerëve, t'i pushtojë ata si vetë mendjen e zemrën e poetit. Pa këtë nuk ka poezi, ka vetëm vargëzime, arsyetime, moralizime, predikime e pretendime në vargje. Botohen shumë vjersha, poema e vëllime poetike, por, edhe kur kemi të bëjmë me poetë e me poezi të vërtetë, ndodh që diçka të mos na ngrohë, të mos na shqetësojë, të mos na rrëmbejë... Në kësi rastesh poezia përthyen diçka të vjetëruar, nuk arrin të zbulojë e të shprehë atë lëvizje mendore e shpirtërore, burim të qëndrimeve të njeriut të sotëm ndaj rrugës së përshkruar, nuk arrin të shikojë jetën, siç thuhet, nën prizmin e shkallës së sotme të zhvillimit e të idealeve tona. Poetët e talentuar duhet të luftojnë më me këmbëngulje për ta kapërcyer këtë prapambetje. Shoqëria ecën përpara. Edhe poeti nuk mbetet ai i dikurshmi. Vërtet ai ruan në thelb fizionominë shoqërore dhe tiparet e një individualiteti krijues të përcaktuar, por edhe përvoja, kultura, moshja, vetë jeta, bëjnë të tyren dhe lënë gjurmë në krijimtarinë poetike, në të menduarit e tij artistik. Dhe ne, lexuesit e poezisë, kur marrim në dorë vëllimet e reja poetike, sidomos librat e poetëve tanë të mirënjohur, kërkojmë atje edhe të njohurin e dikurshëm, edhe gjënë e re që sjell ai në vazhdim. Poeti që arrin këtë mbetet

kurdoherë i ri, i freskët, interesant. Ai është gjithnjë në lëvizje, në rritje, në përsosje.

Në mendime e kërkesa të tilla të shtyjnë edhe vjer-shat e poemat e vëllimit të ri poetik të Dritëro Agollit.

## 2.

Në vëllimin poetik «Fjala gdhend gurin» takohemi përsëri me një poet të njohur, vargjet e të cilit na janë bërë të dashura. Krahas krijimeve që i hasim për herë të parë, gjejmë në vëllim vjersha e poema që i kemi lexuar më parë të botuara në shtyp, ndër to dhe poemat «Komunistët» e «Nëntoriada». Në të gjitha krijimet poetike të vëllimit, në motivet dhe mënyrën e trajtimit, në fizionominë e heroit lirik e në mjetet shprehëse ndeshim përsëri me ato tipare karakteristike, që e kanë bërë poezinë e Dritëro Agollit aq popullore ndër ne. Gjejmë diçka nga vetvetja të derdhur të heroi lirik i poezisë, ndjekim vetveten nën ndikimin e shndërrimeve socialiste të vendit dhe ecjes përpara të revolucionit. Janë tonat krenaria e poetit për atdheun e për Partinë, vendosmëria për të vazhduar luftën me konsekuencë, dëshira e tij për t'u shkrirë me popullin, për të jetuar e punuar tok me të. Janë tonat ndjenjat e ngrohta të dashurisë së tij të çiltër për njerëzit e thjeshtë, gëzimi i tij i vetvetishëm, humori, shpërthimet e zemërimit kundër armiqtë e fundërrinave, satira therëse dhe ironia e hidhur kundër shfaqjeve të një bote së cilës kushdo nga ne duhet t'i kthejë kurrizin me përbuzje e me vendosmëri. Shfletojmë librin «Fjala gdhend gurin» dhe e gjejmë poetin përsëri në rrugë anekënd atdheut, në mes njerëzve të punës, në mes arave e pishave, pranë shokëve e miqve, me të cilët e bashkon jeta dhe shpërthen dëshira për ta gëzuar këtë jetë.

Diçka prej këtyre ne kemi gjetur edhe në vëllimet e mëparshme të Dritëro Agollit dhe na vjen mirë, kur na bie rasti të gjejmë të pasuruar atë ç'ka qenë më

e shëndoshë dhe më e bukur në të gjithë krijimtarinë e tij. Na vjen mirë, mbasi kur themi se në shumë gjëra gjejmë vetveten, duhet të shtojmë patjetër se kjo na ka ndihmuar për të depërtuar në bukurinë e në madhësitinë heroike të jetës sonë, për zgjimin e ndjenjave revolucionare dhe të aspiratave për një jetë sa më të afërt me atë që bën populli, njeriu i punës e i heroizmave, ai që e prodhon vetë prandaj edhe shijon më mirë bukën në sofër.

Takon që poeti kujton përsëri në vargjet e veta të kaluarën, luftën dhe, ndonjëherë, sidomos në poema, edhe mund ta kalojë masën me përsëritje. Po ka dhe kjo përsëritje arsytet, veçoritë e veta të reja, në thellimin e atyre çasteve të së kaluarës që marrin më tepër vlerë aktuale, që ndërthuren me të sotmen, që kërkojnë ritrajtim për të sjellë diçka të re. Kështu në poemën «Nënë. Shqipëri» tema e atdheut dhe e revolucionit është trajtuar në mënyrë të shumanshme, kanë hyrë atje edhe motive të poemës «Komunistët». Kurse në poemën «Nëntoriada» janë ritrajtuar motive nga dy të parat, sado që në fragmente të veçanta ka shkëlqime të vërteta e të freskëta të talentit të poetit. Jehona e së kaluarës vjen në vargjet e vëllimit me krenarinë e ligjshme, me një përmallim të thellë, me një nxitje të brendshme bashkëkohore, ndonjëherë dhe me dramatizimin e saj të ashpër, duke u gërshetuar me të sotmen dhe perspektivën. Vjersha si «Pleqtë e qytetit tim», «Babanë tënd e kisha shok», «Maro Podgozhani», «Baladë malesh», «Zgjimi i baladave» etj., janë ndër krijimet më të bukura të Dritëro Agollit. Në këto vjersha e kaluara i flet së sotmes herë me gjuhën e heroizmave, herë me dramatizimin dhe me gëzimin e vazhdimësisë historike, të zhvillimit fitimtar të revolucionit. Ka në këtë trajtim diçka të re në krijimin e atmosferës së kohës, në shkrirjen e ngjarjes me ndjenjat e meditet e poetit dhe në kalimet nga e kaluara në të sotmen me natyrshmëri të madhe. Le të kujtojmë sa e pasur në ngjarje, në ndjenja e në mendime, sa e freskët e rea-

liste në trajtim është vjersha «Babañë tënd e kisha shok». Në dyzet vargje është dhënë një histori e tërë, janë shkrirë në një brenga për shokun e vrarë, dhe mbja e nënës, tronditja e së shoqes, naiviteti i fëmijës, mendimi i shqetësuar për fatin dhe rrugën e tij në jetë, vazhdimi i revolucionit, gëzimi i revolucionarëve që ndodhen e luftojnë krah për krah. Me ç'ndjenjë të thellë njerëzore është dhënë gjithçka! Lufta është epike, por e ashpër, sakrifica është e madhërishme, e dhimbshme, kurse jeta çan përpara përmes përpjekjesh e ndeshjesh në të cilat shqetësimi kryesor ka qenë e mbetet ecja përpara pa u lëkundur e njerëzve tanë si një vazhdat i pandërprerë heroizmi.

*Sikur të ndodhte ndryshe, do të vija  
Dhe derën ta shkallmoja me mundim,  
Për supesh si i çmendur do të zija,  
Dhe s'dihet ç'do të bëja në tërbim!...*

Por brendia kryesore e vëllimit është pulsi i jetës së sotme, ndjenjat dhe mendimet e bashkëkohësve, përfaqësues i të cilëve është poeti ose më sak heroi lirik, që shpesh njësohet me autorin. Motivet aktuale kanë qenë zotëruese në të gjithë krijimtarinë e poetit, ku janë ndier përherë zhurmat e kantierëve, erë bari e luleshqerre, vlagë dheu; është shpalosur shpirti i madh i njeriut të punës. Dhe, prapë, edhe këtu diçka ka lëvizur, diçka është e re: shpesh vihen re përthyerjet e kohës që ka ecur përpara dhe e moshës së pjekur të poetit. Në vjersha ka më tepër përsiatje, ka më shumë përmallim në dashurinë për jetën, për njerëzit, për fshatin, ka më tepër thellësi e gjerësi, ndihen përpjekje serioze e të suksesshme për të zgjeruar diapazonin e zbulimit të poezisë së jetës. I gjejmë këto motive të derdhura bukur në vargjet e vjershavë «Malli i parë», «Shoqëria», «Vëlla, sa shumë prite!», «Shokët e mi», «Shtigjet», «Bukuria», «Natë», «Kënga e mjerimit», «Reliktet e heroit», «Dy fjalë poetëve që vijnë» etj. E, në

të gjitha këto, po ai shpirt i gjallë, po ato hove të gëzimit të jetës, po ajo dëshirë për vrull e pasione të rinisë, po ajo lirikë e ndier dhe po ai humor që vërshon kudo ngazëllyes. Motivi kryesor ka mbetur hetimi i fizionomisë e botës shpirtërore të njeriut tonë të sotëm, puna e lufta për mishërimin e fitoren e asaj që është njerëzore dhe revolucionare:

*Të dhembshur me shtëpitë kemi qenë,  
Fëmijët si të marrë i kemi dashur,  
Po shpesh në shtrat në gjumë i kemi lënë,  
Andralla e telashe kemi pasur...*

Kjo është epika e jetës sonë, prandaj kushdo gjen përsëri vetveten në vargjet e poetit, e kupton atë dhe i bëhet më e dashur kjo jetë me një bukuri të ashpër e kuptimplote. Prandaj na duket fare e natyrshme të jenë shkruar pak vargje për dashurinë, kur revolucioni kishte aq shumë nevojë për këngë.

Në poezitë e vëllimit, sidomos në dy poemat e fundit, profili moralo-politik i bashkëkohësit tonë ndriçohet edhe përmjet ballafaqimit me të kaluarën e me botën e sotme borgjezo-revizioniste. Edhe këtu kemi të bëjmë me një aspekt të kohës, me një kundërvënie historikisht reale, prej së cilës kalohet e depërtohet më thellë në të renë e tipareve dalluese të njerëzve tanë, të vendit tonë.

Të vërteta e të fuqishme tingëllojnë vargjet:

*Ne jemi mësuar të ndjekim vetëm një vijë kristali,  
Një vijë pa vija të tjera që zgjaten në izëm,  
Ne jemi mësuar t'i falemë vetëm atij ideali  
Me emrin e kuq — komunizëm!*

Poeti shfren dufin edhe kundër servilit që vajton shefin, fshikullon vagabondët, qorton gjyshen që rron ende me konceptë mesquine apo njeriun që priste t'i vente vëllai në fshat si shef i madh e jo si poet etj. Kritika kundër njollave e të njollosurve është realizuar

në formën e fabulave, që Dritëro Agolli i ka përtërirë me mjeshtëri, sidomos kur mendimi është më i konkretizuar.

Motivet e fshatit mbeten gjithnjë të dashura për poetin, mbasi:

*Vërtet shkrova poema në qytete,  
Po mbeti esenca ime prej fshatari....*

Në vëllimin «Fjala gdhend gurin» vjershat për fshatin janë më të pakta po «esenca prej fshatari» ndihet në një pjesë të mirë të krijimeve, edhe kur motivet janë më të përgjithshme. Kjo përshtypje përforcohet prej stilistikës poetike, prej ngjyrimit të figurshëm popullor të vargjeve dhe prej prirjes së përhershme të poetit ndaj natyrës. Po sikur pak ndihet në vjersha fshati i sotëm, fshatari i ri, «bariu me motoçikletë», hapësirat e kooperativave të tipit të lartë, shndërrimet e shumanshme socialiste që po ndodhin në fshatin tonë të sotëm. Nuk është jashtë sferës së ndjenjave të njeriut tonë të sotëm, pra, edhe të poezisë, dashuria për peizazhin e fshatit, dëshira për të mbështetur fagen në shpatullën e kaut etj., po më me rëndësi na duket se janë elementet e reja që hyjnë në jetën e mendimet e fshatarit, tiparet që karakterizojnë rininë e sotme të fshatit. Dëshirojmë që në trajtimin e këtyre motiveve të hidhet më shumë dritë e re, të zbulohet më gjerë e më thellë poezia e fshatit të sotëm, për të kuptuar edhe më mirë pse rritet dashuria për të, si:

*...Dëshira e njeriut të vërtetë  
Që mund të niqet nga gjiri i qytetit,  
Kur shkëmbi e guri e ftojnë t'u japë jetë...*

Heroi i poezisë së Dritëro Agollit nuk është një skemë. Asketizmi për të është i huaj. Ai «ngrihet në kal-tërsinë, i larë me mëngjese e me dritë,/ i zien ndër-gjegjia e klasës në damarë», e do jetën dhe punon e lufton që ajo të bëhet gjithnjë më e bukur, më e lum-

tur për të gjithë. Ai zbraz pushkë e qëndron i patundur përballë tallazeve të historisë, po di të thurë këngë, të thotë fjalë të ngrohta dashurie në një natë me hënë; e të hedhë me shokë vallen burrërore. Po të nisemi prej paragjykimesh e moralizimesh intelektuale, mbase edhe mund të habitemi me ndonjë vjershë si «Balada e Rrush-Rushitit» dhe ta qortojmë poetin. Mirëpo nuk ka asgjë të keqe që edhe vjersha të tilla të shkruhen dhe të këndohen nga populli. Gjersa motivet janë reale, të jetës njerëzore, kanë vendin e tyre edhe në krijimtarinë poetike e duhen marrë me humorin dhe ndjenjën optimiste që i përshkon.

### 3.

Poezia e Dritëro Agollit, me fizionomi të qartë kombëtare popullore, me shpirtin e popullit dhe frymën e krijimtarisë së mrekullueshme popullore, vjen gjithandej erë shqipe. Ndihen mirë lidhjet me traditën, përthyerje të *poezisë së Naimit* («Shokëve të mi», «Pleqëria» e disa fabula), po siç thotë edhe vetë në një prej vjershave të tij, D. Agolli ka gjetur rrugën e vet. Sado popullor dhe i lidhur me traditën letrare të mëparshme, ai është poet i sotëm dhe plotësisht origjinal. Në krijimtarinë e tij, aq më pak në vëllimin e ri, të rralla janë stilizimet me frymë popullore. Por, megjithëkëtë, ç'nuk është popullore në poezinë e tij? Ashtu siç ka depërtuar në vargje jeta e popullit, ndjenjat dhe mendimet popullore, po ashtu jehon në to poezia popullore, tingëllimi i përgjithshëm i saj, jo aq në shfaqjet e jashtme, sa në frymën që e përshkon, në përshtypjet që krijon, Për të është e huaj çdo shfaqje intelektualizmi. Mendimet e ndjenjat burojnë nga vetë jeta dhe heroi lirik është njeriu i popullit, ai që është kënduar edhe në krijimtarinë popullore dje dhe sot. Origjinaliteti i poezisë së Dritëro Agollit dhe vlera kryesore e saj na duket se lidhet pikërisht me përthith-



jen krijuese të traditës kombëtare e popullore, së cilës i është dhënë një shprehje e veçantë, e papërsëritshme. Në vargje shprehet bota e një poeti që nuk e ndan veten prej popullit, po edhe nuk njihet plotësisht me të. Heroi lirik i poezisë së D. Agollit është njeriu i pararojës e nën prizmin e idealeve të tij komuniste gjykohet gjithçka në jetë, në të kaluarën e në kohën tonë. Shpirtin e popullit poeti si simfoni e ndien së largu, e ndien si bubullimë dhe jehonë, prandaj dëshiron që ky shpirt të lulëzojë varg pas vargu. Le të jenë, thotë ai, vargjet të matura, të pamatura e të lira, mjafton të kenë gazin dhe brengën e popullit të madh e zemërmirë.

Vëllimi «Fjala gdhend gurin», krahas këtyre anëve, ka edhe disa veçori që tregojnë se poeti është në vazhdim të rrugës krijuese dhe po arrin lartësi të reja në përvijimin e zbulimin më të plotë të vetvetes dhe në përsosjen e mjeshtërisë artistike. Në poezitë e vëllimit ka më tepër siguri ndjenje, më shumë mendim të ngjeshur, forcë shprehëse më të madhe, konceptime poetike më sintetike, përpjekje për të trajtuar motive më përgjithësuese. Ka në vjersha një frymëmarrje më të gjerë ideore; bashkëbisedimi me lexuesin është më i shtruar, vargjet më të qeta, më me peshë dhe më të përpunuara. Ndihet në vëllim përvoja e gjatë e fituar, pjekuria e një poeti të talentuar, që duket se do të krijojë edhe në të ardhmen vepra poetike me vlerë.

Vëllimi «Fjala gdhend gurin» është ngjarje me rëndësi për jetën letrare të viteve të fundit. Ai tregon që poezia jonë, krahas romanit, po arrin dhe ka mundësi të arrijë lartësi të reja. Sa më shumë poezi jete, aq më shumë jetë ka poezia — ky do të ishte përfundimi kryesor që ritheksojmë.

## Vëllimi poetik «Udhëtoj i menduar»

Në poezinë e Dritëro Agollit hasen shpesh fjalët rrugë dhe udhëtim. Kjo nuk është rastësi. As imtësi që të mos vihet re nuk është. Shumë vjersha e poema të këtij autori sjellin mbresa e përjetime shtegtimesh fshatrave e kantiereve, jehonën e lëvizjes së popullit udhëve të historisë, dinamikën e jetës sonë socialiste. Në to rroken procese shndërrimesh revolucionare, pasqyrohet formimi e lartësimi i njeriut të ri, tregohet si vetë poezia, nën ndikimin përtëritës të jetës, është në lëvizje të pandalshme, kur mban vulën e kohës.

Për të dalë me një libër të ri, për të sjellë diçka të re, vështirësitë me të cilat ndeshen shkrimtarët e afirmuar, nuk janë të pakta. Shkrimtarit të njohur i duhet shumë mund që të mos mbetet në vend, të mos përsëritë vetveten e të mos humbasë besimin e stimën e popullit. Pikërisht se ka ndjekur këtë rrugë, Dritëro Agolli ka arritur që lexuesit ta presin me kënaqësi çdo libër të tij, si shprehje të veçantë të një veprimtarie krijuese të begatë.

Përmbledhja «Udhëtoj i menduar», me vjershat më të mira e me «Poemë për babanë dhe për vete», dëshmon se autori po e pasuron poezinë me motive, përjetime e përsiatje të reja, i jep tonalitete e ngjyrimet rimore, përpiqet të shtojë mundësitë paraqitëse e të përtërijë mjetet shprehëse, duke ruajtur në drejtimet kryesore fizionominë e përgjithshme të individualitetit të vet artistik.

Në këtë përmbledhje, që ka afërsi ideotematike me

«Fjala gdhend gurin», takojmë po atë poet të njohur e të dashur, të çiltër, të kthjellët e të qartë; joshemi nga po ajo lirikë e ngrohtë e depërtuese, ndërthurur me nota gazmore plot humor, me patos realist militant; gjejmë po atë këngëtar të pasionuar të natyrës e të fshatit, të luftës e të revolucionit, të punës e të njerëzve të punës, të dashurisë së zjarrtë e të dëshirës për të gëzuar jetën; vërejmë po atë denoncim të rreptë të psikologjisë e mentaliteteve mikroborgjeze, të burokratizmit, të indiferentizmit dhe të madhëstisë së shtirur.

Këto tipare dalluese si dhe veçoritë e stilit marrin tjetër tingëllim në përmbledhjen që po analizojmë. Karakteristike është se në brendinë e vjershave, dukuritë e paraqitura, përthyerjet e realitetit në vetëdijën e krijuesit dhe vetë karakteristikat e konceptimit e të shprehjes poetike lidhen ngushtë me fillimin e viteve '80 (shumica e vjershave janë të viteve 1982-1984), paraqesin me besnikëri atmosferën e përgjithshme të jetës shoqërore e politike, një stad të mirëpërcaktuar të krijimtarisë së autorit. Ky është një sukses i vërtetë, një shembull për bashkëkohësimin e brendisë e të formës së poezisë, një arritje e re në risimin e pandërprerë të saj.

Në vjershat e vëllimit e në «Poemë për babanë dhe për vete» vërehet prirja e autorit për t'i dhënë më tepër përparësi mendimit, për të qenë më i shtruar, më i matur e më i përmbytur në shkrimin e ndjenjave, të përjetimeve e të aspiratave të heroit lirik. Hovet e diskutshme djaloshare, karakteristike për përmbledhjet «Në rrugë dola», «Hapat e mia në asfalt», «Shtigje malesh e trotuarë», «Mesditë» në librin e ri (si dhe te «Fjala gdhend gurin») ia lënë vendin dinamikës së brendshme, rrejtjeve për të depërtuar në thellësi të dukurive e të ndjenjave, për të zbuluar bukurinë e kuptimit të gjithçkaje që ndodh e përjetohet. Hovet dhe entuziazmi rinor në vjershat e përmbledhjes së re kanë mbetur si një nënshtrësë vepruese që, duke u përtëritur, bëhet ndërlihdëse dy kohësh, u jep krijimeve veçanësinë e papërsëritshme të etapës së re të zhvillimit. Varianti i ri i «Poemë për babanë dhe për vete», botuar së pari më 1956, është

shembull i qartë i ndryshimeve cilësore në poezinë e autorit gjatë tridhjetë vjetëve. Në poemë është ruajtur nga varianti i parë çiltërsia rinore dhe thjeshtësia e ndërtimit vijimor të subjektit. Por, ndërkaq, ajo është përpunuar e përtëritur në brendi e në formë. Është zgjeruar sfera paraqitëse e realitetit ndërthurur natyrshëm me përjetimet e dy heronjve, me përsiatjet e ndërhyrjet vende-vende të poetit, me shprehjen e mendimevë për gjithë ç'ndodh e tregohet, veshur me tisin e përmallimit për një kohë të kaluar, të trazuar e të lavdishme. Ndërsa në variantin e parë poeti i ri vinte theksin në portretizimin e t'et, në variantin e ri trajton edhe vetveten nga një majë më e lartë, me qëndrim të ri ideoemocional që nuk mund të mbahej më parë. E njëjta gjë vërehet dhe në shumë vjersha që janë në vazhden e parapëlqimeve tematike të autorit. Ato janë përsëri interesante e të freskëta, sepse, në mos në thelbin kuptimor e emocional, të paktën në intonacione e në mënyrën e shprehjes ia paraqesin autorin lexuesve në një etapë të re të «shtegtimit».

Kjo tërheqje pas mendimesh e përmallimesh dhe sensi i të përmbajturit të vetvetes nuk ka zbehur militantizmin e poezisë. Qëndrimet e autorit përsëri shfaqen hapur e guximshëm, pa ndërlikime stili, arsyttime abstrakte e thirrje për efekt. Theksi polemik në përmbledhjen «Udhëtoj i menduar» vjen më i mprehtë, nënteksti i vjershave më i pasur. Afirmimi i anëve të ndritura të jetës dhe i prirjeve të zhvillimit, jo rrallë, arrihet përmes zërthimit të një kontradiktë me anë të konstatimesh të forta, gjendjesh të shqetësuar, shtresimesh ndjenje e mendimi që pranëvihen në kontekst të gjerë kohor e shoqëror (p.sh. «Udhëtoj i menduar», «Monologu im para një diversanti», «Lamtumira e pëllumbave», «Ky njeri», «Telefoni», «Para dhe pas shkrepimës»). Në kësi vjershash dhe në ato që mbartin problematikë shoqërore e politike të ditës, qofshin lirike, qofshin humoristike e satirike («Shok i dashur», «Për shqetësimin poetik», «Një çast i pagjumë», «Plazhi», «Kali dhe gomari» etj.) angazhimi i autorit del më në pah përmes evokimesh, përsiatjesh, qëndrimesh ironike e satirike, aty-këtu dhe

përmes shfaqjes së brengës shkaktuar prej dukurish të pakëndshme. Vetëm më të rrallë ky mendim apo ideja që përmban vjersha është disi evaziv, i shkrirë në vizi-me kalimtare («Hëna mbi livadh», «Lule dielli» etj.). Kur përshtypjet janë konkrete e të prekshme, ideja përmbahet si element i vetë përfytyrimit poetik, si të thuash, njësohet në të, ndërsa kur vjersha merr ngjyrimë metaforike, lë shteg për interpretime (p.sh. «Në erë pemët rrinë pranë e afrojnë krahët, në erë pemët kërkojnë mes tyre ngrohtësi. /Po ne të dy?! Ne jemi kaq të largët?! /Ç'erë mund të na afrojë, nuk e di...»).

Vend me rëndësi në «Udhëtoj i menduar» zënë dhe vjershat me motive intime të miqësisë, të dashurisë, të përmallimeve për kohë të shkuara, vende e njerëz të dëshiruar, për gjëra që «i do me zemër e shpirt, por s'qëndrojnë» («Dashuri e vështirë», «Shokët e vjetër», «Përrenjtë», «Një vegim i largët», «Turkësja» etj.) Për t'u vënë re është se në vjershat e kësaj përmbledhjeje intimiteti, si frymë e shprehjes poetike, shtrihet thuajse në çdo krijim, pavarësisht në është a jo intim motivi i trajtuar. Kjo është një vlerë tjetër ideomocionale e vëllimit, brenda synimit për të rrokur hapësira sa më të gjera jete, të pushtohet e të fitojë rezonancë të gjerë poetike gjithçka njerëzore, sikurse çdo fillesë intime t'i jepet frymëmarrje shoqërore. Kujtojmë, për shembull, vjershat «Një vegim i largët» dhe «Përrenjtë». Sa të çiltra janë ndjenjat që shprehen në to, sa ngrohtësi lirike përmbahet në vargje! Ç'gjerësi mendimi në paralelizmin e thjeshtë mes përrenjve malorë me oshëtimë dhe pleqve që bien në mendime për jetën, e cila ecën e s'përmbahet! Edhe te «Monologu im para një diversanti», ku përplasen të kundërta të papajtueshme, autori i është përmbajtur këtij konceptimi, duke na e bërë njerëzore vetë urrejtjen dhe vrasjen, kur këto janë të pashmangshme.

Në vjershat me motive intime, siç është e natyrshme por jo aq e zakonshme në poezinë tonë të sotme, optimizmi gjën shteg të shfaqet edhe përmes ndërthurjesh in-

teresante e prekëse me nota malli e brengje. Kjo është një ngjyresë ideomocionale që përforcon lirizmin, e bën atë më jetësor e më komunikues, sepse lidhet me rrokjen e trajtimin e disa këndeve e dridhjeve të holla të botës së brendshme, pa të cilat zor se mund të flitet për plotësi paraqitjeje. Domethënëse në këtë drejtim është poezia e zgjedhur nga shoku Enver Hoxha si epigraf në librin «Kujtime të vegjëlisë», me vargjet: «Pse vallë nga pirgjet e fëmijërisë vjen/ kjo këngë e çuditshme, si fije dëbore e brishtë?... /Kjo këngë ndofta kalon në heshtje për njerëz të tjerë, /kalon siç kalojnë akrepat e orës, /por mua ajo më trazon e më josh ngaherë: «Manushaqe e prillit në mes të dëborës»» («Kjo këngë»). Për njeriun e ri të veprimit e të idealeve të larta revolucionare nuk është i huaj intimiteti njerëzor. Përkundrazi, ai karakterizohet nga një botë e pasur, ndjenja të thella, ndjeshmëri ndaj çdo vezullimi të së bukurës e të madhërishtes, ndaj çdo shfaqjeje të jetës. Veç kësaj, Dritëro Agolli përmallimeve u ka gjetur me mjeshtëri e natyrshmëri kontrapunktin e domosdoshëm ideomocional, herë në mbyllje të vjershave, herë ndërthurur me shtjellimin e motivit bazë. Në vjershën më përmasa shprehëse të një poeme «Udhëtoj i menduar» bashkëzanojnë në vijimësi nostalgjia që mbeti në shpirt prej qytetit të përmbytur dhe mendimit: «Diçka do përmbytim në emër të jetës së lirë», sepse: «Të gjitha janë atje ku ziejnë /qytete, fshatra, lule e gjeth» («Shokët e vjetër»).

Në lirikën e Dritëro Agollit nuk ka përthyerje intelektualiste të realitetit. Bukuria e ndjenjës dhe mjeshtëria e vjershërimit janë në përkim artistik me vlera estetike të mbartura nga realiteti, me bukuritë e natyrës, ndaj të cilave autori tregohet veçanërisht i ndjeshëm, me patosin e afirmimit të atdhedashurisë e të humanizmit socialist. Atdheun e ndiejmë «edhe në kokrrën e rërës së detit... /Edhe në fijen e brishtë të barit... /Edhe në vijat e ballit të ushtarit», po ashtu siç e ndiejmë «në oshëtimën e historisë» e «në të ardhmen që vjen

me gjëmime». Brenda këtij konceptimi poetik shfaqet mahnitja e autorit ndaj së bukurës në natyrë e në jetë, herë si motiv më vete lidhur me përjetime, dëshira e aspirata («Natën në Lukovë», «Më prit se po vij shpejt», «Kur më pushtoi malli për detin»), herë në një ndërthurje të bukurisë së peizazhit me çaste gëzimi të ndritur, ku shkrihen në një dashuria për natyrën me afekcionin për shogën e shtrenjtë («Në breg të detit», «Valbona»). Krijime si këto na shtyjnë të themi se autori do të mund të ishte treguar më kërkues ndaj vetvetes, duke mos përfshirë në përmbledhje vjersha të rëndomta me motive të përsëritura; madje dhe me shprehje dëshirash të njëjta. (Ta marr fjalën e ta bëj plis ugari — ta bëj gurin dele — ta bëj rrokjen, vargun, poezinë vandak bari etj.) Lidhur me këtë vërejmë se autori në disa vjersha vërtitet brenda një rrethi të caktuar motivesh, njomështinë e të cilave e ka shteruar nga trajtimi i tyre shpesh. Jemi të një mendjeje me poetin kur polemizon: — Ti thua se na humbka shqetësimi, /kur lopët i përmendim shpesh në varg, /se shqetësimi poetik s'vjen nga blerimi, /por sipas teje ardhka që nga larg, /mës fjalës që pëlçet nga majmërimi. («Për shqetësimin poetik»). Por edhe teprimi në këtë drejtim, sidomos kur në disa vjersha përmbahet një mendim i përafërt apo i përsëritur në trajta të ngjashme, na duket se nuk rrit vlerat nga një vëllim në tjetrin. Dëshirë e ndjenjë e njëjtë shprehet, për shembull, në vjershat «Qengji» (Dua diçka prej teje të marr); «Lopa laramane» (gati jam t'i qepem si oqiçi); «Dobësia ime për kuajt» (sikur të ndodhnin në jetë mrekullira... /Dhe mua të më pyesnin se ç'dëshiroja të isha...). Sikur autori të ishte treguar më i kursyer do të ishte me doli, ashtu siç dëshirojmë që në krijimtarinë e tij në vazhdim të ketë më tepër motive të reja bashkëkohore.

Lidhjet me realitetin dhe ngjizja e krijimeve me mbresa të drejtpërdrejta u kanë dhënë vjershave e poemave qartësi gati pamore. Në pak vargje jepen imazhe të vërteta piktorike thuajse të shikueshme. Format, ngjy-

rat, dritëhijet, relievi, lëvizja në natyrë e në jetë, gjendjet, pozicionet e përkundërta, ndeshjet, shndërrimet janë dhënë me konkretësi, në unitet me ndjenjën që shfaqet e mendimin që shprehet. Kujtojmë: Unë kulloja gjak në llogore /dhe binin mbi gjakun tim flokë dëbore, tek shihja ëndrra të tjera... /ëndrra për fusha të blerta, /ku zot mbi zotin të ngrihej njeriu i lirë... («Monologu im para një diversanti»). Kjo shtëpi u dogj e tre mure i ranë/ dhe mbeti në këmbë një mur; /pas murit luftuan dy partizanë /dhe muri qëndroi mbi ta si flamur («Muri»). U ngrit shtëpia dhe u lyen tavannet e muret, /balta e gëlqerja ende s'janë fshirë, /copërat e trarëve, xhamave dhe gurët /qëndrojnë në oborr mbi barin e mbirë («Shtëpia e porsangritur»). Në çast u zhyt në heshtje sendi i zi, /si një memec i vrenjtur, te salloni; /i zoti priste me trishtim tani /të ndiente fjalë e thirrje telefoni («Telefoni»).

Ngaqë zanafillë e frymëzimeve janë çaste konkrete të realitetit, kalohet pa «u ndier» dhe pa theksime zhurmuese prej hollësive, gjendjeve të zakonshme e rastësive në përfytyrime e mendime përgjithësuese të plazmuara në figura shembëllyese me realitetin. E gjejmë të parapëlqyer këtë lloj procedimi dhe në poezinë popullore. Në shumë këngë kalohet kreshendo nga rasti konkret në vizione domethënëse. P.sh. «Kur më merr malli për tynë /dal e shikoj Shqipërinë...». Ose «Te ura, te hajsomeri/ ç'ia merr këngës vetë Enveri. /Këngës se ç'ia merr Partia / iso mban gjithë Shqipëria».

Te Dritëro Agolli kjo mënyrë procedimi vjen disi e përpunuar, e përdorur në larmi më të madhe e jo nga herë aq e dukshme, por thelbi mbetet po ai, sikurse dhe efekti që arrihet. Përjashto disa vjersha me synim të parë përcimin e ndonjë mendimi a ideje (p.sh. «E thjeshtë, e vërtetë dhe e vështirë») të tjerat nisin zakonisht me një konstatim nga realiteti. Duke u blatuar lexuesve frytin e frymëzimit, autori u tregon edhe si lindi ky frymëzim në udhë e sipër, në takim me njerëz, në çaste që u japin shtytje përsiatjeve dhe hovit



poetik. Vjersha «Ushtarët prej dëbore» nis me një kujtim fëmijërie («Në vegjëli një herë me ca shokë /gatuam tre ushtarë prej dëbore...») për t'u hedhur natyrshëm në mendimin se një ushtri e vërtetë nuk shkrin si sajemat fëmijërore. Shkas për të shfaqur qëndrimin ndaj problemit të luftës e të paqes në vjershën «Lamtumira e pëllumbave» bëhet «një rastësi»: «Erdhi një çift pëllumbash me xhufkë në ballë». Me një a dy vargje të fillimit disa herë zë fill trajtimi i motivit dhe krijohet atmosfera për procedimin e mëtejshëm me gjithë ç'është e domosdoshme për synimet ideore e qëndrimin emocional: «Atje ku era tund me frymë plepin, /pëlliti një gomar sa pa poetin» («Gomari dhe poeti»). S'ka nevojë për hollësi më të shumta për ta futur lexuesin në gjendje humori e për t'i dhënë të kuptojë se është fjala për kritikë.

Edhe në vjersha me diapazon më të gjerë, siç është «Udhëtoj i menduar», ndiqet e njëjta rrugë, ndonëse lidhja në mes çastit konkret të zanafillës dhe tablosë së paraqitur nuk është aq e dukshme sa në vjershat e përmasave më të vogla. Ky fill lidhës ekziston dhe në to, por ai mbetet në hije para pasurisë së përmbajtjes që e tërheq lexuesin në shtjellën e një bote në shndërrim. Megjithëkëtë vjersha nis me vargun e thjeshtë dëftor: «Unë eci buzë liqenit të Drinit të lashtë».

Sado lirike, vjershat përmbajnë thujtë gjithnjë fillin e një tregimi, flasin për një ndodhi, ekspozojnë një situatë, ku poeti është kurdoherë i pranishëm. Ky tregim diku vjen vetëm si pikënisje, gjetkë shfaqet e humbet nëpër çaste zbulimi të botës së brendshme të autorit e të heroit lirik. rrallë ndodh të marrë formën e një subjekti të plotë. Është edhe kjo një shenjë tjetër e mbështetjes krijuese në folklor, e përpjekjes për t'i qëndruar sa më pranë burimit poetik, e kujdesit për të mos u rrëmbyer prej përroit të arsyesimit spekulativ e të figuracionit frymëmarrës. Çdo ndjenje i përgjigjet objekti përkatës që e shkakton, por çdo ndjenje parakupton edhe çastin e volitshëm për t'u shfaqur e për t'u

shndërruar në impuls veprues si në jetë dhe në krijimtari. Dhënia e këtij çasti në vargje përbën një bërthamë epike. Autori i vëllimit «Udhëtoj i menduar» nuk i pret këto çaste, as i imponon vetes me të përdhunë gjendje frymëzimi. Ai i kërkon ato me dëshirim dhe di të hedhë në vargje mbresat e veta, duke ia nënshtruar rrëfimin paraqitës një lirike që të rrëmben e të fut në atmosferën e përfytyrimeve përkatëse.

Duke ndjekur këtë lloj procedimi Dritëro Agolli, siç siguron mundësinë e paraqitjes së drejtpërdrejtë të përshtypjeve të gjalla nga realiteti, duke u dhënë këtyre vendin e komponentit parësor të brendisë, po ashtu, në vazhden e përruar nga Çajupi, gjen një mënyrë të përshtatshme për të futur vetveten në vjersha, për t'ua bërë më të prekshme lexuesve figurën e poetit, më të natyrshme ndërhyrjet e tij, më të konkretizuar heroin lirik të poezisë.

Në «Poemë për babanë dhe për vete» nëpër këtë rrugë është arritur shkrirja harmonike e epikës me lirikën, e tregimit me çastet meditative, e parashtrimit në vijimësi kohore me shtrirjen në gjerësi, e paraqitjes objektive të ndodhive me përthyerjet e tyre në botën e brendshme të personazheve. Poeti autor dhe hero lirik bëhen një dhe ndihmojnë njëri-tjetrin të njësuar artistikisht në një përkim historikisht të mundshëm.

Poema është ndërtuar thjesht. Në të procedohet pa mbingarkesë emocionale e stilistike. Mendim e ndjenjë përmbahen kryesisht në atë farë veprimi përshkues, i cili mbart përshtypje, përjetime çastesh spikatës në lidhjen e brezave, mendim më të përgjithshëm për epokën, për vendin e për jetën. Në themel të saj është vënë fshatari shqiptar i dhënë pas tokës e bagëtisë, i rrahur në dallgë kohësh, mishërim i viryeteve e i atdashedashurisë popullore, karakterizuar mjeshtërisht dhe në plan psikologjik me veçoritë e klasës e klimën e krahinës. Bukur e natyrshëm vjen jehona e historisë dhe shkëndijimet e mëngurisë, e urtësisë popullore përshtat momenteve të caktuara e natyrës së fshatarit. Për-

fshirja në vepër e këngëve popullore, disa prej të cilave janë përpunime e rikrijime të autorit, e ka pasuruar përmbajtjen. Ato janë sintonuar me tingëllimin e përgjithshëm të poemës e me gjendjet shpirtërore të heronjve, në vijën ngjitëse nga të kënduarit më të qarë, te notat e protestës, afirmimi i bëmave e aspiratave burrërore. Me këto këngë, i ngarkuar me mbresa të shumta nga jeta në fshat, lufta e shndërrimet e para revolucionare pas Çlirimit, me një perspektivë të re të madhe shkëputet nga krahët e t'et heroi i ri për ta vazhduar udhën e për t'i kënduar popullit siç do e siç meriton ai. Fundi i poemës (kënga e dhjetë) e njëson plotësisht heroin e ri me poetin, ka ngjyrimin e një vetërrëfimi. Por, nëse në kuptim të ngushtë mbyllja vjen e rrudhet, në plan më të gjerë ideor ajo është një triumf e një premtim atdhedashurie i brezit të ri, synim i tij për horizonte të reja, për lumturinë e popullit.

*Me vete marr burime e plisa  
Dhe çerdhen e lejlekut,  
Lëndina, bar, lajthi e lisa  
Dhe hithrat e hendekut.*

*Me vete marr shaka e këngë  
Dhe blegërima deleje  
Dhe tok me to qëzim e brengë  
Të çupave e djemve.*

Poezia e Dritëro Agollit, më tepër se e çdo poeti tjetër të sotëm, shquhet për dendësi hollësish sidomos të atyre nga natyra e nga jeta e fshatit. Mendimi përshtues shpërndalet në çdo ind të vjershës, del përcaktueshëm. pa qenë as ngulmues, siç ndodh ndonjëherë në krijime autorësh që nisen nga ide të caktuara por u mungon trualli jetësor për t'i mbështetur e për t'i shndërruar në poezi. Edhe kur hollësitë janë të shumta dhe kalohet në numeracion në dukje prozaik, Dritëro Agolli ia nënshtron ato konceptit bazë, mendi-

mit dhe ndjenjës, duke mos i parë si qëllim në vetvete. Hollësitë mbartin mendimin pa u rënduar, kurse mendimi gjen shtrat të përshtatshëm për t'u shfaqur pa bujë. Vjersha «Çast poetik në zyrë» është ndër shembujt më të zakonshëm. Gjendja shpirtërore e poetit zbulohet në mënyrë bindëse, por edhe lexuesit i zgjohet e njëjta dëshirë për t'u hedhur në krahët e natyrës, për të dalë jashtë mjediseve të mbyllura.

Në funksion të brendisë ideore e të rezonimit emocional janë përdorur imtësitë në vjershën «Udhëtoj i menduar». Autori, pa përshekruar, ka arritur të japë përfytyrimin e gjerësisë së jetës në qytetin e mëparshëm; pa treguar, pa dhënë historinë, pa ndërhyrje të shpeshta e përfshin lexuesin në nostalgjinë e përligjur të banorëve të shpërngulur nga Kukësi i vjetër: «Atje ku mua tani më duket e thjeshtë!... Dilte tym nga oxhakët e ziente një jetë...»

Bëjnë përjashtim disa vjersha në të cilat jepen mendime në formë aforizmash e maksimash, gjë që nuk ka qenë në natyrën e poezisë së mëparshme të Dritëro Agollit dhe nuk shënon ndonjë hap përpara që të meritonte vëmendje. Ndoth që elementi racional të fitojë epërsi edhe për shkak se tema e zgjedhur nuk është përthithur plotësisht, ka munguar shtytja e domosdoshme emocionale për t'u përçarur lexuesve shqetësimin, ndaj vjersha del disi e sforcuar, ndonëse në të shprehen ide e mendime me vlerë si tek: «Antimikroborgjezi» dhe «E thjeshtë, e vërtetë dhe e vesh-tirë». Në të kundërtën, ai po jep ndihmesë të çmueshme në përtëritjen e fabulës përmes bashkëkohësimit të përmbajtjes. Në fabula e në disa vjersha humoristike aforizmi i përshtatet tregimit dhe rrjedh prej tij, siç e vërejmë te «Kali e gomari», «Poeti dhe gomari», «Miqtë», «Njohja e realitetit» etj.

Shenjë tjetër e lidhjeve të autorit me jetën e të poezisë me realitetin është ndërtimi i figurave stilistike në përqasje objektesh reale, mbështetur në përshtypje konkrete, që u japin forcë e origjinalitet. Ato

vihen mirë në funksion të shprehjes poetike e të pasurimit të brendisë me shoqërime përftyrimesh dhe nxitin imagjinatën e lexuesve, pa i shkëputur këta nga synimi ideoemocional bazë. Përmendim disa shembuj:

Ishte genie krejt me shpirt të gjallë, ngrinte shpinën lart duke bërtitur, ndriste, qeshte, hidhej, lóste valle, mrekullia vetë kishte zbritur («Kur më pushtoi malli për detin».).

Për tokën në mbarim vjeshte:

Pas punës toka e lodhur pastrohet /toka vjen erë ujë si një grua pas banje: /me çarçafë të bardhë në dorë dimri afrohet /dhe qesh: Ta mbuloj mos më ftohet («Peizazh në fund të vjeshtës»).

Për lumin malor:

Zbret lumi malit si dashnor i marrë, /t'i puthë i etur buzët e luginës («Në mëngjes para lumit dhe pyllit»).

Përshtypje nate në bregdet:

Mendtë e mia hidhen mbi ullinjtë /vjelin shekujt, vjelin lashtësitë, /shekujt e ngarkuar me mendime, /mbushur dallgë e mbushur shqetësime. («Natën në Lukovë»).

Shprehim bindjen se përmbledhja «Udhëtoj i menduar» është sukses i ri për autorin, shembull i qëndrimit të vetëdijshëm e të çiltër të krijuesit, i punës për zbulime vlerash të reja poetike bashkëkohore dhe për përsosjen e mjeshtërisë artistike.

1985

## «SHKËLQIMI DHE RËNIA E SHOKUT ZYLO»

Romani i Dritëro Agollit «Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo» është një prej veprave të shquara të letërsisë shqiptare të realizmit socialist dhe ndër më të bukurat në prozën tonë satirike. Kur u botua për herë të parë, romani u përshëndet me një artikull të Dalan Shaplos dhe një tjetër të Dhori Qiriazit. Më pas për të është folur deri në referate në diskutime e në shënime kritike, ndërkohë që Zylo Kamberi u bë figurë shumë e njohur, e cila ka joshur jo vetëm lexuesit, por dhe artistët e skenës.

Suksesi i Dritëro Agollit me romanin «Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo», i parë në këndin e thellimit të realizmit në prozën tonë, me përparimin e letërsisë dhe me arritjet që ka pasur vetë shkrimtari në krijimtarinë letrare, lidhet sidomos me dy faktorë kryesorë.

Së pari, të flasësh për Zylon duhet doemos të sjellësh ndër mend e të mbash parasysh luftën që ka bërë e vazhdon të bëjnë Partia dhe klasa punëtore kundër burokratizmit dhe të këqijave që burojnë prej tij, kundër dukurive të tjera antisocialiste si: euforia, ndjenja e stabilitetit, vetëmburrja e vetëkënaqësia, për raporte të drejta kuadër-masë etj. Më konkretisht: do të thotë të rikujtosh hovin që mori kjo luftë në lëvizjen e fuqishme e të gjerë masive për revolucionarizimin e gjithanshëm të jetës së vendit në vitet '60 e më pas. Në kuadrin e kësaj lëvizje bëri përpara edhe letërsia, e cila përforcoi brendinë bashkëkohore, militantizmin socialist dhe mprehu tehun e kritikës ndaj shfaqjeve e dukurive anti-socialiste, krahas afirmimit më të pasionuar të ideve

e të idealeve komuniste. Në atë kohë e në vazhdim u shkruan edhe një numër i konsiderueshëm veprash humoristike e satirike, midis të cilave u shqua «Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zyló».

Së dyti, romani i llojit satirik nuk është diçka e papritur dhe pa precedencë në krijimtarinë letrare të Dritëro Agollit, as e vetmja vepër e tij me këtë profil. Humori dhe satira, ironia dhe sarkazmi janë elemente të qëndrimit ideoemocional që i gjen pothuajse në çdo vepër të shkrimtarit, mjete që ai i ka përdorur me efekt e mjeshtëri në poezi, në prozë, në publicistikë deri dhe në artikujt e referatet për problemet e letërsisë e të artit. Krahas pasqyrimin të çasteve heroike e të dukurive të madhërishme, të hoveve shpirtërore optimiste, të ndjenjave të forta luftarake e të përjetimeve të holla lirike, ai ka sjellë po me aq sukses në letërsi humorin e shëndetshëm karakteristik të popullit dhe ka fshikulluar hidhur me satirën e tij të gjallë e të mprehtë. Drama satirë «Fytyra e dytë» është një tjetër vepër me vlerë, e cila lidhet, gjithashtu, me rrethanat shoqërore politike që u përmendën, kurse në tregimet «Njeriu i mirë», «Portreti i njeriut të madh», në poemthin «Filistini» e në të tjera shkrime është rrahur një problematikë e janë pasqyruar fizionomi që kanë pararendur ose pasuar tipin e Zylós dhe romanin rreth tij.

Zylo Kamberi kudo shoqërohet nga Demka, i cili, deri diku, shpreh edhe qëndrimin e autorit, por në asnjë mënyrë Demka s'mund të njësohet me shkrimtarin. Romani është shkruar në formën e rrëfimit të një vartësi që rreh të «çlirohet» nga eprori i burokratizuar. Me njëfarë modifikimi, që përkon me pikësynimet ideoartistike të autorit dhe me veçoritë e karakterit të Demkës, Dritëro Agolli në romanin e vet ka ndjekur një traditë të njohur strukturimi të shumë veprave satirike realiste të mbështetura në një çift herojsh komikë (p.sh. Don Kishoti dhe Sanço Pança). Duke qenë mbartës të dukurisë komike, këta shërbejnë edhe si faktorë të zbu-

2  
5  
limit e të denoncimit të së keqes në përmasa më të gjera dhe u japin veprave frymëmarrje më të thellë shoqërore. Zyloja është komik dhe njëherësh mishëron dramën e njeriut që degradon dalëngadalë derisa bëhet e kundërta e asaj që pandeh dhe pretendon se është. Demka objektivisht është jo thjesht viktimë e burokratizmit të shefit të vet, por edhe mbështetje e domosdoshme për të dhe për burokratizmin në përgjithësi. Mbrehja e këtyre dy tipave në të njëjtin kular e zbulon më gjerë dukurinë komike.

5  
Z  
Për Dritëro Agollin rrënjët e dukurisë komike nuk përmbahen vetëm e thjeshtësisht në cenet e karakterit të personazheve, por në ata faktorë të psikologjisë e të mjediseve që i bëjnë të mundshme si shfaqjet negative edhe kundërvënien shoqërore ndaj tyre. Në këtë kuptim, sado që mangësisht, vënia e Demkës edhe në rolin e kronikanit të «epopesë» komike të Zylos është diçka e re që i zgjeron përmasat e satirës, duke përfshirë në të si elementin pozitiv edhe qëndrimin e drejtpërdrejtë të shoqërisë sonë ndaj së keqes dhe ceneve morale të njerëzve, të cilët marrin tatëpjetën. Përmes Demkës Zyloja portretizohet më mirë, bëhet më i kuptueshëm si tip komik, zbulohet në mënyrë më të shumanshme në çdo tipar e veçori, në çdo regëtim të ndjenjave, të mendimeve dhe të aspiratave të tij të ndryshme e, në thelb, kontradiktore. Pa e kuptuar as vetë, Demka në përpjekjen, siç thotë, «të zbërthejë figurën e shokut Zylo», e tejkalon detyrën që i vë vetes, dhe e përfshin këtë figurë në një kuadër më të gjerë personazhesh, në mos aq komikë sa Zyloja, të paktën më negativë se ai, më të zbrazët dhe më meskin në jetë, të varfër në aspirata.

5  
Në këtë pikë si dhe në momente e vlerësime të veçanta ka përputhje të Demkës me autorin, me qëndrimin shoqëror ndaj dukurive të pasqyruara, qëndrim që herë del në dukje shprehimisht, herë përmbahet në këndvështrimin e shkrimtarit; aty-këtu edhe në vetëpohimet e hidhura autokritike të Zylos.



7 Këto veçori në trajtimin e çiftit komik bëjnë që vëmendja kryesore të përqendrohet te Zyloja si tip i formuar në rrethana e mjedise të caktuara, por edhe si karakter i plotë me të dhëna për shkëlqim e rënie. Prandaj, kur vihesh të studiosh romanin, çështja e parë që të del është të sqarosh kush është Zylo Kamberi ose «shoku Zylo», siç quhet vazhdimisht jo pa qëllim.

Në një çast çiltërsie e dëshpërimi vetë heroi i Dritëro Agollit na jep çelësin e zgjidhjes së kësaj çështjeje. Ai i thotë Demkës:

«..Unë vij nga legjendat: U përpoqa ta fshij e ta bëj pluhur këtë legjendë... Bile, e kam qëlluar me çiften e mbushur me saçmat-terma: dialektikë, aksion, transformacion, aktivizim filozofiko-shkencor... Por hiç! Prapë legjenda nga kam ardhur më ka ndjekur. Edhe unë mbetem bir i legjendës. Ti m'i bën referatet mua. Unë mund t'i bëj vetë. Por legjenda nga vij unë nuk më lë. «Le t'i bëjë Demka», më thotë legjenda. Dhe unë them: «Bëj raporte, o Demkë!...» (f. 212).

Të vish nga legjenda do të thotë të vish nga një botë (nga një jetë, nga një rend shoqëror) që nuk ekziston më, që është kthyer në legjendë, por edhe që vazhdon të veprojë me forcën e legjendës në vetëdijën e njerëzve, në mentalitetet e në psikologjinë e tyre. Ta mbash veten të lidhur me këtë legjendë e të joshur prej saj, do të thotë që, edhe pa dashur e pa e kuptuar, ta përtërish atë, të përpiqesh të legjendarizosh vetveten, të sajosh një legjendë të re jo vetëm për vetveten, por edhe për paraardhësit e pasardhësit e tu, të kërkosh që këtë legjendë ta pranojnë e ta përhapin të gjithë. Kështu, vetvetiu nis të të pëlqejë të rrethohesh nga një brerore e neveritshme lajkatarësh e servilësh, të ekzaltohesh prej shkëlqimit të rremë, ndaj edhe të shkëputesh nga e vërteta dhe nga ata që mbrojnë të vërtetën, t'u kundërvihesh atyre me pompozitet e me mendjemadhësi. Kjo është njëra anë e çështjes. Ana tjetër është se lajkatarët e servilët ndjekin pikësnyime meskine, ndaj kërkojnë e presin shpërblim për shërbimet

e tyre, zënë vend pranë teje dhe, kur ti pandeh se të lartësojnë, ata të zhytin në meskinitet dhe të shtyjnë në qëndrime të dëmshme e në kotësi.

Z Kështu i ndodh «shokut Zylo». Kjo është drama e tij. Ai vetë ndodhet në një gjendje që nuk e kupton dot plotësisht rrëshqitjen dramatike dhe nuk e ndien siç duhet se po humbet vazhdimisht terren, sepse edhe në çastet më kritike e shohim të vërshtëllëjë, të mbajë fjalime me pretendime qesharake dhe të rrojë me ëndrra boshe për karrierë. I mbështetur në shiltet e rehatshme të meritave, dashur pa dashur, ai i kundërvihet rendit shoqëror që konsolidohet e përparon vazhdimisht, që ia kufizon për herë e më tepër sferën e veprimit dhe të «shkëlqimit»; e hedh mënjanë. Këtë Zyloja nuk e kupton. Ai, i verbuar prej meritave, nga ndjenja e stabilitetit, nga fjalët e bukura të lajkatarëve dhe nga vetëmburrja që i ka hyrë hë gjak, e ka humbur sensin e realitetit. Ai mendon se «dirizhabli» i karrierës së tij jo vetëm s'ka për t'u shpuar, po, përkundrazi, do të ngjitet lart e më lart dhe do të duket gjithnjë më i bukur nën vezullimin e rrezeve të diellit. Por «saçmet-terma» nuk të shpien larg. Forca e realitetit socialist dhe e ideve revolucionare, duke i hequr lëvozhgën e pretendimeve, e nxjerr në sy të botës ashtu siç është: komik, qesharak, parazit.

Legjenda e «shokut Zylo» nuk është pa baza dhe as është sajuar rastësisht e menjëherë. Tërthorazi, me bujon karakteristike të fshehur keq prapa një demokratizmi e modestie të shtirur, marrim vesh prej tij se ka luftuar e ka punuar, ka studiuar e ka aspiruar, jo aq sa thotë, por, sidoqoftë, ka qenë dikush, ashtu siç ka qenë i dhënë edhe pas një jetese vepruese. Ai është gjahtar i pasionuar, siç është dhe gënjeshtar pa të keq; është notar i mirë dhe burrë fizikisht i fortë. Fillimisht, siç flitet dhe siç lihet të nënkuptohet, ai është imponuar me zotësi, me punë, me ndershmëri dhe me qëndrime burrërore — cilësi, të cilat pretendon se i ka pasur mjaft të zhvilluara, pandeh se i ka akoma, por

që, në të vërtetë, i ka humbur, duke ruajtur vetëm dukjen e jashtme të tyre. Këtu qëndron thelbi komik i karakterit me kontradiktën në mes dukjes dhe natyrës së supozuar e të tjetërsuar, për pasojë, edhe në mes vlerës reale dhe pretendimeve.

Zyloja i dikurshëm nuk ekziston më. Ekziston vetëm hija e stërzmadhuar e tij. Në vend që të punojë, ai vetëm u krijon të tjerëve përshtypjen se është i mbytur në probleme me rëndësi; në vend që të studiojë, vetëm u del vartësve me vëllime të trasha në duar; në vend që të vrasë mendjen — kënaqet me lavdinë e leximit të referateve që i përgatit Demka; në vend të misionarit të vetëdijshëm e të pasionuar shoqëror është formuar tipi i zyrtarit që i jep rëndësi vetes dhe çdo gjë e bën për bujë, duke bërë çmos të tërheqë vëmendjen e të tjerëve. Kështu, e keqja ka ndjellë të keqen dhe «shokut Zylo» i ka bërë natyrë të dytë mefshtësinë, mediokritetin intelektual dhe parazitizmin, gënjeshtren dhe maninë për t'u dukur, duke u hequr i çiltër deri në naivitet për gjithçka thotë e bën, sepse çdo privilegj e quan të merituar dhe as i shkon ndër mend se punët mund të rrjedhin edhe ndryshe.]

Mbi këtë bazë, pasi i ka hyrë vetja në qejf, nis të legjendarizojë: të ekzaltojë heroizmat e rrëme të t'et, të mburrë gjenialitetin e paqenë të të bijve dhe ta matë veten, si i thonë, me hijen e mëngjesit. Formohen kështu konceptet e mbrapshta të njeriut që kujton se ka lindur për të komanduar dhe për të qëndruar mbi turmën, duke marrë praktikisht rrugën e njeriut të tepërt, të kotë, shoqërisht të dëmshëm.

Përhapës të legjendës për madhësinë e Zylos janë: e shoqja (Adila) dhe i biri — Diogjeni; tipa servilë si Taqi i padinjitet, njerëz pa karakter si Zaim Avazi e Mitro Karapataqi apo mendjelehta Kleopatër, e nisur nga interesat e veta e të të shoqit (Adem Adashit). Të gjithë këta qëndrojnë më poshtë se «shoku Zylo» dhe janë të interesuar ta kenë mirë me të e të përfitojnë prej tij. Sipër Zylos është shoku Q., i cili për t'i dhënë

dorën heroit të romanit, e cakton të mbajë referatin e përgatitur nga Demka, vetëm se paska zë më të mirë nga Shemshedini.

Ky mjedis i ngushtë në të cilin vërtitet «shoku Zylo», duke bashkëjetuar (i merr në mbrojtje, duke thithur nektarin e lajkave e të lëvdatave të pamerituara), është njëfarë panairi i vogël kotësish, ndaj të cilit shkrimtari tregohet i pamëshirshëm, sepse pa ta nuk do të kishte Zylo, ashtu siç nuk do të mund të «mbijetonin» tipa të tillë, po të mos ekzistonin ende në shoqërinë tonë edhe Zylot.

///Kotësia, ambicjet, shikimi i interesave të ngushta meskine, etja për lavdi, karrierizmi, lajkatimet pa skrupull, përpjekjet për të jetuar nën hijen e të tjerëve (të «të mëdhenjve»), shkëputja nga realiteti i madh i kohës dhe nga populli janë vijat karakteristike të portretit kolektiv të kësaj kategorie shoqërore, //e cila sjell në socializëm trashëgimet e këqija të rendeve të mëparshme, ideologjinë dhe psikologjinë mikroborgjeze, ndikimet e sotme të botës borgjeze e revizioniste. Njerëz të tillë me fjalë përgjërohen për socializmin, por në karakterin dhe në mentalitetin e tyre ruajnë shumë fëlliqësi, mbajnë gjallë prirjen për të shkarë në moçal dhe për të tërhequr pas vetes këdo që bie nën ndikimin e tyre. Ky është një mësim me rëndësi që del nga romani i Dritëro Agollit, një mësim i vlefshëm jo vetëm për të mos rënë në pozitën e Zylos, por edhe për të bërë të kundërtën: për të luftuar aktivisht në veten e në të tjerët çdo shfaqje të papajtueshme me socializmin, çdo manifestim të mentaliteteve e të psikologjisë mikroborgjeze, të intelektualizmit e të zyrtarizmit.

I krahasuar me personazhet e tjera negative që u përmendën Zyloja, në tatëpjetën që merr si kuadër, në thelb, ruan disa cilësi e virtyte të cilat nxjerrin krye aty-këtu, herë si //vlera të mirëfillta të një babaxhani (entuziazmi, ndjenja e turpit, qëndrimi ndonjëherë auto-kritik, dashmirësia, mospajtimi me shfaqjet e skajshme të mungesës së karakterit), herë në sjellje para-

doksale, shkaktuar prej shkëputjes nga realiteti. Shkrimtari, në këtë vepër me theks satirik ndaj dukurive negative të pasqyruara, kur vjen puna të Zylloja, ruan përgjithësisht intonacione humoristike, edhe në situatat më qesharake. Në qeshim me Zylon, por në këtë të qeshur ka edhe tallje, edhe zemërim, edhe këqardhje. Të pranosh Zylon dhe qëndrimin e shkrimtarit ndaj tij do të thotë të ngrihesh, duke qeshur, në lartësinë e kuptimit të disa dukurive komike, të cilat, jashtë rrethanave të rendit socialist dhe veprimit shoqëror mosmiratues, mund të sillnin pasoja tragjike si për mbarësit dhe për gjithë shoqërinë. Dhe më tej: të pranosh qëndrimin e mbajtur në roman ndaj Zylos do të thotë, në disa raste, siç e ka provuar lufta ideologjike e politike ndaj shfaqjeve antisocialiste, të mbash qëndrim autokritik ndaj vetvetes, gjersa psikologjia e mentalitetet mikroborgjeze nuk mund të mos prekin në shkallë të ndryshme jo pak njerëz. Nëse arrijmë këtu, qoftë duke na u skuqur veshët, përballë Zylos, qoftë duke qeshur me «zylosinë» brenda vetes sonë, mund të themi se kemi arritur përmes katarsit një sukses. ndërsa shkrimtari, me të drejtë, mund të mburret se ia ka arritur qëllimit edukativ e artistik.

Zylo Kamberi është ndër ata tipa, të cilët, jashtë gjendjes së privilegjuar dhe postit që mbajnë, humbasin çdo vlerë, kthehen në hije, pa zotësi dhe pa asnjë forcë e aftësi veprimi. Mbyllja e tij në një rreth gje-purak lajkatarësh tregon më së miri se ky njeri e ka humbur sensin e realitetit, po atrofizohet si intelekt, po tjetërsohet dhe po bëhet karikaturë groteske e vetes; tip komik në rrethana të reja historike.

/// Zyloja nuk është karikaturë e mjerë e një burokrati të shablonizuar, siç jemi mësuar ta gjejmë në mjaft shkrime e shfaqje estradash. Ai është një karakter i plotë dhe koherent, me shtresa e mbishtresa kontradiktore, që e bëjnë komik, por edhe kompleks e poliedrik. Ai hiqet me të madh pa qenë i tillë; modest e popullor duke qenë mendjemadh dhe i duket se rëndësia që i

jep vetes është e meritueshme, madje, shoqërisht e domosdoshme. Përndryshe, ç'e shtyn atë të vizitojë të sëmurët në spital, të ndalojë autobusin e shërbimit urban dhe të urojë e të këshillojë shoferin, t'i japë porosi lulishtarit që të shkulë lulet e verdha e të mbjellë lule të kuqe? //

Këtu ka pompozitet qesharak, po ka dhe çiltërsi naive dhe parimësi të absurdizuar. Ai, nga mania për t'u dukur, gënjen vazhdimisht, por gënjen si një mitoman: nuk merret vesh se dhe kur u beson ai vetë gënjeshtrove që thotë. Të gënjerit është bërë natyrë e dytë e tij, një ves që si tip letrar e afron me Tatarinin e Taraskonit të Alfons Dodesë. Ai entuziazmohet sinqerisht me përparimet e fshatit, preket nga bukuritë e natyrës, joshet prej këngës, por çdo veprim, çdo mendim e çdo fjalë duken si stilizime artificiale të natyrës së mirëfilltë popullore.

Zyloja ndërhyt me të drejtë kur shikon dervishin të vërtitet nëpër fshat, por na bën të qeshim kur ngul këmbë që ai t'i bjerë karadyzenit në grupin artistik të kooperativës; ka të drejtë në vlerësimin që u bën parcelave eksperimentale që drejtojnë kuadrot, po shkel mbi këtë qëndrim parimor kur ëndërron të ketë edhe vetë një të tillë; bën mirë që interesohet për banjat, po është qesharak kur vete të lahet për të dhënë shembullin personal; kompromenton problemet serioze duke i vulgarizuar.

Si në pretendime edhe në mendjemadhësi Zyloja është naiv, aq naiv sa nuk vlerëson asnjë kritikë që i bëhet dhe nuk i shkon kurrë në mendje se mund të pësojë gjë. Bile, edhe kur e shkarkojnë nga detyra, është në gjendje të mbajë një fjalim lamtumire, duke treguar gatishmërinë për t'u dhënë ndihmë kuadrove të reja.

// Por Zylo Kamberi ruan, në thelb, diçka nga njeriu i ndershëm dhe me karakter ose, më mirë të themi, ka qenë i ndershëm dhe me karakter, ndaj skandalizohet nga dyfaqësia e Zaim Avazit, përleshet me grushta

me një vagabond, nuk bie në kurthin dashuror të Kleo-  
patrës etj. //

Nga ana tjetër, po ky Zylo, që i ka në majë të gjuhës fjalët «do të ndeshemi», hyn në ndeshje vetëm kur e sheh ose pandeh veten në pozita eprore, dhe këtu ka diçka prej Don Kishoti: është kryelartë midis të përlururve dhe i përlurur midis kryelartëve. I njëjti Zylo që del e bërtet në korridorët e dikasterit me një vëllim të trashë në duar dhe përsëndet fqinjët me dorë kur niset me shërbim, është servil e lajkatar me shokun Q., që e ka mbi krye, nuk e përballon dot ironinë e Kristoforit, nuk e honeps karakterin e Aranitit dhe, i ndodhur ballë për ballë me Shemshedinin, i nënshtrohet fatalisht mospërfilljes së tij. Sikur këtij aspekti t'i ishte dhënë më tepër rëndësi e vend në vepër, më mirë do të kishte qenë, sepse do të ishte pasqyruar edhe më qartë kundërshtimi shoqëror ndaj dukurive që kritikohen. Por dhe me aq sa është dhënë në roman, del se tipa si Zyloja nuk janë në gjendje të përballojnë ndeshjen jo më me realitetin tonë në përgjithësi, por as me njerëz të veçantë që qëndrojnë në pozita të shëndosha. Shërbimi në fshat dhe debati rreth dramës së Adem Adashit e dëshmojnë këtë. Por është e vërtetë edhe diçka tjetër: tipa si Zyloja, në rrethana kritike dhe të ndodhur përballë kundërshtimesh të forta, zakonisht, në jetë e në letërsi, zgjedhin rrugën e intrigës, të goditjes prapa krahëve dhe të hakmarrjes kundër të tjerëve. Zyloja nuk është i tillë. Duke iu shmangur «sherrit», ai nuk ndërmerr asnjë hap të pandershëm. Shumë shumë ai përpiqet të nënvleftësojë të tjerët e të përgënjeshtrojë fjalët e mira që thuhet për ta (rasti i Shemshedinit që udhëton me veturën e shokut Q.). Këtë ndershmëri relative ai e shfaq ca ngaqë është babaxhan, ca i shtyrë nga një vetëbesim i tepruar dhe nga ndjenja e stabilitetit, që ka hedhur rrënjë në vetëdijën e tij. Por në vlerësimin e Zylos, duke e paraqitur të tillë, kemi mendimin se autori ka anuar padrejtësisht ndaj tij dhe është kursyer në fshi-

kullimin satirik, sepse, siç na duket logjike, këtu kemi të bëjmë më tepër me pozime, sesa me karakterin e vërtetë të personazhit.

Rrokja në shumanshmëri dhe në thelbin njerëzor e shoqëror e figurës së Zylo Kamberit nga shkrimtari, ka bërë që edhe ndërtimi i romanit të ketë disa veçori origjinale të dallueshme. Së pari, meqë kemi të bëjmë me një karakter që pothuajse është tjetërsuar, shndërruar në tip komik, jo në fazën e rënies, por në fazën e shkëlqimit të vet, Dritëro Agolli ka vepruar drejt që e ka ndërtuar romanin në një shtrirje të lirë, duke siguruar mundësi për paraqitje sa më të gjerë, në anë e rrafshje të ndryshme. Ai i është shmangur një intrige të rëndomtë, që nuk do të jepte dorë për portretizim të plotë të figurës e do të kishte varfëruar brendinë ideore të romanit, përfshirjen e ndërthurur në të të elementeve aq interesante të shfaqjes së dukurive komike e të kritikës që nuk kanë të bëjnë kurdoherë vetëm me Zylon.

Për arsytet që u përmendën, megjithëse ka një fill procedimi të subjektivit, që paraqet shkëlqimin, ballafaqimin me realitetin, ankthet dhe rënien e shokut Zylo, ky fill nuk bëhet zotërues. Nisur nga kompleksiteti i figurës, shkrimtari ka gjetur një zgjidhje strukturore e kompozicionale, me alternime e kundërbalancime larg çdo skeme e standardi letrar, pa thjeshtëzuar fitoren mbi të keqen, duke parakuptuar me zgjidhje të konfliktit vazhdimin e luftës.

Nisur jo vetëm nga ideja se lufta kundër burokratizmit e të këqijave që sjell ai nuk mbaron me demaskimin apo me eliminimin e një mbartësi të këtyre të këqijave, D. Agolli ka pasur edhe synimin të paraqesë një njeri të gjallë të kohës sonë, i cili shkon drejt rënies, pa iu shmangur koherencës së brendshme dhe atyre tipareve e veçorive që e kanë shndërruar në personazh komik. Autori mban parasysh se ky tip shoqëror është i ndryshëm nga ata që kemi ndeshur në letërsinë e së kaluarës.

Zyloja edhe në fund të veprës qëndron në kë-



mbë, jo vetëm se vetë nuk shkon në mendje gjë të keqe (edhe dënimin ai e merr për vlerësim), por edhe sepse me largimin e tij nuk mund të vejë gjithçka mbroth. Kështu ndodh që ai të hyjë në vorbullën e një legjende të re, që në fakt dëshmon se lufta kundër burokratizmit nuk ka të bëjë vetëm me ndëshkimin e një nëpunësi dhe me shmangien e disa teprimeve burokratike, po edhe, sidomos, me çrrënjosjen e atyre mentaliteteve që e mbajnë më këmbë atë dhe pengojnë të zhdukët përfundimisht. Nga pikëpamja e përgjithshme historike shndërrimi i burokratizmit dhe i burokratëve në dukuri komike është fitore reale e rendit shoqëror socialist, kurse, në pikëpamje praktike, me këto dukuri shoqëria jonë do të ndeshet për një kohë të gjatë, gjersa një tip si Zyloja, nga komik të bëhet i neveritshëm si Taqi. Në këtë drejtim, jo thjesht për Zylon, por në përgjithësi për veprën, krahas vendit më të gjerë që duhej t'i ishte dhënë kundërshtimit të shfaqjeve negative, mbase do të ishte e domosdoshme që ngjarjet të ishin shtrirë në një periudhë më të gjatë kohe dhe për perspektivën e ndonjë tipi të kishte më tepër qartësi. Në roman lihet të kuptohet se Shëmshedini, një tjetër Zylo (kujtojmë fillimin e romanit dhe vlerësimet e Demkës për të), emërohet në vend të shokut Q., duke sajuar kështu një rreth të mbyllur burokratik, sepse zor se mund të besohet që ky të jetë riedukuar në bazë, sidomos po të kemi parasysh se asgjë nuk është dhënë paraprakisht në roman për këtë kthesë. Këtu dhe në drejtime të tjera shkrimtari i lë vend lexuesit të përfytyrojë, të mendojë e të interpretojë, gjë që e ka zgjeruar diapazonin humoristik e satirik. Por, sidoqoftë, disa çaste me rëndësi mund të qenë përvijuar më qartë e më gjerë, pa kaluar në vulgaritet. Përkundrazi, një nga vlerat e shquara të romanit përmbahet në faktin se shkrimtari nuk është joshur nga mundësitë që jep subjekti dhe tipi për të kaluar në banalitete e në humor spekulativ situatash e batutash, siç ndodh ndonjëherë në letërsinë tonë satirike. Kjo tregon se, kur zbulohet thelbi i dukurive

komike dhe zotërohet mirë materiali që ka të bëjë me to, s'është nevoja të përdoren shumë marifete stili për t'i paraqitur ato në dritën e vërtetë të natyrës së tyre.

Në përmbajtjen, në drejtimin ideor dhe në ndërtimin e romanit vend me rëndësi, pas shokut Zylo, zë figura e Demkës. Me Demkën nis romani dhe përmes dëshmimeve e përshtypjeve të tij është portretizuar Zyloja dhe janë paraqitur njerëzit e ngjarjet. Ndërsa me Zylo Kamberin shkrimtari i thotë një kategorie të lexuesve «mos u katandisni si ai», me Demkën, ai i këshillon t'u shpëtojnë kurtheve të burokratizmit, të mos bjerin dinjitetin qytetar dhe të mos bëhen lepitka të mashtrimit e të prirjeve regresive. Në thelb, Demka, ndryshe nga Zyloja, është tip dramatik. Ai jeton dramën e njeriut që ka energji, zotësi e dëshirë për të krijuar, por nuk mundet, ca për shkak të rrethanave në të cilat ndodhet, ca për faj të karakterit të dobët, që e detyron të mos kundërshtojë, të flijohet për të shkruar referatet e diskutimet e shefave mendërisht të mefshtë. Kjo gjendje, pasojë e burokratizmit, e bën atë të vuajë dhe rrezikon shndërrimin gradual të tij në një mekanizëm të gjallë, në një formulues raportesh sipas skemash e standardesh të njohura, të cënojë personalitetin e vet gjersa, detyrimisht, të vihet në pozitën qesharake e të pështirë të formuluesit të dy palë raporteve që kundërshtojnë njëri-tjetrin.

Shenjat e rënies së Demkës janë të dukshme. Ai jo vetëm është kthyer në raportshkrues kokulur, siç e cilëson veten, por detyrohet të pranojë nga eprori mohimin e punës së vet, të kënaqet me thërrimet e lavdisë së shefave dhe të emocionohet prej suksesit të tyre të pamerituar në publik. Gjatë gjithë romanit Demka nuk arrin të çlirohet as nga kthetrat e Zylos e të shokut Q., as nga drojtja dhe mungesa e guximit për të kundërshtuar. Edhe në ndonjë rast që guxon të kundërshtojë (diskutimi për dramën e Adam Adashit), dashur padashur, e mbyll gojën, kur Zyloja ngrihet, zbut efektin e fjalëve të vartësit. Por Demka nuk don ta mbajë

veten të lidhur me Zylon dhe të marrë tatëpjetën tok me të. Demka pajtohet me vlerësimin që i bëjnë Zylos Araniti, Bakiri dhe Kristofori, njeh më mirë se kushdo karakterin e tij komik, ndonëse në paraqitjen e gjërave duket se mban qëndrimin e kronikanit të paansnëm. Ai, më tepër se të tjerët, ka arsye edhe ta urrejë snefin që i shtrydn energjitë dhe i përvetëson punen, por gjer këtu nuk arrin dot. Kjo, gjer në njëjarë mase, perligjet nga konvencioni i autorit: detyra e Demkës si zëdhënës i së vërtetës mbi Zylon, si portretist i tij. Por pozita në të cilën ai ndodhet, punët që kryen dhe qëndrimet që mban japin dorë edhe më tepër për fshikullime satirike dhe përshkrime me ngjyra komike. Kështu edhe pa komente e interpretime, do të kishte mundësi që disa situata të ishin dhënë me komizëm më të duksnëm dhe Demka të ishte portretizuar jo injesht si viktimë që kërkon shpëtim, por edhe si mbartës konceptesh burokratike të një karakteri të ndryshëm nga ato të shefave të tij. Vetë moskundërshtimi, përvoja, gatismeria për të snkruar edhe ndryshe nga çmendon (referat i dyte i Zylos dhe diskutimi i shokut Q.) tregojnë se ai, qoftë dhe në kundërshtim me vetveten, pëhet mbështetje e burokratizmit dhe objektivisht i sjell dëm shoqërisë.

Nga pikëpamja e drejtimit kryesor ideor të veprës ky qëndrim ndaj Demkës është më i përligjur, sepse vetëm një njeri i afërt mund të na jepte me hollësi kronikën e shkëlqimit e të rënies së shokut Zylo, vetëm një Demkë me aq lëkundje, mëdyshje, revoltë të brendshme, dhembje për vetveten dhe dëshirë për të krijuar, real e jetësor, mund të shërbente si paralajmërim serioz për ata njerëz që ndodhen në gjendjen e tij. Nëse Demka nuk lufton dhe nuk ka ndonjë meritë për rrugën që marrin ngjarjet, lexuesit shembulli i tij i thotë të kundërtën: mos ta ulë veten gjer në atë shkallë sa të humbasë dinjitetin, të bëhet shtojcë e të tjerëve, mekanizëm që kurdiset prej tyre, njeri që buzëqesh e

vrenjten pa shkak, vetëm sepse buzëqeshin e vrenjten shefat.

Meritë e shkrimtarit është se e ka paraqitur Zylon si një qenie groteske, në një kohë kur ka ende aty-këtu alter ego të tij, që mbahen më të madh, rropaten të ngrihen mbi podiumet e përgatitura nga Demkët dhe kënaqen kur i lajkatojnë servilët e dyfaqësit. Lufta kundër burokratizmit edhe në kushtet e socializmit është e tensionuar, e vazhdueshme si vetë lufta e klasave ku ajo përfshihet. Por ajo është një luftë në të cilën epërsia e gjithanshme i takon popullit, socializmit, Partisë. Prandaj, nëse në vepra si romani «Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo» përqeshen burokratizmi e burokratët duke i përfytyruar kryesisht në forma groteske, kjo bëhet me prirjen për pasqyrim të epërsisë e të fitoreve të socializmit.

Romani na bën të qeshim, por për të është folur e flitet seriozisht, sepse e qeshura në art, është punë serioze. «Aristofani me të qeshura i çarmatosi perënditë» — lexojmë në roman, ndaj asgjë të tepërt nuk themi po të pohojmë se edhe me të qeshura ne kemi qëlluar e do të qëllojmë kundër veseve e të këqijave të trashëguara nga e kaluara, ndër të cilat burokratizmi është në radhën e dukurive më antipopullore e më antisocialiste.

1983

## IDETË E QARTA MISHËROHEN NË FIGURA REALISTE

Vëllimi i ri poetik «Drejt qindra shekujsh shkojmë» i Fatos Arapit përkon me drejtimin kryesor të përmbajtjes së veprës dhe të krijimtarisë së poetit në përgjithësi.

Në poemën që i jep edhe titullin librit janë sintetizuar disa nga motivet kryesore që përshkojnë një pjesë të mirë të vjershave të vëllimit, motive që i hasim si në krijimet e mëparshme të poetit, edhe në dy ciklet me vjersha që ai ka botuar në revistën «Nëntori» dhe në gazetën «Drita» para e pas daljes së këtij vëllimi të ri.

Poema «Drejt qindra shekujsh shkojmë» është krijimi më me vlerë në vëllim dhe një ndër krijimet poetike më të mira të vjetëve të fundit. Ajo, për frymën që e përshkon dhe për nivelin ideoartistik, rri denjësisht përkrah poemave: «Shqipëria dhe tri Romat» e I. Kadarësë, «Mesazh» e Ll. Siliqit, «Firma e popullit tim» e K. Petritit, etj., botuar gjatë kësaj kohe.

Nisur nga një vështrim i tillë, mund të nxirren përfundime mbi frymën e shëndoshë ideoartistike të poezisë sonë të re, gjallërinë dhe ndijshmërinë e mendimit tonë poetik, në të cilin kapen e fiksohen realiteti i ri dhe fryma e kohës. Format dhe mjetet e shprehjes janë të ndryshme, po zemra e poetëve rreh me pulsën e jetës sonë, mendimi i tyre nxitet e merr gjallëri nga vepra e madhe e popullit dhe e Partisë, nga historia që i flet së sotmes me mësimë e motive të fuqishme. I përmendëm të gjitha këto jo kot. Në vëllimin

«Drejt qindra shekujsh shkojmë», poeti ka trajtuar disa prej motiveve kryesore karakteristike për të gjithë poezinë tonë të sotme dhe përfshihet me dinjitet në atmosferën krijuese poetike të kohës. Poezia e F. Arapit, pas shpërthimeve të hovshme të rinisë, ka hyrë tanimë në fazën e pjekurisë së mendimit e të përsiatjeve mbi kohën e jetën tonë.

Në vëllim zotërojnë motive që kalojnë nga një krijim në tjetrin, i japin vëllimit një fizionomi pak a shumë të përcaktuar ideotematike.

Duke medituuar për kohën dhe heronjtë e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, deri diku dhe për aspekte të ndryshme të jetës socialiste, poeti është interesuar të mishërojë në figura poetike disa të vërteta të mëdha, siç janë: lidhjet e njerëzve me vendin, vazhdimësia e historisë dhe e idealeve, progresi i siguruar me luftë revolucionare, raportet e reja ndërmjet atdheut e njerëzimit, atdhedashuria socialiste dhe internacionalizmi proletar. Motivet intime apo nga lufta kundër shfaqjeve të huaja nuk zënë ndonjë vend me rëndësi, qoftë për mendimin që shprehin, qoftë për realizimin artistik.

Në poemën «Drejt qindra shekujsh shkojmë» dhe në ciklin «Në varrezat e dëshmorëve në Vlorë», në vazhdim të pjesës më të mirë të krijimtarisë së vet, autori jep një përfaqësim poetik të ri të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

«Vitet shkojnë tutje... e ju vini tëhu» — u drejtohet ai dëshmorëve, duke perifrashuar këngën popullore. Në atë varg popullor të njohur, aq konciz, po me shumë ndjenjë e mendim, në dy fjali mungesore që i japin këngës më tepër hapësirë, është përfshirë epoka, lidhjet historike, vazhdimësia e idealeve atdhetare e revolucionare, dashuria dhe nderimi i përjetshëm i popullit për të rënë, vepra e të cilëve, në dritën e agimeve të reja del më e madhërishme.

Në vjershën e F. Arapit perifrashimi i këtij vargu nuk është bërë rastësisht dhe nuk mbetet pa jehonë.

Mendimi dhe ndjenja popullore, shprehja poetike po me këtë frymë, shtrihen e konkretizohen në vjershat kushtuar dëshmorëve, të cilat ngjajnë si pllaka përkujtimore në vendin e rënies së tyre. Koha përgjithëson të veçantën, zbulon dhe nxjerr në pah më mirë kuptimin e fakteve dhe madhështinë e heroizmit. Edhe poeti e shikon të kaluarën nga e sotmja, si një vazhdë kujtimesh që janë ngulitur në mendje, si një varg bëmash, emrash, fytyrash të paharruara e lapidare.

Të rënë për liri i buzëqeshën trimërisë, dhanë jetën për atdhe, u kthyen në rrënjë që ushqejnë lirinë dhe mbetën të vdekur që kurrë në sy nuk venë gjumë. Vjen në vjersha mendimi popullor i shprehur aq thjesht, aq shkurt, aq bukur në vargjet e këngës: «Ju kish lindur nëna për një botë të re, lule more trima, që ratë për atdhe». Ky mendim i prin edhe idesë poetike të autorit.

Këtë frymë ideoemocionale popullore e gjejmë dhe në mjaft prej vjershave që poeti ka nxjerrë pas botimit të vëllimit, ndërmyet tyre vjershën «Ata», kushtuar atyre qindra e mijëra heronjve popullorë, që ishin «...në fund të fundit — jeta», por që mbetën pa emër dhe historia i njeh me emrin e përbashkët e lakonik: ata.

«Ata, — thotë poeti, — që ishin buka e vera / dhe fjalla e urtë edhe kuvendi; / ata që ishin nderi / dhe vendi. / Ata që s'kërkuan me majë të shpatës, / t'i luajnë, t'i zhvendosin historisë ndonjë gërmë, / e për veten e tyre të hapnin vend pakëz, / sa të hyjnë brenda...».

Në poemën «Drejt qindra shekujsh shkojmë» është vënë në themel një fakt simbolik me forcë përgjithësuese. Ai me të vërtetë të kujton tragjeditë dhe qëndresën e popujve nëpër histori. Por ajo është, së pari, dëshmi e asaj që ndodhi në vendin tonë në zjarrin e Luftës, siç ka për të ndodhur kudo në zjarrin e revolucioneve. Pikërisht kjo lidhje e fateve të popullit tonë me epopenë partizane, e fateve të popujve me rolin shpëtimtar të revolucioneve proletare e luftërat çlirimtare i japin gjerësi mendimit poetik, e kapërcejnë

konstatimin e faktit bazë, të detajit kur partizanët marrin në duar foshnjën jetime:

«Ne ishim një skuadër partizane, — thotë poeti në kronikën me të cilën nis poemën. — Papritur i pari u ndal. Qëndruam të gjithë: një grua e vrarë rënë në mesin e udhës. Në gjirin e saj foshnja pinte ende qumësht...», në gjirin e nënës vrarë nga fashistët.

Poeti nuk i largohet këtij fakti dhe nuk zhurmon rreth tij. Ai është përpjekur ta zbulojë sa më thellë dhe më emocionalisht atë që ka ndodhur, t'i bëjë lexuesit të vetëdijshëm për kuptimin që merr çdo hollësi.

Përmes prezentit historik të shfrytëzuar me mjesh-tëri, ne marrim pjesë në atë bashkëjetesë tronditëse të jetës me vdekjen, të tragjizmit me optimizmin, të luftës me lirinë, të së kaluarës me të ardhmen. Shfaqen para nesh vegime të fiksuara mirë: nga gjiri i nënës kalohet te ylli i partizanit, i proletarit të kuq, që shkëlqeu në ballin e foshnjës e ndriçoi udhën drej kohës sonë. Mbi mjerimin që solli lufta imperialiste koha lartësoi epikën e luftërave çlirimtare e të revolucioneve. Në poezi, natyrshëm, hyn mendimi se në malet tona «posi dy degë vetëtime, fekste edhe mjerimi, / shpërthente dhe trimëria...» nëpër shtegtimin e pafund të brezave. «Vijmë prej qindra shekujsh, drejt qindra shekujsh shkojmë». Pra, ky përballim, kjo luftë si urëkalim drejt botës së re është përgatitur thellë historisë. Nëna e vrarë na sjell ndër mend nënat legjendare shqiptare, na bën të mendojmë jetën që nuk shteron. Në këtë nyjë ideo-emocionale qëndron edhe forca përgjithësuëse, edhe aftësia e poetit.

F. Arapi ngaherë ka synuar të shikojë si reflekton e përgjithshmja në të veçantën dhe si shprehet përmes saj. Të shumtën e herës në këtë rrugë ka pasur sukses, si në poemë, në mjaft vjersha të përfshira në vëllim e në cikle të botuara në shtyp.

Në vjershën kushtuar dëshmorit Kastriot Muço e përgjithëshmja është dhënë thjesht, qartë, përmes kontrastimeve që krijojnë atmosferë poetike: «Brenda një emri...



/demonstratat e shesheve,/ mbledhjet ilegale, / çetat partizane, / varret e shokëve, / pritat e maleve».

Një mënyrë tjetër po ka e natyrshme dhe e efektshme është zbulimi i kuptimit të përgjithshëm të fakteve e të bëmave heroike ose duke u dhënë atyre vlerën e simboleve. Në vjershën kushtuar Mitat Dautit rrjedhin natyrshëm pyetjet retorike drejtuar atdheut: «Çdo të ishte trupi yt, / pa trupin tonë përzier në të? / Liria jote ç'do të ishte, / pa këtë vdekjen tonë?» Faktet e thjeshta nga jeta e heroit marrin vlerë simbolike: «Yllin e kuq mbi beretë, / sazen e vogël në gojë. / Udhët ngrihen pas teje, gjithë këngën tënde këndojnë», (në vjershën kushtuar Lefter Sallatës).

Ndodh që vetë portreti i një heroit të veçantë ka në vetvete forcën e një përgjithësimi, ndaj poeti nuk ndien nevojën të shtojë diçka tjetër. I tillë është Vrana Konti në vjershën me të njëjtin titull (botuar në revistën «Nëntori»): «Ai ishte kudo ku ishte rreziku, / ku vdekja osmane me thëllime korrtë. / Në natën tradhtare Hamzai iku... / Shqipëria pyeste: a është Vrana Konti? / Të tjerët kishin kështjella, principata, / kishin kohortat e tyre, ushtërirë. / Ai kishte vetëm zemrën e shpatën./ Shqipëria kishte edhe nderin e tij».

Po ka raste kur kjo nuk arrihet, edhe pse poetit nuk i mungon mjeshhtëria. Kujtojmë vjershën kushtuar Teli Ndinit. Ajo nis në mënyrë tepër konkrete: «...Me krye mbi dy qeramidhe / gjunjët kruspull në gjoks». Kështu i kujtohet poetit heroit i vrarë në luftë me fashistët. I ka mbetur i pashlyeshëm në kujtesë ky imazh. Por nisur nga ky fakt, përgjithësimi nuk rrjedh natyrshëm. Flitet në vjershë për grushtet «gjysmë globi», për frontet e luftës, për gjakun e popujve «si lumë madhështor i nëndheshëm» dhe fakti poetik mbulohet me arsyetime, me figura pas figurash. Është një e metë që e gjejmë në shumë vjersha e poema të sotme, sa herë autorët nuk arrijnë në thelbin e vërtetë poetik të dukurive të pasqyruara.

Në disa vjersha përsiatëse e me tema intime të vëllimit jepen çaste e përjetime të veçanta në një

frymë të ngushtë vetmore. Poeti ka diçka për të thënë, por lexuesi e ka të vështirë të përfshihet në atmosferën e krijuar. Tipike për këtë dobësi janë vjershat: «Më thirre?», «Kur vija te ty...»: Citojmë nga vjersha e parë: «Më thirre? Erdha / Se erërat pas erërave shkojnë, / dallgët pas dallgëve. / Më thirre? / Erdha. / Njëri-tjetrit i dalim përpara, takohemi, / si dy re nëpër shi e shtrëngatë / me gjëmime takohen / nëpër qiejt e lartë».

Vjersha e dytë:

«Në fushën e mbrëmjes unë lozja me erën, dhe era me mua e me veten lozte. / Dhe vija te ty e shkelja përherë / me hapin e parë, që mbi tokë hedh foshnja. / Dhe mbaja në buzë trëndafila të bardhë / këputur mes valëve të detit të gjerë. / Unë isha kambana që diku në muzgje /kumbonte në qiell vetiu prej ere».

Në të dy rastet vjershat si tërësi figurative dhe mënyrat e shprehjes mbeten larg e jashtë lidhjeve të qarta me dukuri konkrete. Lexuesi nuk arrin dot të përgjasohet me heroin lirik të vjershave, ta ndiejë veten «re nëpër shi e shtrëngatë», kambanë, që «diku në muzgje» kumbon prej erës.

Reflekse të një konceptimi poetik si ky ndeshim edhe në vjershat «Sonte», «Humba në shoqëri me detin» etj. Jemi me poetin për «luftë kundër feudalit e borgjezit, /kundër vocrrakut të tyre, mikroborgjezit; /kundër servilit e prepotentit, / që më shurdhoi timpanin e veshit: Unë! Unë! Unë», po nuk arrijmë të kuptojmë gjithsesi ç'përfaqëson deti si figurë poetike simbolike: përjetësinë, botën e «madhe», apo çfarë tjetër? Prandaj ne duket i panatyrshëm kalimi nga deti te prepotenti (thjesht nga pikëpamja poetike) dhe mbetet pa ngjyrim kohor mendimi: «Unë jam edhe gur, edhe diell, /edhe djersë, edhe gjak. /Unë jam një fjalë e përgjakur kundër padrejtësisë, /një zemër njeriu në flakë». Këto bien ndesh me karakterin e përcaktuar ideor, kohor e figurativ të krijimtarisë së mëparshme të F. Arapit dhe të krijimeve me vlerë të vëllimit që po shqyrtojmë.

Në vjershat më të mira të vëllimit lexuesin e rrëm-

ben fryma optimiste militante, poezia e ritmeve të jetës sonë Me shumë efekt poeti e ka mbyllur ciklin për dëshmorët me vjershën «Ikja e fëmijërisë», për të pohuar: «Ditë të tjera të zjarra, /para meje shpaloste /lufta e madhe e popujve». Ideja se dëshmorët jetojnë e luftojnë tok me ne plotësohet kështu nga një tjetër ide: ne ecim në rrugën e tyre, ngjitemi më lart.

E gjejmë më të konkretizuar këtë ide në vjershën «Mbrëmë»: «...gjeneratat /që njëra-tjetrën mbajnë mbi shpatulla /e njëra tjetrën mësojnë dritat t'i kapin me duar», po sidomos në poemthin «Rinisë», që lexuesi e njeh nga vëllimi «Ritme të hekurta». Në poemth afirmimi entuziast i poezisë së moshës («...përherë e qeshura, rini /përherë e dashuruara...») harmonizohet me poezinë e vrulleve ndërtimtare («...kënga rend nëpër tokë ditën, natën, /me ty fluturon hekurudhave, /ngjitet terracave, /qiellin kënga sulmon, përpin retë...») dhe me karakterizimin poetik të profilit të saj si: «... gjak i bujshëm i komunizmit», që derdhet në trup të atdheut.

Këto tema e pasqyrime gjejnë shprehjen adekuate poetike me konkretësi e formë koncize të parashtrimit të mendimeve e të ndjenjave, me imazhet e vargun realist në frymë popullore. Kjo është natyra e vërtetë, karakteristika kryesore dhe një ndër vlerat më me rëndësi të poezisë së F. Arapit.

Shumë shembuj mund të përmendeshin në argumentim të këtij konstatimi. Le të kujtojmë vjershën kushtuar dëshmorit Fiqiri Muka, në të cilën me dy vargje është dhënë portreti i heroit: «Fati i grisur i një shegerti, /Shorti i verbër i një jetimi».

Në vjersha e poema gjejmë karakterizime të mprehta e shprehëse, si: «Mesjeta e vdekur dhe e pavarrosur»; «Burrë zemërdiell/ kredhur në qeli»; karakterizimi i shekullit tonë si «...varr madhështor i skllavërive», që «zjarrin e shenjtë të revolucioneve, /si në vatra të varfërisht, /ndez në zemrat e njerëzve» dhe «çdo çast përtyp e bluan /eshtra perëndish e altaresh».

Tjetër veçori e vlerë e krijimeve është harmonizimi

në to i konkretësisë e saktësisë me hovet e fuqishme dhe me figurat e guximshme që i shprehin këto. Vetë shprehjet e figurat konkrete kanë hapësirë të gjerë mendimi e përfytyrimi, ose mendimi i rëndësishëm dhe përfytyrimi i gjerë të jepen përmes një shprehjeje poetike të bujshme, në kuptimin e mirë të kësaj fjale. Kështu Shqipëria përfytyrohet me «...kryet në zemrën e qiellit me re /këmbët ndër harlisje të detit Mesdhe» («Shqipëria») Në poemën «Rinisë» poeti i drejtohet brezit të ri: «...sulu mes kohërave, /brohori e pamposhtur e jetës». Të njëjtën natyrë ka edhe ndonjë përfytyrim poetik te poemthi «Në Orosh».

Në këto raste figurat e pasura e shprehjet metaforike, harmonizohen me konceptimet poetike të realitetit, i gjallërojnë idetë, i bëjnë më ndikuese. Figurat në kësi rastesh nuk kanë të bëjnë me mbingarkesën figurative, që vihet re aty-këtu, as me ndonjë shfaqje parazitare, sikundër në rastin e mëposhtëm. Vargjet «Gjeneratat vijnë njëra pas tjetrës, /shtynjë njëra-tjetrën /si dallgët e detit», pasohen nga vargje si: «Gjeneratat kanë fytyrën, /biografinë e tyre, /si njerëzit. Gjeneratat, si erërat e qiellit, /njëra-tjetrën pjellin /me gjëmime» etj., që nuk shtojnë gjë. Në vjershën «Poezisë» krahasimi detajohet deri në atë shkallë sa e vulgarizon përfytyrimin poetik: «Dhe binim në shtrat. /Me duart e mia të zhvishja linjën e trupit. /Ti mbështilleshe në hutimin tënd mjegullor, të bardhë», i drejtohet autori poezisë.

Nëse i mbyllim këto shënime me një vërejtje, kjo s'do të thotë se duam t'i lëmë këtë përshtypje lexuesit. Sepse në tërësi vëllimi «Drejt qindra shekujsh shkojmë» dhe dy ciklet e vjershave të botuara pas tij, dëshmojnë se poezia e F. Arapit rrjedh e sigurt dhe origjinale në shtratin e përgjithshëm të poezisë sonë të realizmit socialist, e përshkuar nga një frymë e shëndetshme realiste, me figura të gjetura e vargje të skalitura me mjeshteri. Disa dobësi e të meta që u përmendën nuk kanë të bëjnë me drejtimin kryesor ideoartistik të saj, po megjithëkëtë, nuk duhen lënë të thellohen më tej.

## PARALELE DHE KONTRASTE TË KOHËS

(Romani «Bota ime» i Dhimitër Xhuvanit)

Dhimitër Xhuvani, pas romanit «Vdekja e zotit Kaloti» dhe në vazhdim të tij, doli para lexuesve me një vepër të re, me romanin «Bota ime». Ky roman, nga më se një pikëpamje, shënon sukses të ri për shkrimtarin dhe për gjithë prozën tonë me tematikë bashkëkohore. Në «Vdekja e zotit Kaloti» është paraqitur në kontrast fundi i Zejnulla Kalotit — çertexhiut kokëngjeshur e makut, që aspironte përtëritjen e pronës private dhe përfshirja e vetëdijshme e Ridvan Kalotit, birit të tij, në atmosferën e jetës së re, që sapo kish nisur të bënte përpara pas fitores së revolucionit popullor. Në romanin e ri, ngjarjet e të cilit janë thujse të ditës, para lexuesve zbulohet tabloja entuziaste e fitoreve të socializmit dhe e vazhdimit të luftës së klasave në këto kushte të reja. Kjo tablo është më e gjerë, më e shumanshme, me paralele e me kontraste të forta shoqërore, politike e psikologjike dhe përshkohet nga një frymë e shëndoshë bashkëkohore milituese. Në roman pasqyrohen probleme që janë shtruar për zgjidhje në kuadrin e përgjithshëm të zhvillimit e të përparimit socialist të vendit. U bëhet thirrje lexuesve që të mendojnë për këto probleme, të mos pandehin kurrë se mund të arrihet pajtim klasor me përfaqësuesit e klasëve të përmbysura dhe të luftojnë çdo reflektim të mentaliteteve e të psikologjisë së pronarit e të mikroborgjezit si në jetën shoqërore edhe në veten e tyre.

Në një thurje të thjeshtë kompozicionale, pa stërholime e ndërlikime, me subjekt të përqëndruar mirë ideo-artistikisht, shkrimtari ka arritur të paraqesë bukur problematikën që i ka interesuar. Duke e përqëndruar vëmendjen te njerëzit, te proceset e shndërrimeve shoqërore e psikologjike, ai ka arritur të integrojë, përgjithësisht me mjeshteri e realizëm, në një tërësi kompakte rrethanat e përgjithshme historike të reflektuara në tipa e karaktere të spikatura, sfondin veprues të një mjedisi në shndërrim të vazhdueshëm e të pandalshëm, veprimtarinë praktike në jetë e në punë, qëndrimet e çdo njërit prej personazheve ndaj realitetit që e rrethon, ndaj të tjerëve dhe ndaj vetvetes. Në roman flasin vetë faktet, qëndrimet dhe meditimet e personazheve, pa qenë nevoja për ndërhyrje të shpeshta të autorit e për moralizime personazhesh anësore të panevojshme, ndonjëse refleksë të kësaj natyre ndeshen aty këtu edhe në këtë veper.

«Bota ime» është bota e Liri Rekës — heroinës së romanit, një botë që përkon me vetë konceptet e shkrimtarit për problemet morale e politike të trajtuara. Ajo është bota e hapësiravë të mëdha, e idealevë të larta shoqërore, bota e bukurisë së shqetësimeve e të luftës për fatet e vendit, e poezisë së punës krijuese, e mendimevë të kthjellta revolucionare dhe e ndjenjave të pastërta e të singërta, bota në të cilën te çdokush duhet të përfshihet dashuria për të gjithë dhe te të gjithë — kujdesi për secilin.

Kjo botë e madhe dhe e bukur, që, në kuadrin e ngjarjeve të romanit por dhe simbolikisht, ka për sfond ndërtimin e kombinatit metalurgjik, nyja vendore e subjektit nuk përfaqësohet vetëm prej Liri Rekës; ajo nuk është një botë aspiratash dhe Liria nuk është ndonjë heroinë modelore. Përkundrazi, «Bota jonë» është reale, madhërisht e bukur, me forcë të atillë tërheqëse që na bën për vete, na ngazëllen, na entuziazmon dhe na hedh në veprim. Liri Reka është hedhur në krahët e kësaj jete me giltërsinë e vajzës së re, jeton çastet e lumtura

të njeriut, i cili shikon se është bërë realisht zot i vetvetes dhe i vendit, pa hije mëdyshjesh në ndërgjegje.

Në këtë botë ka vend lumturie për të gjithë njerëzit e ndershëm e punëtorë, për Magan Rekën dhe për Ajdin Kolanin, për Agim Rekën dhe për Elsa Kolanin, për Jakubin Sarën dhe për fshatarin Serafin Bodurin, madje dhe për Gidi Dumrelën, nëse kjo do të vihej sinqerisht në rrugën e njerëzve të ndershëm të punës.

Kjo dritë jete e veprimtarie të gjallë, mendimesh dhe idealesh frymëzuese është, siç duhej të ishte, një prej çasteve më me rëndësi të brendisë ideoemocionale të romanit «Bota ime.» Është poezia e jetës sonë të sotme që ka tërhequr shkrimtarin, që e ka bërë atë për vete, prandaj romani të rrëmben dhe të jep krahë, të bën të ngrihesh mbi vogëlsitë e brengat vetjake dhe, tok me Liri Rekën, ta kundrosh horizontin nga kulla e furnal-tës, në dritën e fortë të çelikut të shkrirë.

Poezia e jetës, sado zotëruese, është vetëm njëra prej aspekteve themelore të përmbajtjes ideoemocionale të veprës. Nëse shkrimtari mbetet brenda caqeve të një përfytyrimi euforik të realitetit, siç vërehet ende në disa vepra skematike, romani, sado i frymëzuar dhe i realizuar me mjeshtëri, nuk do të kishte ndonjë vlerë për t'u shënuar, ashtu siç nuk do ta kishte pasur këtë vlerë edhe në qoftë se do të ishte përqendruar subjekti vetëm në dramën intime, sado të vërtetë dhe edukuese, të dy tri personazheve. Vepra me vlerë shoqërore bëhen vetëm ato në përmbajtjen e të cilave përfshihen aspekte themelore të realitetit dhe rroken e trajtohen probleme të rëndësishme të kohës, ato që i lidhin lexuesit me jetën në zhvillim, u çelin dritare për të depërtuar në kuptimin e proceseve që ndodhin, që i frymëzojnë, por edhe i bëjnë të mendohen, të përcaktojnë më mirë qëndrimet e tyre të mëtejshme.

Dhimitër Xhuvani me romanin «Bota ime», si përmes kontrasteve të realitetit socialist me predispozitat dhe aspiratat e familjes së deklasuar të Adem Dumrelës, edhe përmes zhgënjimit të Serafin Bodurit e dra-

mës së Liri Rekës, u kujton lexuesve edhe një herë se poezi e jetës është poezia e luftës së papajtueshme me çdo gjë antisocialiste, qoftë kjo e trashëguar dhe e përmbytur në qëllime kundërrevolucionare, qoftë dhe e mbartur nga e kaluara në të sotmen në formën e interesit të ngushtë vetjak, të egoizmit apo të iluzioneve të pajtimit klasor. Këtë botë të bukur socialiste, u thotë shkrintari lexuesve, ne duhet ta mbrojmë nga depërtimi i elementeve dhe i dukurive armiçësore dhe ta pas-trojmë nga çdo shfaqje e huaj që bie në kundërshtim me të, duke çliruar si marrëdhëniet me të tjerët, edhe vet-veten nga çdo ndikim i kësaj natyre. Socializmi është në sulm të përgjithshëm frontal, por edhe qëndresa armiçësore ndaj tij, qoftë aktive apo pasive, nuk pushon së qeni pjesë e realitetit të sotëm historik. Simbolikisht kjo jepet me faktin kuptimplot që për një periudhë familja e revolucionarit Magan Reka dhe ajo e reaksionarit të përbindshëm Adem Dumrela banojnë nën të njëjtën çati, në të njëjtin oborr të ndarë me vazo lulësh, megjithëse kanë qenë dhe mbeten përfaqësues të dy klasave armiçësore, të papajtueshme. Dumrelasve u është lënë shtegu hapur për të dalë në udhë dhe për të hyrë në jetën e njerëzve të ndershëm e punëtorë. Por ndërsa oborri i mëparshëm tani është ndarë përgjysmë e formon dy sipërfaqe paralele, qëllimet e dy familjeve kanë qenë dhe mbeten antagonistë, kontrastuese. Punëtori i shtypur i Adem Dumrelës tani është përfaqësues i pushtetit popullor dhe pronari i dikurshëm shpirtkazmë është «shndërruar» në punëtor i ndërmarrjes komunale. Por etja e këtij për revansh klasor dhe shpresa për restaurim mbeten të gjalla. Ato ruhen në potencë, shfaqen në format më të ndryshme, gjallërohen kur pandehet se gjendjet janë të favorshme dhe mund të shpërthejnë sikur të zbutet lufta e klasave dhe të shuhet vijilenca.

Familja e Adem Dumrelës jeton në ankthin e kujtimeve të kohës së shkuar, të urrejtjes ndaj çdo për-



parimi të vendit, të armiçësisë ndaj popullit, por edhe të vetëdijës së të shpronësuarve, që rreken të mbijetojnë, duke u ushqyer me iluzione dhe me shpresa. Në këtë gjendje ata janë të detyruar të provojnë çdo shans, pa hequr dorë nga vetvetja, por duke u munduar sa të jetë e mundur të fshihen pas një dukjeje hipokrite. Ky makth, i pasqyruar aq mjeshtërisht në roman, ua nxin jetën dhe ua çorodit mendjen. Adem Dumrela, si «filozof pesimist i të deklasuarve», është i gjithi vrer. I rrahur me vaj e me uthull, ai as dëshiron dhe as shpreson se mund të arrihet pajtim klasor. Ai është armik i vendosur i socializmit dhe këtë ndjenjë ia ka futur në gjak së bijës — Gidit. Si pronar i shpronësuar ai i është nënshtruar fatit, i vjen inat kur i kujtojnë të vëllanë e burgosur dhe bën sikur mburret, kur thotë se është ndër punëtorët më të vjetër të komunales. Ai ka shpresuar dhe është lodhur së shpresuari, ndaj është bërë maniak: rron me gëzimin që binaja e dyqanit të tij më të madh nuk është shembur dhe, kur vithiset ky, ai i jep fund jetës nën gërmadha. Në kuptimin më të përgjithshëm njerëzor ky është fundi i të gjithë atyre që fatalisht e identifikojnë qenien e tyre njerëzore me qenien e tyre si pronarë, pa pranuar kurrë të pajtohen me idenë e një të jetuari me djersën e ballit.

Jalldyz Dumrela, po aq reaksionare në shpirt, është më realiste në jetë. Ajo nga halli është gati t'i thotë derrit dajë, mjaft që të nxjerrë ndonjë përfitim imediat, duke shfrytëzuar çdo rast dhe çdo shteg për t'u shpëtuar goditjeve, për të dalë, siç pandeh ajo, jashtë sferës së veprimit të luftës së klasave. Për t'ia arritur këtij qëllimi, në rrethanat e krijuara, Jalldyzi zgjedh rrugën më të mundshme: futjen e së bijës në kombinatin metalurgjik dhe martesën e saj me një punëtor, duke thyer qëndresën e të shoqit skeptik, e mbështetur në joshjen femërore të së bijës. Asgjë nuk humbasim, mendon ajo. Përkundrazi, nga qëllimet dhe shpresat tona nuk heqim dorë, kurse tani për tani diçka fitojmë duke e futur Gidin «në sërën e tyre».

Gidi, nga ana e vet, i jep më tepër të drejtë të atit, por shpirtërisht anon nga zgjidhja e propozuar prej së ëmës, goftë për arsye se e kupton realisht gjendjen, edhe për shkak se i është bërë e padurueshme vetmia e beqares.

Rrotull Dumrelasve vërtiten edhe elementë të tjerë të deklasuar, por këta janë përgjithësisht personazhe episodike që ruajnë atmosferën e frymës kundërrevolucionare, siç e gjejmë dhe në vepra të tjera të Dhimitër Xhuvanit. E veçantë në romanin «Bota ime» është se shkrintari, në aspektet e trajtuara, nuk ka paraqitur të deklasuarit në përgjithësi, por gjendjen e tyre aktuale, kur këta, të privuar nga çdo pronë dhe nga çdo bazë tjetër materiale, janë të detyruar të jetojnë si punonjës, megjithëse mendojnë dhe aspirojnë si reaksionarë. Ky dyzim i qenies së tyre i bën ata të paskrupull moralisht, hipokritë, deri diku dhe qesharakë në botën e ëndrrave e të shpresave të tyre. Për të ruajtur lëkurën, ata jo vetëm bëjnë atë që nuk do t'ua thoshte zemra të bënin (p.sh. martesë e Gidi Dumrelës me Serafin Bodurin), por dhe në marrëdhëniet në mes tyre udhëhiqen nga egoizmi cinik. Adem Dumrela e përfytyron të bijën femër që mund të presë e të përcjellë klientë, kurse kjo, në fund të fundit, nuk pikëllohet shumë nga vdekja e të atit, me shpresën se kjo vdekje do të jetë një rrethënë lehtësuese në jetën e saj.

Kjo frohtë armiqësore nuk është në gjendje e nuk ka mundësi të sfidojë hapur socializmin. Bota e ëndrrave dhe e shpresave të tyre shembet, ashtu siç shemben çertet dhe dyqanet e vjetra. Prandaj një prej rrugëve të mundshme për të rrojtur në pritje të «ditëve më të mira» është t'u përshtaten rrethanave dhe të përpigjen të depërtojnë me hipokrizi në «botën tonë», duke shfrytëzuar çdo mundësi që u jep humanizmi socialist (ata duhet të jetojnë dhe që të jetojnë duhet të punojnë, — thotë Magan Reka) dhe çdo iluzion e pavendosmëri njerëzish të paformuar ideopolitikisht.

Në roman, si fill që lidh dy botët antagoniste, ka shërbyer Serafin Boduri. Po ç'është ky tip?

Njihemi me të që në fillim të kreut të katërt të veprës. Ai që nga stanet «ku ruante dhitë e kooperativës kishte një vit e ca që i shkonte dritat e shumta të metalurgjikut» dhe nuk ëndërronte tjetër veç «të ikte nga fshati, të zbriste në qytet e të bëhej punëtor mes atij deti me zjarre». Një aspiratë e zakonshme kjo për disa të rinj fshatarë, të cilët kanë pasur rastin të njihen me jetën qytetare dhe janë joshur prej saj. Të rinj si Serafin Boduri, sado të pastër e të çiltër, e shikojnë botën në këndin e ngushtë të interesave vetjake. Qyteti atyre u duhet për të siguruar një jetë më të lehtë dhe për të plotësuar disa synime egoiste, jo si një botë e madhe për të cilën edhe ata mund dhe duhet të japin ndihmesën e tyre, të udhëhequr prej mendimesh të ndritura dhe idealesh të mëdha. Sado paradoksale të duket, tipa si Serafin Boduri i shtyjnë drejt jetës së re reflekset e psikologjisë mikroborgjeze. Nëse Gidi Dumrela hyn në kombinatin metalurgjik për t'i shpëtuar punës së vështirë të ndërmarrjes bujqësore dhe, sido kudo, për t'i shpëtuar «mallkimit» si e dekluar, Serafin Boduri, sado që shpirtërisht i lidhur me socializmin, në motivet që e shtyjnë të braktisë fshatin nuk qëndron shumë larg saj. Ata janë dy të kundërta që përkrijnë pjesërisht e përkohësisht me njëra-tjetrën, deri në njëfarë mase një unitet i përkohshëm, që vjen si pasojë e motiveve josocialiste.

Serafini ka epërsi ndaj familjes të së shoqes (Gidit) prejardhjen dhe përkatësinë e vet klasore, për të cilën nuk është fort i ndërgjegjshëm, Dumrelët kanë pasaportizimin në qytet dhe një strehë për kollovarin.

Në afrimin dhe në bashkimin e përkohshëm të Serafin Bodurit me Gidi Dumrelën ndikojnë kështu disa faktorë të karakterit shoqëror, ideologjik dhe psikologjik, siç janë: dëshira makute për t'u vendosur përfundimisht në qytet, gjykimi i cekët se të dy janë punëtorë, madje në furrnaltë; bindja se Gidi do ta mohonte klasën

dhe familjen për hir të dashurisë dhe, doemos, naiviteti i një të riu fshatar, që bie lehtë në kthetrat e një femre lajkatare, pa menduar thellë kush është ajo.

Për të qëndruar në qytet, Serafin Boduri do të kishte pasur një mundësi tjetër, më të sigurt: punën, kualifikimin dhe përkrahjen e shokëve, por ai, në gjithë këtë çështje, vepron me hile, është dritëshkurtër; ky është një difekt karakteri, siç është refleksi sedre patriarkale këmbëngulja për të mos i dalë fjale Gidi Dumrelës.

Siç shihet, karakteri i Serafinit nuk është aq i thjeshtë sa mund të duket dhe problemi që ai mbart është sa i vërtetë, aq dhe me rëndësi për jetën e sotme shoqërore. Parashtrimi i këtij problemi në roman është realist, militant dhe me synime të përcaktuara edukuese. Shkrimtari, duke qëndruar konsekuent në pozita klasore revolucionare, jo vetëm nuk ushqen asnjë iluzion pajtimi klasor dhe zbutje të luftës së klasave, por, përkundrazi, zbulon para lexuesve të vërtetën bindëse se, edhe në regëtimat e fundit, përfaqësuesit e feudoborgjezisë së përmbysur do të jetojnë me urrejtjen për socializmin, me përbuzjen për njerëzit e popullit dhe me shpresën e restaurimit. Kjo e vërtetë është paraqitur aq qartë dhe me aq mjeshtëri, sa duken të tepërt edhe moralizimet që i bëjnë shokët Serafinit.

Pa qenë nevoja për moralizime të tilla, mbase më mirë do të kishte qenë që të depërtohej në imtësi më të mëdha të dramës së Serafin Bodurit dhe të shkaqeve që e futën atë në një rrugë pa krye. Për këtë qëllim në roman duhej të ndihej më tepër rrjedha e kohës si një ndër faktorët objektivë më me rëndësi për zbërthimin më në hollësi të dramës dhe për t'i dhënë zgjidhjes procedim bindës më të natyrshëm. Nga fillimi i ngjarjeve deri në fund kalon gati një vit, por distanca e kohës objektive nga një ndodhi në një tjetër është pothuajse e pandjeshme, prandaj proceset e shndërtimeve psikologjike duken disi të përshpejtuara.

Serafin Boduri, pa qenë nevoja e këshillimeve të Josif Tollumit etj., është vendosur aq me vend në të-

rësinë e tablosë së paraqitur, saqë vetvetiu, duke u zhgënjyer nga dita në ditë deri në zbulimin e «testamentit» të Adem Dumrelës, do të gjente forca të dilte nga bataku ku kishte rënë. Puna, shoqëria, vetë qartësimi i perspektivës vetjake janë forca të mëdha që do të vinin në lëvizje gjithë potencialin e tij shpirtëror, do t'i zgjeronin këndin e shikimit dhe do ta lartësonin si njeri.

Analizuam së pari personazhet e të deklasuarve, jo se ata janë vënë në qendër të romanit, por sepse lidhen me idenë kryesore të luftës së gjithanshme në mes «botës tonë», e cila na ndjell dhe na shtyn të ecim përpara, duke qenë përherë në revolucion, dhe «botës së vjetër», e cila na frenon në vend, synon të na mbajë në kthetrat e veta, ruan dhe nxit ambiciet, egoizmin e ndjenjën e pronarit, vese të një kohe të perënduar, që ende ka forcë ndikuese në psikologjinë e veprimet e njerëzve. Drama intime e Liri Rekës, së cilës i kushtohet më tepër vëmendje në roman, është pasojë e këtyre trashëgimeve të këqija dhe e koncepteve sa liberale aq dhe konservatore e mikroborgjezë ndaj dashurisë, familjes dhe dinjitetit të njeriut.

Inxhinieri Jakubin Sara, që mund të jepej më i plotë në jetëshkrimin e tij, është një specialist i zoti dhe, kur i vihet punës, i del mbanë çdo vështirësie profesionale. Por punën, aftësitë, meritat ai i shikon si investim kapitali për arritjen e disa qëllimeve meskine. Ai është një tip i dyfishtë, sepse në të, në forma dhe aspekte të reja, zotërojnë po ato mentalitete dhe po ajo psikologji e borgjezëve të dikurshëm. Nëse Gidi Dumrela afrohet e martohet me Serafin Bodurin për qëllimet që u përmendën, Jakubin Sara — «njeri i ri i socializmit» — ruan marrëdhëniet me Elsa Kolanin, jo aq nga dashuria sa nga synimi egoist e meskin për t'u rikthyer në Tiranë me ndërmjetësinë e Ajdin Kolanit. Pra, në thelb, kemi të bëjmë me të njëjtën dukuri, me një paralel shoqëror e psikologjik,

që shkrimtari na e ka bërë të qartë pa folur enkas për të.

Por sidoqoftë, edhe në këtë rast çështja nuk do thjeshtuar. Jakubin Sara, ashtu siç lëkundet në mes Lirisë dhe Elsës, po ashtu lëkundet në mes romantikës së punës në kombinatin metalurgjik dhe dëshirës për një qoshe të qetë, për konfortet e një jetese pa telashe, të një jete ku të tjerët vetëm duhet t'i shërbejnë atij si burim përfitimi dhe kënaqësish. Ai është i pafuqishëm ta përballojë këtë alternativë, sepse është njeri me dobësi karakteri dhe me predispozita josocialiste.

Në marrëdhëniet e Jakubinit me Lirinë duhej të ndihej më tepër kalimi i kohës dhe të dilnin më në pah intimitetet e tyre që çojnë në shpërthimin dramatik. Por edhe me aq sa është dhënë në roman, lexuesi ka mundësi të arrijë në përfundimin se ka të bëjë me një tip hipokrit dhe egoist, me një njeri që i shtrin të drejtat e veta përtej kufijve të moralit e të marrëdhënieve shoqërore socialiste. Në kërkesën që i bën Lirisë për abort dhe në lutjen që i drejton Elsës për ta falur ai e zhvesh plotësisht veten dhe na bind që jo vetëm nuk është aq i ndershëm sa t'i bëjë gjyqin vetvetes, por meriton plotësisht përbuzjen dhe shuplakat.

Në roman nuk flitet për fundin e këtij tipi dhe mendojmë se duke vepruar kështu, shkrimtari ka bërë mirë. Nga pikëpamja shoqërore ne do të ndeshemi për një kohë të gjatë me tipa e me karaktere si Jakubin Sara, kurse nga pikëpamja artistike çështja s'kish pse të shtyhej më tej. Çdo zgjatje do të kish qenë komentative dhe e tepërt për një lexues që arrin të mbajë qëndrim të prerë ndëshkues ndaj tij.

Është meritë e shkrimtarit që marrëdhëniet në mes Jakubin Sarës dhe Liri Rekës, si dhe të gjitha marrëdhëniet e tjera që përbëjnë fijet kryesore në strukturën e romanit, nuk i ka parë thjesht si çështje që kanë të bëjnë vetëm me karakterin e njerëzve të veçantë, por mbi trollin e rrethanave konkrete të kohës u ka dhënë kuptim me shtrirje të gjerë shoqërore. Do të

ishte njëanshmëri sikur, duke fajësuar Jakubin Sarën, problemi të quhej i zgjidhur, siç ndodh disa herë në vepra skematike e të përcipta. Dhimitër Xhuvani, duke mos rënë në këtë dobësi ideoartistike, tërheq një vijë paralele edhe në mes Liri Rekës dhe Serafin Bodurit. Ajo, sikurse Serafini, beson lehtë dhe nuk arrin të zbulojë prapa fjalëve e dukjes së jashtme shpirtin e njeriut me të cilin ka të bëjë. E çiltër, entuziashte, deri diku romantike gati gjer në eufori, Liri Reka nuk shkon ndër mend se në jetën tonë të sotme, midis dy kolegëve, mund të vegjetojë tinëzisht aq hipokrizi, egoizëm dhe meskinitet. Duke qenë vetë e bukur në shpirt e në mendime dhe e rrëmbyer nga ndjenja e ëndërrime të ngazëllyera, asaj i duket se gjithçka është e bukur në jetë, mjaft që të duash të punosh e të jetosh. Luftën e klasave ajo nuk është në gjendje ta shtrijë në çdo aspekt të realitetit, në çdo marrëdhënie e qëndrim ndaj njerëzve. Edhe Liria ushqen iluzione, prandaj bie në një pësim e gjendje dramatike, nga i duhen forca të mëdha shpirtërore për të dalë, jo duke bërë lëshime, po duke afirmuar vendosmërisht dinjitetin e vet.

Shkrimtari, me të drejtë, e përshëndet këtë zgjidhje, duke kapërcyer mentalitetet e rëndomta, që ruajnë doza jo të vogla të moralit patriarkal. Kjo, mbase, ka qenë arsyeja që nga fundi i romanit shtrimi i Liri Rekës në maternitet kthehet kot së koti në manifestim popullor dhe përshtatet pa origjinalitet artistik skena e njohur e dhurimit të gjakut nga shokët e punës. Ky, vetëkuptohet, është një «kompesim» i panevojshëm sentimental dhe, mbase nga pikëpamja edukative, jo fort me vend. Fakti që telekronisti, për të plotësuar reportazhin për përrurimin e furnaltës, kërkon të filmojë patjetër Liri Rekën flet më tepër nga çdo shtojcë tjetër.

Nga sa u tha, arrijmë në përfundimin se «Bota ime» është një roman karakteresh me sfond veprues shoqëror e politik, në të cilin shkrimtari ka mundur të

krijojë një tablo realiste të jetës, të punës, të ndjenja-ve intime dhe të luftës së klasave në kohën tonë. Në tingëllimin e përgjithshëm të veprës dhe në çdo hollësi ndihet si depërton në skajet më të ndryshme dhe si përthyeret në karakteret e njerëzve e në veprimtarinë e tyre atmosfera e realitetit bashkëkohor, i cili karakterizohet nga epika ndërtimore dhe nga poezia, por përmban edhe shumë probleme zhvillimi, që bëhen shkak konfliktesh dramatike.

Lexuesi, duke ndjekur rrugën e personazheve, njihet me Elbasanin e sotëm, ku ndërtohet gjiganti i metalurgjisë dhe vazhdon të shemben vjetërsitë, të zgjerohen sheshet e të zgjaten rrugët, duke bërë të zgjerohet vetë shpirti dhe të menduarit e njerëzve të rinj të këtij qyteti të lashtë.

Nga pikëpamja ideotematike përqendrimi i veprimit në kombinatin metalurgjik i jep frymëmarrje të gjerë e të thellë romanit dhe e bën më të konceptueshme poezinë e ritmeve të ndërtimit socialist e të shndërrimit revolucionar të vetëdijës së njerëzve. Nga pikëpamja e thurjes kompozicionale, duke zgjedhur këtë parashtrim, është gjetur një hapësirë e gjerë, në të cilën ndërthuren pa vështirësi linjat e ndryshme të subjektit dhe arrihet në një integrim organik të problematikës së punës me motivet intime dhe me botën e brendshme të personazheve. Kjo edhe falë njohjes së mirë të anëve teknike të procesit të punës nga autori.

E gjithë problematika e romanit, që nga intimiteti deri te parimet klasore, vërshon natyrshëm në rrugë e në familje, në furnalë dhe në bibliotekë, në uzinën mekanike dhe në mensë. Kujdesi i shkrimtarit është mos japë të dhëna si qëllim në vete, por të zbulojë njerëzit, të përviçojë fizionominë e tyre, të japë dinamikën e botës së brendshme, herë përmes marrëdhënieve reale, herë përmes përsiatjeve, monologëve dhe përshkrimeve të goditura. Kurse aspekti i ndeshjes me revizionistët kinezë mund të ishte integruar më mirë në debatet e atmosferën e punës, pa shablone bashkëbisedimesh qesharake e trajtime skematike. Një



Shen Li Po si dhe disa personazhe të tjera episodike që nuk lënë gjurmë në kujtesën e leuksesve, janë plotësisht të evitueshëm.

Kombinati metalurgjik, veç të tjerash, është terreni ku zënë fill dy linjat kryesore paralele, të mishëruara në marrëdhëniet Liri Reka-Jakubin Sara dhe Serafin Boduri — Gidi Dumrela, sepse vetëm në një vepër të madhe është e mundur të ndeshen karaktere të tilla e të lidhen mes tyre, ashtu si vetëm atmosfera revolucionare e punës për ndërtimin e saj e bën të papranueshëm si pajtimin klasor, edhe meskinitetin dhe egoizmin mikroborgjez.

Përmes këtyre personazheve, që janë katër shtylla të ndërtimit kompozicional, kombinati metalurgjik, si nyja kryesore vendore, fiton mundësi lidhjesh e kontrastimesh të natyrshme me vatrat e tjera të veprimt, me familjet Reka, Kolani e Dumrela dhe me sheshin e pazarit, ku shembet e vjetra.

Shkrimtari, duke i vlerësuar drejt këto mjedise shoqërore, pa e ndërlikuar thurjen kompozicionale, i ka shfrytëzuar me mjeshtëri për të dhënë një tablo sa më të plotë të realitetit shoqëror, politik e moral, për karakterizimin sa më bindës të personazheve dhe për t'u dhënë rrugë disa prej çështjeve që e kanë shqetësuar. Kështu, ndërsa përmes Serafin Bodurit fitohet mundësia për të depërtuar në mjedisin reaksionar, anakronik e të neveritshëm të Dumrelasve e të miqve të tyre dhe kësisoj të jepet qëndrimi i sotëm shoqëror ndaj tyre, përmes Jakubin Sarës është dhënë me mjeshtëri mospajtimi i shoqërisë sonë me egoizmin dhe me meskinitetin mikroborgjez.

Romani «Bota ime», shkruar me realizëm, pasion e mjeshtëri është një vlerë e re që i shtohet prozës sonë të realizmit socialist. Ai zë vend të veçantë në krijimtarinë letrare të autorit edhe sepse kemi të bëjmë me një «teknikë» të re strukturimi e kompozicioni. Në romanet e mëparshme Dhimitër Xhuvani e përqëndroi vëmendjen në një karakter që formohet dhe evo-

luon (Fan Smajli, Nebi Sureli) ose që manifeston tiparet karakteristike (Din Hyka, Zejnulla Kaloti) ndaj realiteti është pasqyruar në raport me përthyerjet në vetëdijën e në qëndrimet e tyre. Kurse në «Bota ime» kjo praktikë letrare tejkalohet në dobi të një ndërtimi kompozicional më të ndërlikuar. Problematika e pasur shoqërore e politike që ka interesuar shkrimtarin është përthyer krahasimisht në disa karaktere dhe në marrëdhëniet në mes tyre, tabloja e realitetit vjen më e gjerë, struktura e veprës — më kompakte. Kështu autori i është shmangur parashtrimit vijimor të subjektit dhe vetvetiu është treguar më i kursyer e më konciz, më i preokupuar për gjetjen dhe paraqitjen e çasteve nryjë e kulmorë, duke përdorur edhe mjaft hollësi me shprehësi të fortë artistike.

1984

## «JUGA E BARDHË»

Romani «Juga e bardhë» sjell një përmbajtje të shëndoshë dhe të pasur ideoemocionale. Në të spikat ndijshmëria artistike e shkrimtarit ndaj shfaqjeve më të ndryshme të jetës, të shpirtit njerëzor e të natyrës përmes paraqitjes së të cilave janë pasqyruar në vepër thjesht e qartë marrëdhëniet shoqërore në fshatin e sotëm kooperativist në shndërrim të pandërprerë. Fantazia e begatë e shkrimtarit është e qetë dhe e sigurt, pa pohë e pasqyrlira. Shkrimtari i shembëllen më shumë një qëmtuesi të vëmendshëm e të pasionuar të realitetit të kohës. Kjo «fshehje» e fantazisë prapa vërtetësisë së materialit të hedhur në roman si dhe nisja nga jeta për të nxjerrë problemet dhe idetë janë dy nga vlerat më të dukshme të mënyrës së të shkruarit të Jakov Xoxës.

Në pjesët më të goditura të romanit ndihet gjerësia e fushave të Myzeqesë, erëtimi i ugareve dhe i arave të mbjella, bukuria e brylakëve të dikurshëm dhe harmonia e planimetrive të reja të fshatrave, ngjyrat e fushave dhe të ylberëve, poezia e netëve me qiell të qëruar, e mëngjeseve e mbrëmjeve të kthjellta, lëvizja e erërave, që është përdorur edhe me ngjyrim simbolik.

Përse kjo joshje ndaj natyrës? Ç'arsye shoqërore e artistike e përftojnë? Natyra është elementi më i përgjithshëm i mjediseve të fshatit ku zhvillohen ngjarjet. Te ne edhe në zona të industrializuara natyra vazhdon të veprojë në ndjenjat e në botën shpirtërore të

njerëzve. Natyra në veprën e Jakov Xoxës, në kuptimin më të gjerë, përbën sfondin që paraprin e shoqëron ngjarjet, «rrethon» karakteret; është trolli ku lindin e shpërthejnë ndjenjat e mendimet. Ky qëndrim ndaj natyrës i përmbajtur në përshkrime poetike, që depërton në vetë frymën e përgjithshme të veprës dhe gjen përthyerje të shumta në hollësitë artistike të përdorura, harmonizohet me stilin përgjithësisht përshkrues të shkrimtarit dhe i jep mundësi të burojë pjesërisht frymëzimi lirik.

Shkrimtari ka një koncept të shëndoshë realist dhe poetik për jetën. Problematika shoqërore politike e romanit «Juga e bardhë» është më e dukshme se e romanit «Lumi i vdekur» dhe kontradiktat e konfliktet e kohës, duke marrë shpesh karakter të theksuar e të mprehtë dramatik, japin një tërësi pasqyrimi të shumanshëm.

Në fatet e personazheve dhe në rrugën e jetës së tyre, në rastet më të mira, bartet një problematikë shoqërore reale dhe përjetime e shqetësime intime; ngjarje e dukuri që nuk kanë të bëjnë kurdoherë me pikësynimet kryesore të veprës, i kanë shërbyer autorit për të pikturuar tablo sa më të gjera. Pikënisja e autorit ka qenë e drejtë dhe realiste, por bien në sy edhe disa kufizime e mangësi, sidomos lidhur me përfshirjen në brendinë e veprës të jehonës së disa ngjarjeve të mëdha kombëtare e ndërkombëtare në vitet 60, — kohë në të cilën është vendosur subjekti i romanit. Nuk është çështje përkujtimi të tyre, aq më pak për një lidhje artificiale dukurish e procesesh shoqërore e politike, por për mishërimin e faktit që në këto ngjarje të mëdha u integruan masat e gjera të popullit dhe situatat e krijuara u përthyen dukshëm edhe në jetën vetjake të njerëzve. Edhe përmasat epike të romanit jepnin mundësi për një konceptim e pasqyrim më përfshirës. Veç kësaj, përfshirja e mangët e atmosferës së kohës ka sjellë si pasojë që disa probleme të shtrohen e të zgjidhen jo si përthyerje në vetëdijen e njerëzve e të rrethanave, të proceseve dhe prirjeve të vetë jetës, po si çështje

predispozite e vullneti individësh më të përparuar se koha (Adnani, Shpresa) dhe secili problem më vete, në rend kohor të paramenduar. Kështu, ndërmerren nismat dhe zgjidhen njeri pas tjetrit problemet që kanë të bëjnë me heqjen e veshjeve të rënda, me përmirësimin e mënyrës së jetesës, me barazinë e burrave me gratë në punët e shtëpisë, deri diku, dhe me bashkimin e kooperativave që ka qenë ndër synimet kryesore. Për pasojë, disa situata evidentohen jonatyrshëm, me tendosje jo aq të përligjura.

Në roman, si një prej anëve më të bukura të brendisë ideomocionale, ndihet mirë dashuria për punën dhe për njerëzit e punës. Punën, sikurse natyrën, shkrimtari e ka vënë në themel të kuptimit e të vlerësimit të jetës e të njerëzve. Në kapituj të veçantë, siç janë ata ku përshkruhet çelja e tokave të reja, puna e palodhur e traktoristëve, vjelja e pambukut etj., jetojmë çaste emociounese, ashtu siç vërejmë se largimi prej veprimtarisë praktike të vetëdijshme apo keqkuptimi i punës shpien në rënie morale, siç ndodh me Llazi Shpiragun, me Petritin dhe me personazhe të tjera-antipode të heronjve të romanit. Por, në qoftë se vështrimi ynë do të kufizohet vetëm në këta kapituj e në këto konstatime, do të ishte e zorshme të kuptohej si duhet vendi që i ka dhënë shkrimtari punës. Puna, sikurse natyra, ka depërtuar në çdo ind të veprës. Mund të themi se, ndërsa natyra përbën sfondin real e të hapur të zhvillimit të ngjarjeve, puna përbën frymëmarrjen ideomocionale të tyre. Në raport me punën shtrohen dhe zgjidhen shumë nga problemet e rëndësishme dhe përvijohen marrëdhëniet në mes personazheve. Ajo pasqyrohet si një prirje e dëshirë e natyrshme njerëzore, ndaj shkrimtari ka poetizuar atë ç'ka gjetur më pozitive në qëndrimet ndaj punës, duke e quajtur të panatyrshme, shoqërisht të papranueshme dhe moralisht të dëmshme çdo shmangie prej veprimtarisë prodhuese.

Më i përcaktuar dhe më realist është qëndrimi i shkrimtarit ndaj pronës dhe marrëdhënieve të reja të

pronësisë, që, në dukje — çështje thjesht ekonomike, në letërsinë tonë është trajtuar rëndomtë në mënyrë të thjeshtëzuar (pothuaj vetëm si luftë kundër lakmisë së kulakëve, shpërdoruesve dhe vjedhësve). Jakov Xoxa i ka përballuar përgjithësisht me sukses vështirësitë e trajtimit artistik të kësaj çështjeje, na jep një përfytyrim të qartë të marrëdhënieve të pronësisë e të dukurive që lidhen me të në fshatin e sotëm kooperativist. Kup-timi socialist i marrëdhënieve të pronësisë dhe i prirjeve të revolucionarizimit të përhershëm të tyre përbën shtyllën vertebrore të mendimit shoqëror-politik të veprës, prandaj dhe trajtimi i tyre është ana më me rëndësi e karakterit bashkëkohor të romanit «Juga e bardhë».

Në veprat letrare me temë nga jeta e fshatit, zakonisht ndeshet njëfarë idealizimi të stadit të sotëm të rendit kooperativist. Kjo pozitë ndaj kolektivizimit të bujqësisë, po të përmblidhej në pak fjalë, do të ishte: prona private mbi tokën ishte burim i gjithë të këqijave për fshatarin; kolektivizimi u dha fund gjithë të këqijave.

Në krahasimin e së sotmes me të kaluarën ky vlerësim i përgjithshëm është i drejtë; kurse, po të mbahen parasysh prirjet e zhvillimit dhe perspektivat, është i mangët, mbasi në pasqyrimin e rendit kooperativist nuk zbulohen, krahas përparimit në raport me të kaluarën, edhe ato embrione e filiza që priren drejt së ardhmes, që do të shpien shkallë-shkallë në shndërrimin e pronës kooperativiste në pronë të të gjithë popullit, në ngushtimin deri në zhdukje të dallimeve thelbësore në mes fshatit e qytetit.

Jakov Xoxa me romanin «Juga e bardhë» ka dhënë ndihmesë me vlerë në zbatimin e kësaj metode njohjeje e pasqyrimi të realitetit në dinamikën e perspektivën e tij. Kolektivizimi i bujqësisë, madje, dhe krijimi i kooperativave të bashkuara si njësi më të mëdha prodhimi, janë parë, ashtu si në realitet, vetëm si shkallë të një procesi të pandërprerë paraecës, si rrugë nëpër të cilën duhet kaluar patjetër për të arritur, siç thuhet në roman, «në një bashkim më të madh». Në varësi prej kuptimit

shoqëror revolucionar të këtij procesi, personazhet e përparuara përcaktojnë edhe qëndrimet ndaj çështjeve që kanë të bëjnë me jetën vetjake. Përmes Shpresës, Adnanit etj., mbi këtë bazë, autori ka thurur disa nga linjat kryesore të konflikteve shoqërore e intime. Vështrimi në rrafsh perspektiv i kolektivizimit i ka dhënë dorë atij të pasqyrojë me mjeshtëri dialektikën e zhvillimeve shoqërore dhe të hidhet natyrshëm prej paraqitjes së shfaqjeve e të dukurive të veçanta në pasqyrimin e proceseve të gjera historike. Kooperativa e Pirganit dhe tatëpjeta që merr kryetari i saj Kiu Koroziu, janë pikërisht pasqyrim i këtij procesi historik objektiv. Përmes tyre autori i «Jugës së badhë» ka theksuar se largimi nga udha e revolucionit dhe e revolucionarizimit shpie patjetër në amulli, në prapambetje, në nxitje të ndjenjës së pronës së grupit të vogël e të prirjeve kapitaliste brenda kolektivizimit socialist; pra, në kundërvënie ndaj interesave të masave punonjëse dhe ndaj shoqërisë socialiste në tërësi.

Shkrimtari, me të drejtë dhe në funksion të idealeve shoqërore që shpreh, ka theksuar vështirësitë nëpër të cilat arrihet bashkimi në një bazë të re më të lartë dhe konfliktet e pashmangshme për realizimin e tij. Këto konflikte kanë bazë ekonomike (pasuria e Pirganit, puna e fshatarëve, sigurimi i të ardhurave në rrugë të paligjshme), por kanë dhe bazë shoqërore e ideologjike (përcmimi i bujqve prej barinjve, mbeturinat e ndryshme patriarkale, ndryshimet në mënyrën e jetesës etj.). Siç shihet, shkrimtari e ka parashtruar problemin mbi një platformë të shëndoshë, ndonëse gjatë trajtimit deri diku e ka thjeshtëzuar dhe e ka trajtuar me njëanshmëri, duke nënvizuar së tepërmi këmbënguljen dhe arbitraritetin e Kiu Koroziut. Nxitjen së jashtmi të procesit, pa u shkuar gjer në fund shkaqeve të shumta që e bëjnë të pashmangshëm atë.

Është parë se si ndikojnë në formimin e karaktereve qëndrimet ndaj punës dhe ndaj pronës. Në roman, sipas idealeve shoqërore që përcaktojnë këto qëndrime, është

pasqyruar rruga e lartësimit të njeriut të ri (Adnani, Shpresa, Ylli, Evëtare); edukimi e përtëritja morale në ndikimin e punës, shndërrimeve shoqërore dhe përvojës vetjake (Diella); rënia ideologjike, morale e klasore, kur elementë të veçantë bien në kundërshtim me normat shoqërore socialiste (Kiu Koroziu e Llazi Shpiragu).

Në kalimin nga kooperativat e vogla në njësi më të mëdha të prodhimit bujqësor, si qendra jo vetëm ekonomike por edhe kulturore, shkrimtari ka parë disa nga hallkat kryesore nëpër të cilat shkohet drejt ngushtimit të dallimeve në mes fshatit dhe qytetit. Kurse në largimin e vazhdueshëm të fshatarit prej pronës vetjake dhe në afrimin me vetëdijë më të fortë të tij me pronën kolektive, përfshirë në shoqërimin përherë më të gjerë të punës në bujqësi, autori ka parë prirjen e shndërrimit gradual të fshatarit në punëtor. Këto dy anë të të njëjtit proces janë pasqyruar shkrimtarit me njëra-tjetrën. Ndonëse shkrimtari nuk arrin gjer në mishërimin e plotë artistik të perspektivës që ka për ideal, prapëseprapë, synimet e tij janë të qarta dhe emocionalisht të prekshme. Me të tilla pikësynime shkrimtari ka vënë në qendër të romanit një heroinë si Shpresa Shpiragu, luftëtare e vendosur për të «shpënë» qytetin në fshat, në kundërshtim me ëndrrën e dikurshme vetjake për t'u larguar nga fshati në qytet. Kështu, zgjidhjes së ngushtë subjektivistë i është kundërvënë zgjidhja e shëndoshë dhe e gjerë shoqërore.

Kjo frymë përshkon veprën që nga idetë bazë deri te hollësitë. Nën këtë prizëm, edhe lakmitë e familjeve e të vajzave fshatare për të lidhur krushqi me qytetarë shkrimtari i sheh si një shfaqje të mentalitetit e të psikologjisë mikroborgjeze dhe, duke iu kundërvënë këtyre, ai shkon deri në idealizim të Shpresës dhe në mbivlerësim të Diellës në marrëdhëniet intime të saj me Agron Omirin.

Një tjetër rrafsh që i jep brendisë së romanit karakter e theks problemor bashkëkohor është pasqyrimi në të i luftës kundër koncepteve e qëndrimeve të pra-



pambetura e burokratike në drejtimin e veprimtarisë së kooperativave bujqësore. Mendojmë se është e nxituar dhe e pasaktë pikëpamja e autorit sipas së cilës, ashtu siç u kthyen kishat në zyra, duhet të kthehen zyrat në shtëpi kulturore, siç është i papërligjur dhe i pavend shkrimi i pakontrolluar i kooperativistëve, aq më tepër i komunistëve të fshatit, ndaj zyrave të kryesisë së kooperativës. Sepse drejtimi i centralizuar nuk duhet njësuar me burokratizmin. Por ky është vetëm një çast në tërësinë e romanit, në të cilin lufta kundër burokratizmit, e ndërthurur me drejtimet e tjera ideore më të rëndësishme, është trajtuar përgjithësisht nga pozita realiste. Shkrimtari ka pasqyruar disa prej shfaqjeve më tipike të burokratizmit, ka spikatur artistikisht disa nga rrënjët e qëndrimeve burokratike dhe ka mundur të japë edhe veçori të manifestimit të këtyre dukurive negative në jetën e fshatit, ku burokratizmi del në formën e bajraktarizmit, të etjes për të komanduar e për t'u imponuar me çdo kusht, të kapadailëkut dhe të njësimin të vetes me kooperativën, duke pronësuar arbitrarisht çdo arritje të rendit kooperativist. Të tilla dukuri gjejnë rast të nxjerrin krye në kooperativën e Pirganit, ku Kiu Koroziu, me aftësinë e një demagogu të regjur, orvatet t'i largojë kooperativistët nga rruga e Partisë, duke u mbuluar me autoritetin e kuadrit që flet gjoja në emër të saj.

Ndryshe ndodh, pohon autori, kur komunistët vihen në krye të masave dhe masat hidhen në veprimtari të ndërgjegjshme. Në kushte të tilla, edhe kur në krye është një njeri si kryetari i kooperativës së Kënetishës, punët do të shkojnë mbroth dhe atij që nuk korrigjohet, masat i tregojnë vendin, duke i dhënë ndëshkimin e merituar.

Rolit të masave në këtë luftë, siç e sugjeron realiteti ynë, shkrimtari mund t'i kishte dhënë vend më të madh, duke iu shmangur paraqitjes së luftës kundër burokratizmit vetëm si «konflikt» në mes kuadrosh, prej të cilëve

disa i kuptojnë dhe i marrin parasysht aspiratat e masave, kurse disa të tjerë u kundërvihen atyre. Në këtë drejtim, me gjithë meritat në portretizimin e tipave, autori i romanit nuk i është shmangur plotësisht skemës sipas së cilës sekretari i organizatës së Partisë i kundërvihet kryetarit të kooperativës apo drejtorit të ndërmarrjes që janë burokratizuar. Konflikti në mes Adnanit dhe dy kryetarëve nuk i qëndron larg kësaj skeme dhe ka sjellë nënvleftësimin e figurave të tjera, sidomos të të rinjve, si përfaqësues të së resë përparimtare.

Dukuritë shoqërore e politike pasqyruar në romanin «Juga e bardhë» — ato që u përmendën dhe të tjera më pak të rëndësishme, janë përfshirë nga autori në një konceptim të qartë të luftës së klasave në kushtet e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste. Përfundimet e ndeshjeve të ashpra — kyç të kontradiktave kryesore në roman — në plan të përgjithshëm shoqëror dhe në vetëdijën e në jetën intime të heronjve e të personazheve, shprehin prirjet objektive të zhvillimit të sotëm: ngadhënjimin e së resë mbi të vjetrën; fuqizimin e krahut revolucionar nga njerëzit pararojë dhe nga masat e gjera punonjëse: dobësimin, rënien dhe çoroditjen morale e politike të atyre që shkëputen nga populli dhe i kundërvihen revolucionit, socializmit. Mbarimi i shëmtuar i Llazi Gjanicës, pas përpjekjes së dështuar për të sabotuar, fundi i mjerë i Kiu Koroziut dhe qëndrimi ndaj kryetarit të Kënetishtës e Petritit, janë shprehje e frymës denoncuese të romanit, pa të cilën forca afirmuese e tij nuk do të kish qenë aq e plotë dhe ndikuese.

Në roman janë të shumta rastet në të cilat elementi i madhërishtëm kontraston me të shëmtuarën e të ultën që përmbahen në fëlliqësinë morale, në meskinitetin e njerëzve zemërngushtë, në poshtërsinë e atyre që, si armë të fundit për realizimin e qëllimeve të mbrapshta, përdorin intrigën dhe shpifjen. Në këto raste, krahas pasqyrimit të shndërrimeve pozitive në botëkuptimin e në psikologjinë e personazheve, është zbuluar edhe dialektika e dukurisë së kundërt. Autori tërheq vëmendjen se

karakteret e këqija, duke mos e duruar bukurinë në jetë dhe lumturinë e të tjerëve, bëjnë çmos t'i përbaltin ato me cinizëm dhe bëhen kështu më të ulët e më të neveritshëm.

Romani «Juga e bardhë», në parashtrimin e problematikës shoqërore e politike, vende-vende merr karakter thjesht propagandistik. Kjo dobësi si dhe disa të meta të pjesshme që lidhen me të (shprehja e jashtme e entuziazmit, ngjarjet e rastësishme, futja e «pleqve edukatore» si nëna e Kiço Çuçit, i ati i Thomait etj.), kanë të bëjnë gjër në njëfarë mase me faktin që në roman realiteti pasqyrohet në zhvillim e sipër; anët e pastuduara mirë të këtij realiteti letërsia i trajton shpesh në plan racional. Kjo e metë theksohet në pjesën e dytë të veprës, ku ngjarjet dendësohen, vëmendja e shkrimtarit shpërqendrohet sa në një problem në një tjetër dhe proceset e zhvillimit pasqyrohen cekët e të përsheptuara. Sado që autori është përpjekur të shpalojë më tej botën e brendshme të ndonjë personazhi, t'i japë përparësi pasqyrimin të veprimtarisë së Adnanit dhe denoncimit të përfundimtar të ndonjë tipi negativ, pjesa e dytë e romanit nuk është në nivelin e së parës as për vlerën njohëse, as si realizim artistik. Materiali jetësor është i zbehtë, konfliktet — të dobët, prandaj dhe mendimi vërtitet brenda një qerthulli të ngushtë e thujtë të shtëruar.

Një çështje më vete e brendisë ideoemocionale të romanit janë «intermexot» e përdorura nga autori dhe rastësitë e përshkuara në to. Këto pjesëza, që u ngjajnë prozave poetike, i kthejnë ngjarjet në një retrospektivë të thellë, që përfshin kujtimet e Shpresës dhe momentet kryesore të zhvillimit të saj si karakter. Megjithëkëtë, kur mbaron së lexuari romanin dhe sjell ndër mend tablonë e gjerë që përftoi ai, këto «intermexo» zbehen, sa humbasin dhe vlerën simbolike që ka dashur t'u japë shkrimtari.

Në romanin «Juga e bardhë», si dhe në «Lumi i vdekur», një prej ndjenjave më të çiltra e më të bukura

përçohet lexuesve nga shkrimtari është dashuria nderimi për njerëzit, dëshira për t'i parë ata gjithnjë të mirë, më të pasur shpirtërisht, më të gjerë në dime, më të dhënë me njëri-tjetrin dhe më të lumtur.

Në dy romanet e vet Jakov Xoxa ka pasur sukses në tretizimin e heronjve pozitivë, përfaqësues të popullit, shërues të idealeve tona. Një gjë e tillë është fryt i nceptimit humanist revolucionar të jetës, i njohjes nga nder të bukurisë shpirtërore të njerëzve të popullit, i esimit në çiltërsinë e ndjenjave e të mendimeve të tyre. Këto të dhëna sjellin atë shkrirje të natyrshme të realizmit me atmosferën lirike, herë-herë romantike që rrethton heronjtë më të dashur të autorit. Si në jetën shoqërore, dhe në njerëz të veçantë ai është i prirë të shikojë e të përshkruajë, në radhë të parë, anën e mirë, të bukur e të ndritur, pa u larguar në të shumtën e herës nga e vërteta e jetës dhe pa sajuar figura e situata të paqena. Kjo prirje fisnike dhe vetë heronjtë ku mishërohet bien ndesh me elemente të një koncepti të huaj për jetën tonë socialiste — jehonë shekujsh të kaluar, përthyerje botëkuptimesh, morali dhe psikologjie borgjeze e mikroborgjeze, shfaqje ndikimesh të sotme borgjeze e revizioniste. Këtu e ka burimin mendimi i figurshëm i shkrimtarit se «e mira duhet të bëhet «e keqe», që të zhduket e keqja», në të cilin shprehet në formë popullore filozofia e zhvillimit përmes luftës së të kundërtave dhe domosdoja e qëndrimit revolucionar në ndeshjet me dukuritë negative dhe me bartësit tipikë të tyre.

Përmes ndeshjeve për zgjidhjen e problemeve të rëndësishme, shkrimtari ka arritur të përcaktojë karakteret tipike të heronjve. Në roman janë pasqyruar njëherësh kahet e kundërta të proceseve të lartësimit të heronjve të vërtetë të kohës dhe të rënies e të çoroditjes së atyre që i kundërvihen prirjes objektive të zhvillimit.

Vendin kryesor në romanin «Juga e bardhë» e zë Shpresa, e bija e Pilo Shpiragut, të cilën lexuesi e ka

njohur te «Lumi i vdekur» dhe e takon tani si ndër-  
lidhës të së kaluarës me kohën tonë.

Shpresa, përfaqëson të renë e sotme fshatare, me  
jetën dhe aspiratat e veta, me nivelin e ndërgjegjes  
shoqërore dhe tiparet që po fiton dhe duhet t'i kris-  
talizojë më tej në etapën e shndërrimeve me ritme të  
shpejta në jetën e fshatarësisë.

Në psikologjinë e Shpresës autori ka fiksuar portre-  
tin e vajzës së sotme myzeqare, punëtore e të dhënë  
pas jetës, të çliruar nga paragjykimet e nga fanatizmi,  
që përpiqet ta bëjë jetën më të mirë e më të gëzue-  
shme. Ajo, përkohësisht, e shikon perspektivën e vet  
ngushtë, duke pandehur se vetëm në qytet mund të një-  
mendësojë aspiratën për një jetesë të kulturar. Ndaj ajo  
ngul këmbë që edhe i fejuari i saj, Ylli, të bëhet traktorist.  
Në këtë aspiratë të Shpresës shkrimtari ka parë kërke-  
sën e natyrshme të njeriut për ta zbukuruar e përmirë-  
suar vazhdimisht jetesën e vet, por edhe një shprehje  
të egoizmit të saj. Ajo, duke synuar të shpërngulet në  
qytet dhe për ta detyruar Yllin të bëhet traktorist, men-  
don vetëm për veten dhe nuk priret nga një ideal i  
madh shoqëror. Edhe arsimimin e vet, e shikon si një  
mjet për të plotësuar kërkesat mikroborgjeze. Krahas  
kësaj ane kryesore, që në fillim shkrimtari ka spika-  
tur edhe anë të tjera të karakterit të saj, në të cilat  
mbështetet ajo kur vjen puna të dalë në ballë të  
përpjekjeve për shndërrimet e mëdha shoqërore në  
jetën e fshatit. Kështu, episodi i shpëtimit të makinës  
shirëse nga flakët zbulon, krahas dashurisë për punën,  
edhe shpirtin e vetëmohimit në çaste vendimtare, nxjerr  
në krye ato ndjenja e forca shpirtërore, të cilat përkohë-  
sisht i kishte tulatur egoizmi.

Vdekja aksidentale e Yllit është një ngjarje shumë  
tronditëse për Shpresën. Ai nuk vdiq për faj të saj  
(edhe pse autori lë të nënkuptohet diçka e tillë), po në  
mendjen e në ndërgjegjen e vajzës sajohet një lidhje e  
fortë në mes kësaj ngjarjeje dhe dëshirës ngulmuese  
për ta parë Yllin traktorist. Nga kjo lidhje faktesh, që

Ë të bëjnë me njëri-tjetrin, ajo nxitet ta shohë  
i në pasqyrë e të skuqet për shpirtvogëlsinë e di-  
hme. Këtu për autorin nis kthesa e saj. Shpresa  
mendon se duhet të luftojë jo që të sigurojë një  
d në qytet, po për ta bërë edhe fshatin si qytet,  
ndaj ndërpret studimet dhe kthehet në kooperati-  
pa pranuar as lëvdatat e nderimet që duan t'i bëj-  
për këtë veprim.

Por, me gjithë këto, në të ka diçka që nuk është  
eale dhe që nuk përlligjet prej idealeve që ka dashur  
ë mishërojë shkrimtari në të. Mundimi i vetvetes dhe  
ngacmimi i vazhdueshëm i plagës që i ka shkaktuar  
vdekja e Yllit, lidhjet me familjen e tij, duke u mbaj-  
tur si nuse e ve, madje edhe braktisja e studimeve,  
nuk mund të gjejnë përlligje të vërtetë, të shëndoshë  
shoqërore dhe as që përbëjnë ndonjë domosdoshmëri  
ideoartistike. Përkundrazi, pa to figura e Shpresës do  
të ishte më afër së vërtetës, më bindëse dhe më e  
dashur.

Qëndrimi në mbledhjen e organizatës së Partisë dhe  
veprimtaria e saj e mëvonshme janë shfrytëzuar mirë  
për nxjerrjen në pah të karakterit, posaçërisht të shpirtit  
autokritik, lidhjes me njerëzit, guximit sulmuës, përbuzjes  
ndaj çdo gjëje të shëmtuar etj. Edhe marrëdhëniet e saj  
me Agron Omirin (simpatia e dikurshme dhe refuzimi  
i mëvonshëm i dashurisë së tij) është në pajtim me lo-  
gjikën e karakterit dhe me konceptin e përgjithshëm  
të shkrimtarit për njeriun e vendosur.

Me këtë heroinë shkrimtari ka synuar të sajtojë një  
vatëzim në të cilin të përqëndroheshin, në mos të gji-  
tha, të paktën problemet më kryesore që e kanë shqetë-  
suar. Këtë gjë ai nuk e ka arritur dhe mbase as mund  
ta arrinte, po të mbahet parasysh gjerësia e veprës.  
Në mes atributiveve që i jep shkrimtari Shpresës dhe  
mundësisë që ka figura e krijuar për t'i mbartur ato ka  
mospërputhje ideoartistike. Duke dashur të përqëndrohet  
te Shpresa më tepër nga ç'pranojnë realiteti i kohës dhe

logjika e karakterit, sipas një koncepti të vjetëruar për heroin pozitiv, autori ka cënuar pasqyrimin e gjerë realist të zhvillimit të sotëm të fshatit dhe vetë figurën e heroinës, prandaj, lexuesi, sa më shumë shtyhet në vepër, aq më tepër nuk e pranon atë, si figurë reale.

Ndërsa Shpresa përfaqëson idealin e shkrimtarit, Diella është mishërim i figurës reale të fshatares kooperativiste, e cila, pa dalë jashtë caqeve të gjendjes së vet shoqërore dhe pa e pasur këtë pretendim, lartësohet nën ndikimin përtëritës të punës dhe të atmosferës së fshatit socialist. Ndërsa Shpresa paraqitet nazike, pak tekanjoze dhe deri diku e ftohtë. Diella është dhënë joshëse. Në marrëdhëni me Kiu Koroziun ajo nuk është e zonja t'u bëjë ballë tundimeve dhe përdhoshjes morale. Mbi këtë të kaluar shkrimtari ka mundur të tregojë se si në punë e në jetë ngrihet dimjiteti njerëzor edhe pas lajthitjesh të rënda. Kushtet për një përtëritje të tillë janë. Duhet vetëm vullneti i njeriut, forcimi i lidhjeve të tij me shoqërinë, përcaktimi dhe ndjekja e qëllimeve të larta.

Në takimin e fundit të Diellës me Agron Omirin, pas incidentit me Kiu Koroziun, para lexuesve del një tjetër figurë, e cila në thjeshtësinë e vet merr përmasa thujse të madhërishme. Ajo nuk e fsheh dashurinë për agrominin, por nuk pranon mëshirë dhe, kur vëren se dashuria e saj mund të ishte vetëm një gënjim i bukur, di t'i mposhtë ndjenjat e veta.

Ndërsa Shpresa dhe Diella janë figura të realizuara, Adnani është një sukses jo vetëm për Jakov Xoxën, por dhe për letërsinë tonë të sotme në përgjithësi. «Juga e bardhë» është ndër veprat e prozës sonë të realizmit socialist në të cilën gjejmë të portretizuar në mënyrë bindëse, të plotë figurën e sekretarit të organizatës së Partisë. Në veprat e shkrimtarëve tanë të sotëm, siç është vënë re më se një herë prej kritikës, komisarët dhe sekretarët jo rrallë janë paraqitur thjesht si «njërez të direktivës», pa dalë jashtë funksionit zyrtar të tyre. Adnani është konceptuar më parë si njeri i gjallë e pas-

taj si funksionar. Kështu, shkrimtari i është larguar njëfarë «zyrtarizmi» në trajtimin e figurave të ngjashme me të. Duke u dhënë rëndësi fizionomisë së tij morale, veprimtarisë konkrete, qëndrimeve që ai mban ndaj njerëzve e situatave para të cilave vihet, autorit i bind lexuesit se pikërisht si ai, Adnani, duhet të jetë sekretari i organizatës së Partisë. Këtij qëllim i ka shërbyer edhe paraqitja e Adnanit në rolin e të dërguarit të Partisë në fshat. Autori i romanit i është shmangur idealizimit të figurës. Ai ka përshkruar me realizëm veprimtarinë e Adnanit dhe qëndrimin e të tjerëve ndaj tij: atë askush nuk e ka frikë dhe askush nuk e nderon vetëm se është sekretar. Madje, Kiu Koroziu dhe kryetari i kooperativës së Kënetishtës arrijnë edhe të intrigojnë e të shpifin, kurse atij, si çdo njeriu të ndershëm në të tilla raste, i vjen turp të dalë para të tjerëve, siç tregohet se ndodh pas fletërrufesë së Llazi Shpiragut. Kjo «dobësi» e bën figurën më të besueshme, më të afërt për lexuesit, të cilët ndiejnë dhembshuri për të, siç provojnë të njëjtën ndjenjë për fatkeqësinë familjare (ndarjen me gruan) dhe për mospërfilljen e dashurisë së pastër e të përmbajtur, ndaj Shpresës.

Përballë këtyre heronjve dhe personazheve pozitive, në një kolizion të pasur, shkrimtari ka vënë figurat e Kiu Koroziut, të Llazi Shpiragut dhe të kryetarit të kooperativës së Kënetishtës. Megjithëkëtë romani nuk ka thurjen e një vepre me protagonistë e antagonistë. Në qendër të tij është vënë jeta e fshatit. Nga kjo pikëpamje na duket gabim që në ndonjë artikull romani analizohet duke konsideruar hero të tij Kiu Koroziun.

Kiu Koroziu është tip i realizuar me mjeshtëri. Në këtë figurë gjejmë dyzimin e karakterit të paqëndrueshëm të njeriut me shpërpjesëtime në botëkuptim, në qëndrimet, etike dhe në psikologji. Ndërsa jeta shoqërore përparon e priret drejt caqesh të reja, karaktere si Kiu Koroziu, duke qenë të mbërthyer nga e kaluara dhe nga cene e koncepte prapavajtës, nuk gjejmë forca morale të shkojnë përpara dhe mohojnë edhe cilësitë që i



kanë dalluar më parë. Kiu është ndër përfaqësuesit tipikë të mentalitetit e të psikologjisë së vjetër patriarkale në krizë, i koncepteve dhe i metodave të vjetëruara të drejtimit. Nisur nga të tilla të dhëna, ai shkel mbi meritat e së kaluarës, humbet perspektivën dhe i kundërvihet përparimit të mëtejshëm të sistemit kooperativist. Meritë e shkrimtarit është se e ka portretizuar këtë tip në shumanshmëri, duke përdorur laps karboni. Pretendimeve të Kiu Koroziut dhe opinionit megalloman që ka ai për veten, shkrimtari u është kundërvënë me qëndrimin qëndisës dhe me groteskun.

Sa më tepër thellohet revolucioni, aq më i huaj bëhet Kiu Koroziu për të. Ndjenja e pronarit, kapadaiut, njeriut që e mban veten të paqortueshëm, e shtynjë atë të lakmojë shumë, të nëpërkëmbë çdo normë morale, t'u «shkelë rrënjën» të tjerëve që të «hidhërohen», për të pasur mundësi t'i luftojë më lehtë. Duke pandehur se ka frenat në dorë, Kiu shpërdoron pushtetin për të kënaqur tekat e veta; i çmon njerëzit sipas leverdisë që ka prej tyre; nuk duron as guximin më të vogël, kur e sheh se çënohet autoriteti i tij apo zbulohet demagogjia që ka përdorur për të fituar zemrën e kooperativistëve me lëshime pa parim e me spekulime në emër parimesh e direktivash. Grotesku, me gjithë ndonjë tepërim pa rëndësi, është plotësisht i përligjur, siç është i përligjur edhe fundi i këtij karakteri të përçudnuar. Shkrimtari ka parapëlqyer këtë zgjidhje, sepse Kiu është përdhosur sa s'mund të kthehet mbrapsht. Atij, në rrethanat e dhëna në roman, i bëhet e pamundur të vazhdojë më tej në rrugën e çoroditjes.

Me interes të veçantë shoqëror është afrimi i Kiu Koroziut me Llazi Shpiragun, matrapazin e falimentuar, i cili ushqen një armiqësi gati biologjike për socializmin e për komunistët. Përmes këtij afrimi autori, si dhe shkrimtarë të tjerë para tij, ka vënë në dukje se shkëputja nga populli dhe devijimi nga rruga e revolucionit shpien në kundërvënje të hapur, armiqësore ndaj popullit dhe socializmit.

Procesin e rënies së kësaj figure shkrimtari e ka shoqëruar me pakësimin e interesimit për të. Kështu, ndërsa në vëllimin e parë Kiu paraqitet figurë zotëruese, sepse denoncimi i tij është qëllim kryesor i autorit, në të dytin ai zhvendoset, duke u lënë përherë e më tepër vend personazheve përmes të cilëve paraqitet shndërrimi revolucionar dhe ngadhënjimi i së resë. Njëfarë vazhdimi i këtij tipi në rrethanat e reja pasqyruar në vepër është figura e kryetarit të Kënetishtës, po ky ka mbetur një personazh i zbehtë, i pamotivuar si duhet, një mjet që ilustron idenë se, kur masat hidhen në aksion, nuk ka pengesë që t'i ndalë. Autori, duke dashur të bindë lexuesin se ky proces është i pashmangshëm dhe i domosdoshëm për socialistizimin e mëtejshëm të fshatit, në vëllimin e parë të romanit pasqyron kryesisht pengesat e vështirësitë, ndaj dhe është përqendruar te Kiu, kurse në vazhdim, krahas kritikës e denoncimit të elementit armik, ka synuar të japë veprimtarinë revolucionarizuese të komunistëve të mbështetur nga masa e kooperativistëve.

Ky konceptim ka bërë të mundur që kompozicioni të marrë shtrirje në gjerësi, të përfshijë aspekte të ndryshme të jetës së fshatit dhe të japë mundësi të ndiqen njëherësh një numër jo i vogël personazhesh. Ndarja thajse e prerë e personazheve në dy grupe që kundërvihen, ka dhënë dorë për mprehjen e vëmendjes ndaj çështjeve që e kanë interesuar më tepër shkrimtarin. Por, megjithëkëtë, ndërtimi disaplanësh me ndërkalime të shpeshta i kanë dhënë subjektit larminë e gjerësinë e rrjedhës së jetës. Në këtë drejtim «Juga e bardhë» shënon një hap përpara në krijimtarinë e Jakov Xoxës, i cili nga ndërtimi vijimor i subjektit të «Lumi i vdekur» ka arritur këtu një tablo artistike më të pasur e më të shumanshme, sado që në ndonjë rast janë kaluar rrëshqitas disa nyja më rëndësi për brendinë idoemocionale të veprës (studimet e Shpresës, vdekja e Yllit), janë shtjelluar intësisht episode pa ndonjë vlerë (grindja e pirgasve me sopishtarët, incidenti i Adnanit me arixhinjtë, historia e fshehjes së shalqinjve në thasët e pambukut,

tregimi për fejesën e Evëtarit, vajtja inkonjito e sekretarit në fshat, episodi për dorëzimin e shtizave e ndonjë ndodhi tjetër gati anekdotike). Zgjatjet në këto raste kanë krijuar një mbingarkesë që, tok me prirjen e shkrimtarit për përshkrime të hollësishme e për detajim të tepruar tregimtar, kanë cënuar kompaktësinë kompozicionale, janë bërë shkak shpërpjesëtimesh dhe zvarritjesh.

Në roman, përgjithësisht, zotëron logjika e jetës, e luftës së klasave, por ka çaste edhe me rëndësi ideore e kompozicionale të cilat janë të rastësishme, të papërligjuara ideoartistikisht e pa ndonjë kuptim shoqëror, goftë dhe simbolik. Alergjia e Yllit ndaj traktorit trajtohet gati si fatalitet, kurse vdekja e papritur e tij nuk përbën një veprim shoqërisht të domosdoshëm. Edhe ngjarjet e përshkruara në «kapitel» marrin shkas nga rastësia. Problemi i martesës së Shpresës, që është mbajtur ngritur gjatë vëllimit të dytë, nuk ka gjetur zgjidhjen e mundshme jetësore, sepse autori është solidarizuar me qëndrimin sentimentalist të heroinës, në kundërshtim me logjikën e jetës e të karakterit.

Në prirjen e shkrimtarit për bashkëkohësim të stilit, të mjeteve shprehëse e të gjuhës, «Juga e bardhë» shënon një përparim. Fraza në këtë roman është më e shkarquar prej stolive të tepërta, më e përcaktuar në vlerën kuptimore, me një sintaksë më të zhdërvjelltë e më të zhvilluar. Shkrimtari edhe në këtë drejtim ka synuar të pasqyrojë nivelet e reja që janë arritur dhe ta përpunojë gjuhën në përshtatje me mjediset e pasqyruara dhe me shkallën e zhvillimit intelektual të personazheve, me ndikimet e reja kulturore mbi ta. Ai ka qëmtuar me pasion fjalë e mënyra të shprehuri që kanë hyrë rishtas në përdorim, ka ruajtur të paprekura disa veçori krahinore që përforcojnë ngjyresën emocionale të të folurit të personazheve, pa shkaktuar disonancë me gjuhën e autorit. Në këtë stil jepen në roman përshkrime piktorike të natyrës, analiza të holla të gjendjeve shpirtërore, skena lirike të freskëta, situata të forta dramatike, debate politike, episode komike. Kujtojmë kapitujt që paraqesin bo-

tën e brendshme të Shpresës, përshkrimin e mbledhjes për pranimin në Parti, referatin për seksionin shkencor, konfliktin pas kthimit të Adnanit nga kamina e tullave, përshkrimet poetike të peisazhit.

Në përgjithësi, Jakov Xoxa është i prirur nga përshkrimi, veçanërisht, nga përshkrimi lirik, ku ka arritje të dukshme. Edhe kur çastet dramatike janë të forta (p.sh. grindja e pigranasve me sopshtarët, aksioni kundër përmytjes etj.). shkrintari nuk i shmanget kësaj veçorie të stilit dhe elementet lirike janë kudo të pranishme, sikurse dhe tonet humoristike, që e bëjnë të qeshurën mjet të efektshëm ideoemocional.

Marrë në tërësi «Juga e bardhë» është vepër në të cilën pasqyrohet, përgjithësisht me realizëm, fshati ynë dhe trajtohen me guxim probleme shoqërore, politike dhe etike të kohës sonë. Në këtë roman autori ka portretizuar me mjeshtëri disa karaktere, ndër të cilat spikat Adnani si një nga heronjtë pozitivë më të goditur të letrësisë sonë të realizmit socialist.

Vlerat e këtij romani dëshmojnë se Jakov Xoxa është në kulm të veprimtarisë krijuese, i aftë t'u japë lexuesve vepra më të përsosura.

1972

## MËSIMET PAS SHTYPJES SË NJË REVOLUCIONI

(Shënim kritik për romanin «Vila në periferi»  
e A. Abdihoxhës).

Krahas përpjekjeve për plotësimin e tablosë së gjerë të realitetit socialist, që mbetet synimi kryesor i letërsisë së sotme, po pasurohet edhe fondit i veprave kushtuar së kaluarës historike të popullit tonë. Ndër këto hyn edhe romani i Ali Abdihoxhës «Vila në periferi» (1982), kushtuar Revolucionit Demokratik Bongjez të 1924-ës dhe ngjarjeve që e pasuan atë.

Çasti historik që ka zgjedhur shkrimtari është ndër pikat një të asaj periudhe, e cila të jep dorë të hedhësh dritë në karakterin e vetë revolucionit, në forcat shoqërore politike që morën pjesë në të, në shkaqet e disfates së tij dhe në pasojat e saj të drejtpëdrejta e të pashmangshme: nga një anë, forcimi i reaksionit feudo-borgjez, shpallja e monarkisë dhe depërtimi i fashizmit; nga ana tjetër, rishikimi autokritik i asaj që kishte ndodhur, rritja e pakënaqësisë dhe revoltat e masave dhe të elementëve demokratë revolucionarë.

Është viti 1928. Reaksioni i ka forcuar pozitën shtetërore dhe Ahmet Zogu e shpall veten mbret, duke u hequr shpëtimtar i kombit dhe «sovrani august». Ky akt është goditja përfundimtare që u jepet forcave të këtij revolucion, ideve, iluzioneve të pjesëmarrësve dhe drejtuesve të tij. Historia po tregonte se më tej duheshin ndjekur të tjera rrugë, për të arritur një përmbysje të vërtetë revolucionare. Noli, përfaqësuesi më tipik e më

në zë i idealeve fisnike, i kufizimeve borgjeze, i lëkundjeve dhe i dobësive të revolucionit që u zhvillua, diçka kuptoi për shkaqet e disfatës dhe për rrugën e mëtejshme që duhej ndjekur. Në vjershat e në artikujt e vet ai, krahas autokritikës që bëri, denoncoi reaksionin feudo-borgjez, u mundua të argumentonte domosdoshmërinë e mbështetjes në masat punonjëse dhe të ndjekjes më me konsekuencë të qëllimeve demokratike revolucionare. Por, as ai, as KONARE-ja, në të cilën bënte pjesë, me gjithë ndihmesën propagandistike që dhanë, nuk ishin në gjendje të viheshin realisht në krye të një lëvizjeje të re me të vërtetë revolucionare. Bajram Curri ndoqi tjetër udhë. Ai luftoi dhe ra me armë në dorë jo si viktimë, po si luftëtar. Të tjerë, megjithëse nuk morën udhën e mërgimit, jetuan në mënyrë pasive dramën kombëtare dhe, të zhgënjyer, në disa raste iu nënshtruan fatit oserranë moralisht. Feudo-borgjezia shtypte e shfrytëzonte, ndërsa regjimi monarkik-përfaqësues i interesave të saj, duke mos pasur aspiratë dhe aftësi të përballonte problemet jetike të vendit, përdorte të gjitha mjetet e mënyrat për të ekzistuar. Ai përdorte dhunën, kompromentimin politik, shantazhin dhe persekutimin moral, dredhinë, demagogjinë, rryshfetin me qëllim që të bënte për vetë të lëkundurit, të mashtronte naivët, të diskreditonte luftëtarët konsekuentë, t'u siguronte një copë bukë nevojtarëve të gatshëm që t'i shërbenin. Në këto ujëra, duke shfrytëzuar koncesionet ekonomike, politike, ushtarake e kulturore, fashizmi italian bënte çmos të futej edhe në jetën shpirtërore të shoqërisë dhe të përgatiste terrenin për një ndërhyrje kolonizuese, t'i imponohej vetë regjimit e mbretit që të luante kartën e tij në politikën e jashtme dhe brenda vendit. Komunistët, si e vetmja forcë efektive, e cila mund të merrte në dorë flamurin e atdhetarisë e të demokracisë, sapo kishin dalë në arenën e luftës dhe vetëm me vonë do të mund të ushtronin ndikimin e tyre.

Historia e Mentar Dikës, të cilën shkrimtari e ka vënë në themel të subjektit të romanit, si dhe fati i

disa personazheve të tjera që lidhen me të, pa pretendimin e krijimit të një tabloje të gjerë epike, për Revolucionin e për kundërrevolucionin, i japin lexuesit një përfytyrim real të kthesës që ndodhi në vendin tonë pas 1924-ës dhe të alternativave politike e shoqërore në perspektivë.

Pa shumë linja subjekti, autori, duke shfrytëzuar disa personazhe të mirëportretizuara dhe disa vatra veprimi, ka arritur të paraqesë shumanshmërinë e rrethanave të përgjithshme e të veçanta dhe dramacitetin e fortë të gjendjes. Po kështu, me anë të shtresëzimit të subjektit (tregimi i rrjedhës së ngjarjeve dhe kujtimet për ditët e revolucionit, për kohë më të hershme e për intimitete njerëzore), të prologëve për çdo libër (romani përbëhet nga tre libra) dhe pjesë të shkëputura për veprimtarinë e «njerëzve me të zeza», autori është përpjekur e përgjithësisht, ia ka arritur të jetë sa më përfshirës, duke kapërcyer kufijtë e një përshkrimi të thjeshtë vijimor. Prologu (me konsiderata të përgjithshme për gjendjen historike) dhe epilogu i romanit, që shkëputet prej lidhjeve të drejtpërdrejta me subjektin, shërbejnë jo thjesht si kornizë e mirëvendosur, po hedhin dritë në kuptimin e asaj që ka ndodhur dhe ndihmojnë të shquhen më qartë fasada ideologjike e propagandistike nga realiteti i vërtetë i Shqipërisë së atëhershme.

Edhe vendi në të cilin zhvillohen ngjarjet është zgjedhur me pikësynim realist, sepse përbën një terren ku bashkëjetojnë, siç është karakteristikë për kohën, autoriteti i pashembur i pashait-pronar i madh tokash, dhuna dhe sjellja brutale e xhandarit, fajdexhinjtë dhe sekserët, demokratët liberalë dhe profashistët, tregtarët e vegjël dhe zanatçinjtë, intelektualët e rëndomtë dhe lipsarët. Qyteti N. (sipas të ngjarit — Elbasani) ka qenë vatrë atdhetarie, ndërsa rrethet malore të tij — çerdhe luftëtarësh të paepur kundër robërisë, dhunës e padrejtësisë. Këto tradita, në çastet historike që përshkruhen në roman, aktivizohen si forcë shpirtërore kundërshtuese ndaj shtypjes e reaksionit dhe si vazhdim i shfaqjes së shpirtit li-

ridashës e kryengritës të popullit e të elementëve përparimtarë të lidhur me të.

Në këtë kuadër rrethanash e mjedisesh, pa iu larguar subjektit konkret, tipave që e kanë interesuar dhe pa u ngushtuar, shkrimtari ka pasqyruar, përgjithësisht me vërtetësi dhe me intensitet emocional, dy prirje të kundërta: forcimin e pozitave të reaksionit, që kurorëzohet me shpalljen e monarkisë, të cilën kasnecët e feudo-borgjezisë rropaten ta paraqesin si triumf festiv në njërin anë; mjërimin e popullit, krizën ekonomike e shpirtërore, vazhdimin e qëndresës dhe orvajtjet për të organizuar kundërgoditje revolucionare, në anën tjetër.

Mentar Dika si hëro tipik i Revolucionit Demokratik Borgjez, që provon dhimbshëm pasojat e dështimit dhe, pa pasur e pa pranuar rrugëdalje tjetër, aspiron për një përtëritje të revolucionit në një platformë demokratike më radikale, pa iluzionet dhe lëkundjet e 1924-ës, Ai mishëron në mënyrë origjinale aspiratat shoqërore të intelektualit të dälë nga shtresat e vobegta e atdhetare. Mentari, si nga formimi dhe nga përvoja, është në gjendje të shqyrtojë në frymë kritike revolucionin që dështuar dhe të synojë për të arritur diçka më tepër përmes një lufte më konsekuente. Amnistia nuk e gënjen, sepse kuptohet që ajo është vetëm një farsë «demokracie» dhe një manovër politike. Por, i liruar nga burgu, ai është i «dënuar me papunësi». Llogaria është bërë me logjikë të fortë e me cinizëm dhe parashikon një procedurë të djallëzuar. Hapi i parë që ndërmerret kundër tij, siç është ndërmarrë ndaj shumëkujt si ai është premtimi për një punë «të respektueshme» në shërbim të regjimit në fuqi, me kusht që i munduri të botonte një deklaratë pendimi për pjesëmarrjen në revolucion. Dividendi politik i reaksionit në këtë rast do të ishte i madh. Oferta për punë, e shoqëruar nga kërkesa për tradhti, atij i bëhen zyrtarisht nga Hasan Minga, fizionomia e të cilit «të dukej sikur ndodhej aty për të dëshmuar lodhjen e brendshme dhe madhështinë e jashtme të rendit të vjetër» (f. 27).



Shansi për t'ia arritur këtij qëllimi është i paktë dhe përpjekjet — të kota. Më tej hyn në veprim presioni ekonomik, edhe ky i lidhur me synime politike. Në skenë del Veniamin Çeku — afarist i çoroditur profashist, i cili e vë Mentar Dikën para alternativës: ose t'i paguajë 50 napolonat që i ka marrë borxh, ose të bashkohet me të, për të qenë «bërthama e grupit të parë fashist në qytet dhe më vonë bërthama e partisë fashiste shqiptare» (f. 50).

Veniamin Çeku, për të marrë paret e dhëna borxh, nuk ishte nevoja të bisedonte me Mentar Dikën. Ai, si çdo pronar e fajdexhi, kishte me vetë edhe ligjin, edhe forcën për të nxjerrë në ankand plaçkën dhe shtëpinë («vilën») e borxhliut. Por ai shfrytëzoi gjendjen e vështirë të të detyruarit e mendon se mund ta joshë atë në rrugën e fashizmit. Politikisht ai përdori tri argumente «të forta» dhe jo pa zgjuarsi: i pari, fakti që regjimi i Zogut nuk e përfilli Mentar Dikën as si bir atdhetarësh të shquar, që «gjithë çfarë kishin i bënë pluhur e hi pas librave dhe abetareve shqipe», as si «artiljer me akademi». I dyti: revolucioni ka marrë fund, vetë Mentar Dika nuk është veçse «një amebë», kurse «Ahmet Zogu është betuar të luftojë derisa idetë e reja të zhduken fare». I treti: gjendja familjare, reputacioni shoqëror e aspiratat politike antizogiste të Mentar Dikës mund të plotësohen vetëm nëse ai aderon në fashizëm, sepse, sipas Veniamin Çekut, fashizmi është perspektiva e vetme që ka mbetur. Mospranimi i kësaj alternative dhe bindja se «çdo gjë do të ringjallet» (f. 47-51) heroit, të hedhur përfundimisht në prehrin e mjerimit, i forcojnë bindjen për rreziqet që i kanosen atdheut dhe për domosdoshmërinë e veprimit revolucionar.

Më tej vijnë orvatjet për diskreditim publik. «Ta poshtërojmë në sy të të gjithë simpatizantëve dhe për-krahësve të tij» udhëzon prefekti (f. 38). Të njëjtin mendim shpreh dhe kapiteni i xhandarmërisë, kur me ligësi porositi vartësit: «Ta, poshtërojmë para të tjerëve, ta

bëjmë qesharak, derisa të humbasë logjikën e të bëjë skandale» (f. 156).

Pra, as të tjerët nuk mendojnë thjesht për një Mentar Dika, as Mentar Dika nuk është nga ata që nënshtrohen, humbasin toruan dhe mendojnë vetëm për veten e për interesa të ngushta të çastit. Dinjiteti i njeriut matet me madhësinë e idealeve që e udhëheqin, me forcën dhe qëndrueshmërinë e karakterit, me përbuzjen e çdo jetese zvarranike dhe të çdo monstruoze politikë shoqëror. Mentar Dika e kupton se nuk luftohet vetëm për të e kundër-tij, po luftohet për diskreditimin e revolucionit e për konsolidimin e reaksionit. Qëndresa e tij mbetet shembull e shkëndijë shprese, ndaj edhe vlerësohet jo aq si fakt në vetvete, se sa për jehonën që bën në popull. Në këtë përfundim mendojmë se përmbahet një vlerë ideore me rëndësi e romanit, një përgjithësim artistik me rrezatim që i kalon caqet e periudhës së dhënë.

Përballë alternativave të papranueshme dhe në rrethanat vetjake tepër dramatike, rruga që vihet të ndjekë heroi është plotësisht e përligjur nga formimi, karakteri, synimi i tij. Faktorët e rëndësishëm subjektivë përforcohen prej faktorësh objektivë (rrethanat e përgjithshme ekonomike e politike të vendit). Është meritë e shkrimtarit që pa ngarkesë të panevojshme përsiatëse dhe pa zhurmë e bujë ka arritur njësimin artistik të individuale me shoqëroren, shkrirjen e natyrshme të motiveve vetjake me ato politike, aq sa është vështirë të ndahen e kuptohen të parat nga të dytat. Jeta e Mentar Dikës rrezaton atë që çdo çështje vetjake mban vulën e rrethave historike të kohës dhe çdo qëndrim shoqëror politik vetjak mbështetet e vjen logjikshëm prej karakteristikës dhe gjëndjes individuale.

Shkrimtarit i ka interesuar Mentar Dika jo vetëm e as kryesisht për të paraqitur revolucionin e 1924-ës (retrospektivat për të mund të kishin qenë edhe më tipike e deri diku më pasqyruese), por, sidomos, për vlerësimin e atij revolucioni nga një kënd shikimi kri-

tik dhe, sado kudo, për të treguar se vërtet dështoi një revolucion i mangët, por shpirti revolucionar nuk u shua, lufta klasore revolucionare mbetej në rend të ditës. Për të nënvizuar këtë janë shfrytëzuar disa episode tipike: artikulli i Mentar Dikës, i cili e rendit atë në krahun më radikal të revolucionit dhe mbajtja e anës së fshatarëve kundër përkrahësve të pashës (kreu i tretë); mbajtja e armëve dhe e municionit me bindjen se situatat revolucionare do të përtërihen; biseda me Habib Kasapin në kreun e shtatë, ku Mentari bën shprehimisht kritikën e revolucionit dhe zbulon shkaqet subjektive të disfatës. «E di pse ndodhi kjo? — i thotë ai bashkëbiseduesit. — Sepse ne u treguam të butë dhe të pavendosur. Sepse lejuam të na gënjenin» (f. 132-133).

Ndër faktorët objektivë që përcaktojnë qëndrimin e Mentar Dikës, veç shtypjes, dhunës e mjerimit, janë dhe ruajtja e frymës revolucionare në gjirin e popullit, vazhdimi i qëndresës së elementëve më të vendosur (kujtojmë Veteranin e Luftës) dhe përpjekjet për t'u riorganizuar e për të ndërmarrë aksione të reja kryengritëse. Këta faktorë ndikues — pjesë të atmosferës që jepet në vepër, janë konkretizuar në karaktere të ndryshme si Veterani i Luftës, i cili bie me armë në dorë në ndeshje me xhandarët; fshatari Lato Morina — përkrahës e ndërlidhës kryengritësish; këpucari i varfër Teli Bashari, që mban anën e të revoltuarve; mësuesi demokrat Besnik Sazani — shok idealesh i Mentar Dikës dhe, mbi të gjithë, Genc Boga — kryengritës i ri, ndër karakteret e vizatuar më plot e më mirë. Plotësim i figurës së Mentar Dikës është sidomos Daklea (e shoqia) që, në pikëpamje të trajtimit ideoartistik, qëndron përkrah karaktereve më të spikatura.

Daklea është pikturuar me dhembshuri, duke e bërë më të prekshme peshën e shtypjes e të dhunës, më të përlligjur zgjimin e ndjenjës së revoltës e të kundërshtimit ndaj rendit antipopullor. Në portretin e saj ndihet butësia, ngrohtësia dhe përkorësia e një gruaje të re vetëmohuese pas të shoqit e fëmijëve, që nuk mendon

për fatkeqësinë e vet dhe vuan ngaqë nuk është në gjendje të lehtësojë sadopak brengën e të shoqit dhe mjerimin e fëmijëve. «Ishte një fytyrë e zbehtë, por e ngrohtë, fytyrë e një gruaje që kishte mbetur gjithmonë pak fëmijë» (f. 137). «Nga dëshpërimet e njëpasnjëshme ajo parapëlqente më shumë të jetonte në buzë të iluzioneve» (f. 65). «Dikur ishte ajo që e vinte në gjumë Mentarin. Po kohët e fundit qe lodhur mjaft. Uria dhe shqetësimet e kishin vrarë. Uria dhe fëmijët» (f. 88). Por, kur Mentar Dikës nuk i mbetet rrugë tjetër veçse të lidhet me komitin Genc' Boga, Daklea, aq natyrshëm sa dhe në vuajtje e në përkorësi, merr anën e të shoqit, duke u bërë përherë e më e vetëdijshme për rrugën e zgjedhur. Kur gjithçka vendoset dhe Genc Boga strehohet në shtëpinë e tyre, midis bashkëshortëve zhvillohet kjo skenë, që shënon çastin më vendimtar të kthesës së Daklesë:

«— Ke frikë? — pyeti befaz Mentari.

Ajo ktheu fytyrën nga ai dhe mbeti ashtu, si e zënë ngushtë. T'i thoshte «jo», kjo përgjigje nuk do të shprehte të vërtetën. T'i thoshte «po», edhe kjo mund të ishte vetëm diçka e përafërt me të vërtetën» (f. 99).

Paskëtaj, goftë për cilësi karakteri e për bindje, goftë e ndikuar nga rrethanat, Daklea vihet vendosmërisht në rrugën e luftës, duke mbartur në mbarim të romanit peshën më të kobshme të konfliktit dramatik, madhështore në dhembjen dhe në heshtjen e vet krenare. E detyruar t'i nënshtrohet dhunës, ajo e lë lexuesin me përshtypjen se nuk do t'i nënshtrohet fatit, po do t'u qëndrojë besnike bindjeve të veta dhe kujtimit të të shoqit në çdo rrethanë, deri në vdekje.

Një karakter tjetër, i vizatuar me mjeshtëri dhe i veçantë në prozën e sotme, është gjelltarja Folta Papi, me rëndësi si karakter dhe si një prej shtyllave kompozicionale.

«E gjatë, e drejtë, e veshur gjithmonë me të zeza, me fytyrën të bardhë, ku shquheshin akoma shenjat e një bukurie të dikurshme, ajo njihej në tërë qytetin si

një grua e ashpër, me sjellje prej burri, e ngrysur dhe e zhytur në purët e në mendimet e veta» (f. 21-22). Të mirën e bën, me rreptësi e pa shfaqje sentimentale, të tjerëve nuk ua ka frikën dhe u imponohet pa fjalë. Pranisë së saj i druhen edhe xhandarët, kurse përmbaruesi i thotë Mentarit, duke i kujtuar një shitje në ankand: «Unë, ti, e nipi, djali i pashës, të gjithë ne, me nder zotërsisë sate u bëmë lakër përpara asaj xhadije, që më ecën si të ketë mbathur patkonj e jo këpucë» (f. 119). Mjafton një fjalë e saj dhe i nipi, Genc Boga, heq dorë nga rivaliteti me të birin e pashës. Reshteri Ago Agoja as guxon ta marrë në pyetje kundër Mentar Dikës. Ajo shqetësohet për të birin (Krist Papin) dhe për të nipin (Gencin), por zien përbrenda kur merr vesh tradhtinë e të birit përballon stoikisht vetëvrasjen e tij, merr anën e të nipit; premtori të bashkohet haptas me komitët.

Episodet që paraqesin karakterin e Folta Papit janë të zgjedhura e tepër shprehëse: dhënia veresie e ushqimit Mentar Dikës, interesimi në xhandarmëri për të birin e të nipin, qëndrimi në postkomandë, thirrur për të dëshmuar kundër Mentarit, përballimi i takimit të Genc Bogës me Krist Papin, situatë që përfundon me vetëvrasjen e këtij të fundit; hyrja në vilën e rrethuar. Edhe veçoritë e paraqitjes, sidomos këpucët me proka, i shkojnë në për bukuri karakterit të një gruaje që është burrë e grua në shtëpi e jashtë saj, nënë e atë për të bijtë.

Gjithashtu, siç theksuam, Folta, më tepër se çdo personazh, duke përfshirë dhe Genc Bogën, i ka shërbyer shkrimtarit për një lidhje tepër organike e të përligjur të historisë së Mentar Dikës me pamje të jetës shoqërore të kohës, me linjën e tradhtisë së Krist Papit dhe me perspektivën e luftës. Pra, shkrimtari krahas dhënies së një figure me veçori të dukshme individuale, bëri të mundur përmes saj shtrirjen e subjektit dhe pasurimin e brendisë ideore të romanit.

Në mënyrë interesante plotësohet edhe portreti i Genc Bogës. Njoftimet e para për të i marrim nga shpallja që

premtonte shpërblim të majmë për kapjen ose vrasjen e tij. Më tej merret vesh se Genci është i nipi i Foltës, biri i një këpucari të varfër që vuante nga veremi. Përmes retrospektivave njihemi dhe më mirë me pjesë të jetës e me anë të ndryshme të karakterit të tij; me anësinë revolucionare; ndihmën që i jep Veteranit për të dalë nga rrethimi; rivalitetin dashuror e ndeshjen me të birin e pashës; merakun që kish humbur një ballë fishkë; vendosmërinë për të ndëshkuar tradhtinë, pa marrë parasysh lidhjet e gjakut dhe, së fundi, me qëndruesën burrërore e gatishmërinë entuziaste për vazhdimin e luftës. Nga pikëpamja ideore Genc Boga është bartës i një realiteti dhe prirjeje të kohës, i asaj që i thotë një miku i t'et: «E di ti, Genc, që je trashëgimtari ynë e që të përket ty dhe brezit tënd të bëni revolucione më të mëdha?» (f. 179). Dhe lexuesi nuk e ka të vështirë të besojë se ky tip shoqëror ka perspektivë që të zhvillohet më tej, deri në përqaftimin e programit revolucionar, konsekuent, që shpалosën komunistët shqiptarë.

Është me interes të vërehet një veçori e karakterit të Genc Bogës. Nga shpallja qeveritare lexuesi përfytyron një komit të tmerrshëm, kurse ai është një djalë «me pamje vërtet të butë, me ballë e sy si prej vajze, por i fuqishëm (f. 53). Ai është i vendosur të ndëshkojë tradhtinë e kushëririt dhe t'i bëjë pretencën duke i thënë: «Tradhtia nuk shpaguhet» dhe: «Sa më shumë të jetosh, aq më shumë dëme do të bësh, aq më i poshtër do të bëhesh» (f. 227). E, megjithëkëtë, dy net me radhë i shmanget takimit me Krist Papin, sepse e tronit përfytyrimi i vrasjes. Edhe pasi kapërcen ngurrimin, parapëlqen t'i krijojë tradhtarit rrethanën që të përfundojë me vetëvrasje. Kreu i nëntë i librit të tretë (ballafaqimi Genc Boga — Krist Papi) është ndër pjesët më të goditura të romanit që, përgjithësisht, shquhet për kulturë të shkruari. Autori dëshmon se është jeta që e shndërron Gencin nga një i revoltuar romantik në një luftëtar të ndërgjegjshëm që fiton të drejtën t'u japë mësim të tjerëve. «Kur pashë hijen e vdekjes të më ndiqte këmba

këmbës, — i thotë ai Daklesë, — dy herë me radhë e ktheva tytën e pushkës drejt zemrës. Kur e mendoj tashti, them ç'gjë e tmerrshme është ta quash veten të mundur, të biesh poshtë e të dorëzohesh!» (f. 192). Shembulli i tij është ndër faktorët me rëndësi që përtërijnë shpirtërisht Daklenë dhe i japin forcë të qëndrojnë e të hidhet në zjarr.

Kjo veçori karakteri, që e bën të besueshëm e të afërt Genc Bogën, merr rëndësi të posaçme për të theksuar artistikisht idenë se nuk është fuqia fizike, por forca e idealeve ajo që i bën njerëzit trima e të vendosur; se janë rrethanat e shtypjes e të dhunës reaksionare ato që edhe natyra të buta i shtyjnë të bëhen të rrepta dhe të përballojnë vështirësi të pamenduara më parë.

Me hyrjen e Genc Bogës në shtëpinë e Mentar Dikës (një gjetje artistike ca e konsumuar, sidomos në romane e në filma kushtuar Luftës Nacionalçlirimtare) shtimi i hallkave të subjektit, shoqërohet me shtimin e dinamikës së veprimit dhe me kalime të shpejta në vatra të ndryshme veprimi, me përjetime e përthyerje të veprimeve në vetëdijën e personazheve. Ndërsa në librin e parë e të dytë është Mentar Dika, deri diku dhe Daklea, në qëndër të vëmendjes dhe po këta evokojnë ngjarje të së kaluarës, më pas, përveç Gencit, Foltës, Kristit, marrin njëfarë rëndësie edhe personazhe të tjera si Teli Bashari, Lato Morina etj., megjithëse mbeten ca të zbehtë e pa individualitet të spikatur. Pa e larguar vëmendjen prej heroit kryesor e së pari përmes tij, autori hedh shikimin më në gjerësi për të treguar qoftë pasojat rrënuese të kundërrevolucionit, të shtypjes feudo-borgjeze e të krizës ekonomike, edhe premiset e mbështetjen reale në popull të një përtëritje revolucionare. Kjo përsa i përket përmbajtjes, kurse nga pikëpamja e ndërtimit kompozicional, kalohet me anë të këtyre personazheve në ndërthurje linjash në një shtrat kompozicional që vjen e zgjerohet, duke përfshirë qëndrime e veprime personazhesh të ndryshme. E përfshirë në këtë tërësi, edhe figura e Mentar Dikës merr përmasa më reale pa dalë jashtë kua-

drit të kohës e aspiratave të intelektualëve demokratë revolucionarë të asaj periudhe. Sidomos Genc Boga dhe Folta Papi, si karaktere të spikatura, e pasurojnë ndjeshëm tablonë me përthyerje të të njëjtave rrethana në shtresa të ndryshme shoqërore me predispozita demokratike.

Kështu, në tre librat e parë të romanit është paraqitur me vërtetësi, drejt dhe në formë të besueshme e të prekshme ideja që mund të përmbliidhet në fjalët: Telat e violinës «u tërhoqën paralel me tendosjen e nervave të njerëzimit» (f. 195). Me fjalë të tjera: dhunës kundërrevolucionare do t'i përgjigjej patjetër zemërimi, revolta dhe lufta revolucionare dhe, sa më të ashpra e të mprehta të bëheshin kontradiktat, aq më tepër do të tendosej litari që tërhiqnin palët kundërshtarë. Në këtë kuadër është plotësisht i vërtetë historikisht dhe i besueshëm artistikisht edhe Genc Boga.

Më tej, në librin e katërt, shkrimtari ka marrë nisim të tregojë edhe atë që mund të kishte ndodhur. Në parim këtu asgjë të keqe nuk ka. Përkundrazi, letërsia artistike e ka këtë mundësi dhe e gëzon këtë liri. Mirëpo vendi i dhënë betejës është një teprim që i kalon kufijtë e së vërtetës historike dhe, ndoshta, me ndonjë retrospektivë, do të kishte qenë plotësisht e mundshme që karakteret e përfshira në këtë pjesë të gjenin vend natyrshëm në librat e mëparshëm. Kompaktësimi artistik i subjektit do të kishte qenë më i madh, nëse do të shmangeshin edhe disa hollësi të betejës.

Janë me vlerë portretizimet e disa personazheve negative — përfaqësues të rendit shoqëror e shtetëror feudo-borgjez. Përmes tyre autori ka synuar, siç thotë Mentar Dika, të paraqesë ndërthurjen midis fashistëve dhe turkoshakëve. Disa syresh, sado mirë, janë trajtuar kryesisht në rrafsh politik (Hasan Manza, Shaban Sinani) sado që përmes arsytimeve e qëndrimeve të tyre zbulohen aty këtu dhe veçori interesante karakteri. Të tjerë (Veniamin Çeku, Krist Papi) janë dhënë më plotësisht si karaktere njerëzore të dallueshme, kurse reshter Ago Agoja,



patrulla e qenve, Kika me Jonuzin dhe Bido Peshti karikaturizohen brenda manierës standarde të letërsisë së rëndomtë humoristike.

Me rëndësi për tingëllimin ideor dhe për strukturën e romanit janë kapitujt e shkurtër për «njerëzit me të zeza», njerëz — agjentë të fashizmit, «arkitektë, arkeologë, a historianë», instruktorë etj., që kanë mision të vërtetë përgatitjen e terrenit për pushtim ushtarak përmes përhapjes së kulturës fashiste (hotel «Venecia»), rekrutimit të ithtarëve të rinj të fashizmit (tentativa e Veniamin Çekut), veprimtarisë sabotuese kundër elementëve përparimarë e kundërshtarë; përmes nxitjes së organeve të shtetit feudo-borgjez për të ndërmarrë aksione persekutuese e terrorizuese ndaj tyre.

Kapitujt për «njerëzit me të zeza» nuk zënë ndonjë vend të ndjeshëm në roman dhe janë jashtë lidhjeve të drejtpërdrejta kompozicionale, por në lidhje logjike me kapitujt e tjerë. Specialisti me profesion të përcaktuar, që vërtitet nëpër qytet, instruktori (deri dhe Adelaida, e cila shërben në hotel «Venecia») jepnin mundësi të plota që të dilnin jo si rrymë e nëndheshme më vete, por veprimtaria e tyre të përfshihej në tërësinë e jetës politike të kohës si shfaqje e qartë e nënshtrimit të qeveritarëve feudo-borgjezë ndaj imperializmit italian.

Veçimi i kapitujve për «njerëzit me të zeza» të bën të mbetesh me përshtypjen se nuk përputhet efektshëm me të vërtetën historike, me brendinë reale vënë në themel të romanit dhe që pohohet shprehimisht në prologun e tij. Në fakt, «njerëzit me të zeza», pavarësisht prej qëllimeve të mëtejshme (qëllime që kuptohen prej të gjithëve, siç del në roman), aty për aty veprojnë si «dorë e zezë» e regjimit. Në kreun e dhjetë të librit të tretë ata dalin si urdhërdhënës, kur përpiqejnë «një listë me njëzet shtëpi që duheshin rrethuar menjëherë» (f. 222). Ndërmarrja pa vonesë në zbatim të këtij plani është provë e bashkëveprimit zogistë-fashistë dhe e faktit që në këtë bashkëveprim dirigjentë

janë «njerëzit me të zeza». Kështu shfaqen interesa të përbashkëta: Zogu lan hesapet me kundërshtarët, kurse fashistët pastrojnë terrenin prej armiqve të tyre të ardhshëm, «diskreditojnë» bolshevizmin dhe, duke shfrytëzuar pakënaqësitë, mendojnë dhe për kontigjentet e shërbëtorëve të tyre të nesërm. Pra, nuk kishte asnjë arsye të lihej qoftë dhe përshtypja më e zbehtë që regjimi zogist i ndërmerre veprimet represive vetëm nën shtytjen e agjunkturës së fshehtë fashiste, gjë që as shkrimtari nuk ka dashur ta thotë. Po kështu, siç është bërë në kreut e gjashtë të librit të dytë dhe në ndonjë rast tjetër, me ndërhyrje të mençura e të shkathta, do të kishte qenë e mundur të përfshihej në vepër vigjilenca e popullit dhe e komunistëve ndaj depërtimit ekonomik, politik e kulturor të fashizmit, duke nxjerrë në pah më mirë karakterin reaksionar dhe tradhtinë e regjimit të kohës.

Kompozicioni i romanit është kompakt e funksional. Autori ka ditur të piketojë e të shfrytëzojë me mjeshtëri personazhet më përfaqësuese e çastet më vendimtare si shtylla të veprës në pajtim me synimet ideoartistike. Më shtetur në tri grupe personazhesh që hyjnë në lidhje e në konflikte shoqërore, politike vetjake në mes tyre, ai ka mundur të pasqyrojë në vijimësi kohore deri diku dhe me gjerësi përfshirëse dy etapa të zhvillimit historik brenda një periudhe të shkurtër, në një mjedis të vetëm. Në roman ndiqet natyrshëm jeta e personazheve dhe po kaq natyrshëm kalohet nga shqetësimet e përditshme e marrëdhëniet intime të tyre në interesimet e veprimtarisë shoqërore politike. Kështu, Mentar Dika është përdorur me efekt për shpallësin e gjendjes para e pas shtypjes së revolucionit; Folta Papi si ndër-lidhëse për vijimin e shtririen më në gjerësi të subjektivit, kurse Genc Boga si elementi vendimtar i kalimit në pikën kulmore të kundërshtimi veprues ndaj dhunës feudo-borgjeze. Vetëm afrimi fillestar Mentar-Genc është i rastësishëm, por jo pa logjikë e pa vijimësi të mëvonshme të përligjur. Në themel e në tërësi vendosen dhe përdoren mirë në roman lidhjet e ndërsjellta mes per-

sonazheve, ballafaqimet e ndeshjet mes palëve kundër-shtare. Këto ballafaqime e ndeshje kanë kontekst logjik e rrethanor të besueshëm, ngjarjet përcaktuese vijnë si domosdoshmëri në subjekt dhe në fatet e karaktereve shoqërore.

Gjithësesi, romani «Vila në periferi» është një vepër me vlera të dukshme njohëse, edukuese e ku spikatin disa veçori stili e ndërtimi kompozicional që dëshmojnë se Ali Abdihoxha vazhdon të jetë ndër shkrimtarët tanë prodhimitarë dhe me arritje të reja.

1984

## P Ë R M B A J T J A

### I. PROFILE SHKRIMTARËSH (Studime)

Vepra letrare e Shevqet Musarajt .....	5
Vepra letrare e Dhimitër S. Shuteriqit .....	50
Tri novela të Zihni Sakos .....	94
Tipare dhe veçori të një prozatori .....	113

### II. SHËNIME KRITIKE PËR VEPRA LETRARE

Tre hapa të një poeti (poema «Nënë Shqipëri») .....	240
vëllimi «Fjala gdhend gurin» dhe vëllimi «Udhëtoj i menduar», të D. Agollit) .....	255
«Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo» .....	276
Idetë e qarta mishërohen në figura realiste .....	291
Paralele dhe kontraste të kohës .....	299
«Juga e bardhë» .....	313
Mësime pas shtypjes së një revolucioni .....	331